



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË

DHJETOR 2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

Pasqyra e Lëndës

Nr.	EMËRTIMI	Faqet
1	Përmbajtja	2
2	I.1. Përmbledhje Ekzekutive	3-12
3	I.2 Opinioni i Auditimit	13
4	Përmbledhje	14-22
5	A. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit	23-27
6	B. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit	28-43
7	C. Auditimi i llogarive për periudhën 01.01.2017-31.08.2018.	44-136
8	D. Gjetjet nga auditimi, impakti te pasqyrat financiare dhe rekomandimet përkatëse.	137-151
9	ANEKSET.	152
10	Aneksi I. “Qasja dhe metodologjia e auditimit”.	152
11	Aneksi II. “Llojet e opinionëve të aplikuara nga KLSH”.	153
12	Aneksi III. “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.	154-158
13	Aneksi IV. “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.	158



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

I.1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Tiranë.

“Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” SHA (këtu e më poshtë UKT), ka formën e shoqërisë aksionare me dy nivele, është themeluar me akt-themelimin e datës 05.12.2000, të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, është regjistruar si person juridik me vendimin e Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 24875 datë 28.12.2000 dhe vepron në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ka për objekt aktiviteti kryerjen e shërbeve publike në fushën e furnizimit dhe të shitjes së ujit të pijshëm për konsumatorët. Më datë 27.09.2017, shoqëria është riorganizuar sipas sistemit me një nivel me Këshill Administrimi.

Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë, të cilat kanë ndikim në Opinionin e Auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2017, u konstatua se:

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstatua se audituesit e pavarur të pasqyrave financiare, nuk kanë dorëzuar dokumentin Letra për Drejtimin e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 4767 prot., datë 08.02.2018.

Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr. 1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA. Nga auditimi i dokumenteve të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të KLSH janë konstatuar parregullsi të shumta, si p.sh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionin të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar.

-Për llogarinë Aktive Afatgjata Jomateriale përfshin edhe llogarinë “Emri i mirë” në vlerën 717,064 mijë lekë, të njohur nga përthithja e fiskal njësisë H L SHA. Gjatë vitit 2017 UKT SHA nuk ka njohur zhvlerësim për këtë zë të bilancit i cili në bazë të SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve” duhet të testohet për vlerën e tij çdo vit.

-Për llogarinë “Aktive Afatgjata Materiale” përfshin vlerën 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorët të AKUK (ish-DPUK). Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga UKT SHA nuk krijohet besueshmëri e arsyeshme në lidhje me vlerën 1,026,003 mijë lekë.

-Për llogarinë “Inventarët” përmban vlerën e materialeve tërësisht apo pjesërisht të vjetëruar për shkak të kohës dhe ndryshimeve teknologjike në vlerën 81,275 mijë lekë. Ndërkohë që vlera e zhvlerësimin të inventarëve është 44,017 mijë lekë. Në bazë të SNK 2 “Inventarët” duhet të llogaritet shuma e zhvlerësimit shtesë por në bazë të dokumentacionit të venë në dispozicion grupi i auditimit nuk mund të llogaritet dhe mund të sillte pasoja mbi vlerën e inventarëve dhe rrjedhimisht në vlerën e rezultatit në pasqyrat financiare të konsoliduara.

-Për Llogari të arkëtueshme me vlerën 2,690,010 mijë lekë konstatohet se UKT SHA ka përdorur si metodologji çmuarjen dhe zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

çdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 39, standard i cili kërkon vlerësim individual për llogaritë e arkëtueshme individualisht dhe vlerësim kolektiv për llogaritë e tjera bazuar në të dhëna të plota historike.

-Për llogarinë “Huamarrje afatshkurtra” në vlerën 1,804,645 mijë lekë, një pjesë e kësaj shume (vlera 1,205,077 mijë lekë) nuk është kontabilizuar në monedhën origjinale por vetëm në lekë dhe për pasojë nuk reflektohen ndryshimet në vlerë si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit në datën 31.12.2017, në kundërshtim me SNK 21 “Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit”.

-Për llogarinë “Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime” me vlerë 465,222 mijë lekë, nga të cilat 463,122 mijë lekë grante afatgjata, 1,777 mijë lekë grante afatgjata rrjet kanalizime dhe 323 mijë lekë grante dhurata pajisje informatike. Nga informacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se është i pamjaftueshëm për shprehjen e një sigurie të mjaftueshme në lidhje me këto vlera.

-Për sa i përket detyrimeve tatimore konstatohet se në datë 28.05.2018 Drejtoria e Përgjithshme ka lëshuar raportin e kontrollit tatimor për periudhën deri në 20.11.2017 (përpara ndarjes së shoqërisë), detyrimi që ka rezultuar nga ky akt kontroll dhe e konfirmuar edhe nga Komisioni të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 është 13,116 mijë lekë. Shoqëria mëmë nuk ka paraqitur në pasqyrat e konsoliduara të datës 31.12.2017 nuk ka reflektuar këtë ngjarje pas datës së bilancit e cila do të ndryshojë rezultatin financiar.

-Në seksionin e kapitalit të shoqërisë mëmë përpara ka qenë e përfshirë rezerva e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë lekë, ndërkohë që me krijimin e shoqërisë së re të UKT SHA pjesa e tepicës së rivlerësimit që i takon kësaj shoqërie i është bashkuar kapitalit aksioner duke e rritur atë. Kjo mënyrë rritje kapitali nuk është e parashikuar në asnjë nga format e rritjes së kapitalit në kundërshtim me Kapitullin Zmadhimi i Kapitalit dhe nenet përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Gjithashtu teprica e rivlerësimit duhet të evidentohet më vete sipas kërkesave të SNK 16 “Aktiveve Afatgjata Materiale” dhe të përdorej në vijim në përputhje me kërkesat e këtij standardi. Ne nuk jemi në përputhje kërkesat e këtij standardi.

-Bazuar në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare të konsoliduara menaxheriale, raporti i ndarjes së shoqërisë është bazuar mbi pasqyrat financiare të shoqërisë të datës 31.12.2016 (të pa audituara).

-Bashkia Kamëz nuk ka pranuar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve të shoqërisë UKT SHA “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionerëve Bashkia Vorë dhe Kamëz nga UKT SHA” dhe ka hapur proces gjyqësor për pavlefshmërinë e këtij vendimi. UKB Kamëz nuk ka marrë në dorëzim asetet dhe ato vazhdojnë të paraqiten në pasqyrën pozicionit financiar të UKT. Në datën 21.03.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin e pjesës së kërkesës padisë. Në datën 26.04.2018 ky vendim është ankimuar nga UKT SHA. Duke qenë se nuk është marrë akoma një vendim i formës së prerë nga gjykata.

-Grupi i auditimit ka shkuar në inspektim në magazinën e UKT SHA në Brar dhe u konstatua se kjo magazine ka një numër shumë të madh artikujsh dhe gjendja dhe organizimi i saj nuk linte mundësinë e identifikimit të artikujve pasi janë pa barkode dhe jo të vendosura nëpër rafta. Grupi i auditimit shpreh rezerva në lidhje me procesin e inventarizimit të kryer në këtë magazine dhe përputhjen e vlerës kontabël (vlerës në bilanc) me atë fizike.

-Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të shoqërisë UKT SHA nuk është pasqyruar vlera e kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakord për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

-Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve mbahen jashtë programit financiar por në Excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël.

-Në magazinat e UKT SHA ka pjesët rezervë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”, të lëna në ambientet e magazinës pa u bërë hyrje, pa u marrë në dorëzim nga përgjegjësi i magazinës dhe pa asnjë dokumentacion dëshmuës. Nuk ka asnjë dokument ku të trajtohet se si janë apo kush i ka sjellë këto materiale, si dhe kush i ka pranuar në magazinë pa kryer veprimet ligjore.

Gjetjet kryesore të konstatuara në auditimin e kryer në UKT, të cilat kanë ndikim në Opinion e Auditimit të Përputhshmërisë, janë si më poshtë vijon:

Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 16 masa dhe 1 masë nuk është pranuar.

-Për shpërblim dëmi janë lënë 11 rekomandime, nga të cilat, 9 masa janë zbatuar dhe 2 masa nuk janë pranuar.

-Nga masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të rekomanduara gjithsej 1 masë, e cila është zbatuar.

-Janë rekomanduar 15 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 3 masa administrative, të cilat janë zbatuar.

Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomik-financiar.

-Nga auditimi mbi prodhimin dhe faturimin e ujit, u konstatua se për vitin 2017 janë prodhuar gjithsej 100 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 35 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në **humbje teknike në masën 65% e ujit të prodhuar, duke e tejkaluar nivelin e humbjeve të miratuar në masën 62%**. Ndërsa për periudhën Janar – Gusht 2018, janë prodhuar gjithsej 63 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 23 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në **masën 63%** të ujit të prodhuar, brenda nivelit të humbjeve të miratuar në **masën 63.3%**.

-Nga auditimi mbi faturimin dhe arkëtimin e ujit, konstatohet se niveli mesatar i arkëtimit për faturat koherente është 61% të faturimit. Ndërsa për nivelin e arkëtimit në total për çdo muaj, konstatohet se niveli i arkëtimeve për vitin 2017 në masën 133% ndërsa për periudhën janar-gusht 2018 është në masën 124%. Nga sa më sipër konstatohet se, **UKT arkëton më shumë detyrime të prapambetura se detyrime koherente.**

-Nga auditimi i debitorëve konstatohet se deri më datë 31.12.2017, shoqëria ka në total 79,425 abonentë debitorë nga 237,245 abonentë në total (**33% e totalit**), të cilët i detyrohen shoqërisë UKT SHA vlerën 4,070,632,815 lekë. Kjo vlerë, e cila është relativisht shumë e lartë, për arsye se është e barabartë me **125% të të ardhurave nga shitjet e shoqërisë**, pasqyruar në pasqyrat financiare. Ndërsa deri më datë 31.07.2018, shoqëria ka në total 82,333 abonentë debitorë nga 249,792 abonentë në total (**33% e totalit**), të cilët i detyrohen shoqërisë UKT SHA vlerën 4,251,993,560 lekë.

-Nga verifikimi i listave të debitorëve të datës 31.07.2018, konstatohet se 11 debitorët (*ato me vlerë detyrimi mbi 5 milion lekë*) me vlerë më të lartë dhe që përbëjnë në total 2% të debisë, konstatohet se *debitori më i madh është shoqëria “Rezidenca Studentore Nr. 1 Tiranë” SHA*, shoqëri publike aksionet e të cilës zotërohen 100% nga Bashkia Tiranë (që është njëkohësisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

aksionari i UKT SHA) dhe që detyrimi i saj vetëm për 3 godina është në vlerën 21,029,264 lekë. Gjithashtu në listën e debitorëve më të mëdhenj janë dhe 2 institucione të tjera si Qendra Universitare Spitalore “Nënë Tereza” në vlerën 18,237,403 lekë dhe Banka e Shqipërisë në vlerën 10,161,943 lekë. Lista e debitorëve më të mëdhenj vazhdon me subjekte private “B.T” SHA me detyrim në vlerën 12,776,179 lekë, “A.H” SHA me detyrim në vlerën 10,392,406 lekë, “A.” SHPK me detyrim në vlerën 6,733,684 lekë, “H.H.T” me detyrim në vlerën 5,996,915 lekë, “I.B” me detyrim në vlerën 5,928,777 lekë dhe “F.E.E” me detyrim në vlerën 5,043,989 lekë.

-Nga auditimi i masave administrative (gjobat) të vendosura dhe arkëtimit të tyre, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë vendosur gjithsej 497 gjoba në vlerën 14,024,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 232 gjoba në vlerën 4,914,000 lekë dhe mbeten pa arkëtuar 265 gjoba në vlerën 9,110,000 lekë, që përbëjnë 65% të totalit të gjobave të vendosura, duke shkaktuar rritje të mëtejshme të debisë, çka përkthehet **në të ardhura të munguara për shoqërinë.**

Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe raportimit të programit ekonomik-financiar u konstatua se ka zëra të cilët ka patur tejkalime të vlerave të miratuara, si më poshtë vijon:

-Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2017 që përfshin arkëtimin nga ndryshim emri, librezat, tarifë shërbimi dhe vlera e kontratave të reja është planifikuar 682 mln lekë dhe është realizuar 819 mln lekë, pra kemi një realizim me 120 % kundrejt planifikimit vjetor.

-Zëri materiale të para është realizuar në total 118 %, i cili paraqet tejkalim vetëm në zërat tuba, rakorderi, Kimikate dhe karbon aktiv.

-Zëri Roje Objektesh – Plani 330 mln lekë, fakti 346.5 mln lekë ose 105 % që përfshin pagesat e detyrimeve për rojet e objekteve ndaj firmave private me të cilët janë lidhur kontrata.

-Zëri Qira zyra – Plani 22 mln lekë, fakti 27.1 mln lekë ose 126 % që përfshin shpenzimet e kryera, për ambiente me qira për njësitë dhe zyrat e marrëdhënieve me konsumatorin dhe të arkëtimit.

-Zëri Kancelari – Plani 9 mln lekë, fakti 11 mln lekë ose 123 %, që përfshin shpenzime kancelarie për nevojat e shoqërisë.

-Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike – Plani 8 mln lekë, fakti 31.9 mln lekë ose 3924%, që përfshin shpenzimet e kryera për konsulencë nga jashtë, eksperti kontabël për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, studimin e fizibilitetit të digës së Liqenit Artificial Tiranë, studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lana Bregas, vlerësimin teknik të rrjetit të UKT.

-Zëri Shpenzime postare – Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.4 mln lekë ose 198.7% që përfshin shpenzime postare për administratën.

-Zëri Shërbime bankare – Plani 6 mln lekë, fakti 18.6 mln lekë ose 311% që përfshin komisionet e paguara në bankë dhe disbursimet për kredinë e Shën Mërisë si dhe komisionet bankare për kredinë Japoneze.

-Zëri Shërbime të përgjithshme – Plani 4 mln lekë, fakti 18.6 mln lekë ose 464.8%. Në këtë zë përfshihen të gjitha shpenzimet e tjera që kryen shoqëria si azhurnime rrjeti, shpenzimet për mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta, shpenzimet e kryer për përmbaruesit në vlerën 3.45 mln lekë dhe lyerja dhe mirëmbajtja e ambienteve të Njësisve 1 dhe 2 në vlerën 5.76 mln lekë.

-Zëri taksa vendore dhe pasurie – Plani 3 mln lekë, fakti 4.6 mln lekë ose 154.3%. Ky ndryshim niveli ka ardhur si pasojë e hapjes së ambienteve të reja të shoqërisë gjatë këtij viti.

-Zëri taksa për automjetet – Plani 1.5 mln lekë, fakti 1.61 mln lekë ose 107.4% që përfshin pagesën vjetore për automjetet e shoqërisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Zëri Gjaba penalitete dhe dëmshpërblime,- Plani 20 mln lekë, fakti 64.5 mln lekë ose 322.3%.Tejkalimi i këtij zëri vjen si rezultat i zërit provizione për çështjet gjyqësore, i cili përfshin dëmshpërblimet për të larguarit nga puna dhe për pavlefshmëri titujsh ekzekutiv.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

-Për vitin 2017, Këshilli Mbikqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime. Referuar statutit të mëparshëm të shoqërisë i miratuar me vendimin nr. 14, datë 31.08.2016 neni 19, pika 2 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, përcaktohet se Këshilli Mbikqyrës do të mblidhet jo më pak se 3 herë në vit me intervale jo më të gjata se 4 muaj dhe në mënyrë të jashtëzakonshme sa herë të vlerësohet si e nevojshme nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose kurdo që të kërkohet nga një e treta e Këshillit Mbikqyrës ose Drejtori i Përgjithshëm. Referuar mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës nuk është respektuar intervali i rregullt i mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës së UKT sh.a, sepse mbledhja e parë për vitin 2017 është kryer më datë 06.07.2017, në kundërshtim me neni 19, pika 2, të statutit të mëparshëm të shoqërisë.

-Për vitin 2017, Këshilli Mbikqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime dhe përkatësisht në datat 06.07.2017, 25.09.2017, 13.12.2017. **Vlera 1,515,600 lekë**, që përbën pagesën e kryer për Këshillin Mbikqyrës për 9 muajt që ky organ kolegjal nuk është mbledhur, përbën **shpenzim jo efektiv** për UKT SHA, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, pika 8.

-Këshilli i Administrimit i UKT SHA, ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2017, me vendimin nr. 09, datë 04.07.2018, me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33/1.

-Për periudhën 01.01.2018-31.08.2018 Këshilli i Administrimit është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 12 vendime. Referuar statutit të shoqërisë nr. 16/2, datë 14.12.2017, neni 14, pika 1, “Këshilli i Administrimit duhet të mblidhet jo më pak se 1 herë në muaj”, ndërsa në pikën 6 të po këtij neni përcaktohet se: “Këshilli i Administrimit mban një regjistër për pjesëmarrjen i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e pranishëm në mbledhje”. Përsa më sipër nuk konstatohet një regjistër pjesëmarrje të nënshkruar nga anëtarët e pranishëm për secilën mbledhje dhe as respektim i intervalit kohor të mbledhjes së Këshillit të Administrimit 1 herë në muaj, në kundërshtim me statutin e shoqërisë nr. 16/2, datë 14.12.2017, neni 14, pika 6.

Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë e ankimuar, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën 01.04.2017-31.12.2017, janë humbur 112 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **46,099,758.40 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore dhe për periudhën 01.01.2018-31.08.2018, janë humbur 53 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **32,300,969.16 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **78,400,727.56 lekë**, **vlerë e cila përbën dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi për buxhetin e shoqërisë.**

Gjithashtu konstatohet se janë në proces gjykimi (në Gjykatën e Apelit) dhe 39 çështje të tjera, për të cilat kërkohet vlera **17,602,000 lekë**, vlerë e cila do të rëndojnë akoma më shumë rezultatin ekonomik-financiar të UKT.

-Me anë të Urdhrave të Brendshëm nr. 720, datë 01.11.2016 dhe nr. 58, datë 24.01.2018, është urdhëruar ndryshimi i orarit zyrtar të punës së shoqërisë nga Hëna deri në të Enjte do të jetë 08.00-16.00, ditën e Premte 08.00-14.00 dhe ditën e Shtunë 08.00-12.00. Sipas këtyre



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

urdhrave konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018, gjatë ditëve të javës punonjësit e shoqërisë kanë punuar 36 orë në javë, ndërsa 4 orët e mbetura janë zëvendësuar ditën e shtunë, duke punuar 4 orët të plota. Por zëvendësimi i kryer gjatë ditës së shtunë, e cila është një nga ditët e pushimit javore dhe si e tillë duhej kryer me një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 (32 javë) dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018 (17 javë), për një total prej 49 javësh, punonjësit e administratës së shoqërisë janë paguar me 1 orë më pak në javë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1.

-Gjithashtu në pikën 1/b, të nenit 8, të Rregullores së Brendshëm të shoqërisë, përcaktohet i njëjti orar, i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1, për arsye se nuk parashikohet një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës.

-Në 4 raste, është shtyrë ndërprerja e marrëdhënieve të punës për punonjës të shoqërisë pas mbushjes së moshës së daljes në pension, në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 4, e cila përcakton se: “*Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në zbatim të dispozitës së mësipërme ligjore, me mbushjen e moshës së daljes në pension, nga UKT duhej kryer ndërprerja e marrëdhënieve të punës.*

-Nga auditimi i rekrutimit të punonjësve, konstatohet se në zbatim të nenit 7/a, të Rregullores së Brendshëm, rekrutimi i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Punës. Duke qenë se Kodi i Punës nuk përcakton se si duhet të kryhet rekrutimi i punonjësve, UKT ka hartuar një pyetësor për procedurat e rekrutimit dhe dokumentacionin që duhet paraqitur nga punëmarrësit. Por kjo rregullore nuk parashikohen procedura mbi shpalljen e vendeve vakante, por vetëm të atyre personave që kanë dorëzuar pranë Burimeve Njerëzore të shoqërisë kërkesë për punësim.

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë dhënë shpërblime në 3 raste (1 për festat e fundvitit dhe 2 me rastin e 8 marsit), vetëm me urdhrat e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, pa u marrë më parë miratimet në Këshillin Mbikëqyrës (Këshillin e Administrimit), në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1.

-Nga auditimi me zgjedhje për 37 dosje personeli u konstatua se: në 5 raste (3 nga këto staf drejtues), mungonte dëshmia e penalitetit; në 4 raste (2 nga këto staf drejtues), mungonte jetëshkrimi (C.V); në 4 raste, mungonte adresa e punëmarrësit; në 4 raste (të gjithë staf drejtues), mungonin kërkesat për punësimin të punëmarrësve; dhe në 6 raste (të gjithë staf drejtues), mungonte raporti mjekësor që është i aftë për punë për punëmarrësit. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën Kolektive nr. 1902/1, datë 03.06.2013, neni 13 dhe Kontratën Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018, neni 8.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave.

Nga UKT janë kryer procedura prokurimi, të cilat kanë rezultuar në marrëdhënie kontraktuale me transaksione në vlera të rëndësishme me palë të treta, bazuar në vlerën e materialitetit të përlllogaritur (**365,464,680** lekë), nga të cilat janë audituar 9 procedura prokurimi, në vlerën totale 527,585 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Pavarësisht nga sa cituam më sipër, nga auditimi i këtyre procedurave u konstatuan, shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon:

-Në 5 raste është konstatuar vendosja e specifikimeve teknike kufizuese për mallrat që do prokurohen, duke mos i argumentuar vendosjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në 6 raste, përlllogaritja e vlerës së kontratës është kryer në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, për arsye se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së OE për studimin e tregut, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE.

-Në 9 raste janë vendosur kërkesa dhe kriteret për kualifikim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 20, 26, 27 dhe 28.

-Në 2 raste nuk është argumentuar vendosja e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 9 raste, Raporti Përmbledhës është hartuar në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, për arsye se nuk përmban gjithë informacionin e kërkuar si numër reference, përshkrim i mallrave/shërbimeve/punëve që do prokurohen, si dhe informacion mbi ankesat.

-Në 3 raste procesi i vlerësimit është kryer në tejkallim të afatit kohor prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 2.

-Në 7 raste, procesi i vlerësimit është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Tuba dhe Rakorderi”, viti 2018, konstatohet se nga ana e KVO janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), ku me OE “A.” SHPK lidhet kontrata, pavarësisht se ka të njëjtat mangësi për skualifikim me OE “M.” LTD SHPK. Për pasojë, **vlera 489,053 lekë**, që përbën diferencën midis OE “M.” LTD SHPK të skualifikuar për të njëjtat mangësi që ka OE i shpallur fitues dhe ofertës së “A.” SHPK (dhe që përbëjnë devijime materiale që nuk ndikojnë thelbësisht në zbatimin e kontratës) të shpallur fitues (plus TVSH), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 dhe neni 53, pika 3 dhe pika 4. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarët e NjP në cilësinë e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës: M.Q, L.R, E.T, A.Q, I.M dhe A.S.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje makineri pajisje (automjete), viti 2018, konstatohet se z. M.Q, i cili ka qenë në pozicionin e kryetarit të KVO për të dy procedurat, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), në dy procedura të ndryshme, ku të njëjtën mangësi e kualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i linjes DN-150mm gizë dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, ndërsa e skualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje makineri pajisje (automjete)”. Në këto kushte **vlera 180,000 lekë**, që përbën diferencën midis BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK të skualifikuar në kundërshtim me LPP dhe ofertës së OE “L.” SHPK të shpallur fitues (41,050,000 - 40,900,000 + tvsh), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**. Për sa më sipër përgjegjësia kryesore mbi këtë veprim mban kryetari i KVO M.Q.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Software (program) dhe pajisje për leximin e matësve të ujit, për UKT sha”, viti 2017, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, **është**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

konstatuar efekt financiar negativ me vlerë 7,872,000 lekë, që i përket zërit të pajisjeve “**Telefona për aplikacionin**”, të prokuruar me anë të kësaj procedure, me arsyetimet si më poshtë vijon:

-Sipas pikës 3.3 të nenit 3, të kontratës së shërbimit nr. 4050/7, datë 22.05.2017, specifikimet teknike kërkuara për këtë pajisje janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

-Sipas dokumentacionit teknik (katalogët) të paraqitur nga OE “J.S” SHPK, konstatohet se produkti i kërkuar nuk është i njëjtë për 1 kriter (dimensionet) me produktin e ofruar, si dhe për 3 kritere nuk provohet përputhshmëria duke qenë se nuk ka të dhëna për to në produktin e ofruar.

-Pajisjet e ardhura janë të markës “U..”, model “A..”, nga krahasimi i të dhënave teknike të këtyre pajisjeve nga faqja zyrtare e shoqërisë (<http://U...com/products/A../spec.html>), me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë, konstatohet se:

- Dimensionet e kërkuara për produktin janë 142.5mm*75mm*13mm, ndryshojnë nga dimensionet për produktin e ofruar janë 148.9*75.8*12.5mm, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
- Për 3 specifikime të kërkuara (Operating Temp.; Storage Temp.; dhe Ekstra), nuk konstatohen të dhëna në katalog, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kritere.
- Për të dhënat e Network, pajisja e ofruar nuk disponon 4G – 700MHz.
- Pajisja e ofruar nuk konstatohet të disponojë “Distance Sensor”.

-Në Akt-Kolaudimin nr. 276/1, datë 25.05.2017, grupi i marrjes në dorëzim të kontratës, nuk është shprehur në asnjë moment të dhënat që ndryshonin dhe mungonin në katalogun e ofruar.

-Këto pajisje kanë mbi 1 vit që përdoren nga UKT.

-Me anë të observacioneve të dërguara me shkresën nr. K-4272/14, datë 16.11.2018, në zbatimin të rekomandimit të lënë nga KLSH, titullari i AK me Urdhrin nr. 521, datë 20.10.2018, ka ngritur një grup të ri kolaudimi, i cili me anë të relacionit nr. 4521/1, datë 29.10.2018, ka vendosur që edhe pse ka mos përputhje për specifikimet teknike të konstatuara nga grupi i auditimit, ato janë të papërfillshme dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin dhe performancën e pajisjeve të prokuruar, si dhe që nga momenti i blerjes dhe deri më këtë datë, aparaturat kanë qenë në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, duke qenë se leximet mujore kryhen pikërisht nga këto aparatura.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të kolaudimit A.Q, E.I dhe S.Zh.

Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.

-Nga kontrolli tatimor i kryer në UKT Sh.a janë nxjerrë detyrime për TVSH në vlerën **2,000,417 lekë** si edhe i është vendosur gjoba me vlerë **611,374 lekë** për TVSH e padeklaruar. Janë nxjerrë detyrime mbi tatim fitimin në vlerën **257,579 lekë** si dhe është vendosur gjoba me vlerë **150,894 lekë** për tatim fitimin e padeklaruar. Janë nxjerrë detyrime mbi tatimin në burim në vlerën **682,030 lekë** si dhe është vendosur gjoba me vlerë **657,736 lekë** për tatimin e mbajtur mbi burim dhe të padeklaruar. Shuma prej **1,420,004 lekë**, paguar për gjodat dhe interesat e vonuara kanë shkaktuar efekt ekonomik negativ për UKT.

-Nga kontrolli fizik i tollonave që mbaheshin në kasafortën e magazinës ishte që nga numërimi i tyre rezultoi se 110 litra naftë, me vlerë 20,108 lekë, ishin të pavlefshëm pasi nuk kishin Bar Code, duke i bërë të pavlefshëm pasi ato nuk pranohen nga pikat e furnizimit. Vlera **20,108 lekë** përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë.

Gjithashtu u konstatua se 100 litra nuk ishin të UKT pasi ishin me logo të institucioneve të ndryshme, një fenomen ky i pa justifikuar sesi kanë përfunduar te kasaforta e UKT. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për këto 100 litra naftë me vlerë **18,280 lekë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Nga auditimi i shpenzimeve për kompanitë telefonike ka rezultuar se deri më datën 31.08.2018 kur mbaroj auditimi rezultoi se për UKT Sh.a detyrimi në total ndaj kompanive celulare është **343,241 lekë**, detyrime nga punonjësit e larguar. Kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë.

-Nga kontrolli në magazinën e UKT është konstatuar një sasi e konsiderueshme litar amianti e cila ishte e papërdorur asnjë herë nga UKT. Në vitin 2011 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 1,200 kg litar amianti me vlerë 1,170,000 lekë. Deri më datën 20.10.2017, kur ky mall është propozuar për jashtë përdorimit, nga sasia prej 1,200 kg janë përdorur vetëm 72 kg. Mos përdorimi i këtij produkti ka bërë që në magazinë të jenë në gjendje stoku 1,128 kg në vlerën **1,104,280 lekë**, vlerë kjo e cila ka sjellë **efekt negativ financiar** për buxhetin e UKT SHA.

-Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël, për vitin 2017 është konstatuar problematika e copëzimit të fondit për blerje pjesë këmbimi automjeteve ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,618,057.6 lekë dhe për blerje materiale ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,328,659 lekë, veprime këto në kundërshtim me nenin nr. 40 dhe nenin nr. 59, të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si edhe nenin 28 dhe 29/5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

-Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël, është konstatuar se në tre raste për operatorët ekonomik fitues mungon vërtetimi nga OSHEE për mospasjen e asnjë detyrimi të maturuar për pagesën e energjisë elektrike edhe pse nga titullari është konsideruar se mos-dorëzimi i një prej dokumenteve të kërkuara, është kusht për skualifikimin e operatorit fitues.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje elektropompë”, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik fitues “A&G” Sh.p.k është 330,000 lekë pa TVSH. Në datën 15.02.2017 është bërë Akt-Kolaudimi për mallin e dorëzuar në ambientet e UKT. Nga shqyrtimi i dosjes të procedurës së prokurimit është konstatuar se me faturën tatimore me nr. 37, datë 15.02.2017 për këtë elektropompë është paguar shifra 365,000 lekë pa TVSH (438,000 lekë me TVSH), kur oferta e OE ishte 330,000 lekë pa TVSH, pra është paguar më shumë dhe në mënyrë të pajustificuar më shumë vlera **42,000 lekë** me TVSH, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e UKT SHA**.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

-Nuk konstatohet dërgimi pranë Ministrisë së Financave i deklaratës së cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit të komponentëve të MFK për vitin 2017 nga nëpunësi autorizues në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimeve të Ministrisë së Financave në zbatim të tij.

-Nga Drejtoria Ekonomike nuk konstatohen propozime mbi politikat financiare dhe dërgimi i tyre për miratim, përgatitja e raportit vjetor mbi funksionimin e MFK-së dhe as mbikëqyrja e raporteve financiare që janë përgatitur nga shoqëria, për vitin 2017 në kundërshtim me nenin 159 të rregullores së brendshme të shoqërisë UKT SHA, miratuar me (Miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha nr. 7, datë 04.04.2016) dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 111, datë 24.02.2017 “Për hartimin e planit vjetor të punës për vitin 2017 me afat raportimi 1 mars 2017 për planin dhe regjistrin e riskut.

-Në këtë shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Gjithashtu konstatohet se nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit të përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtja e tyre dhe IA..mi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

Më hollësisht trajtuar në pikën D. Gjetjet, impakti te pasqyrat financiare dhe rekomandimet.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

I.2. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për Opinionin e auditimit të Pasqyrave Financiare.

Ne kemi kryer auditimin financiar mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Tiranë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Tiranë për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 17001 dhe ISSAI 12002 shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Tiranë duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore”.

Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200):

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion i kualifikuar me rezervë: Nga auditimi mbi përputhshmërinë i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Tiranë, rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) në administrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur *nga gabime materiale*, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar me rezervë*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

PËRMBLEDHJE

Hyrje:

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Tiranë (këtu e më poshtë UKT), në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 893/1, datë 31/07/2018, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, dhënia e opinionit (viti 2017) për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të aktivitetit ekonomik të mbyllur më datë 31.12.2017.

Informacion i përgjithshëm:

Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA (këtu e më poshtë UKT), ka formën e shoqërisë aksionare me dy nivele, është themeluar me akt-themelimin e datës 05.12.2000, të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, është regjistruar si person juridik me vendimin e Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 24875 datë 28.12.2000 dhe vepron në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ka për objekt aktiviteti kryerjen e shërbeve publike në fushën e furnizimit dhe të shitjes së ujit të pijshëm për konsumatorët. Më datë 27.09.2017, shoqëria është riorganizuar sipas sistemit me një nivel me Këshill Administrimi.

Objekti i veprimtarisë së Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së UKT, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre, janë të rregulluara me anë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe Statutit të shoqërisë miratuar me vendimin nr. 8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve.

-Veprimtaria e administratës është e përcaktuar me anë të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha nr. 7, datë 04.04.2016, si dhe Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018.

Adresa e UKT është Rruga “5 Maji”, Tiranë. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore të rrethit Tiranë me NIPT L72320033P.

Numri i punonjësve në fund të periudhës së audituar është 1230 punonjës, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 07, datë 04.07.2018.

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Objektivat e auditimit:

“Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, të dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion”.

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Baza Ligjore:

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”

-INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

-Në praktikat më të mira të fushës si: (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC; Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve); Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar”; Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimite përdorimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar; Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjiellës Kanalizimeve SHA””; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të shoqërisë.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:

A.S me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, është përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar (SNK dhe SNRF) dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Gjithashtu drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Institucionit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Institucionit.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (*apo në përputhje*) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programonim procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Baza për Opinionin

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet, KLSH është e pavarur nga Institucioni dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë. (*Aneksi II*)

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:

Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare në Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA, është realizuar në mbështetje të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipër cituara si edhe shoqërohen me relacion



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

shpjegues. (pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare).

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i auditimit, për vitin 2017 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, vlerën **365,464,680** lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

-Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në ndërmarrje nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin tërë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisë ekonomike nuk mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

-Konfirmim nga të tretët:

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

-Kontabiliteti:

Në nenin 10 të Ligjit nr. 9228, dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (SNK).

Nga auditimi është konstatuar se hartimi i pasqyrave financiare kryhet sipas rregullave kontabël duke u bazuar në parimin e kontabilitetit rrjedhës.

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur para ja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t’u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël si dhe në inspektime fizike në magazinën e kryesore në Brar. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. Kontrolli i vlerësimit përfshin gjithashtu ri-vlerësimin i cili është një proces që identifikon saktësinë e veprimeve të kryera nga stafi drejtues dhe teknik i shoqërisë UKT nëpërmjet ri-llogaritjes nga stafi i auditimit të KLSH-së për çështje të cilat zgjidhen për t’u audituar.

5. Konfirmim nga të tretët.

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduar*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion i kualifikuar (me rezervë):

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Tiranë për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; pozicioni financiar, performanca, ndryshimet në kapital, flukset e mjeteve monetare janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe SNK.

E gjujkojmë të arsyeshme të konstatojmë, se ka probleme për çështje specifike për të cilat duhet të japim një paragraf shpjegues mbi rezervat që kemi.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 17001 dhe ISSAI 12002 shprehim një opinion të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

kualifikuar për llogaritë vjetore të “Ujësjellës Kanalizime” SHA Tiranë duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore”.

Bazat për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionin me rezervë:

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se menaxhimi i subjektit, mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare nëse atij nuk do t'i vihen në dukje rezervat që kemi për çështje specifike të pazakonta të konstatuara:

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për rezervat në opinion te fakti se nuk jemi dakord për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si:

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstatua se audituesit e pavarur të pasqyrave financiare, nuk kanë dorëzuar dokumentin “Letra për Drejtimin”, e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 4767 prot., datë 08.02.2018.

Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr. 1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA. Nga auditimi i dokumenteve të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të KSH janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar.

-Për llogarinë Aktive Afatgjata Jomateriale përfshin edhe llogarinë “Emri i mirë” në vlerën 717,064 mijë lekë, të njohur nga përthithja e fiskal njësisë H L SHA. Gjatë vitit 2017 UKT SHA nuk ka njohur zhvlerësim për këtë zë të bilancit i cili në bazë të SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve” duhet të testohet për vlerën e tij çdo vit.

-Për llogarinë “Aktive Afatgjata Materiale” përfshin vlerën 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorët të AKUK (ish-DPUK). Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga UKT SHA nuk krijohet besueshmëri e arsyeshme në lidhje me vlerën 1,026,003 mijë lekë.

-Për llogarinë “Inventarët” përmban vlerën e materialeve tërësisht apo pjesërisht të vjetëruar për shkak të kohës dhe ndryshimeve teknologjike në vlerën 81,275 mijë lekë. Ndërkohë që vlera e zhvlerësimin të inventarëve është 44,017 mijë lekë. Në bazë të SNK 2 “Inventarët”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

duhet të llogaritet shuma e zhvlerësimit shtesë por në bazë të dokumentacionit të venë në dispozicion grupi i auditimit nuk mund të llogaritet dhe mnd të sillte pasoja mbi vlerën e inventarëve dhe rrjedhimisht në vlerën e rezultatit në pasqyrat financiare të konsoliduara.

-Për Llogari të arkëtueshme me vlerën 2,690,010 mijë lekë konstatohet se UKT SHA ka përdorur si metodologji çmuarjen dhe zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për çdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdoruara për provigjonimin e llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 39, standard i cili kërkon vlerësim individual për llogaritë e arkëtueshme individualisht dhe vlerësim kolektiv për llogarit e tjera bazuar në të dhëna të plota historike.

-Për llogarinë “Huamarrje afatshkurtra” në vlerën 1,804,645 mijë lekë, një pjesë e kësaj shume (vlera 1,205,077 mijë lekë) nuk është kontabilizuar në monedhën origjinale por vetëm në lekë dhe për pasojë nuk reflektohen ndryshimet në vlerë si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit në datën 31.12.2017, në kundërshtim me SNK 21 “Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit”.

-Për llogarinë “Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime” me vlerë 465,222 mijë lekë, nga të cilat 463,122 mijë lekë grante afatgjata, 1,777 mijë lekë grante afatgjata rrjet kanalizime dhe 323 mijë lekë grante dhurata pajisje informatike. Nga informacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se është i pamjaftueshëm për shprehjen e një sigurie të mjaftueshme në lidhje me këto vlere.

-Për sa i përket detyrimeve tatimore konstatohet se në datë 28.05.2018 Drejtoria e Përgjithshme ka lëshuar raportin e kontrollit tatimor për periudhën deri në 20.11.2017 (përpara ndarjes së shoqërisë), detyrimi që ka rezultuar nga ky akt kontroll dhe e konfirmuar edhe nga Komisioni të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 është 13,116 mijë lekë. Shoqëria mëmë nuk ka paraqitur në pasqyrat e konsoliduara të datës 31.12.2017 nuk ka reflektuar këtë ngjarje pas datës së bilancit e cila do të ndryshojë rezultatit financiar.

-Në seksionin e kapitalit të shoqërisë mëmë përpara ka qenë e përfshirë rezerva e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë lekë, ndërkohë që me krijimin e shoqërisë së re të UKT SHA pjesa e tepricës së rivlerësimit që i takon kësaj shoqërie i është bashkuar kapitalit aksioner duke e rritur atë. Kjo mënyrë rritje kapitali nuk është e parashikuar në asnjë nga format e rritjes së kapitalit në kundërshtim me Kapitullin Zmadhimi i Kapitalit dhe nenet përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Gjithashtu teprica e rivlerësimit duhet të evidentohet më vete sipas kërkesave të SNK 16 “Aktiveve Afatgjata Materiale” dhe të përdorej në vijim në përputhje me kërkesat e këtij standardi. Ne nuk jemi në përputhje kërkesat e këtij standardi.

-Bazuar në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare të konsoliduara menaxheriale, raporti i ndarjes së shoqërisë është bazuar mbi pasqyrat financiare të shoqërisë të datës 31.12.2016 (të pa audituara).

-Bashkia Kamëz nuk ka pranuar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve të shoqërisë UKT SHA “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionerëve Bashkia Vorë dhe Kamëz nga UKT SHA” dhe ka hapur proces gjyqësor për pavlefshmërinë e këtij vendimi. UKB Kamëz nuk ka marrë në dorëzim asetet dhe ato vazhdojnë të paraqiten në pasqyrën pozicionit financiar të UKT. Në datën 21.03.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin e pjesës së kërkesës padisë. Në datën 26.04.2018 ky vendim është ankimuar nga UKT SHA. Deri më datë 19.10.2018, nga dokumentacioni i venë në dispozicion, nuk konstatohet të jetë marrë akoma një vendim i formës së prerë nga gjykata.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Grupi i auditimit ka shkuar në inspektim në magazinën e UKT SHA në Brar dhe u konstatua se kjo magazine ka një numër shumë të madh artikujsh dhe gjendja dhe organizimi i saj nuk linte mundësinë e identifikimit të artikujve pasi janë pa barkode dhe jo të vendosura nëpër rafta. Grupi i auditimit shpreh rezerva në lidhje me procesin e inventarizimit të kryer në këtë magazine dhe përputhjen e vlerës kontabël (vlerës në bilanc) me atë fizike.

-Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të shoqërisë UKT SHA nuk është pasqyruar vlera e kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakord për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

-Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve mbahen jashtë programit financiar por në Excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël.

-Në magazinat e UKT SHA ka pjesët rezervë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”, të lëna në ambientet e magazinës pa u bërë hyrje, pa u marrë në dorëzim nga përgjegjësi i magazinës dhe pa asnjë dokumentacion dëshmuar. Nuk ka asnjë dokument ku të trajtohet se si janë apo kush i ka sjellë këto materiale, si dhe kush i ka pranuar në magazinë pa kryer veprimet ligjore.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Tuba dhe Rakorderi”, viti 2018, konstatohet se nga ana e KVO janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), ku me OE “A.” SHPK lidhet kontrata, pavarësisht se ka të njëjtat mangësi për skualifikim me OE “M” LTD SHPK. Për pasojë, **vlera 489,053 lekë**, që përbën diferencën midis OE “M.” LTD SHPK të skualifikuar për të njëjtat mangësi që ka OE i shpallur fitues dhe ofertës së “A.” SHPK (dhe që përbëjnë devijime materiale që nuk ndikojnë thelbësisht në zbatimin e kontratës) të shpallur fitues (plus TVSH), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 dhe neni 53, pika 3 dhe pika 4.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje makineri pajisje (automjete), viti 2018, konstatohet se z. M.Q, i cili ka qenë në pozicionin e kryetarit të KVO për të dy procedurat, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), në dy procedura të ndryshme, ku të njëjtën mangësi e kualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “*Rikonstruktion i linjes DN-150mm gizë dhe rikonstruktion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno”*”, ndërsa e skualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “*Blerje makineri pajisje (automjete)*”. Në këto kushte **vlera 180,000 lekë**, që përbën diferencën midis BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK të skualifikuar në kundërshtim me LPP dhe ofertës së OE “L.” SHPK të shpallur fitues (41,050,000 - 40,900,000 + tvsh), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Software (program) dhe pajisje për leximin e matësave të ujit, për UKT sha”, viti 2017, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, **është konstatuar efekt financiar negativ me vlerë 7,872,000 lekë**, që i përket zërit të pajisjeve “**Telefona për aplikacionin**”, të prokuruar me anë të kësaj procedure, me arsyetimet si më poshtë vijon:

-Sipas pikës 3.3 të nenit 3, të kontratës së shërbimit nr. 4050/7, datë 22.05.2017, specifikimet teknike kërkuara për këtë pajisje janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

-Sipas dokumentacionit teknik (katalogët) të paraqitur nga OE “J.S” SHPK, konstatohet se produkti i kërkuar nuk është i njëjtë për 1 kriter (dimensionet) me produktin e ofruar, si dhe për 3 kritere nuk provohet përputhshmëria duke qenë se nuk ka të dhëna për to në produktin e ofruar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Nga kontrolli fizik i tollonave që mbaheshin në kasafortën e magazinës ishte që nga numërimi i tyre rezultoi se 110 litra naftë, me vlerë 20,108 lekë, ishin të pavlefshëm pasi nuk kishin Bar Code, duke i bërë të pavlefshëm pasi ato nuk pranohen nga pikat e furnizimit. Vlera **20,108 lekë** përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë.

Gjithashtu u konstatua se 100 litra nuk ishin të UKT pasi ishin me logo të institucioneve të ndryshme, një fenomen ky i pa justifikuar sesi kanë përfunduar te kasaforta e UKT. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për këto 100 litra naftë me vlerë **18,280 lekë**.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje elektropompë”, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik fitues “A&G” Sh.p.k është 330,000 lekë pa TVSH. Në datën 15.02.2017 është bërë Akt-Kolaudimi për mallin e dorëzuar në ambientet e UKT. Nga shqyrtimi i dosjes të procedurës së prokurimit është konstatuar se me faturën tatimore me nr. 37, datë 15.02.2017 për këtë elektropompë është paguar shifra 365,000 lekë pa TVSH (438,000 lekë me TVSH), kur oferta e OE ishte 330,000 lekë pa TVSH, pra është paguar më shumë dhe në mënyrë të pajustificuar më shumë vlera **42,000 lekë** me TVSH, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e UKT SHA**.

Trajtimi i detajuar sipas pikave respektive të programit për sa trajtuar më sipër është si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

A. VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA (me poshtë UKT SHA), ka formën e shoqërisë aksionare me dy nivele. Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga ana e grupit të auditimit i është paraqitur institucionit një pyetësor në lidhje me komponentët bazë të menaxhimit financiar dhe kontrollit përgjigjet e të cilit janë reflektuar si vijon. Njësia ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit për vitin 2017. Sektori i riskut në UKT SHA ka funksionuar dhe funksionon në varësi të Departamentit të Shitjes dhe fokusohet vetëm në riskun e vjeljes së debisë. Në strukturën e shoqërisë, pranë Departamentit Ekonomik ka qenë i ngritur deri në Dhjetor 2015 sektori i MFK-së. Në shoqëri nuk disponohen raporte dhe punë e dokumentuar nga ky sektor. Rregullorja e brendshme e UKT SHA (*Miraturar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha nr. 7, datë 04.04.2016*), është ndryshuar me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018. Nga Administratori i shoqërisë janë nxjerrë Urdhri nr. 63, datë 03.02.2017 Per hartimin e planeve mbi ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Urdhri nr. 111, datë 24.02.2017 “Për hartimin e planit vjetor të vitit 2017 me afat raportimi 1 mars 2017 për planin dhe regjistrin e riskut.

Në lidhje me mjedisin e kontrollit:

Mjedisi i kontrollit, është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, për të cilin është konstatuar se:

Është hartuar dhe miratur rregullorja e funksionimit të brendshëm të administratës ku janë saktësuar rregullat për tu zbatuar për shmangien e konfliktit të interesit, kriteret për rekrutimin e stafit të ri si dhe arsimimi përkatës për pozicion pune.

Në bazë të rregullores punonjësit janë të detyruar të zbatojnë rregullat e etikës të parashikuara në ligjin 9131, datë 08.09.2003 “ Për rregullat e etikës në administratën publike”. Përsa i përket politikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore janë miratur përshkrime detyrash individuale dhe ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që ata kryejnë. Për UKT SHA nëpunësi autorizues është drejtori i përgjithshëm si administrator i shoqërisë, ai është përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit ekonomik. Shoqëria ka të përcaktuar një plan vjetor me tematikat e zhvilluara gjatë vitit. Ka analiza 3-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore.

Për vitin 2018 është kryer nga Shoqata e Ujësjetllës-Kanalizimeve të Shqipërisë në UKT sh.a trajnimi me temë “Pasqyrat financiare dhe roli i tyre në vendimarrje”i cili është zhvilluar në muajin Mars. Trajnimi ka pasur si qellim unifikimin e pasqyrave financiare te ujësjetllësave në Republikën e Shqipërisë. Pikë e rëndësishme e trajnimit ishte roli i pasqyrave financiare në vendimarrjen financiare dhe menaxheriale të Ujësjetllësave. Pjesëmarrës në trajnim nga Drejtoria Ekonomike kanë qenë 3 persona. Gjithashtu janë dërguar për trajnim pranë zyrës së Komisionerit për të Drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dy specialist të Burimeve Njerëzore.

Në zbatim të Ligjit Nr. 8734 dt.01.02.2001 “Për garantimin e Sigurisë së punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”(të ndryshuar), ”Formimi i Punëmarrësve”, Ligjit Nr. 13/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8734 dt.01.02.2001”, ”Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet elektrike” pjesa e parë (sigurimi teknik) UKT SHA ka detyrimin ligjor për çertifikim personeli. Meqënëse këto dëshmi aftësie lëshohen nga një organ i Akredituar Çertifikues Personeli për fushën çdo vit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

bëhet testimi (ritestimi) dhe pajisja me dëshmi aftësie e personelit të UKT SHA pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave është zhvilluar seminari dy javor teoriko-praktik për krijimin, evidentimin, klasifikimin, shërbimin dhe ruajtjen e dokumentave në arkivat e institucioneve shtetërore dhe private, nga UKT SHA kanë marrë pjesë 3 punonjës.

Në lidhje me menaxhimin e riskut

Më përpara risku ka qenë një proces i fragmentarizuar vetëm në Departamentin e Shitjes. Për vitin 2016 dhe në vazhdim, siç është lënë rekomandim dhe nga Auditimi i Brendshëm i shoqërisë funksioni i këtij sektori duhet të përfshinte gjithë shoqërinë, në një regjistër risku të vetëm.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se regjistri i riskut i UKT SHA është jo i plotë dhe reflekton vetëm analizën e procedurës në burim (faturim, arkëtim, pezullim kontrate) dhe nuk konstatohet zbatimi i rekomandimit të auditit të brendshëm të shoqërisë nga gjithë sektorët në UKT SHA, sepse regjistri i riskut nuk e përfshin gjithë shoqërinë.

Në lidhje me aktivitetet e kontrollit:

-Ekzistojnë procedura të punës të shkruara për proceset kryesore operacionale dhe financiare, duke përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme.

-Çdo përdorim i aktiveve të rëndësishme ka një procedurë autorizimi dhe ruajtjeje, gjithashtu ka një procedurë e cila rregullon nivelin e aksesit apo autorizimin e përdorimit të të dhënave të rëndësishme.

Në lidhje me informacionin dhe komunikimin

-Ekziston një procedurë e shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit, e cila është pjesë e rregullores së brendshme. Në UKT SHA shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë verbale e shkresore.

-Në Rregulloren e Brendshme të shoqërisë të vitit 2016 përcaktohen nivelet hierarkike të raportimit, mbledhjes dhe dokumentimit e gabimeve, analizimin e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht shoqëria disponon një regjistër për ankesat si në drejtoritë e përgjithshme ashtu edhe në njësitë e saj, për regjistrimin e ankesave.

Në lidhje me monitorimin

-Titullari i institucionit merr raport ditor, javor, mujor, 3-mujor, 6-mujor, 9-mujor dhe vjetor.

-Organet drejtuese të shoqërisë monitorojnë dhe analizojnë realizimin ose shkaqet e mosrealizimit të objektivave.

Kontrolli i Brendshëm

-Nuk konstatohet dërgimi pranë Ministrisë së Financave i deklaratës së cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit të komponentëve të MFK për vitin 2017 nga nëpunësi autorizues në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", udhëzimeve të Ministrisë së Financave në zbatim të tij.

-Nga Drejtoria Ekonomike nuk konstatohen propozime mbi politikat financiare dhe dërgimi i tyre për miratim, përgatitja e raportit vjetor mbi funksionimin e MFK-së dhe as mbikëqyrja e raporteve financiare që janë përgatitur nga shoqëria, për vitin 2017 në kundërshtim me nenin 159 të rregullores së brendshme të shoqërisë UKT SHA, miratuar me (Miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha nr. 7, datë 04.04.2016) dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 111, datë 24.02.2017 "Për hartimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

planit vjetor të punës për vitin 2017 me afat raportimi 1 mars 2017 për planin dhe regjistrin e riskut.

- Në këtë shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.

-gjithashtu konstatohet se nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit të përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industrial), vend mbajtja e tyre dhe IA..mi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për të cilat ngarkohet me përgjegjësi znj.A.S me detyrë Drejtore e Departamentit Ekonomik.

Në lidhje me veprimtarinë e auditit të brendshëm konstatohet se:

Veprimtaria e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Shoqërinë Ujësjiellës–Kanalizime Tiranë bazohet në ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave. Bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 10318, datë 16.09.2009 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe “Manualit të auditimit të brendshëm”, veprimtaria audituese për vitin 2017 dhe 8 mujorin e parë 2018, është përqendruar kryesisht në:

- Programimin dhe kryerjen e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë së UKT SHA.
- Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tij.
- Ndjekja në vazhdimësi e rekomandimeve të dhëna nga auditimet bazuar në planin për ndjekjen e tyre.

Sistemet dhe fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar me nivel të lartë risku përfshijnë sistemet e menaxhimit financiar, sistemet e proceseve organizative, sistemet e të ardhurave nga shitja, sisteme të tjera që kanë të bëjnë me shpenzimet e karburanteve, prokurimeve etj. Me risk të lartë konsiderohen ato degë e sektorë që kanë një aktivitet më të madh ekonomiko-financiar, nisur nga numri i transaksioneve, mundësisë për përdorim abuziv të fondeve apo të mashtrimeve për të përvetësuar, vlerësime të mëparshme për sistemin e kontrollit të brendshëm në subjekt, objektivat e shoqërisë dhe qëllimet e vendosura, qëllimi i proceseve dhe përmirësimi i tyre për stabilitetin e sistemit etj. Në të gjitha fazat e auditimit rëndësi i është dhënë vlerësimit të riskut, duke synuar në auditim me bazë performancën, sidomos në atë pjesë të sistemit të kontrollit që janë më tepër të lidhura me të.

Për vitin 2017, struktura e auditit të brendshëm në UKT SHA, ka funksionuar në nivel njësie si pjesë përbëse e strukturës organizative varësi funksionale nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, me tre veta si organigramë një drejtues i certifikuar nga NJ.Q.H.A.B dhe 2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

specialiste, 1 punonjës i çertifikuar nga D.H.A.B, dhe punonjësi tjetër i paçertifikuar nga D.H.A.B.

Për vitin 2017 nga njësia e auditimit janë realizuar 12 misione auditimi të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë me vendimin nr. 22 datë 12.12.2016. Nga 12 misione auditimi të parashikuara, 1 mision i mbetur pa audituar nga plani i vitit 2016 janë realizuar 9 auditime të parashikuara në planin vjetor 2017, ku një angazhim është në proces përfundimi dhe 2 auditime për shërbime konsulence.

Rekomandime Viti 2017	Pranuar	Zbatuar	Pa zbatuar	Proces
131	131	59	25	47

Burimi: UKT SHA

Nga njësia e Auditimit të Brendshëm të UKT SHA është raportuar në këto nivele:

- Administratorit të Shoqërisë
 - Këshillit Mbikëqyrës
 - Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
- Me shkresën nr. 5534, datë 15.02.2018, NJAB e UKT SHA i ka drejtuar Këshillit të Administrimit, raportin e veprimtarisë së NJAB për vitin 2017, ku pasqyrohet veprimtaria vjetore e kësaj njësie dhe konkretisht:
- Me shkresën nr. 19669, datë 16.10.2017 i ka dërguar Drejtorisë së Harmonizimit dhe Auditit të Brendshëm Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm për vitet 2018-2020.
- Me shkresën nr. 445, datë 08.02.2017 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Karta e Auditit të Brendshëm referuar organizimit të UKT SHA, me dy nivele dhe me organe drejtuese Asamblenë e Aksionerëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Për vitin 2018 me vendimin nr. 22, datë 13.12.2017, Këshilli i Administrimit i UKT SHA ka miratuar planin vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm, ku janë parashikuar 11 misione auditimi, sipas sektorëve dhe departamenteve në UKT SHA, nga të cilat për 9-mujorin janë realizuar 6, 1 auditim është në proces, është realizuar një shërbim konsulence dhe 4 auditime të tjera të plota që parashikohet të mbyllet deri në fund të vitit.

Numri i Audituesve të Brendshëm në UKT sh.a për periudhën objekt auditimi

Emërtimi	Numri Struktura	Punonjës planifikuar	Punonjës faktik	Në proces certifikimi	Të çertifikuar	Të paçertifikuar
NJAB	Njësi	3	3	1	1	1
Shuma		3	3	1	1	1

Burimi: UKT SHA

Nga njësia e Auditimit të Brendshëm të UKT SHA është raportuar në këto nivele:

- Administratorit të Shoqërisë
 - Këshillit Mbikëqyrës
- Me shkresën nr. 23263, datë 11.12.2017 NJAB i ka drejtuar planin vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm për vitin 2018, Këshillit të Administrimit.
- Me vendimin nr. 22, datë 13.12.2017, Këshilli i Administrimit ka miratuar planin vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Në përgjigje të observacionit tuaj ju sqarojmë se rregjistri i riskut që ju vendos në dispozicion grupit të auditimit gjatë periudhës objekt auditimi, ishte siç e keni pranuar edhe ju në observacion në formë elektronike i pa arkivuar dhe jo i plotë me gjithë sektorët që mbulon UKT. Përsa i përket detyrave funksionale që ka Drejtoria Ekonomike e UKT sh.a ju sqarojmë se aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Ujësjiellës Kanalizime dhe konkretisht VKM nr. 63, datë 27.01.2016 përcaktojnë se: Drejtori tregtar ka këto kompetenca: a) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike financiare të shoqërisë. b) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj. c) Harton plan buxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv. ç) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit. d) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë. dh) Ushtron kontrole periodike mbi veprimtarinë ekonomike financiare të ndjekur nga specialistët përkatës. e) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave. ë) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë. f) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë. g) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm. Përsa më sipër aktet nënligjore prevalojnë mbi çdo ndryshim që i bëhet rregullores së brendshme të shoqërisë, për këtë arsye përderisa nuk keni paraqitur prova të reja shkresore të cilat nuk paraqesin prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysht.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

B. VLERËSIMI I PROCESIT TË PROGRAMIMIT DHE ZBATIMIT TË BUXHETIT

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Me relacionin nr. 23711/3, datë 23.11.2016 “Relacion për hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2017 të shoqërisë UKT SHA” është hartuar projektbuxheti për vitin 2017. Ky projekt buxhet është miratuar me Vendimin nr. 21 “Mbi miratimin e buxhetit të shoqërisë UKT SHA, për vitin 2017”, datë 12/12/2016 të Këshillit Mbikqyrës të UKT SHA. Me Vendimin nr. 19, datë 14/12/2016 “Mbi miratimin e buxhetit të shoqërisë UKT SHA, për vitin 2017”.

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2017 buxheti i shoqërisë ka ndryshuar, konkretisht:

Nga Sektori i Planifikimit Financiar është hartuar relacioni nr. 16655/2, datë 05/09/2017, drejtuar Këshillit Mbikqyrës dhe Asambleja e Aksionerëve.

Me Vendimin nr. 16, datë 25/09/2017 “Për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e UKT SHA, viti 2017”, Këshilli Mbikqyrës ka miratuar ndryshimet në buxhetin e shoqërisë.

Me Vendimin nr. 09, datë 27/09/2017 “Për miratim e ndryshimeve në buxhetin e UKT SHA, viti 2017”, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve ka miratuar ndryshimet e buxhetit për vitin 2017.

Analiza e treguesve specifik ekonomik të shoqërisë për vitin 2017

Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2017 që përfshin arkëtimin nga ndryshim emri, librezat, tarifë shërbimi dhe vlera e kontratave të reja është planifikuar 682 mln lekë dhe është realizuar 819 mln lekë, pra kemi një realizim me 120 % kundrejt planifikimit vjetor.

Analiza e të ardhurave të shoqërisë për viti 2017

Të ardhurat e shoqërisë rezultojnë:

Tabela 2. Tabela e të ardhurave; krahasimi Plan-Fakt viti 2017

Tab 2 – Treguesit e Të Ardhurave të rishikuara për vitin 2017						
NR	EMERTIMI	NJESIA	PLAN 2017	FAKT 2017	NDRYSHIMI NE VLERE	NDRYSHIMI NE %
	TË ARDHURAT					
A	Të ardhura nga Shitja e Ujit	mln lekë	3,110.03	2,839.03	(271.00)	91.29
1	Konsumatorë Familjarë	"	1,534.30	1,407.52	(126.79)	91.74
2	Institucione Buxhetore	"	352.15	332.46	(19.69)	94.41
3	Institucione jo Buxhetore	"	70.82	60.61	(10.21)	85.59
4	Ente Private	"	790.22	671.70	(118.52)	85.00
5	Shitje Uji me shumicë	"	33.90	31.02	(2.88)	91.51
6	Tarifë fikse shërbimi	"	282.03	280.77	(1.26)	99.55
7	Kontrata të reja	"	41.30	50.42	9.12	122.09
8	Të tjera nga shitja e ujit	"	5.31	4.53	(0.78)	85.37
B	Shitje uji H L	"	136.80	114.37	(22.43)	83.60
A+B	Totali i të ardhurave nga shitja ujit (Shitje + HEC)	"	3,246.83	2,953.39	(293.44)	90.96
C	Shuma e të ardhura të tjera	"	436.18	353.78	(82.40)	81.11
1	Pikë lidhje uji ujësjetllës-kanalizim	"	15.00	6.93	(8.07)	46.20
2	Vendosje matësa uji	"	85.60	101.99	16.40	119.15
3	Azhornime rrjeti ujësjetllës -kanalizim	"	0.50	3.23	2.73	645.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

4	Interesa banke dhe të ndryshme	"	2.00	0.08	(1.92)	4.10
5	Kuota pjesë e amortizimit	"	14.50	14.43	(0.07)	99.52
6	Të ardhura nga prodhimi i aktiveve	"	108.00	47.31	(60.69)	43.81
7	Të ardhura nga tarifa e pastrimit	"	43.30	25.28	(18.02)	58.39
8	Kamata	"	96.49	75.05	(21.44)	77.78
9	Te Ardhura nga HEC	"	70.80	79.48	8.68	112.25
	TOTALI I TË ARDHURAVE	"	3,683.01	3,307.18	(375.84)	89.80

Të ardhurat nga shitja e ujit, janë planifikuar në vlerën 3,110 mln lekë dhe janë realizuar në vlerën 2,839 mln lekë ose e shprehur në përqindje 92% për vitin 2017 sipas zëravë të mëposhtëm:

Zëri Konsumatorë familjarë- është planifikuar në vlerën 1,534 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 1,408 mln lekë ose e shprehur në përqindje 92%. Në realizimin 92 % të këtij zëri ka ndikuar pezullimi dhe mbyllja e 1,753 kontratave për këtë kategori të cilat i përkisnin ndërtesave të shëmbura dhe që nuk ekzistojnë më. Gjithashtu IA..mi i njësisë 6 ka dhënë ndikimin e vet edhe në të ardhurat nga shitja e ujit për konsumatorët familjarë. Faturimi i kontratave të reja për këtë vit nuk ka dhënë efektin në sasinë e m³ të faturuar mbasi ka një numër të konsiderueshëm që faturohet me zero dhe mesatarja e faturuar është shumë e ulët që sjell ulje të të ardhurave për këtë kategori. Ndryshimi i mënyrës së faturimit nga pa matje (mesatare) në faturim me matje ka sjellë rënie në mesataren e faturimit dhe uljen e të ardhurave për abonentët familjarë (vendosja e 34,532 ujëmatësa).

Zëri Insitucione buxhetore – është planifikuar në vlerën 352 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 332 mln lekë ose e shprehur në përqindje 94 %. Realizimi në këtë përqindje për zërin Insitucione buxhetore ka ardhur si rezultat i faturimit (konsumit) më pak të ujit nga institucionet buxhetore.

Zëri Insitucione jo buxhetore – është planifikuar në vlerën 70 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 60.6 mln lekë ose e shprehur në përqindje 86 %. Realizimi me 86 % i këtij zëri ka ardhur si rezultat i ndryshimit të kategorizimit të disa kontratave në Qytetin Studenti, nga Insitucione jo buxhetore kanë kaluar në konsumatorë familjarë duke ndryshuar kështu edhe çmimin nga 170 leke m³ në 56 leke m³.

Zëri Ente private – është planifikuar në vlerën 790 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 672 mln lekë ose e shprehur në përqindje 85%. Realizimi me 85% ka ardhur si rezultat i instalimit të ujëmatësave në abonentë të cilët faturoheshin pa matje, gjë e cila ka ndikuar në uljen e mesatares së faturimit (si rezultat i kursimit të përdorimit të ujit nga kjo kategori abonentësh) dhe uljen e të ardhurave për kategorinë e lartë përmendur.

Zëri Shitje uji me shumicë – është planifikuar në vlerën 34 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 31 mln lekë ose e shprehur në përqindje 92 %.

Zëri Tarifë fikse shërbimi – është planifikuar në vlerën 282 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 281 mln lekë ose e shprehur në përqindje 99.5 %.

Zëri Kontrata të reja – është planifikuar në vlerën 41 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 50 mln lekë ose e shprehur në përqindje 122 %. Realizimi 122 % ka ardhur si rezultat i efikasitetit të fushatës së ndërmarrë nga Departamenti i Shitjes në bashkëpunim me Njësitë Zonale për hapjen e kontratave të reja në zonat informale.

Zëri Të tjera nga shitja e ujit – është planifikuar në vlerën 5.3 mln lekë dhe është realizuar në vlerën 4.5 mln lekë ose e shprehur në përqindje 85 % që përfshin të ardhurat nga librezat e ujit, rilidhjet etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Të ardhura nga shitje uji H L është planifikuar 136.8 mln lekë dhe është realizuar 114.3 mln lekë ose e shprehur në përqindje 83.6 %. Arsyja e realizimit në këtë masë vjen si pasojë e uljes së kërkesës nga ana e Hec Lanabregas për blerje uji për prodhim energjie.

Të ardhurat e tjera, janë planifikuar 436.1 dhe janë realizuar në vlerën 353.8 mln lekë ose 81.1 % për 12 mujorin e 2017 sipas zërave të mëposhtëm:

Pikë lidhje – është planifikuar 15 mln lekë dhe është realizuar 6.9 mln lekë ose 46.2 % që përfshin të ardhurat nga pikëlidhjet që kryhen ndaj abonentëve. Realizimi 46.2 % i këtij zëri ka ardhur sepse për abonentët privatë apo familjarë të cilët kanë aplikuar për pikë lidhje, pas verifikimeve në terren të kryera nga Departamenti Inxhinierik ka rezultuar që ka ekzistuar pika e lidhjes dhe rrjedhimisht pagesa nuk është kryer nga ana e abonentit.

Vendosje matësa uji – është planifikuar 85.6 mln lekë dhe është realizuar 102 mln lekë ose 119.1 % që përfshin të ardhurat e marra nga vendosja e matësave për abonentët tanë. Realizimi me 119.1 % i këtij zëri vjen si rezultat i ndjekjes me përparësi e vendosjes së matësave në abonentët që faturoheshin me mesatare dhe matje të cilët janë paguar në total 34.532 mijë copë ujëmatësa.

Azhornim rrjeti ujësjiellës-kanalizim – është planifikuar 0.5 mln lekë është realizuar 3.25 mln lekë ose 645 %.

Interesa banke dhe të ndryshme – është planifikuar 2 mln lekë dhe është realizuar 0.08 mln lekë ose 4.1 %.

Kuota pjesë e amortizimit - është planifikuar 14.5 mln lekë dhe është realizuar 14.4 mln lekë ose 99.5%

Të ardhura nga prodhimi i aktiveve – është planifikuar 108 mln lekë dhe është realizuar 47.3 lekë ose 43.8 % që përfshin të ardhurat nga investimet e kryera nga shoqëria.

Të ardhura nga tarifa e pastrimit – është planifikuar 43.3 mln lekë është realizuar 25.3 mln lekë ose 58.4 % që përfshin të ardhurat e mbledhura nga tarifa e pastrimit. Realizimi me 58.4 % i të ardhurave nga tarifa e pastrimit vjen si rezultat i pezullimit dhe mbylljes përfundimtare për afërsisht 1,753 kontratave të cilat i përkasin ndërtesave të vjetra të cilat nuk ekzistojnë më, si dhe përjashtimeve të cilat i kryhen vetë Bashkia Tiranë për abonentë të caktuar.

Kamata – është planifikuar 96.5 mln lekë dhe është realizuar 75 mln lekë ose 77.8% dhe përfshin të ardhurat e përfitura nga kamata nga abonentët.

Të ardhura nga H L- Për vitin 2017 plani vjetor 70.1 mln lekë dhe është realizuar 79.5 mln ose 112.3 % dhe përfshin të ardhurat e përfituara si aksioner të H L, dividenti i vitit 2016.

Totali i të ardhurave – është planifikuar 3,683 mln lekë dhe është realizuar 3,307 mln lekë ose 90%.

Tabela 3. Tabela e treguesve specifikë 12-mujori 2016-2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e Matjes	Plani 2016	Fakti 2016	Plani 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
I	Prodhim uji	000/m ³	101,600.00	106,633.74	102,000.00	99,958.00	(6,675.74)	(6.26)
II	Faturim uji	000/m ³	86,364.76	88,853.01	97,706.49	87,091.22	(1,761.79)	(1.98)
	Faturim uji pijshëm	000/m ³	34,208.54	34,206.97	38,147.61	34,744.45	537.48	1.57
	Faturim uji përdorur	000/m ³	27,958.22	27,952.78	32,198.89	29,473.29	1,520.51	5.44
	Faturim uji HEC	000/m ³	24,198.00	26,693.26	27,360.00	22,873.48	(3,819.78)	(14.31)
III	Të ardhura nga uji i faturuar	mln/lekë	2,903.10	2,756.31	3,110.03	2,839.03	82.72	3.00
IV	Arkëtimi	mln/lekë	3,058.70	3,665.88	3,900.34	3,507.56	(158.33)	(4.32)
	Nga faturimi i ujit		2,729.00	2,791.64	3,081.00	2,576.97	(214.67)	(7.69)
	Nga uji për prodhim energjie		121.00	133.47	136.80	112.08	(21.39)	(16.02)
	Nga shërbime të tjera		208.70	740.78	682.54	818.50	77.73	10.49
V	Investimet gjithsej	mln/lekë	1,588.60	1,501.46	1,369.81	1,091.49	(409.97)	(27.30)
	Nga këto :							
A	Sipas strukturës		1,588.60	1,501.46	1,369.81	1,091.49	(409.97)	(27.30)
1	Ndërtim-Montim	mln/lekë	1,240.50	1,265.81	934.30	795.48	(470.33)	(37.16)
2	Makineri e Pajisje	mln/lekë	17.70	15.54	162.85	129.28	113.74	731.79
3	Pajisje e Orendi	mln/lekë	132.10	26.80	73.60	166.72	139.93	522.13
4	Studime e projektme	mln/lekë	5.00	-	126.06	-	-	-
5	Investime të tjera	mln/lekë	-	-	73.00	-	-	-
6	Hidrocentrali Lanabregas	mln/lekë	193.30	193.30	-	-	(193.30)	(100.00)
B	Sipas burimeve të financimit		1,896.88	1,958.16	1,369.81	1,091.49	(866.67)	(44.26)
1	Burimet e veta	mln/lekë	1,246.88	1,308.16	742.81	506.58	(801.58)	(61.28)
2	Ndihmë e kredi e huaj	mln/lekë	650.00	650.00	589.00	585.85	(64.15)	(9.87)
3	Buxheti i shtetit	mln/lekë	-	-	-	-	-	-
4	Nevoja për financim(kredi, grante)	mln/lekë	-	-	38.00	-	-	-
VI	TREGUESIT E PUNËS							
1	Punonjës gjithsej	Nr.mes	1,150.00	1,100.00	1,220.00	1,204.83	104.83	9.53
2	Fondi i pagave	mln/lekë	592.40	549.10	648.00	641.22	92.12	16.78
3	Paga mesatare	lekë	42,927.54	41,598.73	44,089.00	44,350.45	2,751.72	6.61
VII	Treguesit specifikë të shoqërisë							
	Humbje uji(teknike + administrative)	%	66.33	67.92	62.00	65.24	(2.68)	96.05

Tabela 4. Tabela e të ardhurave 12 mujori 2016-2017

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e Matjes	Plani 2016	Fakti 2016	Plani 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
	TË ARDHURAT							
A	Të ardhura nga uji i faturuar	mln/lekë	2,903.10	2,756.31	3,110.03	2,839.03	82.72	3.00
1	Konsumatorë Familjarë	"	1,361.20	1,348.66	1,534.30	1,407.52	58.85	4.36
2	Institucione Buxhetore	"	330.40	323.95	352.15	332.46	8.50	2.62
3	Institucione jo Buxhetore	"	61.70	62.65	70.82	60.61	(2.04)	(3.26)
4	Ente Private	"	780.00	637.29	790.22	671.70	34.41	5.40
5	Shitje Uji me shumicë	"	34.20	38.39	33.90	31.02	(7.37)	(19.20)
6	Tarifë fikse shërbimi	"	270.30	265.55	282.03	280.77	15.21	5.73
7	Kontrata të reja	"	59.10	41.24	41.30	50.42	9.18	22.27
8	Të tjera nga shitja e ujit	"	6.20	38.57	5.31	4.53	(34.03)	(88.25)
B	Shitje uji Hec Lanabregas	"	121.00	133.47	136.80	114.37	(19.10)	(14.31)
A+B	Totali i të ardhurave nga shitja ujit	"	3,024.10	2,889.77	3,246.83	2,953.39	63.62	2.20
C	Shuma e të ardhura të tjera	"	325.70	185.68	436.18	353.78	168.10	90.54
1	Pikë lidhje uji ujësjellës-kanalizim	"	15.00	10.60	15.00	6.93	(3.67)	(34.64)
2	Vendosje matësa uji	"	49.90	18.75	85.60	101.99	83.24	443.86
3	Azhornime rrjeti ujësjellës -kanalizim	"	0.50	1.42	0.50	3.23	1.80	126.62
4	Interesa banke dhe të ndryshme	"	2.00	1.26	2.00	0.08	(1.18)	(93.49)
5	Kuota pjesë e amortizimit	"	15.00	14.82	14.50	14.43	(0.39)	(2.66)
6	Të ardhura nga prodhimi i aktiveve	"	100.00	56.33	108.00	47.31	(9.01)	(16.00)
7	Të ardhura nga tarifa e pastrimit	"	46.80	23.38	43.30	25.28	1.90	8.14
8	Kamata	"	96.50	59.11	96.49	75.05	15.94	26.97
9	Te Ardhura nga HEC	"	-	-	70.80	79.48	79.48	
	TOTALI I TË ARDHURAVE	"	3,349.80	3,075.45	3,683.01	3,307.18	231.73	7.53

Faturimi i ujit të pijshëm, 1.6 % më shumë ose 537.4 m³ me shumë, ku në këtë rritje ka ndikuar hapja e 9087 kontratave të reja gjatë vitit 2017, ku ka ndikuar në rritjen e sasisë së faturuar të ujit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Faturimi i ujit të përdorur, është rritur në krahasim me një vit më parë me 5.4% ose me 1,520.1 m³. Hapja e kontratave të reja ka dhënë një efekt rritës edhe për këtë zë.

Ne total **të ardhurat** e vitit 2017 kundrejt atij 2016 janë 84 mln lekë më shumë ose 3 % më shumë sipas kategorive më poshtë:

Konsumatorë familjarë, janë realizuar 58.9 mln lekë më shumë ose 4.4% më shume, si efekt e punës që është bërë për hapjen e kontratave të reja ku për këtë kategori janë hapur 7,685 kontratat të reja.

Institucionet buxhetore, 8 mln lekë më shumë në krahasim me një vit më parë ose 2.6%. në realizimin e këtij zëri ka ndikuar monitorimi dhe ndjekja nga njësitë e abonentëve buxhetorë për leximin në afat dhe korrektësi të matësive, si dhe realizimi i mesatares së faturimit më të lartë se 2016 nga 301 m³ për abonent mu në 310 m³ për abonent muaj për vitin 2017.

Institucionet jobuxhetore, nga kjo kategori tre godina të Qytetit Studenti janë kthyer në kategori familjare, ndaj kjo ndërmarrje ka dhënë efekt në realizim të të ardhurave 2 mln lekë më pak se një vit më parë, ose 3.3% më pak.

Entet private, kanë patur një rritje të të ardhurave në krahasim me vitin e kaluar prej 34.4 mln lekë ose 5%, si efekt i hapjes së 1,400 kontratave të reja.

Uji me shumicë, faturimi i 3-mujorit të parë të vitit 2016 për të gjitha komunat, jep efektin e saj në realizim më të lartë të këtij zëri në atë vit. Me krijimin e Drejtorisë Rajonale në Mars 2017 mori në administrim të gjitha komunat përveç 4 prej tyre (Kamëz, Paskuqan, Prezë, Bërxullë), të cilat janë të vetmet Komuna ku blejnë Ujin me shumicë.

Tarifa fikse, hapja e kontrata të reja ka sjellë një rritje në të ardhur për këtë kategori në 13.2 mln lekë ose 5.8 % në krahasim me vitin 2016.

Kontratat e reja, hapja e 3272 kontrata të reja më shumë se një vit më parë, kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave 9.2 mln lekë ose 22.3%.

Vendosje matësa, ky zë ka patur një rritje me 83.3mln më shumë se një vit më parë ose 443.9%, janë vendosur konkretisht 34,532 matësa të rinj në vitin 2017, në krahasim me 7,639 matësa me një vit më parë.

Tabela 5. Realizimi i treguesve per 2017 krahasuar me te pritshmin 2017 per Dep.Shitje

REALIZIMI I TREGUESVE PER 2017 KRAHASUAR ME TE PRITSHMIN 2017 per DEP.Shitje							
	TREGUESIT	njesia matese	Plani 2017	I pritshmi 2017	fakti 2017	realizimi ne % ndaj të pritshmit	realizimi ne % ndaj planit
I	Totali i ujit te faturuar	m3	70,346,494	64,894,566	64,217,737	98.96%	91%
	Sasia e ujit te pijshem	m3	38,147,605	34,913,003	34,744,448	99.52%	91%
	Sasia e ujit te perdorur	m3	32,198,889	29,981,563	29,473,289	98.30%	92%
IV	ARKETIMI	leke	3,636,865,961	2,757,935,104	3,395,475,509	123.12%	93%
a	ARKETIMI (Faturim uje i pijshem+ i perdorur+shumice)	leke	3,081,323,961	2,452,387,004	2,576,970,728	105.08%	84%
b	ARKETIM TE TJERA (kontrata, ujematesa,libreza, kamata+inxh)	leke	555,542,000	305,548,100	818,504,781	267.88%	147%
II	Te ardhura nga uji i faturuar (uje i pijshem dhe perdorur)	leke	2,781,388,478	2,517,877,876	2,503,303,969	99.42%	90%
III	TE ARDHURAT TOTAL (shitje uji dhe te ardhura te tjera, a+b)	leke	3,335,413,856	3,044,761,832	3,041,351,340	99.89%	91%
a	Te ardhura nga shitja e ujit (uje i pijshem, perdorur , shumica dhe te tjera nga shitja)	leke	3,110,030,237	2,852,736,675	2,839,025,700	99.52%	91%
a/1	BUXH	leke	352,148,087	343,221,820	332,455,260	96.86%	94%
a/2	FAMILJARE	leke	1,534,303,362	1,411,832,628	1,407,515,709	99.69%	92%
a/3	JO-BUXH	leke	70,820,604	56,814,170	60,612,186	106.68%	86%
a/4	PRIVAT	leke	790,219,005	674,693,974	671,700,450	99.56%	85%
	TOTAL	leke	2,747,491,058	2,486,562,592	2,472,283,605	99.43%	90%
a/5	Uje me shumice	leke	33,897,420	31,315,284	31,020,364	99.06%	92%
a/6	Tarifa fikse e sberbimit	leke	282,030,500	280,959,830	280,765,630	99.93%	100%
a/7	Lidhja e kontratave te reja	leke	41,300,959	49,273,381	50,424,347	102.34%	122%
a/8	Te tjera	leke	5,310,300	4,625,589	4,531,754	97.97%	85%
b	TE ARDHURA TE TJERA	leke	225,383,619	192,025,157	202,325,640	105.36%	90%
b/1	Kamata	leke	96,486,900	66,805,090	75,050,987	112.34%	78%
b/2	Matesa te rinj	leke	85,596,719	95,542,561	101,992,220	106.75%	119%
b/3	Takse pastrimi	leke	43,300,000	29,677,507	25,282,434	85.19%	58%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Në tabelën e mësipërme është paraqitur krahasimi i projekt-buxhetit të vitit 2017, pritshmëritë për arritjen e këtij plani dhe realizimin e tij faktik. Siç e shohim dhe nga shifrat në tabelë fakti është arritur pothuajse në masën 100% krahasuar me pritshmëritë nga të ardhurat për vitin 2017. Kjo arritje vjen si rezultat i hapjes së kontratave të reja, të përmendura dhe më sipër dhe fushatës së ngritur nga UKT për formalizimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe luftën kundër informalitetit.

Analiza e investimeve vitin 2017

Treguesit e investimeve nga departamenti inxhinjrik po i paraqesim si më poshtë:
Investimet në total janë realizuar 79.75% sipas zërave të mëposhtëm:

Tabela 6. Tabela investimeve plan-realizim viti 2017

Tab 6 – Treguesit e Investimeve për vitin 2017						
Nr.	Emërtimi	Njësia e Matjes	Projekt Buxheti 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
VII	Investimet gjithsej	"	1,369.81	1,091.49	(278.32)	79.68
	Nga këto:		-			
A	Sipas strukturës UKT		1,369.81	1,091.49	(278.32)	79.68
1	Ndërtim-Montim	mln lekë	934.30	795.48	(138.81)	85.14
2	Makineri e Pajisje	"	162.85	129.28	(33.57)	79.39
3	Pajisje e Orendi	"	73.60	166.72	93.12	226.53
4	Studime e projektme	"	126.06	-	(126.06)	-
5	Investime të tjera	"	73.00	-	(73.00)	

Tabela 7. Tabela investimeve krahasim 12-mujori 2016-2017

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e Matjes	Plani 2016	Fakti 2016	Plani 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
V	Investimet gjithsej	mln/lekë	1,588.60	1,501.46	1,369.81	1,091.49	(409.97)	(27.30)
	Nga këto :			-			-	
A	Sipas strukturës		1,588.60	1,501.46	1,369.81	1,091.49	(409.97)	(27.30)
1	Ndërtim-Montim	mln/lekë	1,240.50	1,265.81	934.30	795.48	(470.33)	(37.16)
2	Makineri e Pajisje	mln/lekë	17.70	15.54	162.85	129.28	113.74	731.79
3	Pajisje e Orendi	mln/lekë	132.10	26.80	73.60	166.72	139.93	522.13
4	Studime e projektme	mln/lekë	5.00	-	126.06	-	-	
5	Investime të tjera	mln/lekë	-	-	73.00	-	-	
6	Hidrocentrali Lanabregas	mln/lekë	193.30	193.30	-	-	(193.30)	(100.00)
B	Sipas burimeve të financimit		1,896.88	1,958.16	1,369.81	1,091.49	(866.67)	(44.26)
1	Burimet e veta	mln/lekë	1,246.88	1,308.16	742.81	506.58	(801.58)	(61.28)
2	Ndihmë e kredi e huaj	mln/lekë	650.00	650.00	589.00	585.85	(64.15)	(9.87)
3	Buxheti i shtetit	mln/lekë	-	-	-	-	-	
4	Nevoja për financim(kredi, grante)	mln/lekë	-	-	38.00	-	-	

Zëri N.M, realizimi i investimeve të kryera me të tretë i planifikuar për vitin 2017 në vlerën 934.3 mln lekë, është realizuar 795.5 mln lekë, ose shprehur në përqindje 85% (tabela 6). Investimet e kryera nga shoqëria sipas firmave përkatëse për këtë vit janë si në tabelën e mëposhtme (tabela 8).

Zëri Makineri dhe Pajisje – Plani për vitin 2017 është 162.9 mln lekë, fakti është 129.3 mln lekë, ose shprehur në përqindje 79.4 % dhe përbëhet nga blerja e pajisjeve elektrike, elektropompa, automjete, si dhe pajisje për riparimin e tyre. Në vitin 2017 i është dhënë një rëndësi në investimin në makineri dhe pajisje, ndaj ky investim është më i lartë në krahasim me një vit më parë.

Zëri Pajisje dhe Orendi – Plani i vitit 2017 është 73.6 mln lekë, fakti është 166.8 mln lekë, ose shprehur në përqindje 226.5% dhe përbëhet nga blerja e pajisjeve informatike (kompjutera, Software, licenca, sistem kamerash), orendi zyre për administratën. Realizimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

këtij zëri është i mbartur nga një vit më parë, pasi tenderimet nga sektori i prokurimeve janë bërë në fund të atij viti, dhe kontratat janë realizuar gjatë vitit 2017 duke rënduar në buxhetin e këtij viti.

Zëri Studime dhe Projektme – Plani është 126 mln lekë dhe fakti është 0 mln lekë, si rezultat i mos kthimit në investime të disa studimeve të kryera.

Zëri Investime të tjera – Plani është 73mln lekë dhe fakti është 0 mln lekë. Në këtë zë perfshihen ndërhyrjet në rrjet, që mund të bëhën në mënyre të paparashikuar, por duke qënë se gjatë viti 2017 nuk ka patur raste të tilla, realizimi i tij është 0%

Më poshtë po ju paraqesim disa nga objektet e investimeve të realizuara dhe të përfunduara për këtë periudhë:

Tabela 8. Tabela investimeve sipas firmave plan-realizim viti 2017

Nr.	Firma zbatuese	Emërtimi i objektit	Vlera në lekë
1	B-93 & B.-I.	Ndërtim rrjet ujesjellesi ne zonen qe kufizohet nga rruget, Myslym Keta, Shefqet Kuka dhe Rr. Thoma Filipeu	15,361,499
2	I.E	Ndërtim Depo uji Daias 200 m ³ (Punime B A I Depos 200 m ³ + instalime hidraulike)	4,767,097
3	Gj.K	Mbi Rikonceptimin e Skemes se shfrytezimit te burimeve te Shen-Merise	365,267,989
4	Sh.C	Rikonstruksion I godinave te stacioneve te pompimit, basenit dhe sektorit 5	6,291,953
5	4-A..	Mbrojtja e tubacioneve DN 650, DN 600, DN 350 ne sektorin 5, ne shtratin e Perroit te Selites dhe ne Gurore	5,735,185
6	4-A..	Rikonstruksion rrjet ujesjellesi ne zonen Babrru Qender"	13,276,699
7	E.	Rikonstrukion ujesjelles ne fshatin Ndroq dhe Lagje e re (Linja kryesore STP- rezervuari 400 m ³)	16,729,300
8	K.K	Rikonstruksion rrjet kanalizimi ne Rrugen e Kavajes "nga ish N.SH.R.A.K.U deri te lumi I Lanes	38,438,913
9	K.	Rikonstruksion rrjet kanalizime ne Rrugen "Siri Kodra" (nga Rruga "Ferit Xhajko" deri ne rrugen Don Bosko" deri ne Rrugen "Besa")	4,664,075
10	I.E	Ndërtim rrjet ujësjetllësi, rruga Sulejman Pasha dhe rruga Ded Gjo Luli	14,177,486
Nr.	Firma zbatuese	Emërtimi i objektit	Vleranëlekë
11	S.	Rikonstruksion Rrjet ujesjellesi rruga "Siri Kodra" Tirane	4,646,255
12	I.E	Rikonstruksion i kolektorit të ujërave të zeza 2x1000 në rr. Shyqyri Demneri dhe rikonstruksion ujësjetllësi DN-80mm	9,983,200
13	B.-I.	Rikonstruksion i dy linjave te qendres nga Rr. Todi Shkurti deri te Pedonalja Loti I nga piketa 1 deri te piketa 17	46,279,687
14	E-K	Rikonstruksion rrjet ujesjellesi Ruga "Naim Frashëri"	20,631,306
15	N.	Ndërtim rrjet ujësjetllësi në zonën që kufizohet nga rrugët "Myslym Keta", "Rexhep Tarja" dhe "Zef Serembe" si dhe ndërtim rrjet kanalizimi.	26,182,956
16	K.	Ndërtim rrjet shperndares dhe kanalizimi ne zonen perballe ish Uzines Autotraktori (Shkoze e Siperme deri ne Lanabregas) (Loti I)	59,543,332
17	F.	Ndërtim rrjet shperndares ujesjellesi dhe rikonstruksion i linjes D-426 mm ne Rr. Mihal Grameno dhe Rr. Tomi Kristo	7,985,770
18	E.	Rikonstruksion rrjet ujesjellesi dhe kanalizimi ne Rr. "Shinasi Dishnica"	15,603,510
19	E.	Rikonstruksion linje ujesjellesi ne Blv. "Bajram C.." (Nga ETC deri te Ura ne kryqezim me RR. "Ibrahim Rugova")	13,227,277
20	K.	Rikonstruksion i linjes DV-150 mm gize dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rruges "Mihal Grameno"	33,333,400
21	A. shpk	Permiresim furnizimi me uje per zonen "Kodra e Diellit"	23,234,814
		Supervizione	2,410,634
		Investime nga punonjësit e UKT-së	45,826,099



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

		Instituti I Ndertimit	1,887,777
		TOTALI	795,486,214

Analiza e shpenzimeve për 12-mujorin 2017

Treguesit e planifikuar të shpenzimeve nga departamentet po i paraqesim në vijim:

Tabela 9. Shpenzimet Plan-Fakt viti 2017

Tab 9 – Treguesit e Shpenzimeve të rishikuara për vitin 2017						
Nr.	Emërtimi	Njësia e Matjes	Projekt Buxheti 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
	SHPENZIMET					
1	Mat.të para e mat.të tjera	mln lekë	307.30	362.69	55.40	118.03
	Tuba,rakorderi,elektrike,ndërtimi,m atësa,pjesë ndërrimi automjetesh etj.	"	189.30	214.24	24.95	113.18
	Kimikate	"	70.00	95.50	25.50	136.43
	Karbon aktiv	"	40.00	49.12	9.12	122.81
	Veshje të ndryshme pune	"	8.00	3.82	(4.18)	47.78
2	Furnitura	"	1,088.52	998.94	(89.58)	91.77
	Energji elektrike	"	450.00	379.55	(70.45)	84.35
	Karburant	"	70.00	63.87	(6.13)	91.25
	Shërbime,riparime,mirëm.me të tretë	"	69.82	20.59	(49.23)	29.49
	Shërbim verifikim dhe vulosja e matësave	"	30.00	24.50	(5.50)	81.65
	Roje objektesh	"	330.00	346.41	16.41	104.97
	Qira zyra	"	22.00	27.72	5.72	126.00
	Mirëmbajtje automjete	"	3.00	0.38	(2.62)	12.73
	Siguracion dhe kolaudim makinash	"	3.30	3.30	0.00	100.01
	Shpenzime kancelerie	"	9.00	11.07	2.07	123.01
	Shërbim printimi fatura	"	23.50	18.44	(5.06)	78.47
	Personel i jashtëm (K mbikqyres)	"	2.00	1.97	(0.03)	98.54
	Shpenzime konsulence tek-ekonomik	"	8.00	31.86	23.86	398.24
	Reklamë,publicitet,marketing	"	40.00	25.23	(14.77)	63.08
	Udhëtim e dieta	"	7.00	4.01	(2.99)	57.25
	Shpenzime postare	"	0.20	0.40	0.20	198.67
	Shpenzime telefoni	"	6.30	0.46	(5.84)	7.33
	Shërbime interneti	"	4.00	1.76	(2.24)	43.88
	Telefoni celulare	"	0.10	0.02	(0.08)	17.91
	Shërbime bankare	"	6.00	18.66	12.66	310.99
	Abonime,antarësime,librari teknike	"	0.30	0.15	(0.15)	50.00
Nr.	Emërtimi	Njësia e Matjes	Projekt Buxheti 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
	Shpenzime të përgjithshme		4.00	18.59	14.59	464.75
3	Shpenzime personeli	mln lekë	941.60	930.18	(11.42)	98.79
	Fondi pagave gjithsejt	"	648.00	641.22	(6.78)	98.95
	Trajtimi ushqimor i punonjësve	"	73.20	67.43	(5.77)	92.12
	Shpërblim	"	53.70	22.24	(31.46)	41.42
	Paga jashtë orarit	"	40.00	69.90	29.90	174.74
	Sigurime shoqërore	"	126.70	129.39	2.69	102.12
4	Tatime e taksa:	mln lekë	28.50	32.79	4.29	115.06
	Taksë vendore dhe pasurie	"	3.00	4.63	1.63	154.33
	Taksa për automjetet	"	1.50	1.61	0.11	107.41
	Tarife Erru-së	"	19.32	19.32	0.00	100.00
	Taksa të tjera	"	1.70	1.44	(0.26)	84.97
	Koncension burimesh	"	3.00	5.79	2.79	192.88
5	Gjoha penalitete dhe dëmshpërblime	"	20.00	64.47	44.47	322.34



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

6	Shpenzime të tjera rrjedhëse	"	1.00	0.14	(0.86)	13.54
7	Shpenzime amortizimi për aktivet	"	300.00	298.89	(1.11)	99.63
8	Shpenzime amortizimi emri i mirë		-	-	-	
9	Provizione të llogarive të arkëtueshme	"	47.00	38.42	(8.58)	81.75
10	Shpenzime financiare:	"	88.80	61.39	(27.41)	69.14
	Interesa të paguara	"	88.80	129.24	40.44	145.54
	Fitime Humbje nga kursi këmbimit	"		(67.84)	(67.84)	
11	Shpenzime të jashtëzakonshme	"	2.00	-	(2.00)	-
	Shuma e Shpenzimeve	"	2,824.72	2,787.91	(36.80)	98.70

Shpenzimet për vitin 2017, janë realizuar 98.70 % nga fondi prej 2,824.7 lekë që është planifikuar për këtë vit.

Zëri materiale të para është realizuar në total 118 % dhe përbëhet si më poshtë:

Zëri tuba, rakorderi– Plani 189.3 mln lekë, fakti 214.3 mln lekë ose 113 % dhe përbëhet nga blerja e tubave, rakorderive, matësave të ndryshëm dhe materialeve të tjera ndihmëse. Tejkalmi i këtij zëri vjen si shkak i realizimit të kontratave të vitit 2016 gjatë vitit 2017 duke rënduar në shpenzimet e këtij viti.

Zëri Kimikate– Plani 70 mln lekë, fakti 95.5 mln lekë ose 136.4 % dhe përbëhet nga blerja e kimikateve për nevojat e shoqërisë. Theksojmë që tejkalmi i këtij zëri me 136.4 % ka ndodhur për arsye se gjatë vitit 2017 kanë mbërritur fatura të kontratave të lidhura gjatë vitit 2016, dhe kanë rënduar në shpenzimet e vitit pasardhës.

Zëri Karbon Aktiv – Plani 40 mln lekë, fakti 49.1 mln lekë ose 122.8 % dhe përbëhet nga blerja e sasisë së nevojshme të karbonit aktiv për plotësimin e nevojave të shoqërisë. Siç e përmendëm dhe për *Zërin Kimikate*, tejkalmi në buxhet i këtij zëri rrjedh nga mbërritja e faturave nga kontratat e lidhura në vitin 2016 duke rënduar në shpenzimet e vitit 2017.

Zëri Veshje të ndryshme pune – Plani 8 mln lekë, fakti 3.8 mln lekë ose 47.7 % dhe përbëhet nga blerje e veshjeve të punës të nevojshme për nevojat e shoqërisë për periudhën 12-mujore.

Zëri furnitura dhe shërbime është realizuar në total 91.7% dhe përbëhet si më poshtë:

Zëri Energji elektrike – Plani 450 mln lekë, fakti 379.55 mln lekë ose 84.4 % të realizimit që përfshin shpenzimet e kryera për faturate energjisë elektrike.

Zëri Karburant – Plani 70 mln lekë, fakti 63.9 mln lekë ose 91.2 %, që përfshin shpenzimet e shoqërisë për karburant.

Zëri Mirëmbajtje dhe Riparime nga të tretët – Plani 69.8 mln lekë, fakti 20.6 mln lekë ose 29.5% që përfshin shpenzime riparimi për pajisjet informatike dhe shërbime të tjera riparimi.

Zëri Shërbim verifikim dhe vulosja e matësave- Plani 30 mln lekë, fakti 24.5 mln lekë ose 81.6% që përfshin verifikimin dhe vulosjen e matësave për vitit 2017.

Zëri Roje Objektesh – Plani 330 mln lekë, fakti 346.5 mln lekë ose 105 % që përfshin pagesat e detyrimeve për rojet e objekteve që kemi në ndaj firmave private me të cilat kemi lidhur kontrata.

Zëri Qira zyra – Plani 22 mln lekë, fakti 27.1 mln lekë ose 126 % që përfshin shpenzimet e kryera, për ambiente me qera për njësitë dhe zyrat e marrëdhënieve me konsumatorin dhe të arkëtimit. Tejkalmi i planit është si pasojë e shtimit të kontratave dhe zgjerimit territorial të shoqërisë.

Zëri Mirëmbajtje automjetesh – Plani 3 mln lekë, fakti 0.4 mln lekë ose 12.8%.

Zëri Siguracion dhe kolaudim makinash – Plani 3.3 mln lekë, fakti 3.3 mln lekë ose 100 %.

Zëri Kancelari – Plani 9 mln lekë, fakti 11 mln lekë ose 123 % që përfshin shpenzime kancelarie për nevojat e shoqërisë. Tejkalmi i këtij zëri vjen si pasojë e blerjeve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

kancelarive të vitit 2016 të cilat janë realizuar në fund të vitit për arsye procedurale prokurimi.

Zëri Printim faturash – Plani 23 mln lekë, fakti 18.4 mln lekë ose 78.5% që përfshin shpenzime për printim dhe zarfimin e faturës mujore sipas listës së abonentëve.

Zëri Personel i jashtëm – Plani 2 mln lekë, fakti 1.9 mln lekë ose 98.5% që përfshin shpenzimet e kryera për personel të marrë jashtë kompanisë (Këshilli Mbikëqyrës).

Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike – Plani 8 mln lekë, fakti 31.9 mln lekë ose 3924% që përfshin shpenzimet e kryera për konsulencë nga jashtë, eksperti kontabël për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, studimin e fizibilitetit të digës së Liqenit Artificial Tiranë, studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lana Bregas, vlerësimin teknik të rrjetit të UKT. Të tre këto studime fizibiliteti janë parashikuar në buxhetin e vitit 2016 në zërin Studim –Projektim, por duke qënë se kontratat e tyre janë lidhur në fillim të vitit 2017 (për arsye procedurale nga sektori i prokurimeve) rëndojnë buxhetin e këtij viti, asnjë nga këto studime nuk rezultuan të sukseshëm për ndërmarrjen e një investimi, duke stopuar në këtë formë vazhdimin e një investimi të mirëfilltë, ndaj të tre këto kontrata rëndojnë zërin e Shpenzimeve të konsulencës tekniko-ekonomike duke tejkaluar planin e vitit 2017.

Zëri Marketing dhe promovime –Plani 40 mln lekë, fakti 25.3 mln lekë ose 63.1% ku përfshihen shpenzimet e kryera për promovimin e shoqërisë në media të shkruara dhe vizive, pjesëmarrjen në panairë, etj. Janë përfshirë dy spote publicitare për promovimin e shoqërisë.

Zëri Udhëtime dhe dieta – Plani 7 mln lekë, fakti 4 mln lekë ose 57.2% që përfshihen marrja pjesë e punonjësve të Shoqërisë në aktivitetet Kombëtare dhe Ndërkombëtare që organizohen lidhur me aktivitetin kryesor të shoqërisë atë të furnizimit me ujë, gjetjes së burimeve të reja ujore si dhe të shfrytëzimit maksimal të burimeve ujore ekzistuese, menazhimit të këtyre burimeve, investimeve të domosdoshme në këtë sektor jetik, minimizimin e humbjeve të ujit dhe problematika dhe analiza të tjera.

Zëri Shpenzime postare – Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.4 mln lekë ose 198.7% që përfshin shpenzime postare për administratën.

Zëri Telefoni fikse – Plani 6.3 mln lekë, fakti 0.4 mln lekë ose 7.3% që përfshin shpenzimet e kryera nga shoqëria për telefoni fikse (nr i gjelbër).

Zëri Shpenzime interneti – Plani 4 mln lekë, fakti 1.8 mln lekë ose 43.9% që përfshin shpenzime për administratën.

Zëri telefoni celulare – Plani 0.1 mln lekë, fakti 0.02 mln lekë ose 18 % që përfshin shpenzimet për telefoni celulare për shoqërinë (dispeçeria).

Zëri Shërbime bankare – Plani 6 mln lekë, fakti 18.6 mln lekë ose 311 % që përfshin komisionet e paguara në bankë dhe disbursimet për kredinë e Shën Mërisë si dhe komisionet bankare për kredinë Japoneze.

Zëri Anëtarshime – Plani 0.3 mln lekë, fakti 0.15 mln lekë ose 50 %.

Zëri Shërbime të përgjithshme – Plani 4 mln lekë, fakti 18.6 mln lekë ose 464.8%. Në këtë zë përfshihen të gjitha shpenzimet e tjera që kryen shoqëria si azhurnime rrjeti, shpenzimet për mirëmbajtjen e ambjenteve të përbashkëta, shpenzimet e kryer për përmbaruesit në vlerën 3.45 mln lekë si dhe ljerja dhe mirëmbajtja e ambienteve të njëjësive 1 dhe 2 në vlerën 5.76 mln lekë shpenzim i cili ishte parashikuar në vitin 2016 por është realizuar në vitin 2017 për arsye procedurale dhe si rrjedhojë rëndon shpenzimet e këtij zëri për vitin aktual. Gjithashtu në realizimin e këtij zëri përfshihen shpenzime për trajnimin e punonjësve, shpenzime për analiza uji, etj.

Zëri Shpenzime për personelin është realizuar në total 98.8% dhe përbëhet si më poshtë:

Zëri Fondi i pagave – Plani 648 mln lekë, fakti 641.2 mln lekë ose 99% që përbëhet nga pagat e punonjësve të shoqërisë për 12-mujorin e vitit 2017.

Zëri Trajtim ushqimor –Plani 73.2 mln lekë, fakti 67.4 mln lekë ose 99.1%.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Zëri Shpërblime – Plani 53.1 mln lekë, fakti 22.2 mln lekë ose 41.4%.

Zëri Orë jashtë orarit – Plani 40 mln lekë, fakti 69.1 mln lekë ose 174.8% të planit.

Zëri Sigurime shoqërore – Plani 126.7 mln lekë, fakti 129.4 mln lekë ose 102.1% përfshin sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguara nga shoqëria.

Zëri Shpenzime Tatime e taksa është realizuar në 115.1% dhe përbëhet si më poshtë:

Zëri taksa vendore dhe pasurie – Plani 3 mln lekë, fakti 4.6 mln lekë ose 154.3%. Ky ndryshim niveli ka ardhur si pasojë e hapjes së ambjenteve të reja të shoqërisë gjatë këtij viti.

Zëri taksa për automjetet – Plani 1.5 mln lekë, fakti 1.61 mln lekë ose 107.4% që përfshin pagesën vjetore për automjetet e shoqërisë.

Zëri taksa e Erru-së – Plani vjetor i Tarifës së Erru-së është 19.3 mln lekë, fakti 19.3 mln lekë ose e shprehur në përqindje 100% e cila përfshin tarifën vjetore për Entin Rregullator të Ujit.

Zëri koncesion burimesh – Plani 3 mln lekë, fakti 5.8 mln lekë ose 192.8%.

Zëri Gjoha penalitete dhe dëmshpërblime, - Plani 20 mln lekë, fakti 64.5 mln lekë ose 322.3%. Tejkalimi i këtij zëri vjen si rezultat i zërit provizione për çështjet gjyqësore, i cili përfshin dëmshpërblimet për të larguarit nga puna dhe për pavlefshmëri titujsh ekzekutiv.

Zëri Shpenzime të tjera rrjedhëse, - Plani 1mln lekë, fakti 0.14 mln lekë ose 13.5% që përfshin shpenzime të kryera nga shoqëria për pritje dhe përfaqësime në aktivitetet e kryera nga ndërrmarrja.

Zëri Shpenzime amortizimi për aktivet, - Plani 300 mln lekë, fakti 298.9 mln lekë ose 99.6% duke bërë një përlllogaritje të amortizimit për vitin 2017 duke marrë parasysh shtesat dhe pakësimet e aktiveve gjatë kësaj periudhe.

Zëri Provizione të llogarive të arkëtueshme – Plani 47 mln lekë, fakti 38.4 ose 81.7%

Zëri Shpenzime financiare, - Plani 88.8 mln lekë, fakti 61.4 mln lekë ose 69.1% që përbën vlerën e interesave që do të paguhet për kreditë e marra nga shoqëria dhe nga fitimi humbja nga kursi i këmbimit. Kreditë i cilësojmë si më poshtë:

Kredia Italiane 13 mld F.ROT AID- Paguhet 2 herë në vit në muajin Shkurt dhe Gusht.

Kredia Italiane 53.2 F.ROT AID- Paguhet 2 herë në vit në muajin Mars dhe Shtator.

Kredia Italiane 6.8 F. ROT AID- Paguhet 2 herë në vit në muajin Mars dhe Shtator

Kredia Italiane Bovilla 22 mld F.ROT AID- Paguhet 2 herë në vit në muajin Prill dhe Tetor.

Kredia Italiane Elektropompa 22 F. ROT AID- Paguhet 2 herë në vit në muajin Qershor dhe Dhjetor

Kredia Hec-Lanabregas, interesat paguhet rregullisht çdo muaj, dhe

Kredia e Shfrytëzimit të burimeve të Shën-Mërisë, ku interesat e së cilës paguhet gjithashtu çdo muaj.

Tabela 10. Shpenzimet krahasim 12-mujori 2016-2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e Matjes	Plani 2016	Fakti 2016	Plani 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
SHPENZIMET								
1	Mat.të para e mat.të tjera	mln/lekë	290.50	243.71	307.30	362.69	118.98	48.82
	Tuba,rakorderi,elektrike,ndërtimi,matësia,pjesë ndërrimi automjeteve etj.	"	186.50	154.43	189.30	214.24	59.82	38.73
	Kimikate	"	62.00	58.86	70.00	95.50	36.64	62.26
	Karbon aktiv	"	36.40	28.60	40.00	49.12	20.52	71.74
	Veshje të ndryshme pune	"	5.60	1.82	8.00	3.82	2.00	110.28
2	Furnitura	"	641.20	710.05	1,088.52	998.94	288.89	40.69
	Energji elektrike	"	220.00	348.23	450.00	379.55	31.32	9.00
	Karburant	"	62.10	46.77	70.00	63.87	17.10	36.57
	Shërbime,riparime,mirërm.me të tretë	"	52.80	34.26	69.82	20.59	(13.67)	(39.91)
	Shërbim verifikim dhe vulosja e matësia	"	12.40	21.51	30.00	24.50	2.99	13.89
	Roje objektesh	"	163.40	151.84	330.00	346.41	194.57	128.14
	Qira zyra	"	20.20	21.01	22.00	27.72	6.71	31.91
	Mirëmbajtje automjete	"	2.00	0.38	3.00	0.38	0.01	1.75
	Siguracion makinash	"	1.70	1.73	3.30	3.30	1.57	90.63
	Shpenzime kancelerie	"	13.80	15.41	9.00	11.07	(4.34)	(28.16)
	Shërbim printimi fatura	"	20.20	17.80	23.50	18.44	0.64	3.61
	Personel i jashtëm (K/mbikqyres)	"	2.00	2.01	2.00	1.97	(0.04)	(1.86)
	Shpenzime konsulence tek-ekonomik	"	10.70	2.77	8.00	31.86	29.09	1,050.89
	Reklamë,publicitet,marketing	"	40.00	21.70	40.00	25.23	3.53	16.29
	Udhëtim e dieta	"	10.00	6.43	7.00	4.01	(2.42)	(37.64)
	Shpenzime postare	"	0.30	0.21	0.20	0.40	0.18	85.14
	Shpenzime telefoni	"	0.30	0.29	6.30	0.46	0.17	58.43
	Shërbime interneti	"	2.50	1.45	4.00	1.76	0.31	21.21
	Telefoni celulare	"	1.00	0.24	0.10	0.02	(0.22)	(92.62)
	Shërbime bankare	"	2.00	4.70	6.00	18.66	13.96	296.66
	Abonime,antarësime,librari teknike	"	0.60	0.23	0.30	0.15	(0.08)	(33.91)
	Shpenzime të përgjithshme	"	3.20	11.08	4.00	18.59	7.51	67.82
3	Shpenzime personeli	mln/lekë	849.30	780.11	941.60	930.18	150.07	19.24
	Fondi pagave gjithsej	"	592.40	549.10	648.00	641.22	92.12	16.78
	Trajtimi ushqimor i punonjësve	"	69.00	61.12	73.20	67.43	6.31	10.32
	Shpërbim	"	49.40	22.46	53.70	22.24	(0.22)	(0.97)
	Paga jashtë orarit	"	24.00	39.59	40.00	69.90	30.31	76.55
	Sigurime shoqërore	"	114.50	107.83	126.70	129.39	21.56	19.99
4	Tatime e taksa :	mln/lekë	32.20	28.41	28.52	32.79	4.38	15.42
	Taksë vendore dhe pasurie	"	3.00	-	3.00	4.63	4.63	-
	Taksa për automjetet	"	1.50	1.48	1.50	1.61	0.13	8.68
	Tarifë Erru-së	"	19.30	19.32	19.32	19.32	-	-
	Taksa të tjera	"	1.40	0.35	1.70	1.44	1.09	307.83
	Koncension burimesh	"	7.00	7.25	3.00	5.79	(1.47)	(20.23)
5	Gjoha penalitete dhe dëmspërbim	"	44.20	153.89	20.00	64.47	(89.43)	(58.11)
6	Shpenzime të tjera rrjedhëse	"	2.00	0.26	1.00	0.14	(0.13)	(48.70)
7	Shpenzime amortizimi për aktivet	"	300.00	275.21	300.00	298.89	23.68	8.60
8	Shpenzime amortizimi emri i mirë	"	260.00	239.02	-	-	(239.02)	(100.00)
9	Provizione të llogarive të arkëtues	"	-	(57.94)	47.00	38.42	96.36	(166.32)
10	Shpenzime financiare :	"	88.80	27.36	88.80	61.39	34.03	124.39
	Interesa të paguara	"	88.80	88.42	88.80	129.24	40.82	46.16
	Fitime/Humbje nga kursi këmbimit	"	-	(61.06)	-	(67.84)	(6.78)	11.11
11	Shpenzime të jashtëzakonshme	"	2.00	-	2.00	-	-	-
	Shuma e Shpenzimeve	"	2,510.20	2,400.08	2,824.74	2,787.91	387.83	16.16

Si rezultat i analizës së përgjithshme të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shoqëria rezulton me një rritje të shpenzimeve me 387.8 mln lekë ose me 16.2 %, kjo rritje bazuar edhe në rritjen e planit në krahasim me vitin 2016.

Analiza e fitimit për vitin 2017

Tabela 11. Fitimi Plan-Fakt 12-mujori 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
 Kanalizime” SHA, Tiranë.**

Nr.	Emërtimi	Njësia e Matjes	Projekt Buxheti 2017	Fakti 2017	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
1	Fitimi para tatimit	mln lekë	858.30	519.27	(339.03)	60.50
2	Tatim fitimi	"	138.79	88.12	(50.67)	63.49
3	Fitimi Humbja neto	mln lekë	719.50	431.15	(288.35)	59.92

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime sh.a në bazë të treguesve ekonomik për 12-mujorin 2017 paraqitet me një fitim bruto në masën 431.2 mln lekë, me një realizim më të ulët prej 288.4 mln lekë nga parashikimi. Të ardhurat e shoqërisë janë realizuar në vlerën 3,307.2mln lekë nga planifikimi prej 3,683 mln lekë, pra në masën 89.8%, ndërsa shpenzimet janë realizuar 2,788 mln lekë nga vlera e planifikuar prej 2,824.7 mln lekë me një realizim prej 98.7%. Fitimi neto i shoqërisë është ulur me 288.35 mln lekë krahasuar kjo me vlerën e planifikuar për 12-mujorin e këtij viti që ka qënë 719.5 mln lekë. Një nga arsyet, që ka ndikuar në mos realizimin e fitimit, janë ulja e të ardhuravë pas datës 21.11.2017, me ndarjen e shoqërisë nga Njesia Vorë.

Tabela 12. Fitimi krahasimi 12-mujori 2016-2017

N r	EMËRTIMI	Njësia e Matjes	Plani 2016	Fakti 2016	Plani 2017	Fakti 2017	Ndryshim i në vlerë	Ndryshim i në %
1	Fitimi para tatimit	mln lekë	839.60	675.37	858.28	519.27	(156.09)	(23.11)
2	Tatim fitimi	"	144.31	113.49	138.79	88.12	(25.37)	(22.35)
3	Fitimi Humbja neto	mln lekë	695.30	561.88	719.49	431.15	(130.72)	(23.27)

Siç e shohim dhe nga tabela e mësipërme, në krahasim me vitin e kaluar fitimi ka një rënie prej 130.7 mln ose në vlerë relative një rënie prej 23.3 %. Kjo vjen si rezultat i rritjes së shpenzimeve në krahasim me një vit më parë me 387.8 mln dhe i rritjes së të ardhurave me 231.7 mln lekë.

Të dhënat ekonomiko-financiare në lidhje me prodhimin, faturimin dhe arkëtimin e ujit Mbi prodhimin dhe faturimin e ujit.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për vitin 2017, të dhënat mbi prodhimin dhe faturimin e ujit, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi / Periudha	Shitje m ³ 2017	Prodhim m ³ 2017	Humbjet në sasi (m ³) 2017	Humbjet në % 2017
Janar	2,852,502	8,602,242	5,749,740	67%
Shkurt	2,879,705	8,495,909	5,616,204	66%
Mars	2,792,420	8,610,265	5,817,846	68%
Prill	2,880,519	8,580,845	5,700,326	66%
Maj	2,892,698	8,753,682	5,860,985	67%
Qershor	3,091,292	8,561,973	5,470,681	64%
Korrik	3,012,211	8,138,827	5,126,616	63%
Gusht	2,993,868	7,800,456	4,806,589	62%
Shtator	2,890,555	7,578,327	4,687,772	62%
Tetor	2,937,499	7,783,139	4,845,641	62%
Nëntor	2,764,710	7,744,776	4,980,066	64%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Dhjetor	2,756,469	9,307,558	6,551,089	70%
TOTAL VJETOR	34,744,446	99,957,999	65,213,553	65%

Nga sa më sipër, konstatohet se për vitin 2017, janë prodhuar gjithsej 100 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 35 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 65% të ujit të prodhuar.

Sipas programit ekonomik-financiar të vitit 2017, **niveli i humbjeve i miratuar është në masën 62%, duke e tejkaluar këtë limit.**

Ndërsa për periudhën Janar – Gusht 2018, të dhënat mbi prodhimin dhe faturimin e ujit, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi / Periudha	Shitje m ³ 2018	Prodhim m ³ 2018	Diferenca në sasi (m ³) 2018	Diferenca në % 2018
Janar	2,942,263	8,700,500	5,758,237	66%
Shkurt	2,840,211	7,568,984	4,728,773	62%
Mars	2,759,937	7,965,377	5,205,440	65%
Prill	2,891,663	7,784,031	4,892,369	63%
Maj	2,925,946	7,836,680	4,910,734	63%
Qershor	3,089,594	7,759,027	4,669,433	60%
Korrik	2,879,941	7,611,474	4,731,534	62%
Gusht	2,976,973	7,466,276	4,489,303	60%
TOTAL VJETOR	23,306,528	62,692,349	39,385,821	63%

Nga sa më sipër, konstatohet se për periudhën Janar – Gusht 2018, janë prodhuar gjithsej 63 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 23 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në **masën 63%** e ujit të prodhuar. Sipas programit ekonomik-financiar të vitit 2018, niveli i humbjeve i miratuar është në **masën 63.3%**.

Edhe pse humbjet në rrjet janë zvogëluar me 2% në vitin 2018 dhe nuk e kanë tejkaluar limitin e miratuar, sërish këto humbje janë në nivele shqetësuese, duke cënuar në këtë mënyrë dhe performancën ekonomik-financiare të shoqërisë.

Mbi faturimin dhe arkëtimin e ujit.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i vënë në dispozicion, në lidhje me procesin e arkëtimin dhe faturimit, u konstatua se arkëtimi koherent për çdo muaj, për periudhën janar 2017 – gusht 2018, është sipas tabelës së mëposhtme:

Muaji	Arkëtim	Faturim	% e Arkëtimin
Janar 2017	160,045,925.60	268,567,906	60%
Shkurt 2017	170,471,053.30	277,469,169	61%
Mars 2017	151,504,407.30	268,093,814	57%
Prill 2017	169,384,308.84	278,076,013	61%
Maj 2017	166,804,932.57	278,574,738	60%
Qershor 2017	189,529,385.85	304,020,617	62%
Korrik 2017	164,166,220.00	291,798,431	56%
Gusht 2017	173,183,407.23	286,565,270	60%
Shtator 2017	175,867,628.45	277,403,773	63%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

Tetor 2017	167,849,468.55	281,051,656	60%
Nëntor 2017	169,050,760.88	267,705,720	63%
Dhjetor 2017	168,526,438.37	261,556,282	64%
Janar 2018	227,714,371.20	375,988,252	61%
Shkurt 2018	229,547,343.16	371,240,807	62%
Mars 2018	222,907,031.44	359,543,808	62%
Prill 2018	238,633,735.51	374,230,243	64%
Maj 2018	240,835,099.09	381,739,512	63%
Qershor 2018	256,336,741.10	405,298,092	63%
Korrik 2018	233,963,260.42	374,947,599	62%
Gusht 2018	223,763,926.31	385,846,681	58%

Sipas kësaj tablele, konstatohet se **niveli mesatar i arkëtimit për faturat e periudhës është 61% të faturimit**. Ndërsa për nivelin e arkëtimit në total për çdo muaj, konstatohet se niveli i arkëtimit për vitin 2017 në masën 133% ndërsa për periudhën janar-gusht 2018 është në masën 124%.

Nga sa më sipër konstatohet se, UKT arkëton më shumë detyrime të prapambetura se detyrime e periudhës.

Mbi debitorët.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se të dhënat për debitorët e shoqërisë (në lidhje me shërbimin kryesor – faturimin e ujit) deri më datë 31.12.2017, konstatohet se janë sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Total Debi	% ndaj totalit	Nr. Debitorësh
Buxhetorë	118,018,910	3%	552
Familjarë	2,697,999,062	66%	53,484
Familjarë pa kanalizime	680,852,502	17%	11,754
Familjarë pa ujë	327,524	0%	74
Jo-Buxhetorë	70,407,675	2%	76
Privat	459,200,406	11%	12,822
Privat pa kanalizime	43,687,545	1%	642
Privat pa ujë	139,190	0%	21
SHUMA	4,070,632,815		79,425

Siç konstatohet sipas tabelës së mësipërme, deri më datë 31.12.2017, shoqëria ka në total 79,425 abonentë debitorë nga 237,245 abonentë në total (**33% e totalit**), të cilët i detyrohen shoqërisë UKT SHA vlerën 4,070,632,815 lekë.

Kjo vlerë, e cila është relativisht shumë e lartë, për arsye se është e barabartë me 125% të të ardhurave nga shitjet e shoqërisë, pasqyruar në pasqyrat financiare.

Ndërsa të akumuluar, debitorët deri më datë 31.07.2018, konstatohet se janë sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Total Debi	% ndaj totalit	Nr. Debitorësh
Buxhetorë	112,887,325	3%	549



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

Familjarë	2,844,610,841	67%	56,045
Familjarë pa kanalizime	692,283,603	16%	11,680
Familjarë pa ujë	529,556	0%	64
Jo-Buxhetorë	66,024,019	2%	71
Privat	490,923,548	12%	13,256
Privat pa kanalizime	44,569,913	1%	649
Privat pa ujë	164,754	0%	19
SHUMA	4,251,993,560		82,333

Siç konstatohet sipas tabelës së mësipërme, deri më datë 31.07.2018, shoqëria ka në total 82,333 abonentë debitorë nga 249,792 abonentë në total (**33% e totalit**), të cilët i detyrohen shoqërisë UKT SHA vlerën 4,251,993,560 lekë.

Numri i abonentëve debitorë periudhën janar-korrik, është rritur me 2,908 abonentë ose 4%, në krahasim periudhën deri më datë 31.12.2017.

Ndërsa vlera e abonentëve debitorë periudhën janar-korrik, është rritur me 181,360,745 lekë ose 4%, në krahasim periudhën deri më datë 31.12.2017.

Arkëtimi i këtyre vlerave, do ndikonte në mënyrë të dukshme performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë, dhe jo vetëm për arsye se shoqëria do kishte fonde të mjaftueshme për të kryer investime në rrjetin e ujësjellësit, që do kishte një rritje dhe në performancën operacionale të shoqërisë.

Nga verifikimi i debitorëve, konstatohet se pjesën më të madhe si në numër (68% të totalit) dhe në vlerë (67% të totalit), e zënë abonentët familjarë. Gjithashtu dhe abonentët Buxhetorë, edhe pse janë në një numër relativisht të vogël, debia e tyre totale është në vlerë të konsiderueshme.

Nga verifikimi i listave të debitorëve të datës 31.07.2018, konstatohet se 11 debitorët (*ato me vlerë detyrimi mbi 5 milion lekë*) me vlerë më të lartë dhe që përbëjnë në total 2% të debisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emri i Abonentit	Kategoria	Debia
1	Q.S. Universitare “Nene Tereza”	Buxhetorë	18,237,403
2	B.TSh.A	Privat	12,776,179
3	A.H SH.A	Privat	10,392,406
4	Banka e Shqipërisë	Buxhetorë	10,161,943
5	Ndërmarrja Trajtimit Studentave Godina Nr. 26/27(2)	Jo- Buxhetorë	8,874,244
6	A. SHPK	Privat pa kanal.	6,733,684
7	Ndërmarrja Trajtimit Studentave Godina Nr. 24/25	Jo- Buxhetorë	6,222,505
8	H.H.T	Privat	5,996,915
9	Ndërmarrja Trajtimit Studentave Godina Nr. 20/21(2)	Jo- Buxhetorë	5,932,515
10	I.B	Privat	5,928,777
11	F.E..E	Privat	5,043,989
SHUMA			96,300,560

Sipas listës së mësipërme konstatohet se *debitori më i madh është shoqëria “Rezidenca Studentore Nr. 1 Tiranë” SHA*, shoqëri publike aksionet e të cilës zotërohen 100% nga Bashkia Tiranë (që është njëkohësisht aksioneri i UKT SHA) dhe që detyrimi i saj vetëm për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

3 godina është në vlerën 21,029,264 lekë. Gjithashtu në listën e debitorëve më të mëdhenj janë dhe 2 institucione të tjera si Qendra Universitare Spitalore “Nënë Tereza” në vlerën 18,237,403 lekë dhe Banka e Shqipërisë në vlerën 10,161,943 lekë.

Mbi masat administrative (gjobat) e vendosura dhe arkëtimi i tyre.

Në zbatim të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjiellës Kanalizime SHA””, për shkeljet e konstatuara nga ana e sektorit të Task-Force, për periudhën objekt auditimi, janë vendosur masat administrative (gjobat) si më poshtë:

-Gjoba në sistemin e faturimit (SMI) për vitin 2017, në total 371 gjoba me vlerë 9,421,000 lekë. Nga këto:

- 213 gjoba të paguara me vlerë 4,284,000 lekë dhe
- 158 gjoba të papaguara me vlerë 5,137,000 lekë.

-Gjoba në sistemin e faturimit (SMI) për vitin 2018, në total 79 gjoba me vlerë 2,773,000 lekë. nga këto:

- 19 gjobatë paguara me vlerë 630,000 lekë dhe
- 60 gjoba të papaguara me vlerë 2,143,000 lekë.

-Gjoba në NUIS për vitin 2017 janë vendosur 32 gjoba në vlerën 1,080,000 lekë dhe për vitin 2018 janë vendosur 15 gjoba në vlerën 750,000 lekë. Të gjitha këto gjoba janë të paarkëtuara.

Në zbatim të pikës 2/k, të nenit 30, të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha nr.7, datë 04.04.2016, si dhe pikës 2/k, të nenit 185, të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018, detyrën për vjeljen e gjobave administrative e ka sektori (ish-drejtoria) i Task-Force, pjesë e Departamentit të Shitjes.

Mos vjelja e gjobave **në vlerën 9,110,000 lekë**, që përbëjnë 65% të totalit të gjobave të vendosura, ka shkaktuar rritje të mëtejshme të debisë, çka përktëhet në **të ardhura të munguara për shoqërinë.**

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23909/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/6, datë 16.11.2018, nga Departamenti i Shitjes, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 3, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi prodhimin dhe faturimin e ujit nuk qëndron, për arsye se juve nuk keni sqaruar arsyet e tejkalimit të nivelit të miratuar të humbjeve.

Së dyti, pretendimi juaj në lidhje me të dhënat mbi faturimin dhe arkëtimin e ujit nuk qëndron, për arsye se të dhënat e grupit të auditimit janë marrë po nga departamenti juaj.

Së treti, pretendimi juaj mbi debitorët qëndron pjesërisht. Konkretisht masa e marra nga ju për uljen e debisë qëndrojnë, por efekti i tyre shtihet në një periudhë të gjatë kohore, e për pasojë efektet e saj do ndihen në një periudhë të mëvonshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

C. AUDITIMI I LLOGARIVE PËR PERIUDHËN 01.01.2017-31.08.2018.

C.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 893/1 Prot, datë 31.07.2018, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë, për zbatimin e rekomandimeve.

-Dokumentacioni mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Nga auditimi i ushtruar në Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SH.A (këtu e më poshtë UKT SHA), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën me shkresën nr. 142/16, datë 20.06.2017, konstatohet se:

-Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, ka përgatitur një program pune në zbatim të urdhrit nr. 35, datë 13.01.2017, dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të Drejtorisë për zbatimin e tyre.

-Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se ky afat është zbatuar dhe se është dërguar ky plan veprimi me shkresën nr. Nr. K-1354/2 prot, datë 10.07.2017, i cili është hartuar brenda afatit në përputhje me neni 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, nga UKT SHA nuk është raportuar me shkrim për zbatimin e rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga dërgimi i shkresës së KLSH së.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

-Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore nuk janë lënë rekomandime.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 16 masa dhe 1 masë nuk është pranuar.

-Për shpërblim dëmi janë lënë 11 rekomandime, nga të cilat, 9 masa janë zbatuar dhe 2 masa nuk janë pranuar.

-Nga masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të rekomanduara gjithsej 1 masë, e cila është zbatuar.

-Janë rekomanduar 15 masa disiplinore, a të cilat janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 3 masa administrative, të cilat janë zbatuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.

Nga auditimi u konstatua se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1354/2 prot, datë 10.07.2017 në KLSH “Mbi programin e punës për zbatimin e Rekomandimeve të vendosura me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet me shkresën nr. 142/66/109 prot, datë 20.06.2017.

Drejtori i Përgjithshëm i UKT ka nxjerrë urdhrin nr. 513, datë 19.07.2016 “Mbi miratimin e programit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 253/13, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

06.07.2016”. Ky program është vendosur bashkëlidhur shkresës së kthimit të përgjigjes dhe ka të përcaktuar drejtoritë përgjegjëse si dhe afatet e realizimit.

A. MASAT ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1. Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi drejtues i UKT, të marrin masa të shmangin ndryshimet e pajustificuara të programeve ekonomike gjatë vitit, kryesisht për të justifikuar mosrealizimet e disa treguesve apo tejkallimet në zëra të shpenzimeve, duke evidentuar personat përgjegjës dhe propozuar masat për të përmirësuar situatën në të ardhmen.

Zbatimi i rekomandimit

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nga ana e UKT ka pasur vetëm 1 ndryshim të programit ekonomik për vitin 2017, si edhe 1 ndryshim për vitin 2018. Në të dyja rastet këto ndryshime kanë qenë me kërkesë dhe miratim nga Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme. Përkatësisht në datën 25.09.2017 nga Këshilli Mbikqyrës është marrë vendimi me nr. 16 mbi një ndryshim për programin ekonomik. Ky ndryshim është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin nr. 9, datë 27.09.2017.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 2. Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi drejtues i UKT, të marrin masa për të arritur të shfrytëzojnë kapacitetet tekniko-ekonomike për rritjen e të ardhurave nga faturimi i ujit, uljen e humbjeve në rrjet, lidhjen e kontratave të reja, reduktimin e ujit pa të ardhura dhe ndjekjen e arkëttimeve, me qëllim rritjen e të ardhurave nga aktiviteti kryesor dhe realizimin e objektivave të zhvillimit të shoqërisë.

Zbatimi i rekomandimit

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se edhe pse numri i kontratave të reja ka ardhur në rritje, humbjet e ujit janë në nivele më të larta se ato të parashikuara.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 3. UKT Sha, të ndërpresë praktikën e ristrukturimit të vazhdueshëm dhe ndërhyrjes në strukturat organike të shoqërisë, me synim shmangien e pasojave sociale dhe financiare të këtyre vendimeve, që mund të shtoheshin shoqërisë si pasojë e humbjeve të proceseve gjyqësore.

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për sistemimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin ligjor referuar ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 “Për mbarëvajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe kontratës kolektive të shoqërisë, si dhe të pajisë punonjësit me kopje të kontratës individuale të punës.

Zbatimi i rekomandimit

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka zbatuar rekomandimin e lënë për sistemimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit.

Gjithashtu është konstatuar se nga ana e UKT Sha nuk ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme në strukturën organike duke sjellë shmangien e proceseve gjyqësore me punonjësit.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 4. Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi drejtues i UKT, të marrin masa dhe të programojnë detyrimin në zbatim të shkronjës “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekur politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë” monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Rekomandimi është zbatuar. Konkretisht me Urdhër-Pagesën datë 08.10.2017, drejtuar Bankës Raiffeisen, është kryer pagesa në vlerën 6,412,200 lekë, për llogari të Institutit të Integritimit të ish-të Përndjekurve Politikë për vitin 2017, ndërsa me Urdhër Pagesën datë 17.10.2018, është kryer pagesa në vlerën 5,491,000 lekë, për llogari të Institutit të Integritimit të ish-të Përndjekurve Politikë për vitin 2016.

Rekomandimi 5. Drejtoria e Financës, të marrin masat për të kryer inventarizimin e aseteve në mënyrë korrekte duke pasqyruar të gjitha të dhënat e aseteve dhe specifikimet teknike të pajisjeve së bashku me vendndodhjen e tyre të saktë. Të përcaktohen qartë përgjegjësitë e grupeve të inventarizimit, për tu larguar nga praktikat e formalitetit të konstatuar në realizimin e këtij procesi, kjo bazuar sipas kërkesave të një sistemi menaxhimi financiar dhe kontrolli të strukturuar mirë.

-Drejtoria e Financës të marrë masa që mallrat të cilat janë vlerësuar si mallra stok, të vlerësohen dhe të përdoren ose nga UKT Sha ose nga njësitë e tjera operative me qëllim që të shmangët kryerja e procedurave të panevojshme të prokurimit për mallra ose pajisje që mund të jenë në gjendje të mire tek mallrat stok.

-Drejtoria e Financës të marrë masa për të nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave me përgjegjësi materiale në rastet që ato janë dëmtuar ose vjedhur.

Zbatimi i rekomandimit

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm me urdhrin e brendshëm nr. 465, datë 21.09.2017 ka ngritur komisionin e vlerësimit të materialeve stok në magazinat e UKT Sha.

-Nga ana e grupi të inventarizimit është bërë relacioni me nr. 3215 prot, datë 20.10.2017 ku janë pasqyruar me saktësi mallrat të cilët janë në gjendje jo funksionale dhe të papërdorshme ku dhe kanë propozuar nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 6. UKT Sha, në cilësinë e autoritetit kontraktor, të marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin me korrektësi të procesit të prokurimit publik, duke shmangur kriteret të cilat ulin konkurrencën, dhe pranimin e ofertave me shmangie të vogla të cilat nuk devijojnë në thelb ofertën, me synim rritjen e përfitimeve të institucionit në realizimin e kontratave.

Zbatimi i rekomandimit

Nga auditimi i procedurave të prokurimeve publike, janë konstatuar vendosja e kriterëve të cilat janë jo në përputhje me LPP, por që nuk kanë ndikuar në uljen e konkurrencës.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 7. UKT Sha, të bëjë vlerësimin në kohë të ofertave dhe anulojë procedurat e prokurimit, në rastet e tërheqjes së operatorëve ekonomikë me vlera më të ulëta nga gara, me qëllim shmangien e lidhjes së kontratave me vlera më të larta.

Zbatimi i rekomandimit

Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit nuk janë konstatuar problematika të tilla në procedurat e prokurimit, por vetëm në rastet e blerjeve me vlera të vogla. Trajtuar më hollësisht në pikën e prokurimeve.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 8. UKT Sha, të marrë masa dhe t'i kërkojë kontraktorit riparimin e shtresave rrugore të dëmtuara ndërmjet piketave 9 deri 8, 8 deri 7, 7 deri 5, 5 deri 4 dhe 4 deri 2, si edhe në segmentin ndërmjet piketave 30 dhe 39.

Zbatimi i rekomandimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

Me shkresën nr. 18913 prot, datë 04.10.2017 i është kërkuar shoqërive sipërmarrëse “E.K dhe 4 A-M,, dhe Mbikqyrësit të Punimeve “A..” shpk marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas pikës b.

Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi 9. UKT Sha, në cilësinë e autoritetit kontraktor, të marrë masa për planifikimin e saktë të nevojave vjetore, me qëllim përzgjedhjen e drejtë të llojt të procedurave të prokurimit, të cilat lidhen me zhvillimin e aktivitetit kryesor të shoqërisë, si dhe zhvillimin e procedurave të hapura të prokurimit, me qëllim arritjen e kontratave për mallra e shërbime me ekonomicitet dhe efektivitet.

-Drejtoria e prokurimeve dhe njësia e prokurimit, të marrë masa që për prokurimet e planifikuara në llogaritjen e vlerës së kontratës të merren në konsideratë edhe vlerat e kontratave të realizuara në vitet e mëparshme, duke analizuar çmimet me qëllim arritjen e kontratave me vlerë më të ulët, duke respektuar parimet e prokurimit dhe një nga kriteret kryesore, arritjen e prokurimit të mallrave sipas specifikimeve të kërkuara me çmim sa më të ulët.

Zbatimi i rekomandimit

Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar që nga ana e UKT-së është zbatuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja.

Rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 10. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa për kryerjen e procedurave në varësi dhe në përputhje me natyrën e shërbimeve, punëve dhe mallrave referuar legjislacionit në fuqi.

Zbatimi i rekomandimit

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar që të gjitha prokurimet janë kryer në varësi dhe për puthje me natyrën e shërbimeve

Rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 11. Drejtori i UKT Sha, të marrë masa për eliminimin e arkës, veprimet e kryera nga arka të kryhen nëpërmjet bankës, me qëllim kufizimin e veprimeve CASH dhe uljen e shpenzimeve.

Zbatimi i rekomandimit

Rekomandimi nuk është pranuar nga UKT Sha., për arsye se ka zgjeruar gamën e mënyrave të arkëtimit, me qëllim përfundimtar uljen e debitorëve.

Rekomandimi 12. Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa për hartimin e procedurave për administrimin me e efektivitet të karburantit, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe shmangien e abuzimeve.

-Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Auditit, të marrin masa për saktësimin e përgjegjësisë lidhur me sasinë e konstatuar me mungesë për 2 artikujt për 570 litra naftë dhe 160 litra benzinë, në shumën 119,470 lekë.

Zbatimi i rekomandimit

Procedurat për administrimin e karburantit, janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, miratuar me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018.

Rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 13. Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për kryerjen në kohë të pagesave për detyrimet tatimore, me qëllim shmangien e kostove të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

pajustificuara të institucionit, ndërkohë që duhet të përcaktohet përgjegjësia për pagesat e gjobave, të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në UKT Sha.

Zbatimi i rekomandimit

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk konstatohen pagesa të vonuara për detyrime tatimore.

Rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 14. Drejtoria Teknike të marrë masa për monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, të kryejë analiza të ujërave të ndotura dhe të mbahet regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtja e tyre dhe IA..mi në mënyrë legale dhe të autorizuar, regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, si dhe të zbatohet procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

Zbatimi i rekomandimit

Zbatimi i këtij rekomandimi është pjesë e procesit të përditshëm të punës dhe relatohet në materialet e përgatitura nga Departamenti Inxhinierik.

Rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 15. UKT Sha, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Zbatimi i rekomandimit

Drejtoria Juridike/Sektori i Përfaqësimit ligjor ka hartuar kërkesë padinë për kërkimin e dëmit të shkaktuar nga subjekti M.M.

Rekomandimi është zbatuar

B. 1-MASA SHPËRBLIM DËMI

1. UKT SHA, të kryej kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **270,000 lekë**, të shkaktuar shoqërisë për gjobë deklarim të vonuar të ESIG 27 nga 3 punonjës:

F.M shumën 80,000 lekë.

I.Z shumën 100,000 lekë.

E.M shumën 90,000 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar

Ky rekomandim nuk pranohet bazuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 06.07.2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Raportit Përfundimtar Nr. 142/16, datë 20.06.2017”, pika 2 ku është vendosur: Moszbatimin e rekomandimeve për masat shpërblim dëmi të vendosura ndaj punonjësve të shoqërisë UKT sh.a, të vendosura në Raportin Përfundimtar dërguar me shkresën nr. 142/16 prot, datë 20.06.2017.

2. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën **2,907,824 lekë**, nga anëtarët e KVO të përbërë nga z. M.Q, znj.M.B dhe z.D.M dhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. K.H, znj.B.Xh dhe z.I.G.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Rekomandimi nuk është pranuar

Ky rekomandim nuk pranohet bazuar në Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 14, datë 06.07.2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Raportit Përfundimtar Nr. 142/16, datë 20.06.2017”, pika 2 ku është vendosur: Moszbatimin e rekomandimeve për masat shpërblimit të vendosura ndaj punonjësve të shoqërisë UKT sh.a, të vendosura në Raportin Përfundimtar dërguar me shkresën nr. 142/16 prot, datë 20.06.2017.

3. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 16,042,818 lekë, nga Kontraktori, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “N.M sh.p.k & H. sh.p.k”, për punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “N.M sh.p.k & H. sh.p.k” ndaj UKT sh.a, vlerën prej 16,042,818 lekë. Është dërguar shkresa nr. 13418 prot, datë 05.07.2017 për rekomandimet e lëna nga KLSH. Spektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej 16,042,818 lekë.

4. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 2,117,135 lekë, nga Kontraktori, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “K. & A..”, për punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “K. & A.. sh.p.k” ndaj UKT sh.a, vlerën prej 2,117,135 lekë. Është dërguar shkresa nr. 18909 prot, datë 04.10.2017 për rekomandimet e lëna nga KLSH. Spektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej 2,117,135 lekë.

5. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 2,604,240 lekë, nga Kontraktori, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “JV K. & K.I”, për punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është në zbatuar

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se nga ana e Drejtorisë së Financës është arkëtuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera prej 2,604,240 lekë.

6. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 329,685 lekë, nga Kontraktori, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B 93 & B.-I.”, për punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “B 93 & B.-I.”, ndaj UKT sh.a, vlerën prej 329,685 lekë. Është dërguar shkresa nr. 18911 prot, datë 04.10.2017 për rekomandimet e lëna nga KLSH. Spektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej 329,685 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

7. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **465,126 lekë**, nga Kontraktori, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “E.K” & 4 A-M”, për punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “E.K” & 4 A-M”, ndaj UKT sh.a, vlerën prej **465,126 lekë**. Është dërguar shkresa nr. 18913 prot, datë 04.10.2017 për rekomandimet e lëna nga KLSH. Spektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej **465,126 lekë**.

8. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **729,240 lekë**, nga z. N.Gj, për moszbatimin e kontratës shtesë në masën 20% për nevojat e fillim vitit dhe nënshkrimin e kontratës me çmim më të lartë nga kontrata e mëparshme.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të Z.N.Gj, ndaj UKT sh.a, vlerën prej **729,240 lekë**. Drejtoria Juridike/Spektori i Përfaqësimit Ligjor po përgatit në vazhdim kërkesë padinë.

9. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **942,000 lekë**, nga Kontraktori “A..” sh.p.k, për furnizime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “A..”, ndaj UKT sh.a, vlerën prej **942,000 lekë**. Spektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej **942,000 lekë**.

10. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **634,694 lekë**, nga Kontraktori “K.K” sh.p.k, punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar

Spektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “K.K” sh.p.k”, ndaj UKT sh.a, vlerën prej **634,694 lekë**. Është dërguar shkresa nr. 18912 prot, datë 04.10.2017 për rekomandimet e lëna nga KLSH. Spektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej **634,694 lekë**.

11. Nga UKT SHA, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **700,400 lekë**, nga Kontraktori “K.I” sh.p.k & “C..” sh.p.k, për punime të pa realizuara.

Menjëherë

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Sektori i Kontabilitetit ka kontabilizuar si detyrim të “**K.I**” sh.p.k & “**C..**” sh.p.k, ndaj UKT sh.a, vlerën prej **700,400 lekë**. Sektori i Financës ka mbajtur vlerën e detyrimit të kontabilizuar prej **700,400 lekë**.

C. SHPENZIME ME EFEKTE NEGATIVE NË REZULTATET FINANCIARE DHE TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Këshillim Mbikëqyrës në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e Përgjithshëm dhe strukturat drejtuese të UKT, të ndërmarrin një iniciativë rregullative që do të mundësonte vënin nën kontroll të këtij borxhi të lartë që ka efekte negative në performancën financiare të shoqërisë e përkthyer më pas në mungesë investimesh dhe rritje të cilësisë së shërbimit të ofruar qytetarëve.

Rekomandimi është zbatuar

Departamenti i Shitjes në bashkëpunim me Njësitë Zonale, Drejtorinë Rajonale dhe Drejtorinë Task Forcë ka hartuar plane konkrete pune për: Formalizmin e procesit të matjes, nëpërmjet vendosjes së ujëmatësve në kontrata që faturohen me mesatare apo zëvendësimin e ujëmatësve jashtë kushteve teknike, kontroleve të linjave të paligjshme dhe hapjen e kontratave të reja në objekte që furnizohen me ujë nga rrjeti I UKT-sha, rritjen e arkëtimeve të faturës së ujit nëpërmjet ndërprerjeve të furnizimit me ujë ndaj abonentëve debitorë. Që me datë 14 Gusht, Njësitë Zonale dhe Drejtoria Rajonale punojnë në baze të një plani pune ditor të miratuar dhe që dërgohet në formë elektronike nga Departamenti i Shitjes (Sektori I Riskut). Raportimi i punës së bërë nga Njësitë bëhet në mënyrë elektronike, çdo ditë. Në baza mujore nga departamenti i shitjes janë hartuar relacione mbi realizimin e planit, problematikat e evidentuara dhe detyra për tu realizuar. Gjate verifikimit në terren janë evidentuar objekte të shembura për të cilat janë marre masa për pezullimin e faturimit. Janë evidentuar raste të shkeljeve administrative të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet ose përdorimit të ujit pa kriter dhe janë marra masa të vendosjes gjore në 369 raste (të cilat janë regjistruar edhe në SMI). Janë marre masa për fillimin e procedurave përmbartimore për vjeljen e debisë në abonentët në të cilët janë ezauruar masat administrative (1065 raste) dhe po përgatiten për kërkesa për fillimin e procedurës ligjore edhe 1908 kontrata të tjera. Janë realizuar akte rakordimi me institucione buxhetore për pagës atë faturave debitorë si në formë shkresore ashtu edhe elektronike.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë SHA, mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nenet 7, 9 dhe 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, neni 5, pika b, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë Tiranë, ndëshkimin për kundërvajtje administrative dhe dënimin me gjobë në masën:

-200,000 lekë, për Operatorët Ekonomikë “**A.C**”, “**I.**” dhe “**P-D**”, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për kontratën “Ndërtim depo uji 4000 m³ në Yzberisht”

-100,000 lekë, për Shoqëritë Konsulente “**T..**” sh.p.k, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

-50,000 lekë, për Shoqërinë Konsulente “**A..**” sh.p.k, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Rekomandimi është zbatuar.

Departamenti Inxhinierik pranë UKT ka në proces, përgatitjen e kërkesave drejtuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë Tiranë, për ndëshkimin për kundërvajtje administrative dhe dënimin me gjobë për t’u dërguar në IKMT referuar masave administrative sa më sipër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kontratën Kolektive të punës Neni 24, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

I. “Pushim nga puna” për:

1. Znj. Ermela Metaj, në cilësinë e Ish-Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore, aktualisht punonjëse protokolli pranë degës së Shoqërisë në njësinë 5.

II. Nga “Vërejtje me shkrim” deri “Pushim nga puna” për:

1. z. M.Q

2. znj. M.B

3. z. D.M

4. z. O.Dh

5. znj. A.Z, në cilësinë e anëtarëve të KVO.

6. znj. K.H,

7. znj. B.Xh

8. z. I.G, në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

III. “Vërejtje” për:

1. znj. K.T

2. znj. E.S, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

3. A.K

4. B.N

5. M.M, me detyrë magazinier

6. M.V, me detyrë përgjegjës i sektorit të transportit.

Rekomandimi është zbatuar.

Kjo masë është ezauruar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 14, datë 06.07.2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Raportit Përfundimtar Nr. 142/16, datë 20.06.2017”, pika 2.

C.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

UKT sh.a deri në shtator të vitit 2017 ka funksionuar sipas sistemit me dy nivele bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” kreu III, “Administratorët dhe Këshilli Mbikqyrës, sistemi me dy nivele”, neni 167, në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar me VKM nr.667, datë 03.10.2007, VKM nr.215, datë 28.03.2012 dhe VKM nr.678, datë 03.10.2007, VKM nr.660, datë 12.09.2007 “ Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjiellësave dhe kanalizimeve njësisive të qeverisjes vendore”.

Në sistemin me dy nivele UKT sh.a ka funksionuar me organe drejtuese:

-Asambleja e Aksionarëve

-Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë ka qenë i përbërë nga 6 anëtarë bazuar në aktet e sipërcituara dhe në faktin që UKT sh.a operon në një sektor strategjik sipas VKM nr.1023, datë 16.12.2015. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga asambleja e aksionarëve për një afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet dhe mund të rizgjidhen. Aksionari që zotëron më shumë se ½ e aksioneve të shoqërisë, zgjedh 50+1 të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga aksionarët e tjerë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Pagesa e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është kryer bazuar në VKM nr. nr.642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar me VKM nr. 667, datë 03.10.2007, pika 6/a ku përcaktohet se: Anëtarët e këshillit mbikqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikqyrës si më poshtë vijon: a) në shoqëritë anonime shtetërore strategjike, për kryetarin, në masën 30 % të pagës mujore të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa për anëtarët e tjerë të këshillit mbikqyrës, 20% të kësaj page.

Në mbledhjen e datës 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve, shoqëria UKT sh.a është riorganizuar sipas sistemit me një nivel me Këshill Administrimi. Me vendimin nr.8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve është miratuar statuti i shoqërisë ku janë vendosur emrat e anëtarëve të këshillit të administrimit. **Statuti aktual i shoqërisë është miratuar dhe ndryshuar me Vendimet si vijon: Vendimi nr.13, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a. dhe Vendimi nr.16, datë 14.12.2017 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a.**

Këshilli Mbikqyrës UKT sh.a deri në riorganizimin si Këshill Administrimi në 27.09.2017:

Në mbledhjen e datës **14 Shtator 2015**, me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a nr.18, datë 14.09.2015 janë miratuar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës:

T.T Kryetar/Bashkia Tiranë
I.N Zv.Kryetare/ Bashkia Tiranë
E.Gj Anëtare/ Bashkia Tiranë
I.R Anëtar/ Bashkia Tiranë
S.N Anëtar/Bashkia Kamëz
L.V Anëtar/Bashkia Kamëz

Në mbledhjen e datës 04.04.2016, me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a nr.8, datë 04.04.2016 anëtare e Bashkisë Tiranë Zj.E.Gj u zëvendësua me Zj.K.L me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës. Pas këtij ndryshimi Këshilli Mbikqyrës kishte përbërjen:

T.T Kryetar/Bashkia Tiranë
I.N Zv.Kryetare/ Bashkia Tiranë
K.L Anëtare/ Bashkia Tiranë
I.R Anëtar/ Bashkia Tiranë
S.N Anëtar/Bashkia Kamëz
L.V Anëtar/Bashkia Kamëz

Në mbledhjen e datës 07.07.2017, me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a nr.7, datë 07.07.2017, zv.kryetare e Bashkisë Tiranë në Këshill Mbikqyrës Zj.I.N u zëvendësua me Z.A.D me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Liçencimit pranë Bashkisë Tiranë. Pas këtij ndryshimi Këshilli Mbikqyrës kishte përbërjen:

T.T Kryetar/Bashkia Tiranë
A.D Zv.Kryetar/ Bashkia Tiranë
K.L Anëtare/ Bashkia Tiranë
I.R Anëtar/ Bashkia Tiranë
S.N Anëtar/Bashkia Kamëz
L.V Anëtar/Bashkia Kamëz

Në mbledhjen e datës 27.09.2017, shoqëria është riorganizuar sipas sistemit me një nivel me Këshill Administrimi. Me vendimin nr.8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve është miratuar statuti i shoqërisë ku janë vendosur emrat e anëtarëve të këshillit të administrimit:

T.T Kryetar/Bashkia Tiranë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

A.D Zv.Kryetar/Bashkia Tiranë

R.M Anëtar/Administrator i Përgjithshëm

Statuti aktual i shoqërisë është miratuar dhe ndryshuar me Vendimet si vijon: Vendimi nr.13, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a dhe Vendimi nr.16, datë 14.12.2017 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a.

Nga auditimi konstatohet se:

a.Mbi vendimet e marra nga Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë, për periudhën 01.01.2017-31.12. 2017

-Vendim nr.1, datë 18.04.2017, për rishikimin e kushteve të projekt marrëveshjes dhe raportit të ekspertëve për ndarjen e ekspertëve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz dhe shoqëria UKT sh.a, bazuar në kriteret e VKM nr.660, datë 12.09.2007;

-Vendim nr.02, datë 18.04.2017, për autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm, për aplikimin dhe rinovimin e liçencës;

-Vendim nr.03, datë 07.07.2017, për miratimin e projekt marrëveshjes dhe raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria UKT sh.a (miratimi paraprak faza I, publikimi në QKB);

-Vendim nr.04, datë 07.07.2017, për miratimin e planit të biznesit të shoqërisë UKT sh.a, për vitet 2017-2021 dhe ndryshimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

-Vendimi nr.05, datë 07.07.2017, për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të të ardhurave totale të shoqërisë UKT sh.a për periudhën kontabël që u mbyll me 31.12.2016 dhe raportit të eksperëve kontabël;

-Vendim nr.06, datë 07.07.2017, për miratimin e provizioneve për çështjet gjyqësore të vitit 2016

-Vendim nr.07, datë 07.07.2017, për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të Mbikqyrës;

-Vendim nr.08, datë 27.09.2017, për miratimin e projekt marrëveshjes të ndarjes, raportit të ndarjes të shoqërisë UKT sh.a dhe raportit të ekspertit të pavarur për vlerësimin e projektit të ndarjes (për fazën e dytë, pas publikimit të akteve të ndarjes në QKB);

-Vendim nr.09, datë 27.09.2017, për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2017;

-Vendim nr.10, datë 27.09.2017, për miratimin e relacionit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të UKT sh.a;

-Vendimi nr.11, datë 13.11.2017, për miratimin e akt-themelimit dhe statutit të shoqërive që krijohen rishtazi nga ndarja e shoqërisë UKT sh.a miratuar me Vendimin nr.8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve;

-Vendimi nr.12, datë 13.11.2017, për miratimin e akteve për kalimin në administrim të Bashkisë Vorë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

-Vendimi nr.13, datë 23.11.2017, për konstituimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të UKT Bashkia Tiranë sh.a;

-Vendimi nr.14, datë 23.11.2017, për ndryshimin e emrit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a;

-Vendimi nr.15, datë 23.11.2017, për fillimin e procedurave të transferimit të liçencës së shoqërisë;

-Vendimi nr.16, datë 14.12.2017, për miratimin e ndryshimeve të statutit të shoqërisë UKT sh.a;

-Vendim nr.17, datë 14.12.2017, për miratimin e buxhetit të shoqërisë UKT sh.a për vitin 2018;

-Vendim nr.18, datë 14.12.2017, për miratimin e pagesës së Këshillit të Administrimit të shoqërisë UKT sh.a;

-Vendim nr.19, datë 14.12.2017, për emërimin e ekspertëve kontabël të rregjistruar për auditimin e bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2017;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

b. Mbi vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë dhe Këshillit të Administrimit, për periudhën 1.01.2017-31.12.2017

- Vendim nr.1, datë 06.07.2017, për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të UKT sh.a;
- Vendim nr.2, datë 06.07.2017, për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të të ardhurave totale të shoqërisë UKT sh.a për periudhën kontabël që u mbyll me 31.12.2016 dhe raportit të ekspertëve kontabël;
- Vendim nr.3, datë 6.07.2017, për miratimin e planit të biznesit të shoqërisë UKT sh.a, për vitet 2017-2021;
- Vendim nr.4, datë 06.07.2017, për miratimin e tarifave për shërbimin e akt-kolaudimit, akt-kontroll-spostimit të rrjetit inxhinierik të ujësjellës –kanalizime;
- Vendim nr.5, datë 06.07.2017, për miratimin e udhëzimit nr.239, datë 05.05.2017 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.461, datë 22.06.2016 “Procedurën e vendosjes, regjistrimit dhe vjeljes së gjobave për kundravajtjet administrative në sistemin e ujësjellës kanalizime”
- Vendim nr.6, datë 06.07.2017, për miratimin e kartës së auditit të brendshëm të UKT sh.a;
- Vendim nr.7, datë 06.07.2017 për miratimin e procedurave për faturimin dhe leximin e ujëmatësave nëpërmjet aparaturës “UKT Rider”;
- Vendim nr.8, datë 06.07.2017, për emërimin e specialistit auditues në njësinë e auditimit të brendshëm të UKT sh.a;
- Vendim nr.9, datë 06.07.2017, për miratimin e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e H L 2;
- Vendim nr.10, datë 06.07.2017, për miratimin e vlerësimit me ekspertë të jashtëm i veprave të përfunduara, makinerive e pajisjeve dhe pjesëve rezervë të programit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës”;
- Vendim nr.11, datë 06.07.2017, për miratimin e provizioneve, për çështjet gjyqësore të vitit 2016;
- Vendim nr.12, datë 06.07.2017, për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, marrjen e mendimit të KB dhe paraqitjen e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU;
- Vendim nr.13, datë 06.07.2017, për miratimin e analizës së punës dhe treguesve tekniko-ekonomikë të realizuar nga UKT sh.a gjatë vitit 2017;
- Vendim nr.14, datë 06.07.2017, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nr.142/16, datë 20.06.2017;
- Vendim nr.15, datë 25.09.2017, për miratimin e analizës së punës dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar nga UKT sh.a për 7 mujorin e parë të vitit 2017;
- Vendim nr.16, datë 25.09.2017, për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2017;
- Vendim nr.17, datë 25.09.2017, për miratimin e manualit të procedurave të departamentit të shitjes;
- Vendim nr.18, datë 25.09.2017, për miratimin e relacionit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të UKT sh.a;
- Vendim nr.19, datë 13.12.2017, për zgjedhjen e kryetarit, zv/kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë UKT sh.a;
- Vendim nr.20, datë 13.12.2017, për miratimin e strukturës organizative të shoqërisë UKT sh.a;
- Vendim nr.21, datë 13.12.2017, për miratimin e buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2018;
- Vendim nr.22, datë 13.12.2017, për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2018;

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës për 2017

1. Datë 06.07.2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

2. Datë 25.09.2017
3. Datë 13.12.2017

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme për 2017

1. 18.04.2017
2. 07.07.2017
3. 27.09.2017
4. 23.10.2017
5. 13.11.2017
6. 14.12.2017

a.Mbi vendimet e marra nga Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë, për periudhën 01.01.2018-31.08.2018

- Vendim nr.01, datë 08.03.2018, për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e shoqërisë UKT sh.a për vitin 2018;
- Vendim nr.02, datë 08.03.2018, për miratimin e marrëveshjes së huasë që do të lidhet ndërmjet shoqërisë UKT sh.a dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- Vendim nr.03, datë 08.03.2018, për miratimin e zëvendësimit të debitorit në kontratat e kredisë;
- Vendim nr.04, datë 08.03.2018, për miratimin e relacionit për nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve stok dhe hipoklorit të kalciumit në magazinat e UKT sh.a;
- Vendim nr.05, datë 06.07.2018, për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e shoqërisë UKT sh.a për vitin 2018;
- Vendim nr.06, datë 06.07.2018, për miratimin e pasqyrave financiare dhe bilancit të shoqërisë UKT sh.a për vitin 2017;
- Vendim nr.07, datë 06.07.2018, për miratimin e treguesve kryesorë të shoqërisë UKT sh.a për vitin 2017;
- Vendim nr.08, datë 06.07.2018, për miratimin e draft kontratës për zëvendësimin e debitorit në kontratat e kredisë dhe marrëveshjeve siguroese të lidhura mes UKT sh.a dhe Bankës Kombëtare Tregtare;
- Vendim nr.09, datë 06.07.2018, për shtyrjen e vendimarrjes për miratimin e pagesës së Këshillit të Administrimit të UKT sh.a;
- Vendim nr.10, datë 06.07.2018, për miratimin e provizioneve të llogarive të arkëtueshme, çështjeve gjyqësore dhe debitorëve të personelit të shoqërisë, në pasqyrat financiare të vitit 2017;
- Vendim nr.11, datë 06.07.2018, për emërimin e audituesit ligjor për raportimin financiar të UKT sh.a, për periudhën 31.12.2017 dhe vitin 2018;
- Vendim nr.12, datë 06.07.2018, për miratimin e draft –kontratës që do të lidhet ndërmjet shoqërisë UKT sh.a dhe shoqërisë “T.E” sh.p.k;

b. Mbi vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë dhe Këshillit të Administrimit, për periudhën 01.01.2018-01.08.2018

- Vendim nr.01, datë 24.01.2018, për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë UKT sh.a;
- Vendim nr.02, datë 07.03.2018, për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2018;
- Vendim nr.03, datë 07.03.2018, për miratimin e draft marrëveshjes së huasë që do të lidhet ndërmjet shoqërisë UKT sh.a dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- Vendim nr.04, datë 07.03.2018, për miratimin e relacionit për nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve stok dhe hipoklorit të kalciumit në magazinat e UKT sh.a;
- Vendim nr.05, datë 07.03.2018, për miratimin e kartës së auditit të brendshëm të shoqërisë UKT sh.a;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

- Vendim nr.06, datë 07.03.2018, për vlerësimin me ekspertë të jashtëm të ndërtesës së selisë qendrore të shoqërisë UKT sh.a;
- Vendim nr.07, datë 04.07.2018, për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë UKT sh.a;
- Vendim nr.08, datë 04.07.2018, për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e shoqërisë UKT sh.a për vitin 2018;
- Vendim nr.09, datë 04.07.2018, për miratimin e pasqyrave financiare dhe bilancit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2017;
- Vendim nr.10, datë 04.07.2018, për miratimin e treguesve kryesorë të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2017;
- Vendim nr.11, datë 04.07.2018, për miratimin e provizioneve të llogarive të arkëtueshme, çështjeve gjyqësore dhe debitorëve të personelit të shoqërisë, në pasqyrat financiare të vitit 2017
- Vendim nr.12, datë 04.07.2018, për miratimin e draft kontratës që do të lidhet ndërmjet shoqërisë UKT sh.a dhe shoqërisë “T.E” sh.p.k

Mbledhja e Këshillit të Administrimit për vitin 2018

1. 24.01.2018
2. 07.03.2018
3. 04.07.2018

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme për 2018

1. 08.03.2018
2. 06.07.2018

Mbi vendimet e drejtorisë.

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm për periudhën objekt auditimi janë nxjerrë urdhra dhe vendime që rregullojnë aktivitetin e shoqërisë, të cilat kanë të bëjnë me ristrukturimin e shoqërisë, lëvizje të stafit, fillim të procedurave të prokurimit etj.

Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikqyrës i riorganizuar në Këshill Administrimi me vendimin nr.8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve për periudhën objekt auditimi, janë konstatuar këto mangësi dhe shkelje ligjore:

-Për vitin 2017, Këshilli Mbikqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime. Referuar statutit të mëparshëm të shoqërisë i miratuar me vendimin nr.14, datë 31.08.2016 neni 19, pika 2 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, përcaktohet se Këshilli Mbikqyrës do të mbledhet jo më pak se 3 herë në vit me intervale jo më të gjata se 4 muaj dhe në mënyrë të jashtëzakonshme sa herë të vlerësohet si e nevojshme nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose kurdo që të kërkohet nga një e treta e Këshillit Mbikqyrës ose Drejtori i Përgjithshëm. Referuar mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës nuk është respektuar intervali i rregullt i mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës së UKT sh.a, sepse mbledhja e parë për vitin 2017 është kryer më datë 06.07.2017, në kundërshtim me neni 19, pika 2, të statutit të mëparshëm të shoqërisë.

-Për vitin 2017, Këshilli Mbikqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime dhe përkatësisht në datat 06.07.2017, 25.09.2017, 13.12.2017. Vlera **1,515,600 lekë**, pagesë që është kryer për Këshillin Mbikqyrës për 9 muajt që ky organ kolegjal nuk është mbledhur është shpenzim jo efektiv për UKT sh.a në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” pika 8 ku përcaktohet se “Këshilli Mbikqyrës mbledhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton, për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, ministrit të linjës dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, me cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore, jo më pak se 4 herë në vit”.

-Këshilli i Administrimit i UKT SHA, ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2017, me vendim nr.09, datë 04.07.2018, me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, Datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar, Neni 33/1 Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.

-Për periudhën 01.01.2018-31.08.2018 Këshilli i Administrimit është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 12 vendime. Referuar statutit të shoqërisë nr.16/2, datë 14.12.2017, neni 14, pika 1, “Këshilli i Administrimit duhet të mbledhet jo më pak se 1 herë në muaj, ndërsa në pikën 6 të po këtij neni përcaktohet se Këshilli i Administrimit mban një regjistër për pjesëmarrjen i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e pranishëm në mbledhje”. Përsa më sipër nuk konstatohet një regjistër pjesëmarrje të nënshkruar nga anëtarët e pranishëm për secilën mbledhje dhe as respektim i intervalit kohor të mbledhjes së Këshillit të Administrimit 1 herë në muaj, në kundërshtim me statutin e shoqërisë nr.16/2, datë 14.12.2017, neni 14, pika 6.

Në përgjigje të observacionit tuaj referuar ndryshimeve të vazhdueshme që kanë pësuar aktet nënligjore dhe mos unifikimit që këto të fundit kanë referuar sektorit të Ujësjiellës Kanalizime ju sqarojmë se mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës/Administrimit nuk janë formalitet por detyrim ligjor i përcaktuar në ligj dhe aktet nënligjore me të cilat rregullohet veprimtaria e ujësjiellës kanalizime. Për këtë arsye referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, statutit të UKT, intervalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës duhet të vijnë në linjë të drejtë me interesat e UKT sh.a dhe jo më kot në VKM nr. 63, datë 27.01.2016, neni 13 përcakton se Këshilli i Administrimit mbledhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e Kryetarit. Fakti se UKT SHA mbulon një sektor strategjik siç është furnizimi i banorëve të Tiranës me ujë të pijshëm nuk mund ti përcaktojë mbledhjet e këtij organi kolegjal siç është Këshilli i Administrimit në mbledhje formale, për këtë arsye edhe çdo shpërblim mujor që i është akorduar këtij këshilli sa here nuk është mbledhur reflektohet si shpenzim jo efektiv, përderisa sipas akteve ligjore dhe nënligjore për organizimin e sektorit të Ujësjiellës Kanalizime, vendimet e Këshillit të Administrimit janë të përcaktuara qartë në nenin 13 dhe 14 të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, për arsyet si më lart observacioni juaj nuk merret parasysh.

C.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:
Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA (këtu e më poshtë UKT), ka formën e shoqërisë aksionare me dy nivele, është themeluar me akt-themelimin e datës 05.12.2000, të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, është regjistruar si person juridik me vendimin e Rrethit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Gjyqësor Tiranë nr. 24875 datë 28.12.2000 dhe vepron në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ka për objekt aktiviteti kryerjen e shërbeve publike në fushën e furnizimit dhe të shitjes së ujit të pijshëm për konsumatorët. Më datë 27.09.2017, shoqëria është riorganizuar sipas sistemit me një nivel me Këshill Administrimi.

Struktura e shoërisë për periudhën objekt auditimi është miratuar me vendimet e mëposhtme:

- Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 16, datë 12.12.2016 “Për miratimin e ndryshimeve në Strukturën Organizative dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA”, ku përcaktohet numri i punonjësve 1220.
- Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 13.12.2017 “Për miratimin e strukturës organizative Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA”, ku përcaktohet numri i punonjësve 1220.
- Me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 01, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në Strukturën Organizative të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA”, përcaktohet numri i punonjësve 1220.
- Me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 07, datë 04.07.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në Strukturën Organizative të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA”, përcaktohet numri i punonjësve 1230.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, u konstatua se numri mesatar i punonjësve për vitin 2017 është 1183 punonjës ndërsa për periudhën Janar – Gusht 2018 është 1187 punonjës, duke mos e tejkaluar numrin e punonjësve të miratuar.

Marrëdhëniet e brendshme të stafit të shoqërisë janë të rregulluara më anë të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA nr. 7, datë 04.04.2016.

Pas miratimit të Rregullores së Brendshme, struktura e shoqërisë ka pësuar të paktën 4 ndryshime (si në numër punonjësish dhe në strukturë organizative), si dhe kanë ndodhur ndryshime në organin drejtues të shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës është zëvendësuar me Këshill Administrimi), ndryshime të cilat nuk janë pasqyruar në Rregulloren e Brendshme.

Marrëdhëniet e punës në UKT janë të rregulluara me anë të Kontratës Kolektive nr. 1902/1, datë 03.06.2013, të ndryshuar dhe Kontratës Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018. Kjo kontratë ka afat 5 vjeçar.

Gjithashtu janë lidhur dhe kontratat individuale midis punëdhënësit UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe punëmarrësit. Kohëzgjatja e kontratave, sipas nenit 4, është për një kohë të pacaktuar, duke përfshirë 3 muajt e parë si periudhë prove.

UKT nuk ka zbatuar shkronjën “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, derdhur në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave, për vitin 2017, vlerën **6,412,200 lekë**. Pas konstatimit të grupit të auditimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

me Urdhër-Pagesën datë 08.10.2017, drejtuar Bankës R..., është kryer pagesa në vlerën 6,412,200 lekë, për llogari të Institutit të Integritimit të ish-të Përndjekurve Politikë. Detyrimi i akumuluar për vitin 2018 është në vlerën **6,492,550 lekë**, detyrim duhet të paguhet brenda vitit 2019.

Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën 01.04.2017-31.12.2017, janë humbur 112 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **46,099,758.40 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore dhe për periudhën 01.01.2018-31.08.2018, janë humbur 53 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **32,300,969.16 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **78,400,727.56 lekë**, **vlerë e cila përbën dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi për buxhetin e shoqërisë.**

Gjithashtu konstatohet se janë në proces gjykimi (në Gjykatën e Apelit) dhe 39 çështje të tjera, për të cilat kërkohet vlera **17,602,000 lekë**, vlerë e cila do të rëndojnë akoma më shumë rezultatin ekonomik-financiar të UKT.

Me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 720, datë 01.11.2016, pika 1, është urdhëruar ndryshimi i orarit zyrtar të punës së shoqërisë, si vijon: “Orari zyrtar i punës për Drejtorinë e Përgjithshme Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë SHA, nga e Hëna deri në të Enjte do të jetë 08.00-16.00, orari i pushimit do të jetë nga ora 12.00-12.30, ditën e Premte 08.00-14.00 dhe ditën e Shtunë 08.00-12.00”. Ky urdhër ka hyrë në fuqi më datë 01.11.2016 dhe është shfuqizuar më datë 12.06.2017, me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 317, datë 12.06.2017.

Me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 58, datë 24.01.2018, pika 1, është urdhëruar ndryshimi i orarit zyrtar të punës së shoqërisë, si vijon: “Orari zyrtar i punës për Drejtorinë e Përgjithshme Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë SHA, nga e Hëna deri në të Enjte do të jetë 08.00-16.00, orari i pushimit do të jetë nga ora 12.00-12.30, ditën e Premte 08.00-14.00 dhe ditën e Shtunë 08.00-12.00”. Ky urdhër ka hyrë në fuqi më datë 01.02.2018 dhe është shfuqizuar më datë 31.05.2018, me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 289, datë 25.05.2018.

Sipas këtyre urdhrave konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018, gjatë ditëve të javës punonjësit e shoqërisë kanë punuar 36 orë në javë, ndërsa 4 orët e mbetura janë zëvendësuar ditën e shtunë, duke punuar 4 orët të plota. Por zëvendësimi i kryer gjatë ditës së shtunë, e cila është një nga ditët e pushimit javore dhe si e tillë duhej kryer me një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 (32 javë) dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018 (17 javë), për një total prej 49 javësh, punonjësit e administratës së shoqërisë janë paguar me 1 orë më pak në javë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1, e cila përcakton se: “1. Puna e kryer në ditën e pushimit javor kompensohet me një shtesë page, jo më pak se 25 për qind, ose me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune”.

Këto urdhra janë konceptuar dhe miratuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore (përgjegjësi dhe drejtori) dhe Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, pa kaluar më parë kontrollin e ligjshmërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

nga Sektori i Asistencës ligjore, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshëm të shoqërisë, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionerëve nr. 7, datë 04.04.2016, neni 225, pika 1/a, neni 227, pika 1/a dhe neni 228, pika 1/c.

Gjithashtu në pikën 1/b, të nenit 8, të Rregullores së Brendshëm të shoqërisë, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionerëve nr. 7, datë 04.04.2016, i ndryshuar, përcaktohet që *“Për të gjithë punonjësit dhe strukturat e funksionimit të Shoqërisë, orari i punës fillon në ora 08.30 dhe përfundon në ora 16.00. Ky orar është i vlefshëm nga e Hëna deri të Premten. Ditën e Shtunë orari i punës fillon në ora 08.30 dhe përfundon në ora 13.30. Punonjësit kanë të drejtën e një pushimi prej 30 minutash ne dite. Ky pushim fillon në ora 12.00 dhe përfundon në ora 12.30. Për sektorët të cilët kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me klientët pushimi duhet të bëhet me turne për të evituar ndërprerjen e shërbimit. Ky orar është fleksibël dhe mund të ndryshohet në çdo kohë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë.”*. Ky nen i Rregullores së Brendshme është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1, për arsye se nuk parashikohet një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës.

Me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të UKT nr. 14478, datë 24.07.2017, drejtuar Inspektoriatit Shtetëror të Punës, është dërguar kërkesa për miratimin e tejkalimit të orëve shtesë për disa nivele të caktuara punonjesisht, si hidraulikë, mekanikë, elektrikistë, saldatorë, manovratorë mjetesh të rënda, drejtues autobotesh, drejtues kamionësh dhe punëtorë të ndryshëm.

Me shkresën nr. 1684/2, datë 15.08.2017, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të UKT, Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve shoqërore, shprehet dakord për tejkalimin e orëve jashtë orarit dhe rekomandon mundësinë e shtimit të personelit në të ardhmen.

Nga auditimi i urdhrave të drejtorit të përgjithshëm, u konstatua se:

-Me Urdhrat e Brendshëm nr. 580/1, datë 20.02.2017; nr. 414, datë 18.08.2017; nr. 109, datë 15.02.2018 dhe nr. 674, datë 17.08.2018, për znj. M.Sh me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Faturimit, i shtyhet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të daljes në pension me 6 muaj.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 374, datë 20.07.2018, znj. V.M me detyrë faturuese, i shtyhet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të daljes në pension me 6 muaj.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 410, datë 03.08.2018, z. B.H me detyrë faturues, i shtyhet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të daljes në pension me 6 muaj.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 726, datë 30.08.2018, Z. M.S me detyrë pompist, i shtyhet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të daljes në pension me 6 muaj.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 746, datë 10.09.2018, znj. D.A me detyrë faturuese, i shtyhet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të daljes në pension me 6 muaj.

Shtyrja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për shkak të daljes në pension, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 4, e cila përcakton se: *“Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës për këtë kategori nëpunësish/punonjësish”*. Në zbatim të dispozitës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

mësipërme ligjore, me mbushjen e moshës së daljes në pension, nga UKT duhej kryer ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

Nga auditimi i blloqeve të faturimit për periudhën Janar-Gusht 2018, për zonat që mbulonin faturistët B.H dhe D.A, konstatohet se blloqet e faturimit (lexuesi) janë plotësuar nga këta persona.

Ndërsa nga auditimi i blloqeve të faturimit për znj. V.M, blloqet e faturimit janë plotësuar nga znj. V.M për periudhën Janar-Maj 2018, ndërsa për periudhën Qershor-Gusht 2018, janë plotësuar nga z. B.P dhe znj. V.M (datë 23.08.2018, datë 21.07.2018 dhe datë 21.06.2018).

Nga auditimi i rekrutimit të punonjësve, konstatohet se në zbatim të nenit 7/a, të Rregullores së Brendshëm, rekrutimi i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Punës. Duke qenë se Kodi i Punës nuk përcakton se si duhet të kryhet rekrutimi i punonjësve, UKT ka hartuar një pyetësor për procedurat e rekrutimit dhe dokumentacionin që duhet paraqitur nga punëmarrësit. Por kjo rregullore nuk parashikohen procedura mbi shpalljen e vendeve vakante, por vetëm të atyre personave që kanë dorëzuar pranë Burimeve Njerëzore të shoqërisë kërkesë për punësim.

Në Aneksin e Rregullores janë përcaktuar kriteret dhe kualifikimet përkatëse që kërkon vendi i punës. Nga auditimi me zgjedhje për 20 punonjës, nuk u konstatuan ndryshime midis kualifikimeve të këtyre punonjësve dhe kualifikimeve të kërkuara.

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në dhënien e shpërblimeve, u konstatua se:

Gjatë periudhës objekt auditimi, me anë të Urdhrave të Brendshëm të ndryshëm janë dhënë shpërblime për shkaqe të ndryshme (martesa, lindje, vdekje) në zbatim të nenit 21 të Kontratës Kolektive nr. 1902/1, datë 03.06.2013.

Gjithashtu janë dhënë shpërblimet e mëposhtme:

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 114, datë 28.02.2017, është urdhëruar shpërblimi i punonjësve femra në vlerën 10,000 lekë, me rastin e festës së 8 marsit. Në total është paguar vlera 3,150,000 lekë për 315 punonjës të shoqërisë.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 607, datë 11.12.2017, është urdhëruar shpërblimi i punonjësve të shoqërisë në vlerën 10,000 lekë, me rastin e festave të fundvitit. Në total është paguar vlera 11,540,000 lekë për 1154 punonjës të shoqërisë.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 141, datë 02.03.2018, është urdhëruar shpërblimi i punonjësve femra në vlerën 10,000 lekë, me rastin e festës së 8 marsit. Në total është paguar vlera 3,210,000 lekë për 321 punonjës të shoqërisë.

Shpërblimet e mësipërme janë paguar vetëm me urdhrat e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, pa u marrë më parë miratimet në Këshillin Mbikëqyrës (Këshillin e Administrimit), në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b, e cila përcakton se: “1. *Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës*”.

Nga auditimi me zgjedhje për 37 dosje personeli u konstatua se:

-Në 5 raste (3 nga këto staf drejtues), mungonte dëshmia e penaltetit.

-Në 4 raste (2 nga këto staf drejtues), mungonte jetëshkrimi (C.V.).

-Në 4 raste, mungonte adresa e punëmarrësit.

-Në 4 raste (të gjithë staf drejtues), mungonin kërkesat për punësimin të punëmarrësve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Në 6 raste (të gjithë staf drejtues), mungonte raporti mjekësor që është i aftë për punë për punëmarrësit.

Veprime këto në kundërshtim me Kontratën Kolektive nr. 1902/1, datë 03.06.2013, neni 13 dhe Kontratën Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018, neni 8.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23922/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/4, datë 16.11.2018, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 2, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi përgjegjësinë nuk qëndron, për arsye se emri juaj në akt konstatimin përkatës është vetëm për njohje dhe jo për përgjegjësi.

Së dyti, pretendimi juaj për plotësimin e dosjeve të punonjësve nuk qëndron për arsye se është detyrë e drejtorisë juaj plotësimi i dosjeve.

Së treti, pretendimi juaj për ndryshimin e orarit zyrtar të punës, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1.

Së katërti, pretendimi juaj për shpërblimin e dhënë nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b. Ligji në këtë rast prevalon mbi Vendimet e Këshillit të Ministrave.

C.4. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Për periudhën objekt auditimi, kontabiliteti është i organizuar dhe mbajtur në zbatim të SNK. Shoqëria ka mbajtur në llogaritë e tij aktivet, pasive dhe transaksionet financiare të rezultuara nga veprimtaria e saj.

Gjatë vitit 2017 është realizuar ndarja e shoqërisë UKT SHA, gjë e cila ka detyruar shoqërinë të hartojë jo vetëm pasqyra financiare të datës 31 Dhjetor 2017 por edhe pasqyra financiare në datën e ndarjes së shoqërisë.

Modalitetet për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA u përcaktuan në Relacionin Nr.17170/8 prot, datë 09.08.2016 të Grupit të Punës.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” SHA i miratoi këto modalitete me vendimin Nr. 11 të datës 31/08/2016.

Në bazë të Marrëveshjes dhe në përputhje me Ligjin Për Shoqëritë Tregëtare, ndarja e UKT SHA u shoqërua me krijimin e tre shoqërive të reja:

- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Tiranë SHA,
- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Kamëz SHA,
- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Vorë SHA

Me Vendimin nr. 19, datë 14.12.2017 “Për emërimin e ekspertëve kontabël të regjistruar për auditimin e bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare të shoqërisë UKT SHA, për vitin 2017”, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë ka vendosur emërimin në detyrën e Audituesve të Bilancit Kontabël dhe Pasqyrave financiare të shoqërisë UKT SHA, për vitin 2017:

-M.. shpk me përfaqësues I.H dhe D.Y

-S.T



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Me këta auditues është hartuar kontrata nr. 4767 prot., datë 08.02.2018, e nënshkruar nga Drejtor i Përgjithshëm i UKT SHA z. R.Mdhe Audituesit Ligjor D.Y, I.H, S.T me vlerë 7,920,000 lekë pa TVSH.

Raportet e auditimit të pasqyrave financiare janë dorëzuar në UKT SHA datë 29.06.2018, me nr. 4767/1 prot., nr. 4767/2 prot., nr. 4767/3 prot.

Në bazë të nenit 2 të kontratës nr. 4767 prot. datë 08.02.2018:

*“Audituesi Ligjor ka për detyrë, duke përjashtuar çdo ndërhyrje në administrim, të verifikojë librat e llogarisë të shoqërisë si dhe të kontrollojnë rregullsinë e kontabilitetit të shoqërisë. **Audituesit Ligjor u bëjnë të njohur Drejtimin problemet e dala gjatë auditimit.”***

Si dhe neni 8 pjesë integrale e kontratës është edhe programi i hartuar nga ekspertët kontabël. Në bazë të Programit të Auditimit të Pasqyrave Financiare pika 17, në fund të angazhimit audituesi duhet të përpilojë opinionin e auditimit, raportin e përgjithshëm të auditimit dhe **rekomandimet nëpërmjet Letrës për Drejtimin e entitetit.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstatua se audituesit e pavarur nuk kanë dorëzuar dokumentin Letra për Drejtimin e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 4767 prot., datë 08.02.2018.

Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr. 1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA

Nga auditimi i dokumentave të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 *“Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”*, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të KSH janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar.

Me shkresën nr. 16387/3, datë 02.07.2018 janë përcjellë pasqyrat financiare bashkë me relacionin përkatës për miratim në Këshillin Administrimi dhe Asamblesë së Përgjithshme.

Me vendimin nr. 9, date 04.07.2018 “Për miratimin e pasqyrave financiare dhe bilancit të shoqërisë UKT SHA për vitin 2017”, janë miratuar:

- Pasqyra financiare individuale të shoqërisë UKT SHA të datës 20 Nëntor
- Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë UKT SHA për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor
- Pasqyrat financiare të konsoliduara manaxheriale të shoqërisë UKT SHA.
- Fitimi neto i krijuar nga aktiviteti i shoqërisë UKT SHA për vitin ushtrimor që u mbyll në datën 31.12.2017, të kalohet në investimet për vitin ushtrimor që mbyllet në datën 31.12.2018.
- Kalimi i këtij vendimi vendimi nga Pasqyrave financiare për miratimin në Asamblesë e Aksionerëve dhe Drejtorinë e Monitorimit të Ndërmarrjeve dhe SHA-ve pranë Bashkisë Tiranë.

Me Vendimin nr. 6 datë 06.07.2018 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë”, SHA janë miratuar:

- Pasqyrat financiare Individuale të UKT SHA të datës 20 Nëntor
- Pasqyrat financiare të konsoliduar të UKT SHA për periudhën 21 Nëntor deri në 31 dhjetor 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

- Pasqyrat financiare të konsoliduara Manaxheriale të UKT SHA për periudhën 31 dhjetor 2017
- Fitimi neto i krijuar nga aktiviteti i shoqërisë UKT SHA për vitin ushtrimor që u mbyll në datën 31.12.2017, të kalohet në investimet për vitin ushtrimor që mbyllet në datën 31.12.2018.

Në datë 26.07.2018 pasqyrat financiare janë dorëzuar në sistemin elektronik të tatimeve.

Baza për shprehjen e opinionit:

- Për llogarinë **Aktive Afatgjata Jomateriale** përfshin edhe llogarinë “Emri i mirë” në vlerën 717,064 mijë lekë, të njohur nga përthithja e fiskal njësisë H L SHA. Gjatë vitit 2017 UKT SHA nuk ka njohur zhvlerësim për këtë zë të bilancit i cili në bazë të SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve” duhet të testohet për vlerën e tij çdo vit.

“Një njësi gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë duhet të testohet për zhvlerësim çdo vit dhe sa herë që ka një indikacion se njësi mund të jetë e zhvlerësuar, duke krahasuar vlerën kontabël neto të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, përfshirë emrin e mirë, me shumën e rikuperueshme të saj. Nëse shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhe se vlera kontabël neto e saj, njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe emri i mirë që i është shpërndarë kësaj njësie duhet të konsiderohen si jo të zhvlerësuar. Nëse vlera kontabël neto e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhe se shuma e rikuperueshme.”

-Për llogarinë “Aktive Afatgjata Materiale” përfshin vlerën 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorët të AKUK (ish-DPUK). Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga UKT SHA nuk krijohet besueshmëri e arsyeshme në lidhje me vlerën 1,026,003 mijë lekë.

-Për llogarinë “Inventarët” përmban vlerën e materialeve tërësisht apo pjesërisht të vjetëruar për shkak të kohës dhe ndryshimeve teknologjike në vlerën 81,275 mijë lekë. Ndërkohë që vlera e zhvlerësimit të inventarëve është 44,017 mijë lekë. Në bazë të SNK 2 “Inventarët” duhet të llogaritet shuma e zhvlerësimit shtesë por në bazë të dokumentacionit të venë në dispozicion grupi i auditimit nuk mund të llogaritet dhe mund të sillte pasoja mbi vlerën e inventarëve dhe rrjedhimisht në vlerën e rezultatit në pasqyrat financiare të konsoliduara.

-Për Llogari të arkëtueshme me vlerën 2,690,010 mijë lekë konstatohet se UKT SHA ka përdorur si metodologji çmuarjen dhe zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për çdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjonimin e llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 39, standard i cili kërkon vlerësim individual për llogaritë e arkëtueshme individualisht dhe vlerësim kolektiv për llogaritë e tjera bazuar në të dhëna të plota historike.

-Për llogarinë “Huamarrje afatshkurtra” në vlerën 1,804,645 mijë lekë, një pjesë e kësaj shume (vlera 1,205,077 mijë lekë) nuk është kontabilizuar në monedhën origjinale por vetëm në lekë dhe për pasojë nuk reflektohen ndryshimet në vlerë si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit në datën 31.12.2017, në kundërshtim me SNK 21 “Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit”.

-Për llogarinë “Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime” me vlerë 465,222 mijë lekë, nga të cilat 463,122 mijë lekë grante afatgjata, 1,777 mijë lekë grante afatgjata rrjet kanalizime dhe 323 mijë lekë grante dhurata pajisje informatike. Nga informacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se është i pamjaftueshëm për shprehjen e një sigurie të mjaftueshme në lidhje me këto vlera.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Për sa i përket detyrimeve tatimore konstatohet se në datë 28.05.2018 Drejtoria e Përgjithshme ka lëshuar raportin e kontrollit tatimor për periudhën deri në 20.11.2017 (përpara ndarjes së shoqërisë), detyrimi që ka rezultuar nga ky akt kontroll dhe e konfirmuar edhe nga Komisioni të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 është 13,116 mijë lekë. Shoqëria mëmë nuk ka paraqitur në pasqyrat e konsoliduara të datës 31.12.2017 nuk ka reflektuar këtë ngjarje pas datës së bilancit e cila do të ndryshojë rezultatin financiar.

-Në seksionin e kapitalit të shoqërisë mëmë përpara ka qenë e përfshirë rezerva e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë lekë, ndërkohë që me krijimin e shoqërisë së re të UKT SHA pjesa e tepricës së rivlerësimit që i takon kësaj shoqërie i është bashkuar kapitalit aksioner duke e rritur atë. Kjo mënyrë rritje kapitali nuk është e parashikuar në asnjë nga format e rritjes së kapitalit në kundërshtim me Kapitullin Zmadhimi i Kapitalit dhe nenet përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Gjithashtu teprica e rivlerësimit duhet të evidentohet më vete sipas kërkesave të SNK 16 “Aktiveve Afatgjata Materiale” dhe të përdorej në vijim në përputhje me kërkesat e këtij standardi. Ne nuk jemi në përputhje kërkesat e këtij standardi.

-Bazuar në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare të konsoliduara menaxheriale, raporti i ndarjes së shoqërisë është bazuar mbi pasqyrat financiare të shoqërisë të datës 31.12.2016 (të pa audituara).

-Bashkia Kamëz nuk ka pranuar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve të shoqërisë UKT SHA “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionerëve Bashkia Vorë dhe Kamëz nga UKT SHA” dhe ka hapur proces gjyqësor për pavlefshmërinë e këtij vendimi. UKB Kamëz nuk ka marrë në dorëzim asetet dhe ato vazhdojnë të paraqiten në pasqyrën pozicionit financiar të UKT. Në datën 21.03.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin e pjesëshëm të kërkesë padisë. Në datën 26.04.2018 ky vendim është ankimuar nga UKT SHA. Deri më datë 19.10.2018, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet të jetë marrë akoma një vendim i formës së prerë nga gjykata.

- Grupi i auditimit ka shkuar në inspektim në magazinën e UKT SHA në Brar dhe u konstatua se kjo magazine ka një numër shumë të madh artikujsh dhe gjendja dhe organizimi i saj nuk linte mundësinë e identifikimit të artikujve pasi janë pa barkode dhe jo të vendosura nëpër rafta. Grupi i auditimit shpreh rezerva në lidhje me procesin e inventarizimit të kryer në këtë magazine dhe përputhjen e vlerës kontabël (vlerës në bilanc) me atë fizike.

-Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të shoqërisë UKT SHA nuk është pasqyruar vlera e kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakort për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

-Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve mbahen jashtë programit financiar por në Excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël.

-Në magazinat e UKT SHA ka pjesët rezervë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”, të lëna në ambientet e magazinës pa u bërë hyrje, pa u marrë në dorëzim nga përgjegjësi i magazinës dhe pa asnjë dokumentacion dëshmuar. Nuk ka asnjë dokument ku të trajtohet se si janë apo kush i ka sjellë këto materiale, si dhe kush i ka pranuar në magazinë pa kryer veprimet ligjore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Në vijim po analizojmë disa nga llogaritë e aktivitetit të UKT SHA sipas zërave të pasqyrave financiare të konsoliduara menaxheriale për vitin 2017:

Aktivet në vitin 2017 janë rritur me 1.8% krahasuar me vitin 2016 duke kapur vlerën 18,567,646 mijë lekë sipas zërave të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	14,467,929	13,735,775
Aktive afatgjata jomateriale	717,064	717,064
Parapagime për aktive afatgjata materiale	12,691	-
Totali i aktiveve afatgjata	15,197,684	14,452,839
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	489,542	472,874
Llogaritë e arkëtueshme	2,726,740	2,908,353
Aktive tatimore të shtyra	2,670	1,251
Llogari të arkëtueshme të tjera	65,552	9,419
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	-	99,089
Mjetet monetare në arkë e në bankë	85,458	290,958
Totali i aktiveve afatshkurtra	3,369,962	3,781,944
Totali i aktiveve	18,567,646	18,234,783

Aktivet Afatgjata

Aktivet afatgjata gjatë vitit 2017 janë rritur me 5% (15,197,684 mijë lekë në vitin 2017 nga 14,452,839 mijë lekë në vitin 2016) paraqitur si më poshtë:

Aktivet afatgjata	UKT 2017	UKT 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Aktivet afatgjata materiale	14,467,929	13,735,775	732,154	5%
Aktive afatgjata jomateriale	717,064	717,064	0	0%
Parapagime për aktive afatgjata materiale	12,691	-	12,691	100%
Totali i aktiveve afatgjata	15,197,684	14,452,839	744,845	5%

Rritje ka te Aktive Afatgjata materiale ku gjatë vitit 2017 janë rritur me 5% (14,467,929 mijë lekë në vitin 2017 nga 13,735,775 mijë lekë në vitin 2016) paraqitur në tabelën si më poshtë:

Aktive Afatgjata Materiale	UKT 2017	UKT 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Toka/Troje	-	-	-	0%
Ndërtesa	200	-	200	100%
Rrjet Ujësjiellës	-	0	-	0%
Rrjet kanalizimesh	935	2,675	-1,740	-65%
Makineri Pajisje	16,143	8,907	7,236	81%
Mjete Transporti	3,552	0	3,552	100%
Mobilje dhe pajisje zyre	3,779	1,441	2,338	162%
AAM - Magazinë	286,531	34,210	252,321	738%
AAM në proces Ndërtesa dhe rrjet)	801,409	1,263,140	-461,731	-37%
	1,112,549	1,310,373	-197,824	-15%

Siç shikohet edhe nga tabela për aktivet afatgjata, kemi rritje në zërat:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

- a) Ndërtesa (përfshihen Kabin roje te dera e Hidrocentralit H L)
- b) Makineri, pajisje (përfshihen blerje elektropompa)
- c) Mjete Transporti (përfshihen blerje makinash për nevojat e UKT SHA)
- d) Mobilje dhe pajisje zyre (përfshihen pajisje informatike si dhe rikonstruksioni i dhomës së serverit)
- e) AAM-Magazinë (përfshihen blerjet që janë bërë gjatë vitit për mjete Transporti, Makineri pajisje, Pajisje Zyre si dhe Pajisje Informatike)

Parapagime për aktive Afatgjata Materiale

Te Parapagime për aktive Afatgjata Materiale ka rritje e cila vjen nga marrëveshja midis Bashkisë Tiranë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit për “Ndërtim i Ujësjiellësit për fshatin Vilëz dhe rikonstruksion ujësjiellësi për fshatrat Shengjin i vogël, Belsh, Zall-Bastardhë, Zall-Dajt dhe sanitete në zall-Basatar”.

Aktivët Afatshkurtra

Aktivët Afatshkurtra janë ulur me 11% (3,369,962 mijë lekë në vitin 2017 nga 3,781,944 mijë lekë në vitin 2016) paraqitur në tabelën si më poshtë:

Aktivët afatshkurtra	2017	2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Inventarë	489,542	472,874	16,668	4%
Llogaritë e arkëtueshme	2,726,740	2,908,353	-181,613	-6%
Aktive tatimore të shtyra	2,670	1,251	1,419	113%
Llogari të arkëtueshme të tjera	65,552	9,419	56,133	596%
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	-	99,089	-99,089	-100%
Mjetet monetare në arkë e në bankë	85,458	290,958	-205,500	-71%
Totali i aktiveve afatshkurtra	3,369,962	3,781,944	-411,982	-11%

Inventarët janë rritur me 4% (489,542 mijë Lekë në vitin 2017 nga 472,874 mijë lekë në vitin 2016) paraqitur në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Materiale - rrjetet	363,422	380,015	-16,593	-4%
Pjesë këmbimi	46,363	32,516	13,847	43%
Materiale konsumi	33,457	27,834	5,623	20%
Inventar i imët	18,871	24,390	-5,519	-23%
Materiale kancelari	7,583	12,078	-4,495	-37%
Kimikate, Karbon	2,734	1,136	1,598	141%
Karburant	6,828	2,635	4,193	159%
Të tjera	21,112	21,797	-685	-3%
Materiale jashtë përdorimit	45,521	29,786	15,735	53%
Zhvlerësimi inventarit	-56,349	-59,313	2,964	-5%
	489,542	472,874	16,668	4%

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim janë:

- a) Kimikate, Karbon rezulton me gjendje në fund të vitit me një tepëricë debitore 2,734 mijë lekë ose variance në lëkë dukë e krahasuar me vitin 2016, 1,598 mijë lekë
- b) Karburant rezulton me gjendjenë fund të vitit me një tepëricë debitore 6,828 mijë lekë ose variancë në lëkë duke e krahasuar me vitin 2016, 4,193 mijë lekë.

Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme kanë rënë me 6%: (2,726,740 Lekë në vitin 2017 nga 2,908,353 Lekë në vitin 2016). Në këtë llogari UKT SHA ka përfshirë si më poshtë detyrimet e të tretëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Llogaritë e Arkëtueshme	UKT 2017	UKT 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Klientë të tjerë	138,593	574,969	-436,376	-76%
Klientë familjar	2,253,576	2,329,553	-75,977	-3%
Klientë privat	616,450	602,265	14,185	2%
Klientë Buxhetor	114,851	115,638	-787	-1%
Klientë Komuna, Bashki	152,156	126,904	25,252	20%
Klientë Kesh	2	2	0	0%
Klientë Tx Bashkia Tiranë	-2,993	-2,706	-287	11%
Klientë të UKB Kamëz pas ndarjes së niptit J62005002O	285,966	-	285,966	100%
Klient të HEC	36,730	29,631	7,099	24%
Zhvlerësime për klientë familjar	-722,802	-830,563	107,760	-13%
Zhvlerësime për klientë privat	-15,974	-18,850	2,876	-15%
Zhvlerësime për institucione publik buxhetor	-1,029	-1,307	279	-21%
Zhvlerësime për institucione publike jo-buxh.	-523	-1,441	918	-64%
Zhvlerësime për klientet e Kamzës pas ndarjes 20.11.2017	-128,263	-	-128,263	100%
Zhvlerësime për rreziqe të tjera	-	-15,741	15,741	-100%
	2,726,740	2,908,353	-181,613	-6%

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim janë:

a) Klient Komuna, Bashki (Në këtë kategori klienti përfshihet: Bashkia Kamëz, Komuna Dajt, Farkë, Vaqarr, Zallherr, Krrabë, Berxullë, Bërzhitë, Pezë, Prezë, Petrelë, Ndroq, Paskuqan dhe Kashar. Peshën më të madhe e zë Bashkia Kamëz si pasojë e pagesave më vonesë të faturave të ujit me shumicë.

b) Klientë të UKB Kamëz pas ndarjes së niptit J62005002O (Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Bashkia Kamëz SHA. nuk e ka pranuar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë UKT SHA. “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Kamëz nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tirane SHA.” dhe ka hapur proces gjyqësor për pavlefshmërinë e këtij vendimi. UKB Kamëz nuk ka marrë në dorëzim asetet dhe ato janë të pasqyruara në bilancin e UKT SHA të cilat zënë peshë të llogaritë e arkëtueshme së bashku me zhvlerësimin e klientëve UKB Kamëz në vlerë 157,703 mijë Lekë.

Llogaritë e arkëtueshme të tjera

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim janë:

a) Parapagim i tatimit fitimit për Niptin J62005002O viti 2017 në vlerën 22,946,770 lekë.

b) Pagesë TVSH (gjendje kreditore) për Niptin J62005002O viti 2017 në vlerën 20,387,781 lekë.

Pasivet në vitin 2017 janë rritur me 1.8% krahasuar me vitin 2016 duke kapur vlerën 18,567,646 mijë lekë sipas zërave të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

KAPITALI	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kapitali aksionar	6,792,760	2,544,398
Rezerva nga rivlerësimi	-	3,219,601
Rezerva ligjore	5,220	81,098
Rezerva statutore	-	3,681
Rezerva të tjera	729	729
Fitime të mbartura	390,251	1,315,400



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Fitimi i ushtrimit	417,219	639,624
Totali i kapitalit	7,606,179	7,804,531
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata	5,481,913	5,436,854
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	465,222	479,652
Totali i detyrimeve afatgjata	5,947,135	5,916,506
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	1,804,645	1,553,605
Llogari të pagueshme	2,991,323	2,720,916
Detyrime ndaj personelit	56,164	52,727
Të pagueshme të tjera	1,008	119
Provizione	137,130	144,364
Detyrime tatimore	24,062	42,015
Totali i detyrimeve afatshkurtra	5,014,332	4,513,746
Totali i detyrimeve	10,961,467	10,430,252
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	18,567,646	18,234,783

Provizione

Kjo llogari përmban në pjesën më të madhe për shpenzime për punonjësit e larguar nga puna. Në total kjo llogari në 31.12.2017 është 137,129,920.84 lekë. Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2017 në 34 (31 me vendime + 3 në rigjykim) raste kanë dale vendimet e gjykatës së formës së prerë dhe deri në fund të periudhës objekt auditimi, vlera e të cilave nuk është kontabilizuar por këto vlera e tyre vazhdon të mbetet tek provizionet me vlerën e parashikuar nga Drejtoria Juridike dhe jo me vlerën e tyre reale. Vlera e provizionuar për këto vendime të cilat kanë marrë formën e prerë është 26,115,179 lekë, vlerë e cila nuk duhet të ishte e kontabilizuar në këtë llogari por te llogaritë e pagueshme për vlerën reale pas vendimit gjyqësor. Vlera e llogarisë së provizioneve që duhet të ishte në pasqyrat financiare 111,014,741 lekë (137,129,920.84 - 26,115,179). Vlera e paraqitur në bilanc në lidhje me llogaritë e pagueshme duhet të rritet me 24,719,296 lekë.

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është në vlerën 6,792,760 mijë lekë dhe në vitin 2016: 2,544,398 mijë lekë.

KAPITALI	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	Varianca ne vlerë	Varianca ne %
Kapitali aksionar	6,792,760	2,544,398	4,248,362	167%
Rezerva nga rivlerësimi	-	3,219,601		0%
Rezerva ligjore	5,220	81,098	-75,878	-94%
Rezerva statutore	-	3,681		0%
Rezerva të tjera	729	729	0	0%
Fitime të mbartura	390,251	1,315,400	-925,149	-70%
Fitimi i ushtrimit	417,219	639,624	-222,405	-35%
Totali i kapitalit	7,606,179	7,804,531	-198,352	-3%

Kapitali aksioner është rritur nga 2,544,398 mijë lekë në vitin 2016 në 6,792,760 mijë lekë në vitin 2017. Me krijimin e shoqërisë së re si dhe me vendimin nr.13 datë 23.11.2017 të aksionerit të vetëm Bashkia Tiranë, të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA, Bashkia Tiranë është 100% aksioner me kapital aksioner prej lekë 6,792,760,000, aksione 6,792,760 me vlerë nominale Lek 100/aksion.

a) Diferenca prej 198,352 mijë lekë është tituj pjesëmarrje ku më datën 18/07/2014 është regjistruar shoqëria H L pranë QKR-se me Nipt L4191800I dhe aksioner 100% UKT SHA



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

me një kapital prej 10,000,000 lekë sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve nr.13 datë 13/09/2013.

b) Sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve nr. 22 datë 14.09.2015 u miratua raporti i eksperteve kontabël për transferimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe tregimit të energjisë elektrike nga shoqëria UKT SHA tek shoqëria H L dhe zmadhimin e kapitalit të shoqërisë H L SHA si rezultat i këtij transferimi. Kapitali i shoqërisë H L u shtua në vlerën e aktiveve të transferuara për 182,397,676 lekë (vlerë neto).

c) Si dhe rezerva ligjore dhe rezerva të tjera të H L SHA

Kapitali aksioner njihet me vlerë nominale

Kapitali	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Numri aksioneve	6,792,760	2,544,398
Vlera nominale	1	1
Totali	6,792,760	2,544,398

Detyrimet në vitin 2017 janë rritur me 5% krahasuar me vitin 2016 duke kapur vlerën 10,961,467 mijë lekë sipas zërave të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

DETYRIMET

Detyrime afatgjata

Hua afatgjata	5,481,913	5,436,854
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	465,222	479,652
Totali i detyrimeve afatgjata	5,947,135	5,916,506

Detyrime afatshkurtra

Hua afatshkurtra	1,804,645	1,553,605
Llogari të pagueshme	2,991,323	2,720,916
Detyrime ndaj personelit	56,164	52,727
Të pagueshme të tjera	1,008	119
Provizione	137,130	144,364
Detyrime tatimore	24,062	42,015
Totali i detyrimeve afatshkurtra	5,014,332	4,513,746
Totali i detyrimeve	10,961,467	10,430,252

Detyrimet afatgjata

Zërat që kanë pasur rritje janë Kredia e Shën Mërisë pasi është bërë shtesë kontrate

DETYRIMET	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	Varianca në vlerë	Varianca ne %
Detyrime afatgjata				
Hua afatgjata	5,481,913	5,436,854	45,059	1%
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	465,222	479,652	-14,430	-3%
Totali i detyrimeve afatgjata	5,947,135	5,916,506	30,629	0

Hua afatgjata

Balanca e huave afatgjata të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Bovilla -Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID-95/007/00	629,410	725,564
Konventa Financiare 13 Mld Lit - F.ROT/AID-94/006/00	322,334	378,302
Konventa Financiare 53.2 Mld Lit - F.ROT/AID-94/004/00	2,221,442	2,259,538
Konventa Financiare 6.8 Mld Lit - F.ROT/AID-99/010/00	466,840	474,846
Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID-98/001/00	43,196	48,331



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Kredia e Shën Mërisë nga BKT	1,138,325	696,629
Kredia e H L nga BKT	660,366	853,644
	5,481,913	5,436,854

Gjatë periudhës 1993-2001, Qeveria e Shqipërisë, në vijim të planit të përbashkët të bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës Italiane, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ka firmosur me Zyrën e Bashkëpunimit Italian, një sërë kontratash. Bazuar në këto kontrata, është e përzgjedhur Banka Kombëtare Tregëtare (BKT) si bankë bazë për financimin e objektit të këtyre kontratave.

BKT dhe Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Huaja dhe /ose Ministria e Financave, janë palë e kontratave të kredisë së akorduar me UKT për zhvillimin e rrjetit të saj dhe asistencën teknike.

Përdorimi i kredive kryhet nga kredimarrësi kryesor UKT-ja por edhe nga Ministria përkatëse që ka firmosur kontratën. Si rrjedhojë, UKT detajon veçmas tërheqjet që janë realizuar prej saj, si dhe ato që kryhen prej Ministrive.

Bovilla –Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID-95/007/00

E nënshkruar më 20.06.1996 midis Bankës Kombëtare Tregëtare të Shqipërisë dhe Njesisë së Drejtimit të Projektit pranë Ministrisë në Ndërtimit dhe Turizmit dhe Ndërmarrjes së Ujësjiellësit Tiranë, për shumën prej 22.000.000.000 Lireta italiane. Keto kredi janë të konvertuara në euro sipas kursit të konvertimit të lireta italiane në euro 1,936 në datën 28.02.2002. Afati i kthimit të huasë është 30 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë:

1. Ndërmarrja e Ujësjiellësit Tiranë do të paguajë huadhënësit një normë vjetore interesi prej 1%, e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore.
2. Ndërmarrja e Ujësjiellësit Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 12 viteve të bërjes efektive të huasë, i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Ndërmarrja e Ujësjiellësit Tiranë do të paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur, i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.
4. Të gjitha detyrimet e ndërmarrjes së Ujësjiellësit Tiranë do të paguhet në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.
5. Në rast se ndërmarrja e Ujësjiellësit Tiranë nuk mund të përmbush detyrimin e sa për të bërë pagesat në lidhje me principalin dhe interesin, atëherë huadhënësi në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Financave do të kërkojë buxhetit të shtetit të paguajë shumat përkatëse.

Konventa Financiare 13Mld Lit-F.ROD/AID-94/006/00

E lidhur më datën 05.04.1995 midis Bankës Kombëtare Tregëtare të Shqipërisë (BKTSH) që do të veprojë si bankë agjente në emër dhe për llogari të qeverisë dhe ndërmarrjes Ujësjiellësit Tiranë, për shumën prej 13.000.000.000 lireta. Keto kredi janë të konvertuara në euro sipas kursit të konvertimit të lireta italiane në euro 1,936 në datën 28.02.2002.

Kushtet e huasë:

1. Afati maksimal i kthimit brenda 30 viteve. Ky afat do të jetë i negociueshëm mbi bazën e gjykimit që do të bëjë BKTSH sipas gjendjes ekonomiko-financiare të ndërmarrjes në të ardhmen.
2. Ndërmarrja e Ujësjiellësit Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 10 viteve. Për këtë periudhë interesi do të paguhet.
 - Norma vjetore të Bankës Italiane 1%
 - Kthimi i kredisë dhe interesave do të bëhet me këste 6 mujore
 - Kthimi i kredisë do të bëhet në të njëjtën valutë me të cilën është dhënë kredia pse në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën bëhet shlyerja



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

- Ndërrmarja e Ujësjiellësit Tiranë do ti paguajë huadhënësit një komision prej 0.75 % të huasë së përdorur i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë

Konventa Financiare 6.8 Mld Lit-F.ROT/AID-99/010/00

E lidhur më datën 18.09.2000 midis Bankës Kombëtare Tregëtare Shqipëtare dhe Ujësjiellësit Tiranë, për shumën prej 6.800.000.000 lireta Italiane. Keto kredi jane te konvertuara ne euro sipas kursit te konvertimit te lireta italiane ne euro 1,936 ne daten 28.02.2002. Afati i kthimit të huasë është 35 vjet nga data e bërjes efektive të

huasë sipas Konventës Financiare të lidhur midis qeverisë Italiane përfaqësuar nga Mediocredito Centrale dhe qeverisë Shqiptare përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregëtare.

Kushtet e huasë:

1.Norma vjetore e interesit prej 0.5%, do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore të llogaritur mbi tepricën e kredisë.

2.Huamarrësi do të filloj shlyerjen e pjesës principale të huasë pas 294 muajve të bërjes efektive të saj, i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.

3.Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhen në monedhën në të cilën është dhënë huaja ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.

Konventa Financiare 53.2 Mld Lit-F.ROT/AID-99/004/00

Lidhur në bazë të ligjit Italian nr 49, datë 26 shkurt 1987 midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale-Istituto Centrale per il Credito a Medio Termine S.P.A për shumën prej 53.200.000.000 lireta. Keto kredi jane te konvertuara ne euro sipas kursit te konvertimit te lireta italiane ne euro 1,936 ne daten 28.02.2002. Equivalenti ne euro është i barabarte me shumen 27,475,507 Euro. Nga kjo vlere jane disbursuar vetem 16,708,850.

Kushtet e huasë:

1.Kthimi në 22 kështe 6 mujore të barabarta dhe të njëpasnjëshëm ku afati i pagimit të këstit të parë mbaron 294 pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare.

2.Përqindja e interesit 0.5 % interes nominal vjetor i cili do të paguhet në fund të 6 mujorit i cili fillon nga data e cdo përdorimi

3.Destinacioni: Realizimi i projekti rehabilitimi i rrjetit ujqor të Tiranës dhe asistencë teknike në administrimin e ndërrmarjes së ujrave për përmirësimin e administrimit financiar dhe investimet që lidhen me këtë fushë.

4.Valuta e lëvrimin të kredisë: Kredia do të lëvrohet në lireta italiane me kursin e këmbimit të Bankës Italiane.

Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID/98/001/00

E lidhur më datën 25.08.1998 midis Bankës Kombëtare Tregëtare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellsave për shumën 974.042.799 lireta Italiane dhe ka për objekt përdorimin e huasë për elektropompa dhe materiale për ndërrmarjet e ujësjiellsave. Keto kredi jane te konvertuara ne euro sipas kursit te konvertimit te lireta italiane ne euro 1,936 ne daten 28.02.2002.Afati i kthimit të huasë është 18 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë:

1. Norma vjetore e interesit prej 1%, do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore të llogaritur mbi tepricën e kredisë.

2. Shlyerja e principalit të huasë do të filloj pas 150 muajve të bërjes efektive të huasë, principal ky i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.

3. Huamarrësi do ti paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur, i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.

4. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhen në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.

Kredia nga BKT për shfrytëzimin e burimeve të Shën Mërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

E lidhur më datën 31.07.2015 mes palëve: Banka Kombëtare Tregtare SHA dhe Ujësjetllës Kanalizim Tiranë SHA për shumën 1.000.000.000 lekë e cila do të përdoret për rikonceptimin e skemës së shfrytëzimit të burimeve të Shën Mërisë.

Dorëzanës: Shoqëria “H L”.

Kushtet e huasë:

1. Si kusht paraprakë kredimarrësi ka rënë dakord të paguajë shumën e kredisë dhe interesin mbi të. Disbursimi do të bëhet në cdo rast, vetëm pas paraqitjes së kopjes së faturës dhe të situacionit të punimeve të kryera.
2. Kredimarrësi do të hap një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregëtare, në të cilën banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
3. Kredimarrësi do të paguajë një komision angazhimi prej 0.4%, mbi vlerën totale të kredisë e pagueshme para ditës së disbursimit. Në rast se rezultojnë pjesë të papërdorura të kredisë pas një muaji një komision prej 2%, mbi bazë vjetore, e përlllogaritur mbi masën e papërdorur të kredisë deri në përfundim të kësaj periudhe.
4. Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikoj një penalitet prej 4% në muaj, mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit.
5. Në rast se kredimarrësi është në pA..ndësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar, Banka përveç normës së interesit normal ka të drejtë të aplikoj penalitet në masën 4% në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së papaguar.
6. Gjendja e fundit financiare e kredimarrësit tregon që raporti: Detyrime/Kapitale të veta është më i madh se 2:1.

Kredia për blerjen e H L nga BKT

E lidhur më datën 30.05.2012 midis palëve Banka Kombëtare Tregëtare dhe Ujësjetllës Kanalizime SHA për shumën prej 2.130.000.000 lekë me anë të së cilës do të financojë blerjen e “H L”.

Kushtet e Huasë:

1. Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në të cilën banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
2. Kredimarrësi garanton që kredia do të përdoret për qëllimin e marrjes së huasë, në të kundërt banka ka të drejtë të kerkoj mënjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose mund të aplikojë 1% penalitetin mbi shumën fillestare të kredisë.

Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të shoqërisë UKT SHA nuk është pasqyruar vlera e kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakort për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit. UKT SHA duke parë ecurinë e projektit dhe ndalesën e punimeve i ka kërkuar nëpërmjet Bashkisë Tiranë i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mundësinë e rishikimit të marrëveshjes së nënhuasë duke shtyrë në kohë pagesën pasi UKT SHA si përfitues fundor nuk ka përfituar ende nga projektin si dhe duke parë statusin aktual të tij përfundimi i projektit është shtyrë në kohë.

Detyrimet afatshkurtra

<u>Detyrime afatshkurtra</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31</u>	<u>Varianca në vlerë</u>	<u>Varianca në %</u>
------------------------------	---	----------------------------------	--------------------------	----------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

		dhjetor 2016		
Hua afatshkurtra	1,804,645	1,553,605	251,040	0.2
Llogari të pagueshme	2,991,323	2,720,916	270,407	0.1
Detyrime ndaj personelit	56,164	52,727	3,437	0.1
Të pagueshme të tjera	1,008	119	889	7.5
Provizione	137,130	144,364	-7,234	-0.1
Detyrime tatimore	24,062	42,015	-17,953	-0.4
Totali i detyrimeve afatshkurtra	5,014,332	4,513,746	500,586	0.1

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim janë:

- Llogaritë e pagueshme të cilat pasqyrojnë detyrimet ndaj furnitorëve për blerje dhe investime si dhe detyrimet ndaj Bashkisë Tiranë për taksën e pastrimit, taksën e ndërtesës si dhe taksën e ndikimit në infrastrukturën arsimore.
- Detyrimet ndaj personelit të cilat pasqyrojnë pagat e muajit dhjetor të punonjësve të cilat paguhën në muajin janar 2018.
- Të pagueshme të tjera të cilat janë parapagime për pikë lidhje.
- Huamarrje afatshkurtër e cila pasqyron principalet e Shën Mërise të cilat kalojnë nga huamarrje afat gjatë në huamarrje afatshkurtër për periudhën 1 vjeçare nga disbursimi që ka ndodhur gjatë vitit.

Fitimi neto është ulur me 34.7% (nga 639,624 mijë lekë në 417,219 mijë lekë).

Pasqyra e konsoliduar menaxheriale e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave gjithpërfshirëse

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pasqyra e fitimit/humbjes		
Të ardhura nga shitjet	3,255,822	3,108,845
Të ardhura të tjera	89,481	99,731
Total të ardhura	3,345,303	3,208,576
Shpenzimet e prodhimit	-830,491	-664,777
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	-304,153	-279,284
Rënia në vlerë e emrit të mirë	-	-239,021
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	-641,836	-345,735
Rimarrje/(Shpenzime) provizione	-39,509	-140,417
Ilogari të arkëtueshme	7,239	57,936
Rimarrje/ (Shpenzime) provizione të tjera	-960,832	-805,529
Total shpenzime	-2,769,582	-2,416,827
Të ardhurat financiare	115	1,259
Shpenzimet financiare	-129,239	-88,423
Fitim/(humbje) nga këmbimet valutore	67,845	61,063
Fitimi/humbja para tatimit	514,442	765,648
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-97,223	-126,024
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	-98,643	-127,946
Tatim i shtyrë detyrim (Aktiv)	1,420	1,922
Fitimi/humbja e vitit	417,219	639,624
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	417,219	639,624

Zërat që kane ndikuar në rezultatin e fitimit janë si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

- Të ardhurat janë rritur me 5%. Ndikimin më të madhë në këtë rritje e ka pasur vendosja e matësave.
- Shpenzimet e prodhimit janë rritur me 25%. Rritjen më të madhe e kanë pasur kimikatet, karboni dhe matësat.
- Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative janë rritur 86%. Rritjen më të madhe e kanë pasur shpenzimet për penalitete dhe gjoba, shërbimi rrojes private dhe konsulenca tekniko-ekonomike.

Të Ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten sipas zërave më poshtë:

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Të ardhura nga konsumatorë familjarë	1,407,516	1,348,663	58,853	4%
Të ardhura nga subjekte private	615,287	579,339	35,948	6%
Të ardhura nga institucione buxhetore	332,455	323,953	8,502	3%
Të ardhura nga institucione jo - buxhetore	60,612	62,655	-2,043	-3%
Të ardhura shitje uji KESH	233,465	269,774	-36,308	-13%
Të ardhura nga tarifa fikse e shërbimit	280,766	265,553	15,212	6%
Të ardhura shitje uji me shumicë	31,020	38,391	-7,370	-19%
Të ardhura nga klientë të veçantë	52,424	57,948	-5,523	-10%
Të ardhura shitje uji me bote	4,188	7,113	-2,925	-41%
Të ardhura nga pikëlidhjet	6,930	10,602	-3,673	-35%
Të ardhura vendosje matësash	101,992	18,753	83,239	444%
Të ardhura azhornime rrjeti	1,839	1,423	415	29%
Të ardhura të tjera	54,732	44,973	9,759	22%
Të ardhura nga prodhimi i aktiveve	47,313	56,325	-9,012	-16%
Të ardhura nga tarifa e pastrimit	25,281	23,380	1,901	8%
	3,255,822	3,108,845	146,976	5%

a) Zëri i cili ka pasur më shumë ndikim, është zëri *Të ardhura vendosje matësash*. Rritja prej 444% e këtij zëri ka ardhur si rezultat i reformës së ujit për formalizimin e të gjithë abonentëve me aparat matës. Nga ana e UKT SHA gjatë vitit 2017 është bërë aksion për kompletimin me ujëmatës abonentëve të cilët faturoheshin me mesatare.

Shpenzimet e prodhimit

Përfaqesojnë shpenzimet direkte që përballon UKT SHA në lidhje me prodhimin e produkteve të saj, Ujë i Pijshem dhe i Përdorur, këto detajohen të vecanta si vijon:

Shpenzimet e prodhimit	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Shpenzime materiale të para - mirëmbajtje rrjeti	136,656	124,527	12,129	10%
Shpenzime materiale - kimikate	95,501	58,858	36,643	62%
Shpenzime të tjera - karbon	49,125	28,605	20,520	72%
Shpenzime kancelarie	11,071	15,411	-4,340	-28%
Shpenzime energjie elektrike	379,554	348,231	31,324	9%
Shpenzime materiale - matësat	81,409	31,718	49,691	157%
Shpenzime karburanti	63,872	46,769	17,103	37%
Lënda e parë e materiale të konsumueshme HEC	13,303	10,659	2,644	25%
	830,491	664,776	165,714	25%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim në shpenzimet e prodhimit duke pare dhe nga tabela janë:

- a) Kimikate, Karbon (kjo për shkat të ndarjes së njërive administrative ku kemi më shumë vendburime gjatë vitit 2017 të cilat trajtohen me Kimikate dhe Karbon. Në vitin 2016 trajtimi me Karbon është bërë vetëm 6 muaj, ndërësa në vitin 2017 trajtimi është bërë gjatë gjithë vitit)
- b) Karburant (me blerjen për nevojat e UKT SHA të mjeteve të transportit, rrjedhimisht është rritur edhe konsumi i karburantit).

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Përfaqësojnë shpenzimet për konsulenca, pagesa këshilli mbikqyrës, udhëtime, dieta personeli, telefoni etj.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Varianca në vlerë	Varianca në %
Taksa dhe tatime të ngjashme	32,792	28,411	4,381	15%
Marketing dhe të ngjashme	25,233	21,963	3,270	15%
Transferta, udhëtime	4,007	6,426	-2,419	-38%
Shpenzime të përgjithshme	13,207	9,081	4,126	45%
Penalitete dhe gjoba	64,468	17,424	47,044	270%
Shpenzime telefonike, postare, internet	2,632	2,424	209	9%
Shërbimi i rojes private	346,413	151,840	194,573	128%
Të tjera	26,163	10,433	15,729	151%
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe riparime	24,271	34,644	-10,373	-30%
Qera	27,720	21,014	6,705	32%
Shpenzime printime dhe fotokopje	18,441	17,798	643	4%
Shpenzime kërkimore	3,408		3,408	100%
Konsulencë tekniko-ekonomike	28,452	2,768	25,684	928%
Kolaudim matësash	24,631	21,508	3,122	15%
	641,837	345,735	296,102	86%

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim në shpenzimet e përgjithshme dhe administrative duke parë dhe nga tabela janë:

- a) Penalitete dhe gjoba e cila vjen nga viti 2015 ku për shkak të ristrukturimit janë bërë shumë lA..me punonjësish, të cilët kanë hapur çështje gjyqësore me UKT SHA.
- b) Shërbimi i rojeve private kjo për shkak të ndarjes së njërive administrative kemi më shumë vendëroje duke e krahasuar me vitin 2016.
- c) Shpenzimet e kryera për konsulencë nga jashtë, eksperti kontabël për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, studimin e fizibilitetit të digës së Liqenit Artificial Tiranë, studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lana Bregas, vlerësimin teknik të rrjetit të UKT. Theksojmë, se asnjë nga këto studime nuk rezultuan të suksesshëm për ndërmarrjen e një investimi, duke stopuar në këtë formë vazhdimin e një investimi të mirëfilltë, ndaj të tre këto kontrata rëndojnë zërin e Shpenzimeve të konsulencës tekniko-ekonomike.

Gjatë periudhës objekt auditimi UKT SHA ka pasur një kontroll nga organet tatimore për peroidhën 01/01/2013 deri më 30.11.2017, pra para ndarjes së Ujësjellësit të Tiranës SHA. Nga ky kontroll rezulton se detyrmet tatimore janë:

Detyrime për TVSH

Periudha	Detyrimi	Penaliteti	Totali
-----------------	-----------------	-------------------	---------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

		Neni		
		115	124	
Dhjetor 2013	17,485,381	3,771,493	263,952	21,520,826
Dhjetor 2014	15,576,684	3,411,294		18,987,978
Maj 2015	1,586,400	347,422		1,933,822
Dhjetor 2015	15,325,723	3,356,333		18,682,056
Dhjetor 2016	12,167,141	2,664,604		14,831,745
Nëntor 2017	16,199,849	1,166,389		17,366,238
Totali	78,341,178	14,717,535	263,952	93,322,665

Detyrime për Tatim Fitimi

Periudha	Detyrimi	Penaliteti		Totali
		Neni		
		115	124	
Viti 2013	8,742,691	1,885,747	131,976	10,760,414
Viti 2014	11,768,889	2,577,387		14,346,276
Viti 2015	11,494,293	2,517,250		14,011,543
Viti 2016	9,125,356	1,998,453		11,123,809
Viti 2017	12,149,886	218,698		12,368,584
Totali	53,281,115	9,197,535	131,976	62,610,626

Detyrime për Tatim në Burim

Periudha	Detyrimi	Penaliteti	Totali
		Neni	
		117	
Dhjetor 2014	657,736	657,736	1,315,472
Totali	657,736	657,736	1,315,472

Të tjera penalitete për Kasat Fiskale

Periudha	Mostransmetim kase	Mosnjofitim difekti	Totali
	Neni	Neni	
	113	122/1 gj	
Qershor 2017	30,000		30,000
Korrik 2017	30,000		30,000
Gusht 2017	20,000	25,000	45,000
Shtator 2017	10,000		10,000
Totali	90,000	25,000	115,000

Detyrimi total i shoqërisë për periudhën kontrolluar rezulton në vlerën **157,363,763 lekë**.

UKT sha ka ndjekur hapat ligjorë për ta kundërshtuar njofitim vlerësimin:

-Me shkresën nr. K-2424/1 prot, datë 13.06.2018, “Kundërshtim i Raport Kontrollit Tatimor nr. 8064/6 prot, datë 28.05.2018”, i është drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

-UKT sh.a me shkresën Nr. K-2024/3 prot, datë 23.07.2018 për “Ankim Administrativ Tatimor”, i është drejtuar: “Ministrisë së Financave, Drejtoria e Apelit Tatimor, Tiranë”.

-Në datën 29.08.2018 është kryer takimi me Komisionin e Apelit Tatimor.

Komisioni i Apelit Tatimor ka marrë Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 të Komisionit të Shqyrtimit të Apelit Tatimor, u mor vendimi për heqjen e detyrimeve dhe gjobave nga 157 363 763 lekë, hequr 144 247 542 lekë.”

Detyrimi tatimor pas daljes së vendimit të Komisionin të Shqyrtimit të Apelit tatimor është 13,116 mijë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Për mangësitë e konstatuara në lidhje me pasqyrat financiare mban përgjegjësi A.S, Drejtore Ekonomike.

Në lidhje me observacionet nr. K-4272/17, datë 16.11.2018, të projektraportit të auditimit dhe nr. 23920/1 datë 24.10.2018 të Aktkonstatimit nr. 14, të paraqitura nga A.S, drejtore ekonomike e UKT SHA, ku pretendon se:

“-Për llogarinë Aktive Afatgjata Jomateriale lidhur me kete ceshtje UKT ka parashikur ne fondet e buxhetit të vitit 2018 për kryerjen e zhvlerësimit të Emrit të mirë, miratuar kjo nga Këshilli Mbikqyrës i UKT sh.a me vendim nr.20 datë 12.12.2016 “Mbi zbatimet e Rekomandimeve të Audituesit të jashtëm G.Th shpk për Emrin e Mirë dhe Grantet“. Është vendosur sipas pikës 1. “Miratimin e vlerësimit me ekspertë të jashtëm të Emrit të Mirë, të regjistruar në pasqyrat financiare të UKT sh.a si aset nga blerja e H L dhe pezullimin e zhvlerësimit deri në kryerjen e vlerësimit”.

-Në zërin aktive afatgjata materiale, zëri aktive në proces përfshin vlerën 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorë të kredisë italiane për Impjantin e Bovillës dhe Stacionit të Pompimit të Qafë Mollës, kredi e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizime (DPUK). Zëri i aktiveve në proces janë materiale të mbartura nga viti 2012 dhe nuk janë marrë në dorzim asaj kohe nga palët.

-Për llogarinë “Inventarët”, lidhur me këtë ceshtje UKT ka ndjekur me përparësi zhvlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve stok.

-Për llogari të arkëtueshme çështja e mësipërme nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë Ekonomike. Kjo çështje i përket Drejtorisë së Shitjes, Sektori i Riskut e cila ka përdorur në pasqyrat financiare të vitit 2017 metodologjinë e çmuarjes dhe zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme.

-Për llogarinë “Huamarrje afatshkurtra”, vlera 1,205,077 mijë lekë që i përket kredive afatshkurtra italiane është kontabilizuar gjatë viteve 2008-2015. Bashkëlidhur analizë veprimi të këtyre llogarive me periudhat që i përkasin. Nga ana jonë veprimet e kryera gjatë vitit janë rregjistruar në përputhje me kërkesat e standardit.

-Për llogarinë “Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime”, grantet e UKT sh.a janë krijuar që nga viti 2002 deri në vitin 2011. UKT sh.a gjatë viteve 2016-2017 ka krijuar takime për këto çështje pranë Ministrisë së Financave dhe Degës së Thesarit Tiranë për të marrë informacion të detajuar por ka hasur vështirësi pasi nuk gjëndet kodi i projektit dhe kodi i Ministrisë së linjës që ka mundësuar çeljen e vlerës së projektit nëpërmjet Degës së Thesarit. Bashkëlidhur gjeni bilancin e vitit 2011. Sa më sipër po vijojmë në bashkëpunim me MF për të gjetur të dhëna.

- Rezerva e rivlerësimit, në seksionin e kapitalit të Shoqërisë mëmë përpara ndarjes ka qenë e përfshirë rezerva e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë Lekë, ndërkohë që me krijimin e shoqërisë së re të UKT sh.a., pjesa e tepricës së rivlerësimit që i takon kësaj shoqërie i është bashkuar kapitalit aksionar duke e rritur atë. UKT sh.a. ka kryer procesin e ndarjes të Aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. Ky proces për vetë rëndësinë dhe kompleksitetin nuk mund të bëhet nga UKT sh.a, prandaj është kryer nga ekspertët e jashtëm “UHY.E sh.p.k.” dhe “S.A”. Ekspertët kanë vendosur që rezervën e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë Lekë ta bashkojnë me kapitalin aksionar duke e rritur atë.

-Në lidhje me magazinën e UKT sh.a në magazinën Brar, ne jemi dakort me konstatimin tuaj. Magazina është tejet e amortizuar dhe nuk ka pësuar kurre rikonstruksion gjatë viteve për ta sjellë atë në formë më të organizuar. Nga ana e UKT sh.a është bërë projekti për rikonstruksionin e magazinës Brar për të patur një organizim më të mirë në lidhje me vendosjen e artikujve nëpër raftet me qëllim identifikimin e tyre, i cili do të kryhet gjatë vitit 2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Kredia Japoneze, vlera e kredisë e marrë nga Qeveria Japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare për arsyet e mëposhtëme:

-Mungesa e dokumentacionit përkatës për justifikimin e kredisë japoneze nga AKUK(ish-DPUK),ku përvec një kontrate nënhuaje ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Shqipërisë dhe Ujësjiellës Kanalizimeve Tiranë sh.a e datës 12.02.2009, nuk disponohet asnjë dokument tjetër.

-AKUK(ish-DPUK) duhet të paraqiste pranë UKT sh.a. situacionet që lidheshin me disbursimin e secilit transh, gjë e cila ka mos pasqyrimin e vlerës së kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”.

-UKT sh.a nuk ka marrë në dorëzim asnjë vepër të përfunduar mbi projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”.

-Ekziston një korespondencë sot, për vetë rëndësinë e projektit, e cila ka marrë përsipër për të negociuar mbi projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, si shtyrjen e afatit të pagesës së principalit dhe kontabilizimin.Kjo nismë është ndërmarrë ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrstrukturës dhe Energjisë, dhe AKUK.

-Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve, UKT ka ndërmarrë një nisëm të madhe për modernizimin e sistemeve të saj. Gjate vitit vitit 2017 ka nisur ndërtimi i sistemit NAVISION i cili ndërlidh të gjitha departamentet me database të përbashkët. Ndër të tjera ky sistem ka dhe modulën e llogaritjes së pagave dhe shpërblimeve, sikurse ju e citoni si mangësi. Ky sistem është drejt përfundimit dhe testimit për tu vënë në funksionim. Nga ana e UKT në vitin 2017 për të sqaruar këtë çështje të gjetur të mbartur nga parardhësit me shkresën Nr. 509/1, datë 16.03.2017, kemi ngritur grupi i punës për shqyrtimin dhe verifikimin në lidhje me programin “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”.

-Për sa i përket detyrimeve tatimore të konstatuara në datën 28.05.2018, faqja 130.

Sqarojmë se këto detyrime i përkasin periudhave në të cilat unë nuk kam ushtruar detyrën, periudha 01/01/2013 deri 30/11/2017. UKT sha ka filluar të ndjeki hapat ligjorë për ta kundërshtuar njoftim vlerësimin:

-Me shkresën nr. K-2424/1 prot, datë 13.06.2018, me lëndë: “Kundërshtim i Raport Kontrollit Tatimor nr. 8064/6 prot, datë 28.05.2018”, i është drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

-UKT sh.a me shkresën Nr. K-2024/3 prot, datë 23.07.2018 për “Ankim Administrativ Tatimor”,i është drejtuar: “Ministrisë së Financave, Drejtoria e Apelit Tatimor, Tiranë”.

-Në datën 29.08.2018 është kryer takimi me Komisionin e Apelit Tatimor dhe jemi në pritje të vendimit.

Kjo ngjarje, në kundërshtim me konstatimin tuaj është shprehur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë UKT sh.a. të datës 20.11.2017 në faqen 34, pika 33. Bashkëlidhur gjeni Pasqyrat Financiare të datës 20.11.2017.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se me Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 të Komisionit të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor, u mor vendimi për heqjen e detyrimeve dhe gjobave nga 157 363 763 lekë, hequr 144 247 542 lekë”.

Ju sqarojmë se problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit qëndrojnë dhe se ju nuk keni paraqitur asnjë argumentim ligjor apo shkresor por keni sqaruar situatën si dhe keni ndarë përgjegjësinë tuaj në lidhje me këto konstatime. Përgjegjësia juaj qëndron për vet faktin se ju jeni hartuese e pasqyrave financiare të UKT SHA dhe nuk keni marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të lëna edhe nga audituesit e pavarur të pasqyrave financiare të cilët kanë të njëjtat konstatime mbi të cilin shprehin opinionin e pasqyrave financiare. Observacioni juaj nuk qëndron.

Për sa i përket detyrimeve tatimore konstatimi juaj qëndron dhe u bë reflektimi në material.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Mbi ndarjen e aseteve të shoqërisë.

Më datë 20.11.2017, është formalizuar ndarja e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA Tiranë, nga e cila u krijuan e tre shoqërive të reja:

- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Tiranë SHA,
- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Kamëz SHA
- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Vorë SHA.

Modalitetet për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.a u përcaktuan në Relacionin Nr. 17170/8 prot, datë 09.08.2016 të Grupit të Punës.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” Sh.a i miratoi këto modalitete me vendimin Nr. 11 të datës 31/08/2016.

Në bazë të Marrëveshjes dhe në përputhje me Ligjin Për Shoqëritë Tregtare, ndarja e UKT sha u shoqërua me krijimin e tre shoqërive të reja:

- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a.,
- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a.,
- Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.

-Vendim nr. 1, datë 18.04.2017, për rishikimin e kushteve të projekt marrëveshjes dhe raportit të ekspertëve për ndarjen e ekspertëve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz dhe shoqëria UKT sh.a, bazuar në kriteret e VKM nr.660, datë 12.09.2007.

Në lidhje me këtë ndarje është konstatuar se është kryer me vendimmarrjen e mëposhtme:

-Vendim nr. 1, datë 18.04.2017, për rishikimin e kushteve të projekt marrëveshjes dhe raportit të ekspertëve për ndarjen e ekspertëve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz dhe shoqëria UKT sh.a, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007;

-Vendim nr. 03, datë 07.07.2017, për miratimin e projekt marrëveshjes dhe raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria UKT sh.a (miratimi paraprak faza I, publikimi në QKB);

-Vendim nr. 08, datë 27.09.2017, për miratimin e projekt marrëveshjes të ndarjes, raportit të ndarjes të shoqërisë UKT sh.a dhe raportit të ekspertit të pavarur për vlerësimin e projektit të ndarjes (për fazën e dytë, pas publikimit të akteve të ndarjes në QKB);

-Vendimi nr. 11, datë 13.11.2017, për miratimin e akt-themelimit dhe statutit të shoqërive që krijohen rishtazi nga ndarja e shoqërisë UKT sh.a miratuar me Vendimin nr. 8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve;

Nga sa më sipër konstatohet se:

Në statusin e shoqërisë UKT SHA, në nenin 6/6, përcaktohet se ndarja e aksioneve të shoqërisë së re krijuar në bazë të ndarjes së re administrativo-territoriale, është:

- Bashkia Tiranë, 82.5% të aksioneve,
- Bashkia Kamëz, 14.6% të aksioneve,
- Bashkia Vorë, 2.9% të aksioneve.

Me Vendimin nr. 1, datë 18.04.2017, për rishikimin e kushteve të projekt marrëveshjes dhe raportit të ekspertëve për ndarjen e ekspertëve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz dhe shoqëria UKT sh.a, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007, është vendosur që ndarja e aseteve të shoqërisë, do të kryhet duke u bazuar në numrin e popullsisë, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Ndërsa me Vendimin nr.03, datë 07.07.2017, për miratimin e projekt marrëveshjes dhe raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria UKT sh.a (miratimi paraprak faza I, publikimi në QKB), është vendosur ndarja si më poshtë vijon:

- Bashkia Tiranë 98% të aktiveve të shoqërisë së vjetër,
- Bashkia Kamëz 1.57% të aktiveve të shoqërisë dhe
- Bashkia Vorë 0.43% të aktiveve të shoqërisë.

Siç konstatohet dhe më sipër, Bashkia Kamëz edhe pse zotëronte 14.6 % të aksioneve të shoqërisë para ndarjes, është diskriminuar duke i lënë vetëm 1.57 % të aktiveve.

Me anë të Kërkesë Padisë nr. 34946, datë 10.08.2017, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Bashkia Kamëz ka ankimuar Vendimin nr. 03, datë 07.07.2017, duke mos e pranuar dhe duke mos marrë në dorëzim asetet. Bashkia Kamëz kërkon që ndarja e aseteve të shoqërisë së vjetër, të kryhet në bazë të kriterëve të VKM nr. 660, datë 12.09.2007, ku përcaktohet që ndarja e aseteve të shoqërisë, të kryhet duke u bazuar në numrin e popullsisë, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007.

Me Vendimin e datës 21.03.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur:

- 1- *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*
- 2- *Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimeve datë 07.07.2017, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë UKT sh.a “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.*
- 3- *Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit nr.08, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë UKT sh.a “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.*
- 4- *Konstatimin e pavlefshmërisë së Marrëveshjes së Ndarjes së Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë nr.08/2 prot., datë 27.09.2017.*
- 5- *Rrezimin e kërkesë padisë për konstatimin e pavlefshmërisë të vendimit Nr.11, datë 31.08.2016, “Për miratimin e modaliteteve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a”,*
- 6- *Rrezimin e kërkesë padisë për Kundërshtim të raportit nr.15367 prot, datë 09.08.2017 të ekspertit të pavarur për vlerësimin e projektit për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, caktimin e një tjetri eksperti për vlerësimin e raportit të ndarjes.*
- 7- *Ky vendim të dërgohet në QKB për kryerjen e regjistrimeve përkatëse.*
- 8- *Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.*
- 9- *Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.”.*

Shoqëria UKT SHA, e ka ankimuar këtë vendim, i cili pritet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

C.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

1. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje Software (program) dhe pajisje për leximin e matësave të ujit, për UKT sha”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 4050 Prot., datë 25.02.2017	M.Q, kryetar, jurist, M.B, juriste, A.Q, Inxhinieri Elektronike, anëtarë. Urdhri Nr. 4050/2 Prot., datë 25.02.2017.	K.H, juriste, D.K, ekonomiste, I.G, inxhinier
Vlera e përlogaritur e kontratës 23,442,667 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 21.03.2017.		
Operatori ekonomik fitues, ““J.S”” SHPK me ofertë 23,200,000 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 242,667 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 5 operatorë ekonomikë: 1. ““J.S”” SHPK me ofertë 23,200,000 lekë pa TVSH. 2. “BNT E” SHPK me ofertë 23,200,000 lekë pa TVSH. 3. “F..” SHPK pa ofertë, skualifikuar. 4. “CCS” SHPK pa ofertë, skualifikuar. 5. “I.T.A” SHPK pa ofertë, skualifikuar.		
Kualifikuar 1 operator ekonomik. Skualifikuar 4 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 4050/7 Prot., datë 22.05.2017, me vlerë 27,840,000 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 4050/5 Prot., datë 04.04.2017.	Komisioni për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 83, datë 13.02.2017: E.C, K.T dhe A.S. Komisioni i kolaudimit: A.Q, E.Idhe S.Zh	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 4050/1, datë 25.02.2017. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 4050/6, datë 04.04.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 4050/8, datë 23.05.2017. Ankesa: Nuk ka.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesë nr. 474, datë 10.02.2017 “Kërkesë për blerje Software (programi) pajisje për leximin e matësave”, z. A.Q me detyrë Përgjegjës i Njesisë së IT, ka dërguar specifikimet teknike për këtë procedurë. Në lidhje me këto specifikimet teknike, u konstatua se:

-Në pikën 1 të Shtojcës nr. 10, ndër të tjera është kërkuar që “Ky aplikacion duhet të funksionojë në PDA me sistemin Android v4.4.3 e siper dhe të jete me nderfaqe në gjuhën shqipe”, duke përmendur emrin e markës pa shtuar fjalët “ose ekuivalent”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 5.

-Në pikën 4 të Shtojcës nr. 10, karakteristikat minimale teknike të pajisjes janë përcaktuar në anglisht, në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 14, pika 1, e cila përcakton se: “1. Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja”.

-Në pikën 4 të Shtojcës nr. 10, në karakteristikat minimale teknike të pajisjes, janë përcaktuar dimensionet e pajisjes që janë dimensione fikse (142.5mm*75mm*13mm). Ky kriter është diskriminues, për arsye se është shumë kufizues për pajisjet që do prokurohen, duke mos i argumentuar vendosjen e këtyre përmasave kaq fikse. Veprimet e mësipërme janë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre” dhe neni 23, pika 2, e cila përcakton se: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

Për sa më sipër mban përgjegjësi hartuesit i specifikimeve teknike.

Me Urdhrin nr. 83, datë 13.02.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për testimin e tregut. Grupi i punës me anë të relacionit nr. 83/4, datë 24.02.2017, ka vendosur që vlera e fondit limit të jetë 23,442,667 lekë pa tvsh, si mesatarja e ofertave të OE si më poshtë vijon:

1. “X.C.S” SHPK me vlerë 23,408,000 lekë pa tvsh,
2. “J.S” SHPK me vlerë 23,304,000 lekë pa tvsh dhe
3. “ITS” SHPK me vlerë 23,616,000 lekë pa tvsh.

Nga kjo përllogaritje e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, konstatohet se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së këtyre OE, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE (konkretisht nuk dokumentohet mënyra e kërimit të ofertës nga këta OE). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila përcakton se: “...Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së kontratës.***

Me anë të procesverbalit nr. 4050/3, datë 25.02.2017, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Njësia e prokurimit e ka klasifikuar këtë procedurë si “Mallra”, ku sipas vetë këtij procesverbalit, pjesa e licencës e cila është shërbim përbën 71% të vlerës së përllogaritur kësaj kontrate, e si e tillë duhej përcaktuar si “Kontratë publike shërbimi”. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3, pika 5, e cila përcakton se: “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike që kanë objekt kryerjen e shërbimeve. Kontrata publike, që ka si objekt mallra dhe shërbime, vlerësohet si “kontratë publike për shërbime”, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë. Kontratat publike, që kanë objekt shërbimet, por që përfshijnë edhe punime të lidhura në mënyrë dytësore me objektin kryesor të kontratës, vlerësohen “kontrata publike për shërbime”.

-Në pikën 2.1.1 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik”, kërkesë kjo e paqartë dhe diskriminuese për arsye se kufizohen për pjesëmarrje vetëm OE që kanë të pasqyruara në ekstraktin e tyre të regjistrimit objektin e prokurimit dhe jo natyrën e shërbimeve/mallrave të kërkuara për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në pikën 2.3.3 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që OE ofertues të jetë i certifikuar sipas ISO 9001:2008, ISO 27001 dhe ISO 20000, ndërsa ka argumentuar vendosjen e certifikatave ISO 9001, OHSAS 18001 dhe ISO 14001, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Nuk është argumentuar vendosja e kërkesave për kualifikim 2.3.4 deri në 2.3.12, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në pikën 2.2.1 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar “Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit (2015 dhe 2016) duhet të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave, për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku vlera mesatare e tyre të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit”, duke mos përcaktuar qartë afatin nëse është 3 vite apo vetëm vitet 2015 dhe 2016. Veprime në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pikat 3 dhe 4, të cilat përcaktojnë se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, **autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.** 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë **tri viteve të fundit**”.

-Në pikën 2.2.2 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar “Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjate tre viteve të fundit (2014 dhe 2015). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopjet e çertifikuara të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, si dhe të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar” duke mos përcaktuar qartë afatin nëse është 3 vite apo vetëm vitet 2014 dhe 2015. Veprime në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3, e cila përcakton se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, **autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve**”.

-Në pikën 2.3.3 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas: - ISO 9001:2008 per menaxhimin e cilesise;”, ndërkohë certifikatë është përmirësuar me ISO 9001:2015.

-Në pikën 2.3.3 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të paraqesi në ditën dhe oren e hapjes së tenderit, një moster të produkteve mobile dhe Software të ofruar, të paperdorur dhe të ambalazhuar nga prodhuesi”. Kërkesa për sjelljen e mostrës së Software, i cili është një shërbim, është e konfuzë dhe mbetet i paqartë fakti se si KVO mund ta vlerësojë një mostër të tillë. Veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”.

-Në pikën 2.3.7 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të jetë Microsoft Partner ose Oracle Partner me qellim suportin për RDBMS dhe sigurimin e të dhenave”, duke përmendur emrin e markës pa shtuar fjalët “ose ekuivalent”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 5, e cila përcakton se: “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

-Në pikën 2.3.8 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të jete i autorizuar nga autori i programit kompjuterik “Al-Billing””, duke mos e argumentuar vendosjen e këtij kriteri nëse ka lidhje ndonjë ekskluzivitet apo jo, e që në këtë rast do duhej përdorur tjetër procedurë në kuptim të LPP.

-Në pikën 2.3.9 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të kete ne stafin e tij minimalisht 3 specialiste IT, nga te cilet team leader te jete me te pakten 10 vite eksperience pune (te ngjashme me objektin e prokurimit). Nje prej specialisteve IT, i cili minimalisht te kete 5 vite eksperience pune (te ngjashme me objektin e prokurimit).

Per te vertetuar sa me lart duhet te dorezohen listepagesat e printuara nga sistemi i tatimeve per nje periudhe te pakten 3 mujore, duhet te dorezohen kopje te diplomave te specialisteve.”, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave”. Gjithashtu nga NjP nuk është argumentuar vendosja e një kriteri të tillë diskriminues për vjetërsinë e stafit të OE ofertues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në fund të Shtojcës nr. 8, është shënuar që “**KUJDES!** Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të kontratës, kontraktori mban përgjegjësi të plotë për veprimet ose mosveprimet e shkaktuara nga ana e tij dhe do të jetë përgjegjës për çdo dëm kontraktor dhe jashtëkontraktor të shkaktuar në kantier. Kontraktori mban përgjegjësi financiare për kompensimin e dëmit, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim si dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme dhe gjithashtu dënohet me gjobë në vlerën nga 100,000 (njëqind mijë) deri në 1,000,000 (një milion) lekë.”. Ky shënim i vënë nga AK, është një shënim i paargumentuar dhe pasnjë bazë ligjore, për arsye se për çdo dëm të shkaktuar nga moszbatimi i plotë i kushteve të kontratës, AK gëzon të drejtën e konfiskimit të sigurimit të kontratës, në zbatim dhe të nenit 32.2 të Shtojcës nr. 16 “Kushtet e përgjithshme”, e cila përcakton se: “Shuma e sigurimit të kontratës duhet t’i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesi në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 474, datë 10.02.2017, specifikimet teknike për këtë procedurë janë përgatitur nga z. A.Q me detyrë përgjegjës i Njësisë së TI, i cili është njëkohësisht anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. **Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.** Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek”. Për pasojë z. A.Q nuk duhej ta kish pranuar detyrën e anëtarit të KVO.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 21.03.2017, ora 09:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S' kualifikuar	Klasifikuar
1	“J.S” SHPK	23,200,000	Kualifikuar	1
2	BNT E.. SHPK	23,200,000	Skualifikuar	
3	F.. SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	
4	CCS SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	
5	I.T.A SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr. 4050/4, datë 27.03.2017, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së OE BTN E.. SHPK, F.. SHPK, CCS SHPK dhe I.T.A SHPK, si dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE “J.S” SHPK.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 4050/5, datë 04.04.2017, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues. Nga auditimi u konstatua se Raporti Përmbledhës nuk është paraqitur në mënyrë të plotë, për arsye se:

-Nuk përcaktohet numri i referencës së procedurës.

-Nuk përmban përshkrimin e mallrave dhe shërbimeve që do prokurohen.

-Nuk përmban informacion mbi ankesa për këtë procedurë.

Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, i cili përcakton se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to”, e për pasojë ky Raport Përmbledhës nuk duhej miratuar nga titullari i AK. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.*

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

OE BNT E.. SHPK

OE BNT E.. SHPK ka paraqitur vetëm formularin e ofertës dhe asnjë dokumentacion tjetër.

OE F.. SHPK, CCS SHPK dhe I.T.A SHPK, nuk kanë paraqitur ofertë ekonomik dhe dokumentacion teknik e financiar.

OE “J.S” SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, u konstatua se:

-OE “J.S” SHPK e ka të pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, natyrën e pajisjeve dhe shërbimeve të kërkuara nga AK, por nuk ka të pasqyruar objektin e prokurimit, në kundërshtim me pikën 2.1.1 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë procedurë. Kjo mangësi ka ardhur si pasojë e paqartësisë në vendosjen e këtij kriteri për kualifikim nga AK, që ka penalizuar këtë OE.

-OE “J.S” SHPK ka paraqitur Vërtetimin nr. 5623/1, datë 20.03.2017, lëshuar nga Ujësjetllës Kanalizime SHA Tiranë (vetë AK), më anë të të cilit vërtetohet se për kontratën nr. 177876-1, nuk rezulton debitor ndaj UKT. Në lidhje me këtë kontratë, konstatohet se është një kontratë **familjare** në pronësi të administratorit të Jehona SHPK dhe me adresë në **Yzberisht**. Ndërsa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

sipas ekstraktit të gjendjes aktuale të shoqërisë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, vërtetimit të OSHEE pa numër datë 14.03.2017, adresa zyrtare e OE “J.S” SHPK është “Njësia Bashkiak Nr. 5, Rruga Prokop Mima, Pallati Universal, hyrja e parë, kati i parë, Hyrja 1/A”. Siç konstatohet ky OE ka paraqitur vërtetimin e debisë ndaj UKT për kontratën familjare të administratorit të shoqërisë (vërtetuar kjo dhe nga noterizimi i DT me nr. 735 REP, datë 20.03.2017) dhe jo për zyrat e shoqërisë, në kundërshtim me pikën 2.3.12 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “J.S” SHPK ka paraqitur bilancet e vitit 2014 dhe 2015, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të Shtojcës nr. 8, në të cilën kërkohej kopje e certifikuar e bilanceve për 3 vitet e fundit, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter. Kjo mangësi ka ardhur si pasojë e paqartësisë në vendosjen e këtij kriteri për kualifikim nga AK, që ka penalizuar këtë OE.

-OE “J.S” SHPK ka paraqitur Vërtetimin për realizim kontrate nr. 12720/1, datë 16.11.2016, lëshuar nga vetë AK, UKT, për realizimin e kontratës nr. 14861/7, datë 23.08.2016 “Shërbim dhe konfigurim i kasave dhe sistemit të faturimit për UKT SHA”, me vlerë 10,728,000 lekë me tvsh. Nga auditimi konstatohet se OE “J.S” SHPK, sipas kontratës së bashkëpunimit për këtë procedurë, ka realizuar 70% të volumit të punimeve. Nga auditimi i zërave të ngjashëm më procedurën për kontratën nr. 14861/7, datë 23.08.2016, konstatohet se nuk janë realizuar në masën 40% e konkretisht “Blerje e pajisjeve barcode reader”, që janë të ngjashëm me telefona mobile, sipas përqindjes së volumit të punimeve është realizuar në masën 11%. Veprime në kundërshtim me pikën 2.3.1 të Shtojcës nr. 8, në të cilën kërkohej furnizime të ngjashme në masën 40% të fondit limit, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “J.S” SHPK ka paraqitur kontratat dhe certifikatat për 3 specialistë IT. Nga auditimi i këtyre kontratave konstatohet se team leaderi (administratori i shoqërisë) ka mbi 10 vite eksperience, ndërsa asnjë prej specialistëve të paraqitur (J.B dhe F.M) nuk kanë eksperiencë në fusha të ngjashme mbi 5 vite, në kundërshtim me pikën 2.3.9 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “J.S” SHPK ka paraqitur kopje jo origjinale dhe të panoterizuara të katalogut të pajisjeve mobile, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Nga krahasimi i të dhënave të produktit U.. të paraqitur nga OE “J.S” SHPK, me të dhënat e kërkuar në specifikimet teknike të kërkuara, konstatohet se:

- Dimensionet e kërkuara për produktin janë 142.5mm*75mm*13mm, ndryshojnë nga dimensionet për produktin e ofruar janë 148.9*75.8*12.5mm, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
- Për 3 specifikime të kërkuara (Operating Temp.; Storage Temp.; dhe Ekstra), nuk konstatohen të dhëna në katalog, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

Referuar konstatimeve të mësipërme, OE “J.S” SHPK nuk duhej kualifikuar, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Zbatimi i kontratës

OE “J.S” SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 46451808, datë 13.04.2017, me vlerë 2,784,000 lekë.

Kontrata e **shërbimit** nr. 4050/7, datë 22.05.2017, me vlerë 27,840,000 lekë me tvsh, me afat 10 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. K.Z për Kontraktorin “J.S” SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 276, datë 23.05.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e kolaudimit të përbërë nga:

1. Z. A.Q,
2. Z. E.I,
3. Z. S.Zh.

Me anë të Akt-Kolaudimit nr. 276/1, datë 25.05.2017, grupi i kolaudimit ka arritur në konkluzionin se malli dhe shërbimi i sjellë nga kontraktori “J.S” SHPK, është në përputhje me kontratën.

Me anë të faturës tatimore nr. 31920997, datë 25.05.2017, me vlerë 27,840,000 lekë me tvsh, kontraktori “J.S” SHPK, ka sjellë mallrat dhe shërbimet e ofruara, të cilat janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 11, datë 25.05.2017.

Nisur nga fakti që:

-Sipas pikës 3.3 të nenit 3, të kontratës së shërbimit nr. 4050/7, datë 22.05.2017, specifikimet teknike kërkuara për këtë pajisje janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

-Sipas dokumentacionit teknik (katalogët) të paraqitur nga OE “J.S” SHPK, konstatohet se produkti i kërkuar nuk është i njëjtë për 1 kriter (dimensionet) me produktin e ofruar, si dhe për 3 kritere nuk provohet përputhshmëria duke qenë se nuk ka të dhëna për to në produktin e ofruar.

-Pajisjet e ardhura janë të markës “U..”, model “A..”, nga krahasimi i të dhënave teknike të këtyre pajisjeve nga faqja zyrtare e shoqërisë (<http://U...com/products/A../spec.html>), me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë, konstatohet se:

- Dimensionet e kërkuara për produktin janë 142.5mm*75mm*13mm, ndryshojnë nga dimensionet për produktin e ofruar janë 148.9*75.8*12.5mm, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
- Për 3 specifikime të kërkuara (Operating Temp.; Storage Temp.; dhe Ekstra), nuk konstatohen të dhëna në katalog, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kritere.
- Për të dhënat e Netëork, pajisja e ofruar nuk disponon 4G – 700MHz.
- Pajisja e ofruar nuk konstatohet të disponojë “Distance Sensor”.

-Në Akt-Kolaudimin nr. 276/1, datë 25.05.2017, grupi i marrjes në dorëzim të kontratës, nuk është shprehur në asnjë moment të dhënat që ndryshonin dhe mungonin në katalogun e ofruar.

-Si dhe këto pajisje kanë mbi 1 vit që përdoren nga UKT.

-Me anë të observacioneve të dërguara me shkresën nr. K-4272/14, datë 16.11.2018, në zbatimit të rekomandimit të lënë nga KLSH, titullari i AK me Urdhrin nr. 521, datë 20.10.2018, ka ngritur një grup të ri kolaudimi, i cili me anë të relacionit nr. 4521/1, datë 29.10.2018, ka vendosur që edhe pse ka mos përputhje për specifikimet teknike të konstatuara nga grupi i auditimit, ato janë të papërfillshme dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin dhe performancën e pajisjeve të prokuruar, si dhe që nga momenti i blerjes dhe deri më këtë datë, aparaturat kanë qenë në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, duke qenë se leximet mujore kryhen pikërisht nga këto aparatura.

Për pasojë, vlera e pajisjeve “Telefona për aplikacionin” me vlerë 7,872,000 lekë, përbën efekt financiar negativ për llogari të shoqërisë. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77. ***Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të kolaudimit.***

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23910/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/3, datë 16.11.2018, nga z. S.Zh, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 4, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsytet si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Së pari, pretendimet tuaja mbi hartimin e specifikimeve teknike nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

Së dyti, pretendimi juaj për përgjegjësinë nuk qëndron, për arsye se për sa kohë nuk është bërë ndarja e detyrave midis anëtarëve të komisionit përkatës, përgjegjësia është e barabartë midis tyre.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23910/2, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/7, datë 16.11.2018, nga anëtarët e grupit të kolaudimit, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 4, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj qëndron pjesërisht, e për pasojë merret pjesërisht parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimet tuaja mbi marrjen në dorëzimit të produktit i cili nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuar, nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77.

Së dyti, pretendimi juaj se me anë të relacionit nr. 4521/1, datë 29.10.2018, grupi i punës ka vendosur që pajisjet e prokuruar e kryejnë qëllimin për të cilin janë prokuruar, qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Së treti, pavarësisht këtij fakti, ju si grup kolaudimi nuk shmangeni nga përgjegjësia për marrjen në dorëzim të produktit jo sipas specifikimeve të nënshkruara në kontratë.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23910/3, datë 24.10.2018, nga z. A.Q, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 4, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimet tuaja mbi hartimin e specifikimeve teknike nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

Së dyti, pretendimet tuaja mbi marrjen në dorëzimit të produktit i cili nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuar, nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77.

Së treti, fakti që për këtë procedurë nuk ka patur ankesa, nuk nënkupton që procedura është kryer në përputhje me LPP.

Së pesti, përgjegjësia kryesore për këtë procedurë është e juaja, duke qenë se jeni njëkohësisht hartues i specifikimeve teknike, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtar i komisionit për marrjen në dorëzim (grupit të kolaudimit).

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23910/4, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/14, datë 16.11.2018, nga anëtarët e komisionit për llogaritjen e fondit limit, anëtarët e njësisë së prokurimit dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 4, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Së dyti, pretendimi juaj për kategorizimin e kësaj procedure në mall dhe jo shërbim, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3, pika 5.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Së treti, pretendimi juaj se nisur nga fakti që për këtë procedurë nuk ka patur ankesa, nuk nënkupton që procedura është kryer në përputhje me LPP.

Së katërti, pretendimi juaj mbi certifikatën ISO:9001:2008, nuk qëndron për arsye se kjo certifikatë është përmirësuar me ISO 9001:2015 në Shtator 2015.

Së pesti, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27.

Së gjashti, pretendimi juaj për përmbajtjen e raportit përmbledhës nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68. Citimi i përmendur nga ju për këtë nen, është kryer me ndryshimet që i janë bërë VKM nr. 914, me anë të VKM nr. 797, datë 29.12.2017, vendim i cili në datën e zhvillimit të kësaj procedure nuk kishte hyrë në fuqi.

Së shtati, pretendimet tuaja në lidhje me procesin e vlerësimit nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i linjës DN-150mm gizë dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 2207 Prot., datë 07.02.2017	M.Q, kryetar, jurist, M.B, juriste, O.Dh, Inxhinier Hidro, anëtarë. Urdhri Nr. 2207/2 Prot., datë 07.02.2017.	K.H, juriste, D.K, ekonomiste, I.G, inxhinier
Vlera e përlogaritur e kontratës 35,744,607 lekë pa tvsh.		
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 03.03.2017.		
Bashkimi i Operatorëve ekonomikë fitues, “K.” SHA & “A..” SHPK me ofertë 32,660,862 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 3,083,745 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 5 operatorë ekonomikë: 1. JV “E.K.” SHPK & “B..” SHPK me ofertë 27,753,521 lekë pa TVSH. 2. “C..” SHPK me ofertë 30,558,042 lekë pa TVSH. 3. JV “K.” SHA & “A..” SHPK me ofertë 32,660,860 lekë pa tvsh. 4. JV “N.” SHPK & “K.” SHPK me ofertë 33,438,738 lekë pa tvsh. 5. “Gj.K” SHPK me ofertë, 34,238,523 lekë pa tvsh.		
Kualifikuar 2 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 3 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 2207/7 Prot., datë 14.04.2017, me vlerë 39,193,035 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 2207/5 Prot., datë 04.04.2017.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

	Fituesit nr. 2207/6, datë 04.04.2017.
--	---------------------------------------

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesë nr. U28, datë 21.01.2017 “Mbi miratimin e projektit “Rikonstruksion i linjes DN-150mm gizë dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, z. O.Dh me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinierik, ka dërguar detyrën e projektimit për këtë procedurë, së bashku me preventivin përkatës.

Me anë të procesverbalit nr. 2207/3, datë 07.02.2017, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Në pikën 2.1.1 të Shtojcës nr. 10, është kërkuar që “Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik”, kërkesë kjo e paqartë dhe diskriminuese për arsye se kufizohen për pjesëmarrje vetëm OE që kanë të pasqyruara në ekstraktin e tyre të regjistrimit objektin e prokurimit dhe jo natyrën e shëbimeve/mallrave të kërkuara për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në pikën 2.3.3 të Shtojcës nr. 10, ndër të tjera është kërkuar që OE ofertues të ketë liçensat NP-12A, NS-1A, NS-3A, NS-5A, NS-6A dhe NS-13A, ndërkohë që në preventivin e publikuar nuk përcaktohen punime të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.

-Në pikën 2.3.3 të Shtojcës nr. 10, ndër të tjera është kërkuar që “Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 70 punonjës për periudhën 2016- Janar 2017”, ndërkohë që një kërkesë e tillë nuk është e argumentuar nga NjP mbi numrin e punonjësve dhe profesionin e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në pikën 2.3.4 të Shtojcës nr. 10, ndër të tjera është kërkuar që OE të ketë në stafin e tij drejtues teknik me profesion inxhinier mekanik dhe inxhinier mjedisi, ndërkohë që në preventivin e publikuar nuk përcaktohen punime të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma b, e cila përcakton se: “b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”.

-Në pikën 2.3.6 të Shtojcës nr. 10, ndër të tjera është kërkuar që OE të ketë minimumi 30 kokore, ndërsa në pikën 2.3.3, numri i punonjësve të kërkuar është 70. NjP nuk ka argumentuar direfrençën në numrin e kokoreve, duke qenë se sipas rregullave të sigurimit teknik në punë, kokorja është një mjet i detyrueshëm për të gjithë punonjësit. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në fund të Shtojcës nr. 10, është shënuar që “KUJDES! Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të kontratës, kontraktori mban përgjegjësi të plotë për veprimet ose mosveprimet e shkaktuara nga ana e tij dhe do të jetë përgjegjës për çdo dëm kontraktor dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

jashtëkontraktor të shkaktuar në kantier. Kontraktori mban përgjegjësi financiare për kompensimin e dëmit, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim si dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme dhe gjithashtu dënohet me gjobë në vlerën nga 100,000 (njëqind mijë) deri në 1,000,000 (një milion) lekë.” Ky shënim i vënë nga AK, është një shënim i paargumentuar dhe pasnjë bazë ligjore, për arsye se për çdo dëm të shkaktuar nga moszbatimi i plotë i kushteve të kontratës, AK gëzon të drejtën e konfiskimit të sigurimit të kontratës, në zbatim dhe të nenit 32.2 të Shtojcës nr. 16 “Kushtet e përgjithshme”, e cila përcakton se: “Shuma e sigurimit të kontratës duhet t’i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesi në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës”.

-Në pikën 2.3.6 të Shtojcës nr. 10, është kërkuar që OE ofertues të ketë në pronësi ose qira një listë me 19 makineri, ndërkohë që nuk është argumentuar nevoja e kërkimit të këtyre makinerive, nëse kanë ose jo lidhje me objektin e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. U28, datë 21.01.2017, specifikimet teknike për këtë procedurë janë përgatitur nga z. O.Dh me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinierik, i cili është njëkohësisht anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. **Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.** Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek”. Për pasojë z. O.Dh nuk duhej ta kish pranuar detyrën e anëtarit të KVO.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 03.03.2017, ora 09:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	“K.” SHA & “A..” SHPK	32,660,862	Kualifikuar	1
2	“N.” SHPK & “K.” SHPK	33,438,738	Kualifikuar	2
3	“E.K..” SHPK & “B..” SHPK	27,753,521	Skualifikuar	
4	“C..” SHPK	30,558,042	Skualifikuar	
5	“Gj.K” SHPK	34,238,523	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr. 2207/4, datë 27.03.2017, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së BOE “E.K..” SHPK & “B..” SHPK, OE “C..” SHPK dhe OE “Gj.K” SHPK, kualifikimin e ofertave të BOE “K.” SHA & “A..” SHPK dhe BO “N.” SHPK & “K.” SHPK dhe shpalljen fituese të ofertës së BOE “K.” SHA & “A..” SHPK. Procesi i vlerësimit (Procesverbali i hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

2207/4, datë 27.03.2017 dhe vlerësimi elektronik) është kryer më datë 27.03.2017, pra 24 ditë pas procesit të hapjes së ofertave, në tejkallim të afatit kohor prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 2. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.***

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 2207/5, datë 04.04.2017, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe BOE fitues. Nga auditimi u konstatua se Raporti Përmbledhës nuk është paraqitur në mënyrë të plotë, për arsye se:

-Nuk përcaktohet numri i referencës së procedurës.

-Nuk përmban përshkrimin e punëve që do kryhen.

-Nuk përmban informacion mbi ankesa për këtë procedurë.

Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, i cili përcakton se: ***“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to”, e për pasojë ky Raport Përmbledhës nuk duhej miratuar nga titullari i AK. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.***

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

BOE “E.K.” SHPK & “B.” SHPK

Në vlerësimin e saj, KVO është shprehur se ky BOE skualifikohet për arsyet si më poshtë vijon:

-OE “B.” SHPK nuk ka për objekt aktiviteti objektin e kësaj procedurë në ekstraktin e QKR.

-BOE “E.K.” SHPK & “B.” SHPK nuk disponon certifikatën CE të Konformitetit për produktet që ofron.

-BOE “E.K.” SHPK & “B.” SHPK nuk disponon makineri për pastrimin e argjiles dhe makineri për prodhimin e pusetave 1.5*1.5 m dhe 2.5*2.5 m.

-BOE “E.K.” SHPK & “B.” SHPK nuk ka pasqyruar te shtojca e makinerive “- *Kokore min copë =30*

- *Fikse zjarri të levizshme me kapacitet 5-7 litra secila copë=3*

- *Prozhektorë ndriçimi natën copë=4*

- *Komplet i ndihmës së shpejtë copë=5*

- *Tabela paralajmeruese për sigurinë në objekt copë=20”.*

BOE “E.K.” SHPK & “B.” SHPK ka sjellë faturën tatimore nr. 26, datë 21.02.2011, me anë të së cilës vërteton plotësimin e kriterit të mësipërm, për pasojë duhej kualifikuar për këtë kriter.

BOE “N.” SHPK & “K.” SHPK

Në vlerësimin e saj, KVO është shprehur se ky BOE nuk ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

BOE “N.” SHPK & “K.” SHPK ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit nr. 1862 Rep., 1421, datë 02.03.2017, sipas të cilës konstatohet se:

-Kontrata e bashkëpunimit nuk përmban pjesën e punëve që do kryhen nga secili OE.

-Kontrata e bashkëpunimit është hartuar në mënyrë të gabuar, për arsye se në pikën 4 të saj përcaktohet se pjesëmarrja do jetë OE “N”. SHPK 67% dhe OE “K.” SHPK 33%, ndërsa në pikën 5 pjesëmarrja do jetë OE “N.” SHPK 67% dhe OE “K.” SHPK 67%. Pra njëherë është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

përcaktuar si pjesëmarrëse OE “K.” SHPK i cili nuk figuron në asnjë dokumentacion të paraqitur nga ky BOE dhe më poshtë përcaktohet se pjesëmarrja në këtë procedurë do jetë 67% secili, duke e çuar totalin e punimeve në 134%(!!!). Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 1, e cila ndër të tjera përcakton se: *“Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë procedurë.

-Sipas Ekstraktit Historik, OE “K.” SHPK, nuk ka për objekt aktiviteti ndërtim në rrjet ujësjiellës, në kundërshtim me pikën 2.1.1, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Sipas Ekstraktit Historik, OE “N.” SHPK, nuk ka për objekt aktiviteti ndërtim në rrjet ujësjiellës, në kundërshtim me pikën 2.1.1, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

Për sa më sipër, oferta e BOE “N.” SHPK & “K.” SHPK, nuk duhej kualifikuar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3.

OE “C..” SHPK

Në vlerësimin e saj, KVO është shprehur se ky OE skualifikohet për arsyet si më poshtë vijon:

-Nuk ka mjete për pastrimin e argjiles dhe mjete për prodhimin e pusetave 1.5*1.5m dhe 2.5*2.5m.

OE “Gj.K” SHPK

Në vlerësimin e saj, KVO është shprehur se ky BOE nuk ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

-Nuk ka mjete për pastrimin e argjiles dhe mjete për prodhimin e pusetave 1.5*1.5m dhe 2.5*2.5m.

-Nuk plotëson kriterin 2.3.10 për *“Kontrate furnizimi ne prani te noterit me prodhuesin e tubave qe do te vendosen ne objekt, i shoqeruar me certifikate ISO 9001:2008 te prodhuesit te mallit, Autorizimin nga prodhuesit dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar, si dhe certifikate konformiteti te produkteve CE”*.

BOE “K.” SHA & “A..” SHPK

-BOE “K.” SHA & “A..” SHPK ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit nr. 1855 Rep., nr. 1437, datë 01.03.2017, me anë të së cilës vërtetojnë se pjesëmarrja në këtë procedurë do jetë “K.” SHA 70% dhe “A..” SHPK 30%. Përfaqësues për këtë kontratë do jetë OE “K.” SHA. Marrëveshja e bashkëpunimit nuk përmban pjesën e punëve që do kryhen nga secili OE, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 1, e cila ndër të tjera përcakton se: *“Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë procedurë.

-Sipas Ekstraktit Historik, OE “K.” SHA, nuk ka për objekt aktiviteti ndërtim në rrjet ujësjiellës, në kundërshtim me pikën 2.1.1, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “A..” SHPK ka paraqitur certifikatën e CE të Konformitetit për *“Prodhimi i tubave të betonit dhe pjesëve lidhëse të tyre, të armuar, të pa armuar dhe me fibra çeliku”*. Theksojmë se kjo certifikatë mbulon vetëm produktet për të cilat është lëshuar dhe jo të gjithë produktet pjesë e kësaj procedure. Gjithashtu nisur nga fakti që marrëveshja e bashkëpunimit nuk



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

përcakton qartë punët që do kryejë secili OE, atëherë dhe OE “K.” SHA duhej ta paraqiste një certifikatë të tillë. Veprime në kundërshtim me pikën 2.3.2, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “A..” SHPK, nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se nuk disponon licencat NP-11A, NP-12A, NS-3A, NS-5A, NS-13A dhe NS-18A, licenca të cilat zotërohen nga OE “K.” SHA. Nisur nga fakti që marrëveshja e bashkëpunimit nuk përcakton qartë punët që do kryejë secili OE, atëherë dhe OE “A..” SHPK duhej ta paraqiste licencat e mësipërme. Veprime në kundërshtim me pikën 2.3.1, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “K.” SHA, ka paraqitur kontratat e punës të noterizuara, të lidhura më datë 01.03.2017, për z. J.B me detyrë topograf, z. K.Zh me detyrë drejtues teknik mekanik, znj.M.N me detyrë drejtues teknik për mjedis, z. M.A me detyrë drejtues teknik për ndërtim, z. A.H me detyrë drejtues teknik inxhinieri gjeodezike dhe z. M.K me detyrë drejtues teknik për punime elektrike. Punonjësi z. J.B nuk figuron në listë-pagesat e 6 muajve të fundit, në kundërshtim me pikën 2.3.4, të Shtojcës nr. 10. BOE nuk ka paraqitur dokumentacion për inxhinierin hidroteknik të kërkuar, në kundërshtim me pikën 2.3.4, të Shtojcës nr. 10. Gjithashtu, nisur nga fakti që marrëveshja e bashkëpunimit nuk përcakton qartë punët që do kryejë secili OE, atëherë dhe OE “A..” SHPK duhej ta paraqiste inxhinierët e mësipërm. Veprime në kundërshtim me pikën 2.3.4, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-BOE “K.” SHA & “A..” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e pikës 2.3.10 *“Kontrate furnizimi ne prani te noterit me prodhuesin e tubave qe do te vendosen ne objekt, i shoqeruar me certifikate ISO 9001:2008 te prodhuesit te mallit, Autorizimin nga prodhuesit dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar, si dhe certifikate konformiteti te produkteve CE”*, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Nga verifikimi i listës së makinerive dhe mjeteve të paraqitura nga BOE “K.” SHA & “A..” SHPK, konstatohet se:

- Për mjetet Autobitumatriçe, Eskavator me goma dhe Eskavator me zinxhir me çekiç pneumatik, nuk janë paraqitur dokumentacioni përkatës si regjistrimi i mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, në kundërshtim me pikën 2.3.7, të Shtojcës nr. 10, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
- Nisur nga fakti që marrëveshja e bashkëpunimit nuk përcakton qartë punët që do kryejë secili OE, mbetet e paqartë fakti se si është kryer kualifikimi i këtij BOE nga ana e KVO për makineritë e paraqitura.

Referuar konstatimeve të mësipërme, BOE “K.” SHA & “A..” SHPK nuk duhej kualifikuar, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.***

Zbatimi i kontratës

BOE “K.” SHA & “A..” SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 021061, datë 10.04.2017, me vlerë 3,919,304 lekë.

Kontrata e sipërmarrjes nr. 2207/7, datë 14.04.2017, me vlerë 39,193,035 lekë me tvsh, me afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. A.N dhe z. A.L për Kontraktorin BOE “K.” SHA & “A..” SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Sipas Akt-Kolauditimit pa numër protokolli, datë 21.07.2017, nënshkruar nga grupi i kolauditimit i përbërë nga Z. O.Dh, znj. H.G dhe z. K.L, Mbikqyrësi i punimeve z. G.I, merren në dorëzim punimet dhe pranohet situacioni përfundimtar i punimeve, i cili me shkresën nr. 2739, datë 11.09.2017, i dërgohet drejtorisë ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të pagesës.

Me faturën tatimore nr. 187, datë 04.09.2017, me vlerë 39,164,880 lekë me tvsh, OE K. SHA ka faturuar punimet e kryera.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23911/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/15, datë 16.11.2018, nga anëtarët e njësisë së prokurimit dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 5, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26.

Së dyti, pretendimi juaj në lidhje me procesin e vlerësimit, se e keni kualifikuar BOE fitues në zbatim të pikës 4, të nenit 53 të RrPP, duke i cilësuar si devijime të vogla, nuk qëndron për arsye se në procesverbalin e vlerësimit të ofertave si dhe në raportin përmbledhës përkatës për këtë procedurë, ju nuk i keni pasqyruar këto mangësi.

3. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje Tuba dhe Rakorderi”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 13323 Prot., datë 11.05.2018	M.Q, kryetar, jurist, L.R, juriste, E.T, anëtarë. Urdhri Nr. 13323/1 Prot., datë 11.05.2018.	A.Q, I.M, juriste, A.S, inxhinier mekanik.
Vlera e përlogaritur e kontratës 67,323,117 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Tender i hapur – Marrëveshje Kuadër” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 12.06.2018.		
Operatori ekonomik fitues, ““A.”” SHPK me ofertë 62,336,661 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 4,986,456 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë: 1. ““A.”” SHPK me ofertë 62,336,661 lekë pa tvsh. 2. ““N.”” SHPK & ““A..”” SHPK me ofertë 56,940,680 lekë pa tvsh. 3. ““M” LTD” SHPK me ofertë 61,929,117 lekë pa tvsh.		
Kualifikuar 1 operator ekonomik. Skualifikuar 2 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 13323/15 Prot., datë 12.07.2018, me vlerë 74,803,993.20 lekë me TVSH. V		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 13323/12 Prot., datë 02.07.2018.	Komisioni për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 161, datë 10.03.2018: D.M, D.B dhe E.K.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 13323/3, datë 11.05.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 13323/13, datë 02.07.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 13323/16, datë 12.07.2018. Ankesa: Ka.
--	--	--

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me Urdhrin nr. 161, datë 10.03.2018, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për testimin e tregut. Grupi i punës me anë të relacionit nr. 161/4, datë 30.04.2018, ka vendosur që vlera e fondit limit të jetë 67,323,117 lekë pa tvsh, si mesatarja e ofertave të OE A-E..SHPK, M.. 2007 SHPK dhe PF V.K.

Nga kjo përllogaritje e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, konstatohet se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së këtyre OE, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE (konkretisht nuk dokumentohet mënyra e kërimit të ofertave nga këta OE). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila përcakton se: “...*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës*”. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së kontratës.***

Me anë të procesverbalit nr. 13323/2, datë 11.05.2018, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

Në pikat 2.9, 2.10 dhe 2.3.8, të Shtojcës nr. 9, është kërkuar që “2.9 *Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist - Për punonjësin “Kimist” dokumentat që duhet të paraqes janë: diplomë, CV dhe kontratë pune (e vlefshme per të paktën periudhën e parashikuar si dhe të figurojë në listpagesa e shoqërisë minimalisht gjashtë muajt e fundit.*

2.10 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda automakinist. Për këtë punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmia e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit.*

2.3.8. *Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qera një kamionçinë me kapacitet mbajtës minimumi deri në 1,5 ton, si dhe 2 (dy) kamiona me vinç me kapacitet mbajtës minimumi nga 5 ton -10 ton për secilin kamion.”.* Vendosija e kësaj kërkesë është kryer në kundërshtim me me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave”, ku përcaktohen qartë kriteret që mund të kërkojnë në procedurat e prokurimit të mallrave.

Me anë të shkresës nr. 13944, datë 19.05.2018, OE V.. SHPK ka paraqitur ankesën e tij në lidhje me DT. Me Urdhrin nr. 13323/4, datë 19.05.2018, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës, ndërsa me Urdhrin nr. 13323/5, datë 19.05.2018, ka ngarkuar KVO për shqyrtimin e ankesës.

Me anë të shkresës nr. 13323/6, datë 21.05.2018, drejtuar titullarit të AK, komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, konkretisht pranon pretendimin e ankimuesit në lidhje me certifikatat e kërkuara, por jo mbi makineritë dhe fuqinë punëtore të kërkuar.

Me shkresën nr. 13944/1, datë 21.05.2018, drejtuar OE V.. SHPK, titullari i AK e njofton mbi rezultatet e komisionit mbi ankesën e paraqitur.

Me urdhrin nr. 13323/7, datë 01.06.2018, titullari i AK heq pezullimin e kësaj ankesë. Me shtojcën nr. 1, njësia e prokurimit ndryshon DT dhe shtyn datën e hapjes së ofertave më 12.06.2018, ora 08:30.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 12.06.2018, ora 08:30. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	“A.” SHPK	62,336,661	Kualifikuar	1
2	N. SHPK & A.. SHPK	56,940,680	Skualifikuar	
3	“M” LTD SHPK	61,929,117	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa numër, datë 13.06.2018, KVO skualifikimin e ofertave të OE “M” LTD SHPK dhe BOE N. SHPK dhe A.. SHPK, si dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE “A.” SHPK.

Me anë të shkresës nr. 15840, datë 18.06.2018, OE “M” LTD SHPK ka paraqitur ankesën e tij në lidhje me DT. Me Urdhrin nr. 13323/8, datë 18.06.2018, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës, ndërsa me Urdhrin nr. 13323/9, datë 18.06.2018, ka ngarkuar NjP për shqyrtimin e ankesës.

Me anë të shkresës nr. 13323/10, datë 19.06.2018, drejtuar titullarit të AK, komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vendosur mos pranimin e ankesës. Me shkresën nr. 15840/1, datë 19.06.2018, drejtuar OE “M” LTD SHPK, titullari i AK e njofton mbi rezultatet e komisionit mbi ankesën e paraqitur, ndërsa me Urdhrin nr. 13323/11, datë 02.07.2018, titullari i AK heq pezullimin e kësaj ankese

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

OE “M” LTD SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se mjetet e paraqitur nga ky OE, nuk plotësojnë kushtin e peshës së kërkuar në pikën 2.3.8, konkretisht për mjetin e paraqitur me targë AA349AO, kapaciteti mbajtës është 11.7 tonë, ndërsa për mjetin me targë AA254EN, kapaciteti mbajtës është 13.4 ton, në kundërshtim me kapacitetin e kërkuar 5-10 ton.

Skualifikimi i kësaj oferte, e cila është ekonomikisht më e volitshme, ka ardhur si pasojë e një devijimi të vogël, për arsye se kapaciteti mbajtës i kamionave me vinç të paraqitura nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 4, e cila përcakton se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarët e NjP në cilësinë e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.**

BOE N. SHPK & A.. SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se nuk ka sjellë dokument që vërteton shlyerjen e energjisë elektrike. Vërtetimi i sjellë nga ky BOE nuk provon kryerjen e pagesës së detyrimeve të energjië elektrike për muajin prill 2017, duke qenë se në zbatim të VKM nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji të klientëve jofamiljarë”, kjo faturë është maturuar përpara datës së hapjes së ofertave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

OE “A.” SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, u konstatua se:

-OE A.. SHPK ka paraqitur kontratën e qirasë nr. 293, datë 21.05.2018, për dhënien me qira të kamionit me vinç me targë EL4112C dhe kamionçinës me targë AA739IR. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për këto 2 mjete, konstatohet se:

- Për mjetin kamioni me vinç me targë EL4112C, pesha maksimale sipas lejes së qarkullimit është 26,000 kg, ndërsa pesha e mjetit bosh është 13,500 kg, çka nënkupton se pesha mbajtëse e mjetit është 12,500 kg ose 12.5 ton, në kundërshtim me pikën 2.3.8, të Shtojcës nr. 9, që kërkohej 5-10 ton, e për pasojë ky OE nuk duhej kualifikuar për këtë procedurë.
- Për mjetin kamioni me vinç me targë AA739IR, pesha maksimale sipas lejes së qarkullimit është 2,800 kg, ndërsa pesha e mjetit bosh është 1,340 kg, çka nënkupton se pesha mbajtëse e mjetit është 1,460 kg ose 1.46 ton, në kundërshtim me pikën 2.3.8, të Shtojcës nr. 9, që kërkohej minimumi 1.5 ton, e për pasojë ky OE nuk duhej kualifikuar për këtë procedurë

Për sa më sipër, konstatohet se nga ana e KVO janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), ku me OE “A.” SHPK lidhet kontrata, pavarësisht se ka të njëjtat mangësi për skualifikim me OE “M” LTD SHPK. Për pasojë, **vlera 489,053 lekë**, që përbën diferencën midis OE “M” LTD SHPK të skualifikuar për të njëjtat mangësi që ka OE i shpallur fitues dhe ofertës së “A.” SHPK (dhe që përbëjnë devijime materiale që nuk ndikojnë thelbësisht në zbatimin e kontratës) të shpallur fitues (plus TVSH), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 dhe neni 53, pika 3 dhe pika 4.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarët e NJP në cilësinë e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.

OE “A.” SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 070120020024371, datë 05.07.2018, me vlerë 7,480,400 lekë.

Kontrata nr. 13323/15, datë 12.07.2018, me vlerë 74,803,993.20 lekë me tvsh, me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. Y.G për Kontraktorin “A.” SHPK.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23912/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/10, datë 16.11.2018, nga anëtarët e njësisë së prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave, komisionit të shqyrtimit të ankesave dhe komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 6, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj qëndron pjesërisht, e për pasojë merret pjesërisht parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsye si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Së dyti, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27. Duke qenë se kjo është një kontratë furnizimi mallrash, edhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, duhen hartuar në përputhje me neni 27 të RrPP.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Së treti, pretendimet tuaja në lidhje me procesin e vlerësimit nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66.

Së katërti, dëmi ekonomik ka ardhur si pasojë e mbajtjes së qëndrimeve të ndryshme nga KVO në vlerësimin e OE.

Së pesti, në zbatim të nenit 78 të RrPP, pika 6/a, ku përcakton se: “Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës”, pjesë e përgjegjësisë janë dhe anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesës.

Së gjashti, pretendimi juaj mbi miratimin e raportit përmbledhës nga titullari i AK, nuk qëndron për arsye se titullari e ka miratuar raportin përmbledhës në bazë të informacionit të dhënë nga anëtarët e KVO dhe shqyrtimit të ankesës.

Së shtati, dëmi ekonomik i shkaktuar nuk është hipotetik dhe imagjinar, por real dhe i shkaktuar si pasojë e vendimmarrjes së gabuar të kryer nga anëtarët e KVO dhe komisionit të shqyrtimit të ankesës.

Së teti, pretendimi juaj se dëmi ekonomik nuk mund të përkufizohet nga audituesit e KLSH është i gabuar dhe nuk qëndron. Më hollësisht ju lutemi ti referoheni Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma b, e cila përcakton se: “të informojë drejtuesit e njësisë të audituara apo organet e kompetencës mbi parregullsitë dhe **dëmet financiare** gjatë administrimit të fondeve publike dhe t’u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të **dëmshpërblehet** në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji”.

Së nënti, pretendimi juaj mbi përmbajtjen e raportit përmbledhës qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

4. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje automjete për UKT sh.a.”, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 3007 Prot., datë 14.02.2017		
Vlera e përlllogaritur e kontratës 29,026,874 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 10.03.2017.		
Operatori ekonomik fitues, “ H.A.A ” SHPK me ofertë 28,250,000 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 776,874 lekë pa TVSH.	M.Q, kryetar, jurist, M.B, juriste, F.M, Inxhinieri Mekanike, anëtarë.	K.H, juriste, D.K, ekonomiste, I.G, inxhinier
Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë: 1. “H.A.A” SHPK me ofertë 28,250,000 lekë pa tvsh. 2. “C..” SHPK me ofertë 29,000,000 lekë pa tvsh. 3. “P. A” SHPK pa ofertë, skualifikuar.	Urdhri Nr. 3007/2 Prot., datë 14.02.2017.	
Kualifikuar 1 operator ekonomik. Skualifikuar 2 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 3007/7 Prot., datë 14.04.2017, me vlerë 33,900,000 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 3007/5	Komisioni për përlllogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhërit të	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 3007/1, datë 14.02.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Prot., datë 06.04.2017.	Brendshëm Nr. 81, datë 13.02.2017: E.C, K.T dhe A.S.	Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 3007/6, datë 06.04.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 3007/8, datë 14.04.2017. Ankesa: Ka.
-------------------------	--	--

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesës nr. 463, datë 09.02.2017 “Kërkesë për blerje Automjesh, 2 Autovetura Fuoristradë 10 Autovetura”, znj. K.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Transportit, ka dërguar specifikimet teknike për këtë procedurë. Specifikimet teknike janë hartuar nga z. M.V me detyrë përgjegjës i sektorit të transporteve dhe z. F.M me detyrë përgjegjës i sektorit të oficinës. Në lidhje me këto specifikimet teknike, u konstatua se:

<u>Autovetura Fuoristradë</u>	
Shpejtesia maksimale	Min 200 km/ore
Gjatesia	min 4.900 mm – max 5.000 mm
Lartësia nga toka	Min 180 mm
Gjeresia	Min 1800 mm- Max 1900 mm
Distanca aksiale	Min 2800 mm- Max 2900 mm
Lartësia	Min 1.600 mm – max 1.700 mm
Xhamat me nuance	
Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE	
Xhamat e erret mbrapa	
Baxha xhami	
<u>Autovetura</u>	
Gjatesia	min 4.000 mm – max 4.100 mm
Lartësia	min 1.400 mm – max 1.500 mm
Gjeresia	min 1.700 mm – max 1.800 mm
Distanca aksiale	Min 2500 mm- Max 2600 mm
Xhamat me nuance	

Kriteret e mësipërme janë diskriminuese, për arsye se janë kufizuese për automjetet që do prokurojnë, duke mos i argumentuar vendosjen e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre” dhe neni 23, pika 2, e cila përcakton se: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike.**

Me Urdhrin nr. 81, datë 13.02.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për testimin e tregut. Grupi i punës me anë të relacionit nr. 81/5, datë 14.02.2017, ka vendosur që vlera e fondit limit të jetë 29,026,874 lekë pa tvsh, si mesatarja e ofertave të OE U. M SHPK, T. A.. SHPK, H. M.. SHPK dhe C.. SHPK.

Nga kjo përllogaritje e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, konstatohet se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së këtyre OE, si dhe nuk ka dokumentuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

komunikimin me këta OE (konkretisht nuk dokumentohet mënyra e kërimit të ofertave nga këta OE). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila përcakton se: “...Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së kontratës.**

Me anë të procesverbalit nr. 3007/3, datë 14.02.2017, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Në pikën 2.1.1 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “*Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik*”, kërkesë kjo e paqartë dhe diskriminuese për arsye se kufizohen për pjesëmarrje vetëm OE që kanë të pasqyruara në ekstraktin e tyre të regjistrimit objektin e prokurimit dhe jo natyrën e shërbimeve/mallrave të kërkuara për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në pikën 2.2.1 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “*Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit (2013, 2014 dhe 2015) duhet të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave, për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku vlera mesatare e tyre të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit*”, kërkesë kjo e paqartë dhe konfuze, për arsye se tenderi është zhvilluar më 10.03.2017, dhe 3 vitet e fundit janë 2014-2016. Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 4, e cila përcakton se “*Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin*”.

-Në pikën 2.3.5 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku deklaron se mjeti i ofruar janë të prodhuara sipas normave të standarteve të Bashkimit Europian*”, kërkesë kjo e paqartë dhe konfuze, për arsye se nuk janë përcaktuar se cilat norma apo standarde duhet të përmbushin mjetet e ofruara. Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 4, e cila përcakton se “*Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin”.

-Në fund të Shtojcës nr. 8, është shënuar që “**KUJDES!** Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të kontratës, kontraktori mban përgjegjësi të plotë për veprimet ose mosveprimet e shkaktuara nga ana e tij dhe do të jetë përgjegjës për çdo dëm kontraktor dhe jashtëkontraktor të shkaktuar në kantier. Kontraktori mban përgjegjësi financiare për kompensimin e dëmit, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim si dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme dhe gjithashtu dënohet me gjobë në vlerën nga 100,000 (njëqind mijë) deri në 1,000,000 (një milion) lekë.”. Ky shënim i vënë nga AK, është një shënim i paargumentuar dhe pasnjë bazë ligjore, për arsye se për çdo dëm të shkaktuar nga moszbatimi i plotë i kushteve të kontratës, AK gëzon të drejtën e konfiskimit të sigurimit të kontratës, në zbatim dhe të nenit 32.2 të Shtojcës nr. 16 “Kushtet e përgjithshme”, e cila përcakton se: “Shuma e sigurimit të kontratës duhet t’i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesi në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Në lidhje me dokumentet e tenderit, më datë 23.02.2018, OE T.. 3A SHPK ka paraqitur ankesën e tij, ankesë e cila me shkresën nr. K-381/1, datë 24.02.2018, është refuzuar për arsye se është jashtë afateve të përcaktuara në nenin 78, pika 4 të RrPP.

Gjithashtu në lidhje me dokumentet e tenderit, më datë 24.03.2018, OE M.M SHPK ka paraqitur ankesën e tij, ankesë e cila me shkresën nr. K-596/1, datë 28.03.2018, është refuzuar për arsye se është jashtë afateve të përcaktuara në nenin 78, pika 4 të RrPP.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 463, datë 09.02.2017, specifikimet teknike për këtë procedurë janë përgatitur nga z. M.V dhe z. F.M, z. F.M është njëkohësisht anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. **Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.** Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek”. Për pasojë z. F.M nuk duhej ta kish pranuar detyren e anëtarit të KVO.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 10.03.2017, ora 09:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	H.A.A SHPK	28,250,000	Kualifikuar	1
2	C.. SHPK	29,000,000	Skualifikuar	
3	P. A SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr. 3007/4, datë 28.03.2017, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së OE C.. SHPK dhe P. A SHPK, si dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE H.A.A SHPK. Procesi i vlerësimit (Procesverbali i hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr. 3007/4, datë 28.03.2017 dhe vlerësimi elektronik) është kryer më datë 28.03.2017, pra 19 ditë pas procesit të hapjes së ofertave, në tejkallim të afatit kohor prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 2. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.***

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 3007/5, datë 04.04.2017, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues. Nga auditimi u konstatua se Raporti Përmbledhës nuk është paraqitur në mënyrë të plotë, për arsye se:

-Nuk përcaktohet numri i referencës së procedurës.

-Nuk përmban përshkrimin e mallrave dhe shërbimeve që do prokurohen.

-Nuk pasqyrohen ankesat e OE T.. 3A SHPK dhe M.M SHPK.

Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to”, ***e për pasojë ky Raport Përmbledhës nuk duhej miratuar nga titullari i AK. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.***

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

OE P. A SHPK

OE P. A SHPK nuk ka paraqitur formularin e ofertës dhe dokumentacion teknik e financiar për këtë procedurë.

OE C.. SHPK

Në vlerësimin e ofertës së këtij OE, KVO është shprehur se:

-Nuk ka paraqitur deklaratat sipas Shtojcës nr. 6, nr. 7 dhe nr. 9.

-Nuk ka sjellë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore sipas pikës 2.1.2, të Shtojcës nr. 8.

-Nuk ka sjellë dëshmi për punë të ngjashme sipas pikës 2.3.1, të Shtojcës nr. 8.

-Nuk ka sjellë autorizim prodhuesi për garancinë e mjeteve sipas pikës 2.3.3, të Shtojcës nr. 8.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE për këtë procedurë, konstatohet se dokumentet e mësipërme nuk janë paraqitur.

OE H.A.A SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, u konstatua se:

-OE H.A.A SHPK ka paraqitur kopje të bilanceve të viteve ushtrimore 2013, 2014 dhe 2015, si dhe raportet e auditimit për vitet 2013 dhe 2014, por jo për vitin 2015, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE H.A.A SHPK nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron për vitin 2013, në kundërshtim me pikën 2.2.1 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

-OE H.A.A SHPK ka paraqitur katalogët në gjuhën gjermane, të papërkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me pikën 4.6 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Nga verifikimi i katalogut të paraqitur nga OE H.A.A SHPK, për autoveturat fuoristradë, konstatohet se asnjë prej mjeteve të paraqitura nuk e përmbush kriterin për 4 dyer (4+1 janë të gjitha), në kundërshtim me Shtojcën nr. 9, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

Referuar konstatimeve të mësipërme, OE H.A.A SHPK nuk duhej kualifikuar, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Zbatimi i kontratës

OE H.A.A SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 020888, datë 11.04.2017, me vlerë 3,390,000 lekë.

Kontrata nr. 3007/7, datë 14.04.2017, me vlerë 33,900,000 lekë me tvsh, me afat 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. I.Z për Kontraktorin H.A.A SHPK.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 195, datë 14.04.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e kolaudimit të përbërë nga:

1. Znj. K.H,
2. Z. M.V,
3. Z. L.Z.

Me anë të Akt-Kolaudimit nr. 195/1, datë 11.05.2017, grupi i kolaudimit ka arritur në konkluzionin se automjetet e sjella nga kontraktori H.A.A SHPK, janë në përputhje me kontratën.

Me anë të faturave tatimore nr. 238-250, datë 11.05.2017, me vlerë 33,900,000 lekë me tvsh, kontraktori H.A.A SHPK, ka sjellë mallrat dhe shërbimet e ofruara, të cilat janë bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 11, datë 25.05.2017.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23913/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/12, datë 16.11.2018, nga anëtarët e komisionit për llogaritjen e fondit limit, anëtarët e njësisë së prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave dhe grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 7, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsye si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi specifikimet teknike nuk qëndron, për arsye se janë shumë kufizuese për automjetet e kërkuara dhe të pa argumentuara për vendosjen e tyre.

Së dyti, pretendimi juaj mbi përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Së treti, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23.

Së katërti, fakti që për këtë procedurë nuk ka patur ankesa, nuk nënkupton që procedura është kryer në përputhje me LPP.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Së pesti, pretendimi juaj për përmbajtjen e raportit përmbledhës nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68. Citimi i përmendur nga ju për këtë nen, është kryer me ndryshimet që i janë bërë VKM nr. 914, me anë të VKM nr. 797, datë 29.12.2017, vendim i cili në datën e zhvillimit të kësaj procedure nuk kishte hyrë në fuqi.

Së gjashti, pretendimet tuaja në lidhje me procesin e vlerësimit nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66.

5. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje automjete”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 14230 Prot., datë 23.05.2018 Vlera e përlogaritur e kontratës 18,333,333 lekë pa TVSH. Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 18.06.2018. Operatori ekonomik fitues, “H.A.A” SHPK me ofertë 18,830,000 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 3,333 lekë pa TVSH.	M.Q, kryetar, jurist, L.R, juriste, A.G, Inxhinieri Mekanike, anëtarë.	I.M, juriste, A.Q, A.S, inxhinier mekanik
Kanë marrë pjesë në tender 1 operator ekonomik: 1. “H.A.A” SHPK me ofertë 18,830,000 lekë pa tvsh. Kualifikuar 1 operator ekonomik. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë. Kontrata Nr. 14230/7 Prot., datë 13.07.2018, me vlerë 22,596,000 lekë me TVSH.	Urdhri Nr. 14230/1 Prot., datë 23.05.2018.	
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 14230/4 Prot., datë 26.06.2018.	Komisioni për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 244, datë 07.05.2018: E.P, Y.Fdhe M.V.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 14230/3, datë 23.05.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 14230/5, datë 26.06.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 14230/8, datë 13.07.2018. Ankesa: Nuk ka.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesë nr. 1804, datë 04.05.2018 “Kërkesë për prokurim”, z. A.G me detyrë Drejtor i Transportit dhe Oficinës, ka dërguar kërkesën për 5 makina elektrike dhe specifikimet teknike për këtë procedurë.

Me Urdhrin nr. 244, datë 10.05.2018, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për testimin e tregut. Grupi i punës me anë të relacionit nr. 244/4, datë 10.05.2018, ka vendosur që vlera e fondit limit të jetë 18,833,333 lekë pa tvsh, si mesatarja e ofertave të OE C.. SHPK, A.E.. SHPK dhe H.M.. SHPK.

Nga kjo përlogaritje e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, konstatohet se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së këtyre OE, si dhe nuk ka dokumentuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

komunikimin me këta OE (konkretisht nuk dokumentohet mënyra e kërimit të ofertave nga këta OE). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila përcakton se: “...Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përlllogaritjen e vlerës së kontratës.**

Me anë të procesverbalit nr. 14230/2, datë 23.05.2018, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Gjatë publikimit të DT, nga NjP nuk janë hedhur të plota specifikimet teknike për këtë procedurë, konkretisht, nuk janë hedhur specifikimet e kërkuara për:

1. Përshpejtimi 0-100 km/h (Sport /Normal)
2. Konsumi i Energjisë kËh/100km Kombinuar km/kËh
3. Koha e karikimit të plotë 230V Prizë normale 0-100%

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, e cila përcakton se: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara*”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësies së prokurimit.**

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 1804, datë 04.05.2018, specifikimet teknike për këtë procedurë janë përgatitur nga z. A.G me detyrë Drejtor i Transportit dhe Oficinës, i cili është njëkohësisht anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek*”. Për pasojë z. z. A.G, nuk duhej ta kish pranuar detyrën e anëtarit të KVO.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 18.06.2018, ora 08:30. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	H.A.A SHPK	18,830,000	Kualifikuar	1

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa numër, datë 18.06.2018, KVO kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE H.A.A SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 14230/4, datë 26.06.2018, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues.

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

OE H.A.A SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, u konstatua se:

-OE H.A.A SHPK ka paraqitur katalogët në gjuhën gjermane, të papërkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me pikën 4.6 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

Referuar konstatimit të mësipërme, OE H.A.A SHPK nuk duhej kualifikuar, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

OE H.A.A SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 46452100, datë 27.06.2018, me vlerë 2,259,600 lekë.

Kontrata nr. 14230/7, datë 13.07.2018, me vlerë 22,596,000 lekë me tvsh, me afat 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. I.Z për Kontraktorin H.A.A SHPK.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23914/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/16, datë 16.11.2018, nga anëtarët e komisionit për llogaritjen e fondit limit, anëtarët e njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 8, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj qëndron pjesërisht e për pasojë merret pjesërisht parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Së dyti, pretendimi juaj se keni hedhur të gjitha specifikimet teknike në DT e publikuara online, nuk qëndron për arsye se nga krahasimi i atyre të publikuara me ato të ardhura me shkresën nr. 1804, datë 04.05.2018, u konstatua se nuk janë hedhur 3 specifikimet të kërkuara.

Së treti, pretendimi juaj se specifikimet teknike nuk janë hartuar nga z. A.G me detyrë Drejtor i Transportit dhe Oficinës, nuk qëndron për arsye se nuk është i provuar nga ana dokumentare dhe ligjore.

Së katërti, pretendimet tuaja në lidhje me procesin e vlerësimit nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66.

Së pesti, pretendimi juaj mbi përmbajtjen e raportit përmbledhës qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

6. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje makineri pajisje (automjete)”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 9870 Prot., datë 27.03.2018	M.Q, kryetar, jurist, L.R, juriste,	A.Q, I.M, juriste,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Vlera e përlogaritur e kontratës 43,200,000 lekë pa TVSH.	M.V, Administrim biznesi, anëtarë.	K.T, ekonomiste.
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 23.04.2018.	Urdhri Nr. 9870/1 Prot., datë 27.03.2018.	
Operatori ekonomik fitues, ““L.”” SHPK me ofertë 41,050,000 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 2,150,000 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 4 operatorë ekonomikë: 1. ““L.”” SHPK me ofertë 41,050,000 lekë pa tvsh. 2. ““T.”” SHPK & “P.S”” SHPK me ofertë 40,900,000 lekë pa tvsh. 3. “M.M” SHPK me ofertë 42,000,000 lekë pa tvsh. 4. “Rr.M..” nuk ka paraqitur ofertë.		
Kualifikuar 1 operator ekonomik. Skualifikuar 3 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 9870/11 Prot., datë 08.06.2018, me vlerë 49,260,000 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 9870/8 Prot., datë 09.05.2018.	Komisioni për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 112, datë 19.02.2018: E.P, H.L dhe F.Ç. Komisioni për shqyrtimin e ankesës ngritur me Urdhrin 9870/5, datë 25.04.2018: A.Q, A.S dhe A.K.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 9870/3, datë 27.03.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 9870/9, datë 09.05.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 9870/12, datë 08.06.2018. Ankesa: Ka.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesës nr. 194, datë 19.01.2018 “Kërkesë për prokurim”, znj. K.H me detyrë Drejtor i Transportit dhe Oficinës, ka dërguar kërkesën për mjete pune (Eskavator 2 copë, Çekiç hidraulik për fadromë 1 copë, Kamionçina 2 copë dhe Prerëse asfalti dhe betoni 1 copë) dhe specifikimet teknike për këtë procedurë. Nga auditimi i këtyre specifikimeve teknike, konstatohet se:

1. Kamioncina Vetshkarkuese Dopolio kabine	
Pesha	3500kg
Gjatesia e pergjitheshme	6450-6550mm
Gjeresia e pergjitheshme e kabines	2000-2020mm
Lartesia e pergjithshme e kabines	2200-2300mm
Distanca aksiale	3650-3750mm
Injektimi	16 valvula
Nr i cilindrave	4 ne nje linje
Kapaciteti	~2300 cm ³ Euro 6
Dimensioni gomave	195/75 R 16C
2. Fadroma	
Numri I cilindrave	4 ne linje
Kapaciteti	4400CC



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Gjeresia e pergjithshme	2250 - 2295 mm
Gjatesia e pergjithshme	5890 - 6050 mm
3. Çekiç hidraulik	
Gjatesia	1600-1700mm
Diametri i daltes	70-80mm
4. Prerese asfalti/betoni me strukture	
Permasat (gjatesi, gjeresi, lartesi)	830-840x570580x1000-1100 mm
Kapaciteti i depozites se naftes	5-6 l

Kriteret e mësipërme janë diskriminuuese, për arsye se janë vendosur kriteret të cilat janë kufizuese për mjetet që do prokurorë, duke mos i argumentuar vendosjen e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre” dhe neni 23, pika 2, e cila përcakton se: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike.**

Në lidhje me specifikimet teknike, me ankesën nr. K-1634, datë 05.04.2018, OE V.. SHPK, ka paraqitur pretendimet përkatëse mbi kufizimet e specifikimeve të tij, ankesë e cila me shkresën nr. K-1634/1, datë 06.04.2018, është refuzuar për arsye se është jashtë afateve të përcaktuara në nenin 78, pika 4 të RrPP.

Me Urdhrin nr. 112, datë 19.02.2018, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për testimin e tregut. Grupi i punës me anë të relacionit nr. 112/9, datë 26.03.2018, ka vendosur që vlera e fondit limit të jetë 43,200,000 lekë pa tvsh, si mesatarja e ofertave të OE “M” LTD SHPK, P.I. SHPK dhe “L.” SHPK.

Nga kjo përllogaritje e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, konstatohet se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së këtyre OE, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE (konkretisht nuk dokumentohet mënyra e kërimit të ofertave nga këta OE). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila përcakton se: “...Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së kontratës.**

Me anë të procesverbalit nr. 9870/2, datë 27.03.2018, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 23.04.2018, ora 08:30. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
-----	----------	------------------------------	-------------------------------	-------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

1	“L.” SHPK	41,050,000	Kualifikuar	1
2	“T.” SHPK & “P.S” SHPK	40,900,000	Skualifikuar	
3	M.M SHPK	42,000,000	Skualifikuar	
4	Rr.M.. SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa numër, datë 24.04.2018, KVO skualifikimin e ofertave të OE “M.M” SHPK, Rr.M.. SHPK dhe BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK, si dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE “L.” SHPK.

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

OE Rr. M

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka paraqitur dokumentacion teknik dhe ofertë ekonomike për këtë procedurë.

BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se Kontrata e Bashkëpunimit nr. 1180, datë 20.04.2018, ku është përcaktuar që “T.” SHPK do kryejë 60% të furnizimit dhe P.S” SHPK do kryejë 40% të furnizimit, nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për arsye se nuk përmban elementët konkret që duhet të kryejë secili OE.

Nga auditimi i dokumentacionit elektronik të paraqitur nga ky BOE, konstatohet se marrëveshja e bashkëpunimit e paraqitur, nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 74, të RrPP, për arsye se nuk përmban elementët konkret që duhet të kryejë secili OE.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i linjes DN-150mm gizë dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, me fond limit 35,744,607 lekë, zhvilluar më 03.03.2017, në të cilën anëtarë të KVO kanë qenë M.Q (kryetar), M.B dhe O.Dh anëtarë, konstatohet se kanë kualifikuar BOE “K.” SHA & “A..” SHPK dhe BOE “N.” SHPK & “K.” SHPK, për të cilët marrëveshja e bashkëpunimit nuk ishte hartuar në përputhje me RrPP, mangësi e njëjtë me BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK.

Në këtë rast, z. M.Q, i cili ka qenë në pozicionin e kryetarit të KVO për të dy procedurat, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), në dy procedura të ndryshme, ku të njëjtën mangësi e kualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i linjes DN-150mm gizë dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, ndërsa e skualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje makineri pajisje (automjete)”. Në këto kushte **vlera 180,000 lekë**, që përbën diferencën midis BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK të skualifikuar në kundërshtim me LPP dhe ofertës së OE “L.” SHPK të shpallur fitues (41,050,000 - 40,900,000 + tvsh), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika a dhe c, të cilat përcaktojnë se: “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve” dhe neni 53, pika 3.

Për sa më sipër përgjegjësia kryesore mbi këtë veprim mban kryetari i KVO M.Q.

OE M.MSHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se në Vërtetimin e Debisë nr. 807, datë 16.03.2018, lëshuar nga OSHEE SHA për këtë OE, përcaktohet se në këtë vërtetim debie nuk përfshihet detyrimi për muajin Shkurt 2018, detyrim i cili është maturuar më datë 31.03.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

OE “L.” SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, u konstatua se:

-OE “L.” SHPK ka paraqitur Pasqyrat Financiare dhe raportin e ekspertit kontabël për vitin 2016, të paraqitura në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë. Ndërsa për pasqyrat financiare të vitit 2015, ky OE ka paraqitur vetëm pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e llogaritjes së amortizimit të aktiveve dhe inventarin fizik të mallrave dhe materialeve (të konfirmuara nga tatimet), duke mos paraqitur bilancin e vitit ushtrimor 2015 dhe raportin e ekspertit kontabël, në kundërshtim me pikën 2.2.1, të Shtojcës nr. 9, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-OE “L.” SHPK ka paraqitur certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 18001:2007, ISO 28000:2007, certifikata të cilat konstatohet se nuk janë dhënë për mallrat objekt prokurimi, në kundërshtim me pikat 2.3.4 dhe 2.3.5, të Shtojcës nr. 9, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

Referuar konstatimeve të mësipërme, OE “L.” SHPK nuk duhej kualifikuar, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Me shkresën nr. 12175, datë 25.04.2018, BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK kanë sjellë ankesën në lidhje me vlerësimin e kryer. Me Urdhrin nr. 9870/4, datë 05.04.2018, titullari i AK pezullon procedurën, ndërsa me Urdhrin nr. 9870/5, datë 25.04.2018, ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesës.

Me shkresën nr. 9870/6, datë 26.04.2018, drejtuar titullarit të AK, komisioni i shqyrtimit të ankesës, konstaton se oferta e paraqitur nga BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK, nuk është në përputhje me RrPP, për arsye se marrëveshja e bashkëpunimit nuk përmban elementët konkretë që do kryejë secili nga anëtarët e grupit. Me shkresën nr. 12175/1, datë 27.04.2018, drejtuar BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK, titullari i AK e njofton mbi arsyet e mos pranimit të ankesës, ndërsa me Urdhrin nr. 9870/7, datë 09.05.2018, titullari i AK heq pezullimin e procedurës.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 9870/8, datë 09.05.2018, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues.

OE “L.” SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 070351810023783, datë 11.05.2018, me vlerë 4,926,000 lekë.

Kontrata nr. 9870/11, datë 08.06.2018, me vlerë 49,260,000 lekë me tvsh, me afat 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. K.M për Kontraktorin “L.” SHPK.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23915/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/8, datë 16.11.2018, nga anëtarët e komisionit për llogaritjen e fondit limit, anëtarët e njësisë së prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave dhe ish-drejtori i transportit dhe ofiçinës, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 9, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj qëndron pjesërisht e për pasojë merret pjesërisht parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Së pari, pretendimi juaj mbi specifikimet teknike se janë të përgjithshme nuk qëndron, për arsye se në Akt-Konstatimin nr. 9, datë 19.10.2018, janë dhënë argumentet nga grupi i auditimit se për cilat mjete/pajisje janë vendosur specifikime kufizuese.

Së dyti, pretendimi juaj mbi përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Së dyti, pretendimi juaj mbi vlerësimin e kryer nga anëtari i KVO M.Q se nuk ka të bëjë me interpretime të ndryshme por me mos konstatim të mangësisë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me nenin 58 të RRPP, si dhe Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika a dhe c.

Së treti, pretendimet tuaja në lidhje me procesin e vlerësimit nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66.

Së katërti, pretendimi juaj mbi përmbajtjen e raportit përmbledhës qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

7. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje mjete dhe automjete teknologjike për nevojat e shoqërisë”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 5283 Prot., datë 13.03.2017	M.Q, kryetar, jurist, M.B, juriste, F.M, Inxhinieri Mekanike, anëtarë. (Zëvendësuar me z. E.P me Urdhër nr. 5283/4, datë 04.04.2017)	K.H, juriste, D.K, ekonomiste, I.G, inxhinier
Vlera e përlllogaritur e kontratës 70,000,000 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 06.04.2017.		
Operatori ekonomik fitues, “S.... CO” SHPK me ofertë 67,909,000 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 2,091,000 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë: 1. “S.... CO” SHPK me ofertë 67,909,000 lekë pa tvsh. 2. “G. C” SHPK pa ofertë, skualifikuar.		
Kualifikuar 1 operator ekonomik. Skualifikuar 1 operator ekonomikë.		
Kontrata Nr. 5283/8 Prot., datë 25.05.2017, me vlerë 81,490,800 lekë me TVSH.	Urdhri Nr. 5283/2 Prot., datë 13.03.2017.	
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 5283/6 Prot., datë 02.05.2017.	Komisioni për përlllogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 116, datë 28.02.2017: A.K, K.T dhe A.S.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 5283/1, datë 13.03.2017. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 5283/7, datë 02.05.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 5283/9, datë 27.05.2017. Ankesa: Nuk ka.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesës nr. 736, datë 27.02.2017 “Kërkesë për blerje Automjetesh”, z. M.V me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transportit, ka dërguar specifikimet teknike për këtë procedurë. Specifikimet teknike janë hartuar nga z. M.V me detyrë përgjegjës i sektorit të transporteve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

dhe z. F.M me detyrë përgjegjës i sektorit të oficinës. Nga auditimi i këtyre specifikimeve teknike, konstatohet se janë vendosur specifikimet të përcaktuara në mënyrë shumë kufizuese. Këto specifikime janë diskriminuese, për arsye se janë vendosur kritere të cilat janë shumë kufizuese (si përmasat, pesha, fuqia motorike etj.) për mjetet që do prokurojnë, duke mos i argumentuar vendosjen e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, i cili përcakton se: *“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”* dhe neni 23, pika 2, e cila përcakton se: *“2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”*. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike.***

Me Urdhrin nr. 116, datë 28.02.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për testimin e tregut. Grupi i punës me anë të relacionit nr. 116/45, datë 13.03.2017, ka vendosur që vlera e fondit limit të jetë 70,000,000 lekë pa tvsh, si mesatarja e ofertave të OE “M” LTD SHPK, S... CO SHPK dhe “ A. Co..” SHPK.

Nga kjo përllogaritje e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, konstatohet se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së këtyre OE, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE (konkretisht nuk dokumentohet mënyra e kërimit të ofertave nga këta OE). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila përcakton se: *“...Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”*. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e vlerës së kontratës.***

Me anë të procesverbalit nr. 5283/3, datë 13.03.2017, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Në pikën 2.1.1 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që *“Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik”*, kërkesë kjo e paqartë dhe diskriminuese për arsye se kufizohen për pjesëmarrje vetëm OE që kanë të pasqyruara në ekstraktin e tyre të regjistrimit objektin e prokurimit dhe jo natyrën e shëbimeve/mallrave të kërkuara për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në pikën 2.3.8 të Shtojcës nr. 8, është kërkuar që *“2.3.8 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij të paktën një inxhinier me diplomë Inxhinieri mekanike, dega Transport, të certifikuar për mjete transporti dhe me ekperience jo më pak se 5 vjet.*

Për plotësimin e kësaj kërkesë, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- CV ku të pasqyrohet eksperiencia e punës jo më pak se 5 vjet.
- Diplome në Inxhinieri Mekanike dega Transport.
- Kontratë noteriale pune lidhur ndërmjet shoqërisë ofertuese dhe punonjësit të kualifikuar”. Në argumentimin e vendosjes së kësaj kërkesë për kualifikim, NjP është shprehur se *“kriteri i mësipërm është hartuar mbështetur në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 28, pika 5”*. Vendosja e kësaj kërkesë është kryer në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 27 *“Kontratat e mallrave”*, ku përcaktohen qartë kriteret që mund të kërkojnë në procedurat e prokurimit të mallrave, për arsye se në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

DST kjo procedurë është përcaktuar si kontratë mallrash dhe neni 28 ka për objekt vetëm kontratat e shërbimeve.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 736, datë 27.02.2017, specifikimet teknike për këtë procedurë janë përgatitur nga z. M.V dhe z. F.M. Z. F.M është njëkohësisht anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. **Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.** Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek”. Për pasojë z. F.M nuk duhej ta kish pranuar detyren e anëtarit të KVO.

Me Urdhrin nr. 5283/4, datë 04.04.2017, është ndërruar si anëtar i KVO, si pasojë e dorëheqjes si anëtar i KVO për arsye të uljes në detyrë.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 06.04.2017, ora 11:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	S.... CO SHPK	67,909,000	Kualifikuar	1
3	G. C SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr. 5283/5, datë 24.04.2017, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së OE G. C SHPK, dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE S.... CO SHPK. Procesi i vlerësimit (Procesverbali i hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nr. 5283/5, datë 24.04.2017 dhe vlerësimi elektronik) është kryer më datë 24.04.2017, pra 18 ditë pas procesit të hapjes së ofertave, në tejkalim të afatit kohor prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 2. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.***

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 5283/6, datë 02.05.2017, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues. Nga auditimi u konstatua se Raporti Përmbledhës nuk është paraqitur në mënyrë të plotë, për arsye se:

-Nuk përcaktohet numri i referencës së procedurës.

-Nuk përmban përshkrimin e mallrave që do prokurohen.

-Nuk pasqyrohen informacion mbi ankesa për këtë procedurë.

Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to”, **e për**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

pasojë ky Raport Përmbledhës nuk duhej miratuar nga titullari i AK. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Nga auditimi i procesit të vlerësimit konstatohet se:

OE G. C SHPK

OE G. C SHPK nuk ka paraqitur formularin e ofertës dhe dokumentacion teknik e financiar për këtë procedurë.

OE S.... CO SHPK

Në vlerësimin e kryer KVO është shprehur se ky OE nuk ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE, u konstatua se:

-OE ka paraqitur deklaratën e datës 06.04.2017, me anë të së cilës deklaroi se garanton servisin e specializuar “Fast&Furious”, me NIPT L51706022H, me adresë “*Rruga Sabaudin Gabrani, Misto Mame, pranë berrës KAON Tiranë*”. Nga verifikimi i NIPT të paraqitur në faqen zyrtare të QKB (<http://ëëë.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>), konstatohet se me katër NIPT figuron OE P.I. SHPK, i cili ka për adresë “*Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 7, Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14*”, si dhe nuk ka për objekt aktiviteti servis. Gjithashtu nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB, servisi i specializuar “F.&F.”, i paraqitur nga OE S.... CO, nuk rezulton të jetë i regjistruar. Për sa më sipër, OE S.... CO SHPK, nuk disponon servis të specializuar, në kundërshtim me pikën 2.3.7 të Shtojcës nr. 8, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter, si dhe **ka dhënë informacion jo të saktë** për servisin e disponuar.

-Nga krahasimi i të dhënave teknike të mjeteve në katalogët përkatës të paraqitur nga OE S.... CO SHPK me specifikimet teknike të kërkuara, konstatohet se:

- Për mjetin Fadromë konstatohet se:
 - Presioni i kërkuar është jo më pak se 220 bar, ndërsa presioni i paraqitur është 190 bar.
 - Prurja e pompës hidraulike të kërkuar është jo më pak se 85 litra/minutë, ndërsa prurja e paraqitur është 57 litra/minutë.
 - Depozita e vajit të kërkuar është 70 litra, ndërsa depozita e paraqitur është 140 litra.
 - Forca thyese e kovës së përparme e kërkuar është jo më pak se 7209 kgf, ndërsa forca e paraqitur është 6344 kgf.
 - Forca thyese e kovës së pasme është jo më pak se 6364 kgf, ndërsa forca e paraqitur është 2026 kgf.
- Për mjetin pompë e presionit të lartë, fuqia e kërkuar është 37 kë, ndërsa fuqia e paraqitur është 52 kë.
- Për mjetin Vinç Kamioni, momenti maksimal në ngritje i kërkuar është 87 kN.m, ndërsa momenti i paraqitur 82 kN.m.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën nr. 10, e për pasojë ky OE nuk duhej kualifikuar për këto kritere.

Referuar konstatimeve të mësipërme, OE S.... CO SHPK nuk duhej kualifikuar, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Zbatimi i kontratës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

OE S.... CO SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 021414, datë 22.05.2017, me vlerë 8,149,080 lekë.

Kontrata nr. 5283/8, datë 25.05.2017, me vlerë 81,490,800 lekë me tvsh, me afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe znj. I.Q për Kontraktorin S.... CO SHPK.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 286, datë 26.05.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e kolaudimit të përbërë nga:

4. Z. M.V, kryetar
5. Znj. K.H anëtarë
6. Z. D.M anëtarë.

Me anë të Akt-Kolaudimeve nr. 286/5, datë 12.07.2017, nr. 286/47, datë 11.07.2017, nr. 286/3, datë 30.06.2017, nr. 286/1, datë 02.06.2017, grupi i kolaudimit ka arritur në konkluzionin se automjetet e sjella nga kontraktori S.... CO SHPK, janë në përputhje me kontratën.

Kontraktori S.... CO SHPK, ka sjellë mjetet e ofruara me anë të faturave tatimore si më poshtë vijon:

- nr. 17, datë 12.07.2017, me vlerë 7,146,000 lekë me tvsh, bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 21, datë 12.07.2017;
- nr. 15, datë 30.06.2017, me vlerë 32,904,000 lekë me tvsh, bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 17, datë 30.06.2017;
- nr. 06, datë 11.07.2017, me vlerë 16,080,000 lekë me tvsh, bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr.20, datë 11.07.2017;
- nr. 46, datë 02.06.2017, me vlerë 14,580,000 lekë me tvsh, bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 15, datë 02.06.2017;
- nr. 50, datë 14.06.2017, me vlerë 5,860,800 lekë me tvsh, bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 16, datë 14.06.2017;
- nr. 21, datë 18.07.2017, me vlerë 4,920,000 lekë me tvsh, bërë hyrje në magazinë me anë të Fletë-Hyrjes nr. 22, datë 18.07.2017;

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23916/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/9, datë 16.11.2018, nga anëtarët e komisionit për llogaritjen e fondit limit, njësisë së prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave dhe grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 10, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsye si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimet tuaja mbi hartimin e specifikimeve teknike nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

Së dyti, pretendimi juaj mbi përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për këtë procedurë, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Së treti, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27.

Së katërti, fakti që për këtë procedurë nuk ka patur ankesa, nuk nënkupton që procedura është kryer në përputhje me LPP.

Së pesti, pretendimi juaj për përmbajtjen e raportit përmbledhës nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68. Citimi i përmendur nga ju për këtë nen, është kryer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

me ndryshimet që i janë bërë VKM nr. 914, me anë të VKM nr. 797, datë 29.12.2017, vendim i cili në datën e zhvillimit të kësaj procedure nuk kishte hyrë në fuqi.

Së gjashti, pretendimet tuaja në lidhje me procesin e vlerësimit nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66.

8. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Linjë Trasmetimi Ujësjiellësi nga Baseni i Presionit në dalje të tunelit Dajt-takimin me tubacionin e Depos Gurore (puseta e marrjes Fushe Dushk)”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 11840 Prot., datë 20.04.2018	M.Q, kryetar, jurist, L.R, juriste, O.Dh Inxhinieri Hidro, anëtarë. Urdhri Nr. 11840/1 Prot., datë 20.04.2018.	M.B, juriste, K.H, juriste, I.G, inxhinier
Vlera e përllogaritur e kontratës 166,340,323 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 11.06.2018.		
Operatori ekonomik fitues, “4-A..” SHPK me ofertë 164,556,567 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 1,783,756 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë: 1. “4-A..” SHPK me ofertë 164,556,567 lekë pa tvsh. 2. BOE “L..” SHPK & “Sh I..” SHPK me ofertë 166,326,596 lekë pa tvsh. 3. “ANK” SHPK me ofertë 166,240,473 lekë pa tvsh. 4. “C..” SHPK me ofertë 166,288,658 lekë pa tvsh. 5. “E..” SHPK pa ofertë, skualifikuar.		
Kualifikuar 2 operatorë ekonomik. Skualifikuar 2 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 11840/10 Prot., datë 25.05.2018, me vlerë 197,467,880.4 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 11840/6 Prot., datë 02.05.2018.	Ankesa: Ka.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 11840/2, datë 20.04.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 11840/8, datë 26.06.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 11840/12, datë 20.07.2018.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesës nr. U-643/1, datë 30.03.2018 “Mbi miratimin e procedurës së tretë”, z. O.Dh me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinierik, ka dërguar projekt-preventivin e plotë për zbatimin e kësaj procedure.

Me anë të procesverbalit nr. 1, datë 20.04.2018, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë, të cilët janë ndryshuar me Shtojcën datë 14.05.2018. Nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Në pikën 2.a, të Shtojcës nr. 12, ndër të tjera është kërkuar që OE ofertues të ketë licensën NP-2A, NS-5A dhe NS-6A, ndërkohë që në preventivin e publikuar nuk përcaktohen punime të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”.

-Në pikën 3, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e meposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbdhjete) vjet*”, pa u argumentuar se përse drejtuesi teknik duhet të ketë eksperiencë mbi 15 vjeçare, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

-Në pikën 4, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Një punësim mesatar i të paktën 120 (njëqind e njëzet) personave, për periudhën Mars 2017 - 2018 të vërtetuar me...*”, ndërkohë që një kërkesë e tillë nuk është e argumentuar nga NjP mbi numrin e punonjësve dhe profesionin e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

-Në pikën 5.b, të Shtojcës nr. 12, ndër të tjera është kërkuar që: “*Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis Kodi III.2.A (1+2) (lëshuar nga QKL)*”, licencë e cila ka të bëjë me shërbime të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor, ndërkohë që në preventivin e publikuar nuk përcaktohen punime të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”.

-Në pikën 8, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 23 (njëzetëe tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta të jene të pakten:*

- Grupi I- 6(gjashtë) punonjës
- Grupi II-5(pesë) punonjës
- Grupi III- 6(gjashtë) punonjës
- Grupi IV- 3 (tre) punonjës
- Grupi V- 3 (tre) punonjës

- *(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten dëshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)*”. Kjo është një kërkesë e pa argumentuar dhe nuk ka lidhje me këtë procedurë, për arsye se këto dëshmi kualifikimi kërkohen vetëm për punime elektrike, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Në pikën 14, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme) (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)”, kërkesë kjo e pa argumentuar për arsye se certifikata e mësipërme ka të bëjë me **menaxhimin e sigurisë në trafik**, ndërkohë që vendi i punimeve është në zonë malore dhe jo në rrugë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” dhe neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në pikën 16, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO SA 8000:2014 (e vlefshme) Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes”, kërkesë kjo e pa argumentuar për arsye se certifikata e mësipërme ka të bëjë me **përgjegjësinë sociale të OE**, kërkesë e cila nuk ka lidhje me procedurën që po zhvillohet, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” dhe neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

Me shkresën nr. 41, datë 28.04.2018, OE C.. SHPK ka paraqitur ankesën e tij në lidhje me këtë procedurë. Konkretisht ky OE është ankuar për pikën 5 (licenca I.2.a dhe III.2.a), si dhe për pikën 8 (23 punonjësit me dëshmi nga ISHTI).

Me Urdhrin nr. 11840/3, datë 30.04.2018, ka ngritur ngarkuar me shqyrtimin e ankesës KVO, ndërsa me Urdhrin nr. 11840/4, datë 30.04.2018, ka urdhëruar pezullimin e procedurës.

Me shkresën nr. 11840/5, datë 02.05.2018, drejtuar titullarit të AK, komisioni i shqyrtimit të ankesës, i ka propozuar pranimin pjesërisht të ankesës, konkretisht pranohet ankesa për pikën 5.a të Shtojcës 12, ndërsa për të tjerat nuk pranohet, edhe pse këto kërkesa janë në kundërshtim me RrPP. **Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO, në cilësinë e komisionit të shqyrtimit të ankesës.**

Me shkresën nr. K-2013/1, datë 02.05.2018, drejtuar OE C.. SHPK, titullari i AK ka dërguar përgjigje mbi ankesën e paraqitur.

Gjithashtu konstatohet se me anë të e-mailit të ardhur nga adresa Koordinimi.App@app.gov.al, APP i kërkon AK ndryshimin e kriterëve për kualifikim të mëposhtme për arsye se nuk janë të lidhura me objektin e kontratës:

- Certifikata ISO 27001:2013 “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”,
- Certifikatat NS-5A dhe NS-6A,
- Inxhinierin elektrik,
- Mjekun e kërkuar në rastin e BOE duhet ta kenë sipas përqindjes së pjesëmarrjes dhe
- 23 punonjësit me dëshmi nga ISHTI.

Me anë të Shtojcës në DT, datë 14.05.2018, NjP modifikon DST si më poshtë vijon:

- Hiqet kërkesa për licencën I.2.a,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

- Hiqet kërkesa për inxhinierin elektrik,
- Hiqet kërkesa për Licencën ISO 27001:2013, si dhe
- Shtyhet afati kohor i dorëzimit të ofertave deri më 11.06.2018, ora 09:00.

Me Urdhrin nr. 1840/6, datë 14.05.2018, titullari i AK urdhëron heqjen e pezullimit të procedurës.

Megjithë kërkesën e APP, si dhe ankesën e paraqitur për modifikimin e DT, nga NjP dhe komisioni i shqyrtimit të ankesës, janë modifikuar vetëm një pjesë e tyre, duke mos marrë parasysh parregullsitë e konstatuara më sipër. ***Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe anëtarët e KVO, në cilësinë e komisionit të shqyrtimit të ankesës.***

Gjithashtu konstatohet se ndërhyrja e APP në këtë procedurë, kryer në fazën e zhvillimit të saj, megjithëse në formën e rekomandimeve, **është kryer në tejkallim të kompetencave të këtij Institucioni** dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 65, pika 1, e cila përcakton se: “Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik **pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit**, por, në çdo rast, jo më vonë se 2 vjet nga nënshkrimi i saj”.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 11.06.2018, ora 09:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	4-A.. SHPK	164,556,567	Kualifikuar	1
2	BOE L.. SHPK & Sh I.. SHPK	166,326,596	Kualifikuar	2
3	ANK SHPK	166,240,473	Skualifikuar	
4	C.. SHPK	166,288,658	Skualifikuar	
5	E.. SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa numër, datë 18.06.2018, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së OE ANK SHPK, C.. SHPK dhe E.. SHPK, kualifikimin e ofertavës së OE 4-A.. SHPK dhe BOE L.. SHPK & Sh I.. SHPK, si dhe shpalljen fituese të ofertës së OE 4-A.. SHPK.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 11840/7, datë 26.06.2018, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues.

OE 4-A.. SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 021414, datë 22.05.2018, me vlerë 8,149,080 lekë.

Kontrata nr. 11840/10 Prot., datë 25.05.2018, me vlerë 197,467,880.40 lekë me tvsh, me afat 180 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. A.M për Kontraktorin 4-A.. SHPK.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23917/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/11, datë 16.11.2018, nga anëtarët e njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 11, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj qëndron pjesërisht e për pasojë merret pjesërisht parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

Së pari, pretendimi se juaj se z. O.Dh nuk është hartues i specifikimeve teknike e për pasojë nuk kishte pengesa në emërimin e tij si anëtar i KVO, qëndron por nga grupi i auditimit nuk është evidentuar si mangësi në këtë procedurë.

Së dyti, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26.

Së treti, pretendimi juaj mbi përmbajtjen e raportit përmbledhës qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

9. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksioni dhe rrethimi i depove në Ujesjetllës Rajonal (Faza I)”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 11643 Prot., datë 18.04.2018	M.Q, kryetar, jurist, L.R, juriste, O.Dh Inxhinieri Hidro, anëtarë. Urdhri Nr. 11643/2 Prot., datë 18.04.2018.	M.B, juriste, D.K, ekonomiste, I.G, inxhinier
Vlera e përlogaritur e kontratës 74,173,641 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 21.05.2018.		
Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë fitues, “E.” SHPK & “E..2000” SHPK me ofertë 72,058,922 lekë pa tvsh. Zbritja nga fondi limit 2,114,719 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë: 1. BOE “A. K..” SHPK & “P..” SHPK me ofertë 62,752,076 lekë pa tvsh. 2. “E.K” SHPK me ofertë 64,113,457.80 lekë pa tvsh. 3. “A..-G..” SHPK me ofertë 68,706,103.30 lekë pa tvsh. 4. BOE “E.” SHPK & “E..2000” SHPK me ofertë 72,058,922 lekë pa tvsh. 5. “Sh L..” SHPK me ofertë 72,864,034 lekë pa tvsh. 6. “K..” SHPK me ofertë 73,202,620 lekë pa tvsh. 5. “K.K” SHPK me ofertë 74,126,814 lekë pa tvsh.		
Kualifikuar 2 operatorë ekonomik. Skualifikuar 5 operatorë ekonomikë.		
Kontrata Nr. 11643/6 Prot., datë 06.07.2018, me vlerë 86,70,706.40 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: R.M. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 11643/3 Prot., datë 06.06.2018.	Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 11643/8, datë 09.07.2018. Ankesa: Nuk ka.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 11643/1, datë 18.04.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 11643/4, datë 06.06.2018.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Me anë të kërkesës nr. 1100/1, datë 27.03.2018 “Mbi procedurën e zbatimit me të tretë të objektit: Rikonstruksioni dhe rrethimi i depove në Ujesjetllës Rajonal (Faza I)”, z. O.Dh



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
**Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.**

me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinierik, ka dërguar projekt-preventivin e plotë për zbatimin e kësaj procedure.

Me anë të procesverbalit nr. 1, datë 18.04.2018, Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë, të cilët janë ndryshuar me Shtojcën datë 02.05.2018. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike për këtë procedurë, u konstatua se:

-Në pikën 2.a, të Shtojcës nr. 12, ndër të tjera është kërkuar që OE ofertues të ketë licensën NP-11A dhe NP-12A, ndërkohë që në preventivin e publikuar nuk përcaktohen punime të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”.

-Në pikën 3, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e meposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 10 (dhjete) vjet*”, pa u argumentuar se përse drejtuesi teknik duhet të ketë eksperiencë mbi 10 vjeçare, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

-Në pikën 4, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetëdhjetë) personave, për periudhën Mars 2017 - Mars 2018 të vërtetuar me...*”, ndërkohë që një kërkesë e tillë nuk është e argumentuar nga NjP mbi numrin e punonjësve dhe profesionin e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

-Në pikën 5, të Shtojcës nr. 12, ndër të tjera është kërkuar që: “*I (një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”, kërkesë e cila nuk ka të bëjë me objektin e kësaj procedure, për arsye se kjo certifikatë e cila ka të bëjë me shërbime të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor, ndërkohë që në preventivin e publikuar nuk përcaktohen punime të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”.

-Në pikën 7, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta të jete të pakten:*

- Grupi I- 4(kater) punonjës
- Grupi II-3(tre) punonjës
- Grupi III- 4(kater) punonjës
- Grupi IV- 2 (dy) punonjës
- Grupi V- 2 (dy) punonjës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

- (Per punonjesit e sipërpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)”, kërkesë e pa argumentuar mbi ndarjen e mësipërme, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në pikën 9, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga cilet dy automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit”, kërkesë kjo e paargumentuar për numrin e manovratorëve, për arsye se në pikën 18, të Shtojcës 12, janë kërkuar vetëm 2 mjete të tilla.

-Në pikën 12, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Shoqëria duhet të paraqesë Certifikate ISO 14001-2004 (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)”, kërkesë e paargumentuar për arsye se kjo certifikatë ka të bëjë me sistemin e menaxhimit mjedisor, e si e tillë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” dhe neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në pikën 15, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme) (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)”, kërkesë e paargumentuar për arsye se kjo certifikatë ka të bëjë me menaxhimin e trafikut rrugor, e si e tillë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” dhe neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në pikën 16, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 27001:2013 (e vlefshme) Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes”, kërkesë e paargumentuar për arsye se kjo certifikatë ka të bëjë me teknologjinë e informacionit, e si e tillë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” dhe neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Në pikën 17, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO SA 8000:2014(e vlefshme) Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes”, kërkesë kjo e pa argumentuar për arsye se certifikata e mësipërme ka të bëjë me përgjegjësinë sociale të OE, e si e tillë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, **objekt i kontratës**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” dhe neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 21.05.2018, ora 09:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	BOE E. SHPK & E..2000 SHPK	72,058,922	Kualifikuar	1
2	Sh I.. SHPK	72,864,034	Kualifikuar	2
3	BOE A. K.. SHPK & P.. SHPK	62,752,076	Skualifikuar	
4	E.K SHPK	64,113,457.80	Skualifikuar	
5	A..-G.. SHPK	68,706,103.30	Skualifikuar	
6	K.. SHPK	73,202,620	Skualifikuar	
7	K.K SHPK	74,126,814	Skualifikuar	

Me anë të Procesverbalit të hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa numër, datë 29.05.2018, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së BOE A. K.. SHPK & P.. SHPK, OE E.K SHPK, OE A..-G.. SHPK, OE K.. SHPK dhe OE K.K SHPK, kualifikimin e ofertavës së BOE E. SHPK & E..2000 SHPK dhe OE Sh I.. SHPK, si dhe shpalljen fituese të ofertës së BOE E. SHPK & E..2000 SHPK.

Me anë të Raportit Përmbledhës nr. 11643/3, datë 06.06.2018, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe OE fitues. Nga auditimi u konstatua se Raporti Përmbledhës nuk është paraqitur në mënyrë të plotë, për arsye se:

- Nuk përcaktohet numri i referencës së procedurës.
- Nuk përmban përshkrimin e mallrave që do prokurohen.
- Nuk përmban informacion mbi ankesa.

Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrja në lidhje me to”, **e për pasojë ky Raport Përmbledhës nuk duhej miratuar nga titullari i AK. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

BOE E. SHPK & E..2000 SHPK ka sjellë sigurimin e kontratës nr. 070310420024143, datë 11.06.2018, me vlerë 8,900,837 lekë.

Kontrata nr. 11643/6 Prot., datë 06.07.2018, me vlerë 86,470,706.40 lekë me tvsh, me afat 180 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, është nënshkruar nga z. R.M për AK dhe z. S.Ç dhe Q.S për Kontraktorin BOE E. SHPK & E..2000 SHPK.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 23918/1, datë 24.10.2018 dhe nr. K-4272/13, datë 16.11.2018, nga anëtarët e njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, në lidhje me Akt Konstatimin nr. 12, datë 19.10.2018, sqarojmë se observacioni juaj qëndron pjesërisht e për pasojë merret pjesërisht parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimet tuaja mbi vendosjen e kritereve të veçanta për kualifikim nuk qëndrojnë, për arsye se janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26.

Së dyti, fakti që për këtë procedurë nuk ka patur ankesa, nuk nënkupton që procedura është kryer në përputhje me LPP.

Së treti, pretendimi juaj mbi përmbajtjen e raportit përmbledhës qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

C.6. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, konstatohet se dokumentacioni është mbajtur i rregullt, veprimet janë regjistruar kronologjikisht dhe shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Janë mbajtur çdo muaj procesverbalet për gjendjen e arkës nënshkruar nga personat përgjegjës. Veprimet e kryera për periudhën objekt auditimi, janë kryesisht arkëtime për shërbimet e kryera ndaj subjekteve private në lidhje me dhënie me qira të boteve nga UKT, azhurnime rrjeti, etj.

Karburanti për UKT, magazinohej dhe shpërndahej në parkun e automjeteve, Brar, i cili funksionon për të gjitha mjetet e transportit dhe të administratës si magazinë dhe oficinë për riparime të ndryshme.

Dokumentacioni për shpenzimet e karburantit mbahej nga sektori i transportit duke plotësuar për çdo mjet kartelat, fletë udhëtimin, programin e punës, etj, të cilat nënshkruhen nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e mjeteve. Automjetet janë pajisur me sistemin GPS, ku kontrollohen km e përshkruar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patentat shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nga normativat e konsumit/100km të miratuara nga komisionet e ngritura për këtë qëllim.

Nga verifikimi i gjendjes së karburantit në magazinë në datën 05.10.2018 rezultoi, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Gjendja kartelës	Gjendja fizike	Diferenca	Çmimi	Vlera
1	Naftë	13,360 lit	7,560 lit	-5,800 lit	182,9 l/lit	1,060,820
2	Benzinë	2310 lit	3,060 lit	+750 lit	174,1 l/lit	- 130,575
	Shuma					930,245

Në datën 05.10.2018 në magazinë duhej të ishin 13,360 litra naftë dhe 2310 litra benzinë, por faktikisht në magazinë për këta 2 artikuj rezultoi me diferencë për -5,800 litra naftë dhe +750 litra benzinë, në shumën **930,245 lekë**.

Grupit të auditimit nga magazinieri iu sqarua se sasia e munguar e karburantit prej 5,800 litrash ishte për shkak se shefi i transportit kishte tërhequr nga magazina sasinë prej 5000 litra naftë në fillim të muajit, pa asnjë dokumentacion financiar ose fletë dalje provizore, kurse 800 litra naftë mungonin për shkak se shoferët në situara të caktuara kur nuk ka pasur gjendje të benzinës në magazinë, ishin pajisur me tollona nafte duke i shkëmbyer ato te pikat e furnizimit (ky veprim i pafaktuar me ndonjë letër zyrtare). Në momentin që magazina është furnizuar me benzinë rezultoni që në gjendje të ishin 750 litra benzinë me shumë në krahasim me gjendjen kontabël (vlerë kjo e ardhur nga shkëmbimi i mëparshëm i tollonave të naftës me ato të benzinës).

Për shkak se në datën e kontrollit në magazinë shefi i transportit nuk ndodhej aty, nga grupi i KLSH-së u krye një tjetër kontroll me datën 11.10.2018 ku pas verifikimit të gjendjes kontabël dhe tërheqjeve të karburantit nga shoferët, nga data 05.10.2018 deri më datë 11.10.2018, gjendja fizike rezultoi si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Gjendja kartelës	Gjendja fizike	Diferenca	Çmimi	Vlera
1	Naftë	11,780	11,750 lit	-30 lit	182,9 l/lit	5,487
2	Benzinë	1870 lit	1870 lit	-	-	-
	Shuma					5,487

U konstatua se nafta kishte diferencë prej 30 litrash për arsyen e tërheqjes së tyre nga 1 prej drejtuesve të automjeteve, e cila ende nuk ishte kontabilizuar. Benzina rezultoi pa diferencë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

për shkak se tollonat që ishin tepër ishin ndërruar sërish me tollona naftë (dhe në këtë rast, ky veprim ishte i pavërtetuar nga ndonjë letër zyrtare).

Problematikë tjetër e hasur nga kontrolli fizik i tollonave që mbaheshin në kasafortën e magazinës ishte që nga numrimi i tyre rezultoj se 110 litra naftë, me vlerë $110 \text{ l} \times 182.8 \text{ l/litër} = 20,108 \text{ lekë}$, ishin të pavlefshëm pasi nuk kishin bar code, duke i bërë të pavlefshëm pasi ato nuk pranohen nga pikat e furnizimit. Vlera **20,108 lekë** përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit. U konstatua gjithashtu se 100 litra nuk ishin të UKT pasi ishin me logo të institucioneve të ndryshme, një fenomen ky i pajustikuar sesi kishin përfunduar te kasaforta e UKT. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për këto 100 litra naftë me vlerë, $100 \text{ litra} \times 182.8 \text{ l/litër} = \mathbf{18,280 \text{ lekë}}$.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39, ku citohet se:

-Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

-Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe vërtetohen kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike, të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

-Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

-Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi z. M.M, me detyrë magazinier dhe z. M.V, me detyrë përgjegjës i sektorit të transportit.

Nga kontrolli në magazinën e UKT është konstatuar një sasi e konsiderueshme litar amianti e cila ishte e papërdorur asnjë herë nga UKT. Në vitin 2011 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 1,200 kg litar amianti me vlerë 1,170,000 lekë. Deri më datën 20.10.2017 kur ky mall është propozuar për jashtë përdorimit, nga sasia prej 1,200 kg janë përdorur vetëm 72 kg. Mos përdorimi i këtij produkti ka bërë që në magazinë të jenë në gjendje stoku 1,128 kg në vlerën **1,104,280 lekë**, vlerë kjo e cila ka sjellë efekt negativ financiar për buxhetin e UKT Sh.a.

Veprimet e kryera nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimi, janë mbajtur të rregullta, kronologjike dhe çdo pagesë/arkëtim është shoqëruar me dokumentacionin justifikues, urdhrat e nëpunësve autorizues dhe janë nënshkruar nga punonjësit zbatues. Janë respektuar dispozitat ligjore dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Nëpërmjet bankës janë likuiduar shpenzimet e kryera për udhëtime jashtë vendit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Nga auditimi konstatohet se prokurimi i biletave të udhëtimit dhe fjetjes për vitin 2017 janë kryer me blerje me vlera të vogla në momentin që del nevoja për udhëtim, pa detajuar shpenzimet nga ku nuk përcaktohet e ndarë vlera e biletës nga ajo e akomodimit. Nga auditimi i dokumenteve justifikues për shërbimet e kryera jashtë vendit përgjatë vitit 2018 konstatohet se mungojnë fletët e hotelit, nga ku nuk mund të përcaktohet kategoria e hotelit për punonjësit sipas kategorizimit, veprime në kundërshtim me pikat 9 dhe 11, të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” sepse edhe prokurimi nuk ka të përcaktuar specifitime teknike për kategoritë e hoteleve për çdo punonjës udhëtues.

Shpenzimet për udhëtime jashtë vendit janë të kufizuara, kryesisht pjesëmarrje në konferenca dhe seminare të organizuara për rritjen e kapaciteteve në drejtim të zhvillimit të shoqërisë dhe marrjen e eksperiencave më të mira.

Nga UKT SHA, nuk janë kryer shpenzime udhëtimi e dieta për shërbime brenda vendit si edhe për periudhën objekt auditimi nuk janë dhënë sponsorizime.

-Nëpërmjet bankës janë kryer pagesat mujore të telefonisë celulare për të gjithë punonjësit, referuar kontratave të nënshkruara me kompanitë celulare “V..”, “P C..” dhe “T M..”.

Për telefoninë celulare, UKT SHA, ka nënshkruar kontratë shërbimi me operatorin e telefonisë celulare “V.. Albania” dhe pagesa për numrat në dispozicion të punonjësve kryhet nga UKT.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, pagesa e faturave për shërbimin e ofruar nga operatori mobile, kryhet nga financa e UKT SHA, duke likuiduar në fillim vlerën totale të faturës përmbledhëse dhe më pas kryhen ndalesat analitike për çdo punonjës nga paga, nëpërmjet listëpagesave.

Në datën 13.11.2015, është nënshkruar një Marrëveshje me kompaninë celulare “P C..” me objekt “Për terma të veçanta të ofertës Plus”, nga ish drejtori N.Gj dhe A.K drejtor i dep. të shitjeve të P.. Kjo kontratë ka zgjatur deri më datën 31.12.2017, në momentin që kompania “P C..” ka mbyllur aktivitetin e saj. Deri në momentin e mbylljes UKT Sh.a ka pasur një detyrim të prapambetur në shumën **1,281,091 lekë**, por që nuk është bërë asnjë shkresë zyrtare për arkëtim nga ndonjë përfaqësues të kompanisë celulare “P C..”.

Në shumë raste nga grupi i auditimit është konstatuar që në analizën e faturës të muajit paraardhës për të gjitha kompanitë ishte zëri: “detyrime për punonjësit e larguar”.

Deri më datën 31.08.2018 vlera totale e detyrimit nga punonjësit e larguar për kompaninë “P C..” është **336,241 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të shoqërisë.**

Për “V..e Albania” detyrimi është **4,900 lekë**, ndërsa për “T M..” është **2,100 lekë**. Këto vlera priten të arkëtohen në momentin që punonjësit e larguar të cilët janë debitor, do vijjnë për të tërhequr librezën e punës, **vlera të cila përbëjnë dëm ekonomik për llogari të shoqërisë.**

Detyrimi në total ndaj kompanive celulare deri në muajin gusht 2018, është **343,241 lekë**, detyrime nga punonjësit e larguar.

Likuidimi i vlerës për shpenzimin e telefonisë celulare ndaj kompanive kryhet për gjithë shumën e faturuar ndaj UKT, bazuar në kontratat e nënshkruara mes palëve.

Likuidimi i faturave të telefonit celular analitike për çdo punonjës kryhet nga dega e financës nëpërmjet listëpagesave, kjo mënyrë vështirëson ndjekjen në kohë të debitorëve, pasi faturat vijjnë në muajin pasardhës ose me vonesë, si dhe ka lëvizje të punonjësve, si pranime e largime nga puna, veprime të cilat sjellin debitorë në rritje, pasojë kjo e neneve të kontratave përkatëse sa më lart dhe koston e paguan institucioni.

-Nëpërmjet bankës janë paguar gjoba për llogari të Drejtorisë së tatimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Nga kontrolli tatimor i kryer në UKT Sh.a janë nxjerrë detyrime për TVSH në vlerën **2,000,417 lekë** si edhe i është vendosur gjoba me vlerë **611,374 lekë** për TVSH e padeklaruar.

Janë nxjerrë detyrime mbi tatim fitimin në vlerën **257,579 lekë** si dhe është vendosur gjoba me vlerë **150,894 lekë** për tatim fitimin e padeklaruar.

Janë nxjerrë detyrime mbi tatimin në burim në vlerën **682,030 lekë** si dhe është vendosur gjoba me vlerë **657,736 lekë** për tatimin e mbajtur mbi burim dhe të padeklaruar.

Shuma prej **1,420,004 lekë**, paguar për gjobat dhe interesat e vonuara kanë shkaktuar **efekt financiar negativ** për UKT.

Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi Drejtori Ekonomik znj. A.S.

Mbi kontrollin e shpenzimeve për karburant.

UKT Sh.a për vitin 2017 ka pasur në përdorim 140 automjete, ndërsa për vitin 2018, 135 automjete. Në çdo fund muaj nga shefi i parkut Brar vijjnë fletët e plotësuara për distancat e përshkruara nga secili automjet, dhe konsumi i tyre sipas normativës dhe sipas faktit.

Në muajin qershor të vitit 2017 UKT Sh.a ka blerë automjete të reja të markës HYUNDAI (modeli i20 dhe Santa Fe). Automjetet kanë qënë të gjitha me 0 km dhe me një normë konsumi të ndërthur prej 5.9 l/100 km për automjetet tip HYUNDAI i20 dhe 8.3l/100km për automjetet tip HYUNDAI Santa Fe, normë kjo e nxjerrë nga fabrika. Për 6 muaj deri në janar të vitit 2018 të gjitha udhëtimet, fletë shërbimet dhe tërheqja e karburantit nga magazina është bërë duke u bazuar te kjo normë. Me datën 16.01.2018 është dërguar relacioni nga grupi i punës për matjen e konsumit të karburantit (i ngritur me urdhërin e brendshëm nr.513, datë 18.10.2017) ku kanë dalë në përfundimin se automjetet tip HYUNDAI i20 kanë një normë konsumi prej 7 l/100km., ndërsa HYUNDAI Santa Fe ka një konsum prej 13l/100 km. Arsyeja e ndryshimit të normativës së konsumit është e paargumentuar duke u bazuar që automjetet e reja ende nuk kanë plotësuar vitin në përdorim dhe që deri në fillimin e muajt kur është bërë testimi i konsumit po këto automjete, ato rakordonin dhe ishin në përputhje me normën e konsumit të nxjerrë nga fabrika prej 5.8 litra / 100 km.

Mbi kryerjen e shpenzimeve për procedurat e prokurimit me vlera të vogla.

Nga ana e UKT Sh.a për vitin 2017, në datën 13.01.2017 me shkresën nr. 461 i është dërguar APP regjistri vjetor i parashikimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2017. Në datën 12.10.2017 i është dërguar APP shkresa me nr.461/4, mbi regjistrin përmbledhës i realizimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2017.

Numri i prokurimeve të parashikuara dhe të realizuara pasqyrohet si më poshtë:

PROKURIME ME VLERË TË VOGËL		
Përmbajtja	Viti 2017	Viti 2018
Parashikuar	59	64
Realizuar	49	34

Për vitin 2017 nga 49 procedura të kryera, janë audituar 20 prej tyre. Për vitin 2018 deri më 31.08.2018 nga 34 procedura të kryera, janë audituar 15 prej tyre. Në shumicën e Disa prej procedurave të konstatuara me probleme janë paraqitur si më poshtë.

Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël, për vitin 2017 është konstatuar problematika e **copëzimit të fondit për zëra të ndryshëm** veprime këto në kundërshtim me nenin 40 dhe nenin nr. 59 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si edhe nenit 28, neni 29/5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Më saktësisht kjo problematikë është konstatuar në rastin e blerje pjesë këmbimi automjeteve ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është **2,618,057.6**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

lekë, në rastin e blerjeve materiale ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,328,659 lekë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Me datë 15.09.2017, është lëshuar urdhri i prokurimit nr.2 “Blerje matës sasior elektronik ne tre sensorë” me fond limit 786,666 lekë pa TVSH. Në praktikë është konstatuar se një nga specifikimet teknike është që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë vërtetimin nga OSHEE për mospasjen e asnjë detyrimi të maturuar për pagesën e energjisë elektrike. Nga titullari është konsideruar se mos-dorëzimi i një prej dokumentave të kërkuara, është kusht për skualifikimin e operatorit fitues. Në këtë rast nga grupi i auditimit është konstatuar se mungon vërtetimi nga ana e OSHEE, për operatorin ekonomik fitues, ndaj ky operator duhej të ishte skualifikuar nga njësia e prokurimit. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit me anëtarë z.A.K Kryetar, znj.K.T Anëtare dhe z.A.S Anëtar.

Me datë 09.02.2017, është lëshuar urdhri i prokurimit nr.2486/4 “Blerje elektropompë” me fond limit 400,000 lekë pa TVSH. Në praktikë është konstatuar se oferta e operatorit ekonomik fitues “A&G..” Sh.p.k ka qënë 330,000 lekë pa TVSH. Në datën 15.02.2017 është bërë Akt-Kolaudimi për mallin e dorëzuar në ambjentet e UKT. Nga grupi i kolaudimit i përbërë prej z.K.I, z.A.A dhe z.E.C është konstatuar se elektropompa ishte sipas specifikimeve teknike. Nga shqyrtimi i dosjes të procedurës së prokurimit është konstatuar se me faturën tatimore me nr.37, datë 15.02.2017 për këtë elektropompë është paguar shifra 365,000 lekë pa TVSH (438,000 lekë me TVSH), kur oferta e OE ishte 330,000 lekë pa TVSH, pra është paguar më shumë dhe në mënyrë të pajustificuar më shumë vlera **42,000 lekë** me tvsh, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e shoqërisë.**

Në datën 15.02.2018 është lëshuar urdhri i prokurimit me nr. 5618/3 për “Blerje varke për nevojat e UKT Sh.a” me fond limit 400,000 lekë pa tvsh. Me faturën tatimore me nr.91, datë 28.02.2018 është paguar vlera 360,000 pa tvsh (432,000 lekë me tvsh) operatorit ekonomik fitues “A.P” person fizik. Nga auditimi i dokumentacionit është konstatuar se në ftesën për ofertë, tek specifikimet teknike është kërkuar që varka të ketë një gjatësi fikse prej 360 cm, gjerësi prej 140 cm dhe lartësi prej 50 cm duke mos e arsyetuar nevojën e vendosjes së këtyre kritereve. Me vendosjen e këtyre specifikimeve nga ana UKT Sh.a është penguar konkurrenca, veprim ky në kundërshtim me pikën nr.2 të nenit 23 të LPP. *Sa më sipër mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga z.A.K kryetar, znj.E.C anëtare dhe z.A.S anëtar.*

Me datë 05.06.2017, është lëshuar urdhri i prokurimit nr.11897/4 “Blerje tonera për UKT Sh.a” me fond limit 393,460 lekë pa TVSH. Në praktikë është konstatuar se një nga specifikimet teknike është që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë vërtetimin nga OSHEE për mospasjen e asnjë detyrimi të maturuar për pagesën e energjisë elektrike. Nga titullari është konsideruar se mos-dorëzimi i një prej dokumentave të kërkuara, është kusht për skualifikimin e operatorit fitues. Në këtë rast nga grupi i auditimit është konstatuar se mungon vërtetimi nga ana e OSHEE, për operatorin ekonomik fitues, ndaj ky operator duhej të ishte skualifikuar nga njësia e prokurimit. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit me anëtarë z.A.K Kryetar, znj.K.T Anëtare dhe z.A.S Anëtar.

Me datë 21.02.2017, është lëshuar i prokurimit nr.3649/4 “Blerje detektor (Pajisje lokalizuese të tubacioneve të nëndheshme dhe kablllove elektrike)” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH. Fitues është shpallur operatori ekonomik “R..” Sh.p.k me ofertën 570,000 lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i procedurës është konstatuar se kjo blerje ka ardhur pas kërkesës nga Drejtori i Drejtorisë Operacionale z.D.M dhe Drejtori i Drejtorisë së Faturim-Arkëtim z.B.B me arsyen



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

e evidentimin e saktë të tubacioneve nëntokësore për lidhjet e paligjshme dhe uljen e kostos për gjetjen e tyre. Në këtë procedurë nuk ekziston asnjë dokument nga magazinat e UKT-së për mos pasjen në gjendje të kësaj aparature. Në kontrollin e kryer në magazinën e Brarit nga grupi i KLSH-së me datë 05.10.2018 u konstatua se kjo pajisje ishte në gjendje në magazinë që prej vitit 2008, ndaj blerja e një detektorit të ri, ka qënë e panevojshme duke rënduar buxhetin e UKT-sha në vlerën **570,000 lekë** pa TVSH. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Drejtorisë Operacionale z.D.M dhe Drejtorin e Drejtorisë së Faturim-Arkëtim z.B.B .

Me datë 14.07.2017, është lëshuar urdhri i prokurimit nr.13990/4 “Blerje letër për makinë biletarie ” me fond limit 300,000 lekë pa TVSH.Në praktikë është konstatuar se një nga specifikimet teknike është që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë vërtetimin nga OSHEE për mospasjen e asnjë detyrimi të maturuar për pagesën e energjisë elektrike. Nga titullari është konsideruar se mos-dorëzimi i një prej dokumentave të kërkuara, është kusht për skualifikimin e operatorit fitues. Në këtë rast nga grupi i auditimit është konstatuar se mungon vërtetimi nga ana e OSHEE, për operatorin ekonomik fitues, ndaj ky operator duhej të ishte skualifikuar nga njësia e prokurimit. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit me anëtarë z.A.K Kryetar, znj.K.T Anëtare dhe z.A.S Anëtar.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. K-4272/17, datë 16.11.2018, nga znj. A.S në lidhje me Akt Konstatimin nr. 17 “Për auditimin e ushtruar mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës,shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël” sqarojmë se observacioni juaj nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të auditimit, me arsyt si më poshtë vijon:

Përsa i përket pretendimit tuaj mbi pagesat e e kryera për udhëtimet jashtë vendit dhe mbi detyrimet e mbetura për kompanitë celulare nga punonjësit e larguar nuk qëndron pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që ta vërtetoj të kundërtën e asaj që është konstatuar nga grupi i auditimit në këtë rast, ndaj pretendimi juaj nuk vërtetohet nga ana dokumentare dhe ligjore.

Përsa i përket pretendimit tuaj mbi pagesat e e kryera për gjobat tatimore, ju ritheksojmë se për këtë problematikë jeni vënë në dijeni si Drejtoresha Ekonomike e UKT Sh.a ndaj nuk merret parasysh pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që ta vërtetoj të kundërtën e asaj që është konstatuar nga grupi i auditimit në këtë rast, ndaj pretendimi juaj nuk vërtetohet nga ana dokumentare dhe ligjore.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. K-4272/17, datë 16.11.2018, nga z. M.M në lidhje me Akt Konstatimin nr. 17 “Për auditimin e ushtruar mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës,shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël” sqarojmë se observacioni juaj nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të auditimit, me arsyt se nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që ta vërtetoj të kundërtën e asaj që është konstatuar nga grupi i auditimit në këtë rast, ndaj pretendimi juaj nuk vërtetohet nga ana dokumentare dhe ligjore.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. K-4272/17, datë 16.11.2018, nga z. B.B, z. D.M dhe z. L.Z në lidhje me Akt Konstatimin nr. 17 “Për auditimin e ushtruar mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës,shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël” pas paraqitjes së këtij dokumentacioni i cili nuk është paraqitur gjatë periudhës së auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

në terren sqarojmë se observacioni juaj merret parasysh në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

D. GJETJET NGA AUDITIMI, IMPAKTI TE PASQYRAT FINANCIARE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE.

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për Opinionin e auditimit të Pasqyrave Financiare.

Ne kemi kryer auditimin financiar mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SHA Tiranë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” SHA Tiranë për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 17001 dhe ISSAI 12002 shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të “Ujësjellës Kanalizime” SHA Tiranë duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore”.

• **Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200):**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SHA Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion i kualifikuar me rezervë: Nga auditimi mbi përputhshmërinë i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SHA Tiranë, rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) në administrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur ***nga gabime materiale***, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar me rezervë***.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave mbi prodhimin, faturimin dhe arkëtimin e ujit, u konstatua se:

-Nga auditimi mbi prodhimin dhe faturimin e ujit, u konstatua se për vitin 2017 janë prodhuar gjithsej 100 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 35 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në **humbje teknike në masën 65% e ujit të prodhuar, duke e tejkaluar nivelin e humbjeve të miratuar me 3%, nga niveli i miratuar në masën 62%**. Ndërsa për periudhën Janar - Gusht 2018, janë prodhuar gjithsej 63 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 23 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në **masën 63 %** të ujit të prodhuar, brenda nivelit të humbjeve të miratuar në **masën 63.3%**.

-Nga auditimi mbi faturimin dhe arkëtimin e ujit, konstatohet se niveli mesatar i arkëtimit për faturat e periudhës është 61% të faturimit. Ndërsa për nivelin e arkëtimit në total për çdo muaj, konstatohet se niveli i arkëtimeve për vitin 2017 në masën 133% të faturimit, ndërsa për periudhën janar-gusht 2018 është në masën 124% të faturimit. Nga sa më sipër konstatohet se, **UKT arkëton më shumë detyrime të prapambetura se detyrime të periudhës**.

-Nga auditimi i debitorëve konstatohet se deri më datë 31.12.2017, shoqëria ka në total 79,425 abonentë debitorë nga 237,245 abonentë në total (**33% e totalit**), të cilët i detyrohen shoqërisë UKT SHA vlerën 4,070,632,815 lekë. Kjo vlerë, e cila është relativisht shumë e lartë, për arsye se **është e barabartë me 125% të të ardhurave nga shitjet e shoqërisë**, pasqyruar në pasqyrat financiare. Ndërsa deri më datë 31.07.2018, shoqëria ka në total 82,333 abonentë debitorë nga 249,792 abonentë në total (**33% e totalit**), të cilët i detyrohen shoqërisë UKT SHA vlerën 4,251,993,560 lekë.

-Nga verifikimi i listave të debitorëve të datës 31.07.2018, konstatohet se 11 debitorët (*ato me vlerë detyrimi mbi 5 milion lekë*) me vlerë më të lartë dhe që përbëjnë në total 2% të debisë, konstatohet se *debitori më i madh është shoqëria “Rezidenca Studentore Nr. 1 Tiranë” SHA*, shoqëri publike aksionet e të cilës zotërohen 100% nga Bashkia Tiranë (që është njëkohësisht aksionari i UKT SHA) dhe që detyrimi i saj vetëm për 3 godina është në vlerën 21,029,264 lekë. Gjithashtu në listën e debitorëve më të mëdhenj janë dhe 2 institucione të tjera si Qendra Universitare Spitalore “Nënë Tereza” në vlerën 18,237,403 lekë dhe Banka e Shqipërisë në vlerën 10,161,943 lekë. Lista e debitorëve më të mëdhenj vazhdon me subjekte private “A.H.” SHA me detyrim në vlerën 10,392,406 lekë, “A..” SHPK me detyrim në vlerën 6,733,684 lekë, “H.H.T” me detyrim në vlerën 5,996,915 lekë, “I.B” me detyrim në vlerën 5,928,777 lekë dhe “F.E.E” me detyrim në vlerën 5,043,989 lekë, (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqet 28-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Departamenti i Shitjes, të marrin masa të menjëhershme për angazhimin e strukturave të shoqërisë, për evidentimin, ndjekjen dhe minimizimin e nivelit të abonentëve debitorë.

Vazhdimisht

1.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe raportimit të programit ekonomiko-financiar konstatua se ka zëra të cilët ka patur tejkalime të vlerave të miratuara, si më poshtë vijon:

-Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2017 që përfshin arkëtimin nga ndryshim emri, librezë, tarifë shërbimi dhe vlera e kontratave të reja është planifikuar 682 mln lekë dhe është realizuar 819 mln lekë, pra kemi një realizim me 120 % kundrejt planifikimit vjetor.

-Zëri materiale të para është realizuar në total 118 %, i cili paraqet tejkalim vetëm në zërat tuba, rakorderi, kimikate dhe karbon aktiv.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

-Zëri Roje Objektesh – Plani 330 mln lekë, fakti 346.5 mln lekë ose 105 % që përfshin pagesat e detyrimeve për rojet e objekteve ndaj firmave private me të cilët janë lidhur kontrata.

-Zëri Qira zyra – Plani 22 mln lekë, fakti 27.1 mln lekë ose 126 % që përfshin shpenzimet e kryera, për ambiente me qira për njësitë dhe zyrat e marrëdhënies me konsumatorin dhe të arkëtimit.

-Zëri Kancelari – Plani 9 mln lekë, fakti 11 mln lekë ose 123 %, që përfshin shpenzime kancelarie për nevojat e shoqërisë.

-Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike – Plani 8 mln lekë, fakti 31.9 mln lekë ose 3924%, që përfshin shpenzimet e kryera për konsulencë nga jashtë, eksperti kontabël për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, studimin e fizibilitetit të digës së Liqenit Artificial Tiranë, studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lana Bregas, vlerësimin teknik të rrjetit të UKT.

-Zëri Shpenzime postare – Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.4 mln lekë ose 198.7% që përfshin shpenzime postare për administratën.

-Zëri Shërbime bankare – Plani 6 mln lekë, fakti 18.6 mln lekë ose 311% që përfshin komisionet e paguara në bankë dhe disbursimet për kredinë e Shën Mërisë si dhe komisionet bankare për kredinë Japoneze.

-Zëri Shërbime të përgjithshme – Plani 4 mln lekë, fakti 18.6 mln lekë ose 464.8%. Në këtë zë përfshihen të gjitha shpenzimet e tjera që kryen shoqëria si azhurnime rrjeti, shpenzimet për mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta, shpenzimet e kryer për përmbaruesit në vlerën 3.45 mln lekë dhe ljerja dhe mirëmbajta e ambienteve të Njësisë 1 dhe 2 në vlerën 5.76 mln lekë.

-Zëri taksa vendore dhe pasurie – Plani 3 mln lekë, fakti 4.6 mln lekë ose 154.3%. Ky ndryshim niveli ka ardhur si pasojë e hapjes së ambienteve të reja të shoqërisë gjatë këtij viti.

-Zëri taksa për automjetet – Plani 1.5 mln lekë, fakti 1.61 mln lekë ose 107.4% që përfshin pagesën vjetore për automjetet e shoqërisë.

-Zëri Gjoha penalitete dhe dëmshpërblime,- Plani 20 mln lekë, fakti 64.5 mln lekë ose 322.3%. Tejkalimi i këtij zëri vjen si rezultat i zërit provizione për çështjet gjyqësore, i cili përfshin dëmshpërblimet për të larguarit nga puna dhe për pavlefshmëri titujsh ekzekutiv, (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqet 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.2- Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të merret në analizë puna e departamenteve të shoqërisë me qëllim përmirësimin e treguesve të performancës financiare të shoqërisë, si dhe të merren masa që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko ekonomik të shoqërisë, si dhe shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në mos arritjen e objektivave të shoqërisë. Çdo analizë dhe relacion të shoqërohet me evidentimin e mangësive, nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe me një plan masash konkrete për arritjen e rezultateve.

Brenda datës 31.12.2018 dhe Vazhdimisht

2.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës/Administrimit u konstatua se:

-Për vitin 2017, Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime. Referuar statutit të mëparshëm të shoqërisë i miratuar me vendimin nr. 14, datë 31.08.2016 neni 19, pika 2 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës do të mbledhet jo më pak se 3 herë në vit me intervale jo më të gjata se 4 muaj dhe në mënyrë të jashtëzakonshme sa herë të vlerësohet si e nevojshme nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ose kurdo që të kërkohet nga një e treta e Këshillit Mbikëqyrës ose Drejtori i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Përgjithshëm. Referuar mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës nuk është respektuar intervali i rregullt i mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës së UKT SHA, sepse mbledhja e parë për vitin 2017 është kryer më datë 06.07.2017, në kundërshtim me neni 19, pika 2, të statutit të mëparshëm të shoqërisë.

-Këshilli i Administrimit i UKT SHA, ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2017, me vendimin nr. 09, datë 04.07.2018, në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33/1, ku përcaktohet se duhet miratuar brenda 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

-Për periudhën 01.01.2018-31.08.2018 Këshilli i Administrimit është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 12 vendime. Referuar statutit të shoqërisë nr. 16/2, datë 14.12.2017, neni 14, pika 1, “Këshilli i Administrimit duhet të mbledhet jo më pak se 1 herë në muaj”, ndërsa në pikën 6 të po këtij neni përcaktohet se: “Këshilli i Administrimit mban një regjistër për pjesëmarrjen e cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e pranishëm në mbledhje”. Përsa më sipër nuk konstatohet një regjistër pjesëmarrje të nënshkruar nga anëtarët e pranishëm për secilën mbledhje dhe as respektim i intervalit kohor të mbledhjes së Këshillit të Administrimit 1 herë në muaj, në kundërshtim me statutin e shoqërisë nr. 16/2, datë 14.12.2017, neni 14, pika 6, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 53-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi: *Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të merren masa për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit jo më pak se një herë në muaj, me qëllim analizimin e vijueshëm të performancës së shoqërisë dhe marrjen e vendimeve koherente në bazë të problematikave që rezultojnë nga aktiviteti i përditshëm i shoqërisë, në zbatim të statutit të shoqërisë.*

Vazhdimisht

3.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve, u konstatua se:

-Me anë të Urdhrave të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 720, datë 01.11.2016 dhe nr. 58, datë 24.01.2018, është urdhëruar ndryshimi i orarit zyrtar të punës së shoqërisë nga hëna deri në të enjte do të jetë 08.00-16.00, ditën e premte 08.00-14.00 dhe ditën e shtunë 08.00-12.00. Sipas këtyre urdhrave konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018, gjatë ditëve të javës punonjësit e shoqërisë kanë punuar 36 orë në javë, ndërsa 4 orët e mbetura janë zëvendësuar ditën e shtunë, duke punuar 4 orët të plota. Por zëvendësimi i kryer gjatë ditës së shtunë, e cila është një nga ditët e pushimit javore dhe si e tillë duhej kryer me një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 (32 javë) dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018 (17 javë), për një total prej 49 javësh, punonjësit e administratës së shoqërisë janë paguar me 1 orë më pak në javë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1.

-Gjithashtu në pikën 1/b, të nenit 8, të Rregullores së Brendshëm të shoqërisë, përcaktohet i njëjti orar, i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1, për arsye se nuk parashikohet një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës.

-Nga auditimi i rekrutimit të punonjësve, konstatohet se në zbatim të nenit 7/a, të Rregullores së Brendshëm, rekrutimi i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Punës. Duke qenë se Kodi i Punës nuk përcakton se si duhet të kryhet rekrutimi i punonjësve, UKT ka hartuar një pyetësor për procedurat e rekrutimit dhe dokumentacionin që duhet paraqitur nga punëmarrësit. Por kjo rregullore nuk parashikohen procedura mbi shpalljen e vendeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

vakante, por vetëm të atyre personave që kanë dorëzuar pranë Burimeve Njerëzore të shoqërisë kërkesë për punësim.

-Për 4 punonjës, është shtyrë ndërprerja e marrëdhënieve të punës për punonjës të shoqërisë pas mbushjes së moshës së daljes në pension me mbi 6 muaj, në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 4, e cila përcakton se: “Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në zbatim të dispozitës së mësipërme ligjore, me mbushjen e moshës së daljes në pension, nga UKT duhej kryer ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë dhënë shpërblime në 3 raste (1 rast për festat e fundvitit dhe 2 raste për festën e 8 marsit), vetëm me urdhrat e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, pa u marrë më parë miratimet në Këshillin Mbikëqyrës (Këshillin e Administrimit), në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b.

-Nga auditimi me zgjedhje për 37 dosje personeli u konstatua se: në 5 raste (3 nga këto staf drejtues), mungonte dëshmia e penalitetit; në 4 raste (2 nga këto staf drejtues), mungonte jetëshkrimi (CV); në 4 raste, mungonte adresa e punëmarrësit; në 4 raste (të gjithë staf drejtues), mungonin kërkesat për punësim të punëmarrësit; dhe në 6 raste (të gjithë staf drejtues), mungonte raporti mjekësor që është i aftë për punë për punëmarrësit. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën Kolektive nr. 1902/1, datë 03.06.2013, neni 13 dhe Kontratën Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018, neni 8, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 60-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1- Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike e shoqërisë, të merren masa për përshtatjen e rregullores së brendshme të shoqërisë me kërkesat e Kodit të Punës.

Brenda datës 28.02.2019

3.2- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masat për sistemimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Kontratës Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018.

Brenda datës 31.12.2018 dhe Vazhdimisht

4.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë, u konstatua se:

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstatua se audituesit e pavarur të pasqyrave financiare, nuk kanë dorëzuar dokumentin Letra për Drejtimin e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 4767 prot., datë 08.02.2018.

Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr. 1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA. Nga auditimi i dokumenteve të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar.

-Për llogarinë Aktive Afatgjata Jomateriale përfshin edhe llogarinë “Emri i mirë” në vlerën 717,064 mijë lekë, të njohur nga përthithja e fiskal njësisë “H L” SHA. Gjatë vitit 2017 UKT SHA nuk ka njohur zhvlerësim për këtë zë të bilancit i cili në bazë të SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve” duhet të testohet për vlerën e tij çdo vit.

-Për llogarinë “Aktive Afatgjata Materiale” përfshin vlerën 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorët të AKUK (ish-DPUK). Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga UKT SHA nuk krijohet besueshmëri e arsyeshme në lidhje me vlerën 1,026,003 mijë lekë.

-Për llogarinë “Inventarët” përmban vlerën e materialeve tërësisht apo pjesërisht të vjetruar për shkak të kohës dhe ndryshimeve teknologjike në vlerën 81,275 mijë lekë. Ndërkohë që vlera e zhvlerësimit të inventarëve është 44,017 mijë lekë. Në bazë të SNK 2 “Inventarët” duhet të llogaritet shuma e zhvlerësimit shtesë, por në bazë të dokumentacionit të venë në dispozicion grupi i auditimit nuk mund të llogaritet dhe mund të sillte pasoja mbi vlerën e inventarëve dhe rrjedhimisht në vlerën e rezultatit në pasqyrat financiare të konsoliduara.

-Për Llogari të arkëtueshme me vlerën 2,690,010 mijë lekë konstatohet se UKT SHA ka përdorur si metodologji çmuarjen dhe zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për çdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 39, standard i cili kërkon vlerësim individual për llogaritë e arkëtueshme individualisht dhe vlerësim kolektiv për llogaritë e tjera bazuar në të dhëna të plota historike.

-Për llogarinë “Huamarrje afatshkurtra” në vlerën 1,804,645 mijë lekë, një pjesë e kësaj shume (vlera 1,205,077 mijë lekë) nuk është kontabilizuar në monedhën origjinale por vetëm në lekë dhe për pasojë nuk reflektohen ndryshimet në vlerë si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit në datën 31.12.2017, në kundërshtim me SNK 21 “Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit”.

-Për llogarinë “Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime” me vlerë 465,222 mijë lekë, nga të cilat 463,122 mijë lekë grante afatgjata, 1,777 mijë lekë grante afatgjata rrjet kanalizime dhe 323 mijë lekë grante dhurata pajisje informatike. Nga informacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se është i pamjaftueshëm për shprehjen e një sigurie të mjaftueshme në lidhje me këto vlera.

-Për sa i përket detyrimeve tatimore konstatohet se në datë 28.05.2018 Drejtoria e Përgjithshme ka lëshuar raportin e kontrollit tatimor për periudhën deri në 20.11.2017 (përpara ndarjes së shoqërisë), detyrimi që ka rezultuar nga ky akt kontroll dhe e konfirmuar edhe nga Komisioni të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 është 13,116 mijë lekë. Shoqëria mëmë nuk ka paraqitur në pasqyrat e konsoliduara të datës 31.12.2017 nuk ka reflektuar këtë ngjarje pas datës së bilancit e cila do të ndryshojë rezultatit financiar.

-Në seksionin e kapitalit të shoqërisë mëmë përpara ka qenë e përfshirë rezerva e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë lekë, ndërkohë që me krijimin e shoqërisë së re të UKT SHA pjesa e tepricës së rivlerësimit që i takon kësaj shoqërie i është bashkuar kapitalit aksioner duke e rritur atë. Kjo mënyrë rritje kapitali nuk është e parashikuar në asnjë nga format e rritjes së kapitalit në kundërshtim me Kapitullin Zmadhimi i Kapitalit dhe nenet përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Gjithashtu teprica e rivlerësimit duhet të evidentohet më vete sipas kërkesave të SNK 16 “Aktiveve Afatgjata Materiale” dhe të përdorej në vijim në përputhje me kërkesat e këtij standardi. Ne nuk jemi në përputhje me kërkesat e këtij standardi.

-Bazuar në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare të konsoliduara menaxheriale, raporti i ndarjes së shoqërisë është bazuar mbi pasqyrat financiare të shoqërisë të datës 31.12.2016 (të pa audituara).

-Grupi i auditimit ka shkuar në inspektim në magazinën e UKT SHA në Brar dhe u konstatua se kjo magazine ka një numër shumë të madh artikujsh dhe gjendja dhe organizimi i saj nuk linte mundësinë e identifikimit të artikujve pasi janë pa barkode dhe jo të vendosura nëpër rafta. Grupi i auditimit shpreh rezerva në lidhje me procesin e inventarizimit të kryer në këtë magazine dhe përputhjen e vlerës kontabël (vlerës në bilanc) me atë fizike.

-Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të shoqërisë UKT SHA nuk është pasqyruar vlera e kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakord për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

-Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve mbahen jashtë programit financiar por në Excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël.

-Në magazinat e UKT SHA ka pjesët rezervë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”, të lëna në ambientet e magazinës pa u bërë hyrje, pa u marrë në dorëzim nga përgjegjësi i magazinës dhe pa asnjë dokumentacion dëshmuës. Nuk ka asnjë dokument ku të trajtohet se si janë apo kush i ka sjellë këto materiale, si dhe kush i ka pranuar në magazinë pa kryer veprimet ligjore, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 64-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1- Rekomandimi: Drejtori Ekonomik i Shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen të zbatohet të gjitha nenet e kontratës së lidhur dhe të shqyrtojë të gjitha rekomandimet e lëna nga audituesit e pavarur të pasqyrave financiare si dhe të marrë masa mbi zbatimin e tyre për përmirësimin e paraqitjes me vërtetësi të pozicionit financiar të shoqërisë.

Vazhdimisht

4.2- Rekomandimi: Nga Drejtori Ekonomik i shoqërisë, të merren masa që për periudhat ushtrimore në vazhdim, hartimi i pasqyrave financiare të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Vazhdimisht

4.3- Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për kontabilizimin e vlerës së kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakord për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

Brenda datës 31.12.2018

4.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ndarjes së aseteve të shoqërisë, u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Në statusin e shoqërisë UKT SHA, në nenin 6/6, përcaktohet se ndarja e aksioneve të shoqërisë së re krijuar në bazë të ndarjes së re administrativo-territoriale, është:

- Bashkia Tiranë, 82.5% të aksioneve,
- Bashkia Kamëz, 14.6% të aksioneve,
- Bashkia Vorë, 2.9% të aksioneve.

Me Vendimin nr. 1, datë 18.04.2017, për rishikimin e kushteve të projekt marrëveshjes dhe raportit të ekspertëve për ndarjen e aksioneve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz dhe shoqëria UKT SHA, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007, është vendosur që ndarja e aseteve të shoqërisë, do të kryhet duke u bazuar në numrin e popullsisë, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007.

Ndërsa me Vendimin nr. 03, datë 07.07.2017, për miratimin e projekt marrëveshjes dhe raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria UKT SHA (miratimi paraparak faza I, publikimi në QKB), është vendosur ndarja si më poshtë vijon:

- Bashkia Tiranë 98% të aktiveve të shoqërisë së vjetër,
- Bashkia Kamëz 1.57% të aktiveve të shoqërisë dhe
- Bashkia Vorë 0.43% të aktiveve të shoqërisë.

Siç konstatohet dhe më sipër, Bashkia Kamëz edhe pse zotëronte 14.6 % të aksioneve të shoqërisë para ndarjes, është diskriminuar duke i lënë vetëm 1.57 % të aktiveve.

Me anë të Kërkesë Padisë nr. 34946, datë 10.08.2017, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Bashkia Kamëz ka ankimuar Vendimin nr. 03, datë 07.07.2017, duke mos e pranuar dhe duke mos marrë në dorëzim asetet. Bashkia Kamëz kërkon që ndarja e aseteve të shoqërisë së vjetër, të kryhet në bazë të kriterëve të VKM nr. 660, datë 12.09.2007, ku përcaktohet që ndarja e aseteve të shoqërisë, të kryhet duke u bazuar në numrin e popullsisë, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007.

Me Vendimin e datës 21.03.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë, konkretisht:

-Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimeve datë 07.07.2017, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë UKT sh.a “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

-Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit nr. 08, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë UKT sh.a “Për miratimin e Projekt marrëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

-Konstatimin e pavlefshmërisë së Marrëveshjes së Ndarjes së Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë nr. 08/2 prot., datë 27.09.2017.

-Rrëzimin e kërkesë padisë për konstatimin e pavlefshmërisë të vendimit Nr. 11, datë 31.08.2016, “Për miratimin e modaliteteve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a”,

-Rrëzimin e kërkesë padisë për Kundërshtim të raportit nr. 15367 prot, datë 09.08.2017 të ekspertit të pavarur për vlerësimin e projektit për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, caktimin e një tjetri eksperti për vlerësimin e raportit të ndarjes.

Çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 64-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.4- Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori Ekonomik i shoqërisë, të merren masa që ndarja e aseteve të shoqërisë, do të kryhet duke u bazuar në numrin e popullsisë, bazuar në kriteret e VKM nr. 660, datë 12.09.2007, përcaktuar dhe në Vendimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve nr. 1, datë 18.04.2017, me qëllim që krahas të tjerave të mos kemi diskriminim të Bashkisë Kamëz.

Vazhdimisht

5.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit të kontratave, u konstatua se:

- Nga UKT janë kryer procedura prokurimi, të cilat kanë rezultuar në marrëdhënie kontraktuale me transaksione në vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e vitit ushtrimor, bazuar në vlerën e materialitetit të përlllogaritur (**365,464,680** lekë), deri më tani janë filtruar 9 procedura prokurimi, në vlerën totale 527,585 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pavarësisht nga sa cituam më sipër, nga auditimi i këtyre procedurave u konstatuan, shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon:

-Në 5 raste është konstatuar vendosja e specifikimeve teknike kufizuese për mallrat që do prokurohen, duke mos i argumentuar vendosjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në 6 raste, përlllogaritja e vlerës së kontratës është kryer në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, për arsye se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së OE për studimin e tregut, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE.

-Në 9 raste janë vendosur kërkesa dhe kritere për kualifikim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 20, 26, 27 dhe 28.

-Në 2 raste nuk është argumentuar vendosja e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 9 raste, Raporti Përmbledhës është hartuar në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, për arsye se nuk përmban gjithë informacionin e kërkuar si numër reference, përshkrim i mallrave/shërbimeve/punëve që do prokurohen, si dhe informacion mbi ankesat.

-Në 3 raste procesi i vlerësimit është kryer në tejkalim të afatit kohor prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 2.

-Në 7 raste, procesi i vlerësimit është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 84-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1- Rekomandimi: *Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt.*

Vazhdimisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

6.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi prokurimeve me vlerë të vogël, u konstatua se:

-Për vitin 2017 është konstatuar problematika e copëzimit të fondit për blerje pjesë këmbimi automjetesh ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,618,057.6 lekë dhe për blerje materiale ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,328,659 lekë, veprime këto në kundërshtim me nenin nr. 40 dhe nenin nr. 59, të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si edhe nenin 28 dhe 29/5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

-Në 3 raste për operatorët ekonomik fitues mungon vërtetimi nga OSHEE për mospasjen e asnjë detyrimi të maturuar për pagesën e energjisë elektrike edhe pse nga titullari është konsideruar se mos-dorëzimi i një prej dokumenteve të kërkuara, është kusht për skualifikimin e operatorit fitues, në kundërshtim me DT, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 130-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1- Rekomandimi: *Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të marri masa, që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën me një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.*

Vazhdimisht

7.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua se:

-Nuk është dërguar pranë Ministrisë së Financave deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit të komponentëve të MFK për vitin 2017 nga nëpunësi autorizues në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimeve të Ministrisë së Financave në zbatim të tij.

-Nga Drejtoria Ekonomike nuk konstatohen propozime mbi politikat financiare dhe dërgimi i tyre për miratim, përgatitja e raportit vjetor mbi funksionimin e MFK-së dhe as mbikëqyrja e raporteve financiare që janë përgatitur nga shoqëria, për vitin 2017 në kundërshtim me nenin 159 të rregullores së brendshme të shoqërisë UKT SHA, miratuar me (Miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha nr. 7, datë 04.04.2016) dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 111, datë 24.02.2017 “Për hartimin e planit vjetor të punës për vitin 2017 me afat raportimi 1 mars 2017 për planin dhe regjistrin e riskut.

-Në këtë shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.

-Gjithashtu konstatohet se nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industrial), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja, (Më hollësisht trajtuar në pikën A faqet 23-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1- Rekomandimi: *Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të marrë masa që në vazhdimësi, të informohet stafi drejtues mbi ligjin e MFK dhe komponentëve të tij, të kryhet hartimi i një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik, gjithashtu të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Vazhdimisht

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Tuba dhe Rakorderi”, viti 2018, konstatohet se nga ana e KVO janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), ku me OE “A.” SHPK lidhet kontrata, pavarësisht se ka të njëjtat mangësi për skualifikim me OE “M” LTD SHPK. Për pasojë, **vlera 489,053 lekë**, që përbën diferencën midis OE “M” LTD SHPK të skualifikuar për të njëjtat mangësi që ka OE i shpallur fitues dhe ofertës së “A.” SHPK (dhe që përbëjnë devijime materiale që nuk ndikojnë thelbësisht në zbatimin e kontratës) të shpallur fitues (plus TVSH), përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 dhe neni 53, pika 3 dhe pika 4, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 84-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **489,053 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkëlqet e konstatuara në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje Tuba dhe Rakorderi”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shoqërisë**.

Brenda datës 28.02.2019

2.1 Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje makineri pajisje (automjete)”, viti 2018, konstatohet se z. M.Q, i cili ka qenë në pozicionin e kryetarit të KVO për të dy procedurat, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), në dy procedura të ndryshme, ku të njëjtën mangësi e kualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i linjës DN-150mm gizë dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, ndërsa e skualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje makineri pajisje (automjete)”. Në këto kushte **vlera 180,000 lekë**, që përbën diferencën midis BOE “T.” SHPK & “P.S” SHPK të skualifikuar në kundërshtim me LPP dhe ofertës së OE “L.” SHPK të shpallur fitues, përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA**, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 84-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **180,000 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkëlqet e konstatuara në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje makineri pajisje (automjete)”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shoqërisë**.

Brenda datës 28.02.2019

3.1 Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli fizik i tollonave që mbaheshin në kasafortën e magazinës ishte që nga numërimi i tyre rezultoi se 110 litra naftë, me vlerë 20,108 lekë, ishin të pavlefshëm pasi nuk kishin Bar Code, duke i bërë të pavlefshëm pasi ato nuk pranohen nga pikat e furnizimit. Vlera **20,108 lekë** përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë. Gjithashtu u konstatua se 100 litra nuk ishin të UKT pasi ishin me logo të institucioneve të ndryshme, një fenomen ky i pa justifikuar sesi kanë përfunduar te kasaforta e UKT. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për këto 100 litra naftë me vlerë **18,280 lekë**, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 130-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

3.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **38,388 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në administrimin e karburantit të shoqërisë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Brenda datës 28.02.2019

4.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për kompanitë telefonike ka rezultuar se deri më datën 31.08.2018 kur mbaroj auditimi rezultoi se për UKT Sh.a detyrimi në total ndaj kompanive celulare është **343,241 lekë**, detyrime nga punonjësit e larguar. Kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 130-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1- Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **343,241 lekë**, ndaj punonjësve të larguar për detyrimin e tyre ndaj kompanive celulare, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Brenda datës 28.02.2019

5.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje elektropompë”, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik fitues “A&G” Sh.p.k është 330,000 lekë pa TVSH. Në datën 15.02.2017 është bërë Akt-Kolaudimi për mallin e dorëzuar në ambientet e UKT. Nga shqyrtimi i dosjes të procedurës së prokurimit është konstatuar se me faturën tatimore me nr. 37, datë 15.02.2017 për këtë elektropompë është paguar shifra 365,000 lekë pa TVSH (438,000 lekë me TVSH), kur oferta e OE ishte 330,000 lekë pa TVSH, pra është paguar më shumë dhe në mënyrë të pajustificuar më shumë vlera **42,000 lekë** me TVSH, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e UKT SHA**, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 130-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **42,000 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje elektropompë”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Brenda datës 28.02.2019

C.2. DËM EKONOMIK PA MUNDËSI ARKËTIMI

1.1 Gjetje nga auditimi: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë e paditur, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën 01.04.2017-31.12.2017, janë humbur 112 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 46,099,758.40 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore dhe për periudhën 01.01.2018-31.08.2018, janë humbur 53 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 32,300,969.16 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **78,400,727.56 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi për buxhetin e shoqërisë**.

Gjithashtu konstatohet se janë në proces gjykimi (në Gjykatën e Apelit) dhe 39 çështje të tjera, për të cilat kërkohet vlera **17,602,000 lekë**, vlerë e cila do të rëndojnë akoma më shumë rezultatin ekonomik-financiar të UKT, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 60-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

1.1- Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike e shoqërisë, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Vazhdimisht

C.3. TË ARDHURA TË MUNGUARA PËR SHOQËRINË

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i masave administrative (gjobat) të vendosura dhe arkëtimit të tyre, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë vendosur gjithsej 497 gjoba në vlerën 14,024,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 232 gjoba në vlerën 4,914,000 lekë dhe mbeten pa arkëtuar 265 gjoba në vlerën **9,110,000 lekë**, që përbëjnë 65% të totalit të gjobave të vendosura, duke shkaktuar rritje të mëtejshme të debisë, çka përkthehet në të ardhura të munguara për shoqërinë, (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqet 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Shitjes, të merren masat për përcaktimin e një procedure që do mundësonte arkëtimin e masave administrative (gjobave) të aplikuara, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, duke patur për qëllim përfundimtar uljen e nivelit të debisë.

Brenda datës 30.06.2019 dhe Vazhdimisht

C.4. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1 Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, Këshilli Mbikqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime dhe përkatësisht në datat 06.07.2017, 25.09.2017, 13.12.2017. **Vlera 1,515,600 lekë**, që përbën pagesën e kryer për Këshillin Mbikqyrës për 9 muajt që ky organ kolegjal nuk është mbledhur, përbën **efekt financiar negativ** për UKT SHA, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, pika 8, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 53-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,515,600 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në pagesat e kryera ndaj Këshillit Mbikqyrës, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

Brenda datës 28.02.2019

2.1 Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli tatimor i kryer në UKT Sh.a janë nxjerrë detyrime për TVSH në vlerën 2,000,417 lekë si edhe i është vendosur gjoba me vlerë 611,374 lekë për TVSH e padeklaruar. Janë nxjerrë detyrime mbi tatim fitimin në vlerën 257,579 lekë si dhe është vendosur gjoba me vlerë 150,894 lekë për tatim fitimin e padeklaruar. Janë nxjerrë detyrime mbi tatimin në burim në vlerën 682,030 lekë si dhe është vendosur gjoba me vlerë 657,736 lekë për tatimin e mbajtur mbi burim dhe të padeklaruar. Shuma prej **1,420,004 lekë**, paguar për gjobat dhe interesat e vonuara kanë shkaktuar **efekt financiar negativ** për UKT, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 130-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Tiranë.

2.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,420,004 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me gjobat e aplikuara nga kontrolli tatimor, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

Brenda datës 28.02.2019

3.1 Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në magazinën e UKT është konstatuar një sasi e konsiderueshme litar amianti e cila ishte e papërdorur asnjë herë nga UKT. Në vitin 2011 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 1,200 kg litar amianti me vlerë 1,170,000 lekë. Deri më datën 20.10.2017, kur ky mall është propozuar për jashtë përdorimit, nga sasia prej 1,200 kg janë përdorur vetëm 72 kg. Mos përdorimi i këtij produkti ka bërë që në magazinë të jenë në gjendje stoku 1,128 kg në vlerën **1,104,280 lekë**, vlerë kjo e cila ka sjellë **efekt negativ financiar** për buxhetin e UKT SHA, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 130-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,104,280 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me vlerën e litarit të amiantit të prokuruar në vitin 2011 dhe të papërdorur, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

Brenda datës 28.02.2019

4.1 Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Software (program) dhe pajisje për leximin e matësive të ujit, për UKT sha”, viti 2017, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, është konstatuar **efekt financiar negativ me vlerë 7,872,000 lekë**, që i përket zërit të pajisjeve “**Telefona për aplikacionin**”, të prokuruar me anë të kësaj procedure, me arsyetimet si më poshtë vijon:

-Sipas pikës 3.3 të nenit 3, të kontratës së shërbimit nr. 4050/7, datë 22.05.2017, specifikimet teknike kërkuara për këtë pajisje janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

-Sipas dokumentacionit teknik (katalogët) të paraqitur nga OE “J.S” SHPK, konstatohet se produkti i kërkuar nuk është i njëjtë për 1 kriter (dimensionet) me produktin e ofruar, si dhe për 3 kritere nuk provohet përputhshmëria duke qenë se nuk ka të dhëna për to në produktin e ofruar.

-Pajisjet e ardhura janë të markës “U..”, model “A..”, nga krahasimi i të dhënave teknike të këtyre pajisjeve nga faqja zyrtare e shoqërisë (<http://U...com/products/A../spec.html>), me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë, konstatohet se:

- Dimensionet e kërkuara për produktin janë 142.5 mm*75mm*13mm, ndryshojnë nga dimensionet për produktin e ofruar janë 148.9*75.8*12.5 mm, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
- Për 3 specifikime të kërkuara (Operating Temp.; Storage Temp.; dhe Ekstra), nuk konstatohen të dhëna në katalog, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
- Për të dhënat e Network, pajisja e ofruar nuk disponon 4G – 700 MHz.
- Pajisja e ofruar nuk konstatohet të disponojë “Distance Sensor”.

-Në Akt-Kolaudimin nr. 276/1, datë 25.05.2017, grupi i marrjes në dorëzim të kontratës, nuk është shprehur në asnjë moment për të dhënat që ndryshonin dhe mungonin në katalogun e ofruar.

-Këto pajisje kanë mbi 1 vit që përdoren nga UKT.

-Me anë të observacioneve të dërguara me shkresën nr. K-4272/14, datë 16.11.2018, në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH, titullari i AK me Urdhrin nr. 521, datë 20.10.2018, ka ngritur një grup të ri kolaudimi, i cili me anë të relacionit nr. 4521/1, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjetës Kanalizime” SHA, Tiranë.

29.10.2018, ka vendosur që edhe pse ka mos përputhje për specifikimet teknike të konstatuara nga grupi i auditimit, ato janë të papërfillshme dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin dhe performancën e pajisjeve të prokuruar, si dhe që nga momenti i blerjes dhe deri më këtë datë, aparaturat kanë qenë në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, duke qenë se leximet mujore kryhen pikërisht nga këto aparatura, (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 84-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1- Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë të shqyrtojë vlerën 7,872,000lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Blerje Software (program) dhe pajisje për leximin e matësave të ujit, për UKT sha”, viti 2017, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 28.02.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

V. ANEKSE

ANEKSI I:

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, në vlerën 365,464,680 lekë për tu konsideruar për vitin 2017, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Niveli i materialitetit për vitin 2017, është përlogaritur si vijon:

Materialiteti 2015

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës
Paga (600)	800,792,022
Sigurime Shoqërore (601)	129,390,000
Mallra e Shërbime (602)	1,857,727,978
Investime të brendshme (230-231)	1,092,430,000
Të tjera transfertë korrente (606)	0
Total	3,880,340,000
<i>Materialiteti në %</i>	<i>2%</i>
Materialiteti në vlerë	77,606,800
<i>Kalkulimi i precizionit</i>	
Materialiteti	77,606,800
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	7,760,680
Nëntotali	69,846,120
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	<i>90%</i>
Vlera e precizionit	62,861,508



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës
Kanalizime” SHA, Tiranë.

ANEKSI II: LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Baza për Opinionin

a. Manuali i auditimit financiar të KLSH.

Audituesi duhet të shprehë një *opinion të pamodifikuar* mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

Një *opinion i pakualifikuar (pa rezervë)* jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinion i me rezervë. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose
2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Opinion negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT PROJEKT RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË.

ANEKSI III:

SNA (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit)
(ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”)

Krijimi i opinionit dhe raporti mbi pasqyrat financiare

143. Audituesit duhet të krijojnë një opinion të bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga provat e marra gjatë auditimit, nëse pasqyrat financiare si tërësi janë përgatitur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Opinionit duhet të shprehet qartë në një raport nënshkrim që përshkruan gjithashtu kriteret mbi të cilat është bazuar opinionit.

144. Objektivat e auditimit financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa shprehja e opinionit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. Mandati i auditimit ose legjislacioni, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave të qeverisë apo rezolutat nga legjislativi, mund të përfshijnë objektiva të tjera që kanë të njëjtën rëndësi sikurse opinionit mbi pasqyrat financiare. Këto objektiva shpesh mund të përfshijnë përgjegjësitë për auditimin dhe raportimin përpara i takon p.sh., gjetjeve të mospërputhjes me kompetencat.

Megjithatë edhe kur nuk ka objektiva të tjera të përcaktuara, mund të ketë pritshmëri të gjerë të publikut në lidhje me raportimin e mospërputhjes me kompetencat ose efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

145. Audituesit që kanë përgjegjësinë e raportimit mbi përputhshmërinë ose mospërputhshmërinë me kompetencat mund të marrin në konsideratë Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë dhe udhëzuesit përkatës.

146. Në mënyrë që të krijojnë një opinion, audituesi duhet së pari të konkludojë nëse ka siguri të arsyeshme, që pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë ndaj mashtrimit ashtu edhe gabimit.

Në konkluzionet të tilla duhet të mbahet parasysh:

- Nëse është marrë evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme;
- Nëse gabimet e pakorrigjuara janë materiale, veç e veç ose në total; dhe
- Vlerësimet e audituesit në lidhje me çështjet e mëposhtme, të cilat janë marrë parasysh në përcaktimin e formës së opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, duke përfshirë shqyrtimin e aspekteve cilësore të praktikave kontabël të njësisë ekonomike, të tilla si mundësia e njëanshmërisë në gjykimet e menaxhimit;

- Nëse pasqyrat financiare shfaqin mjaftueshëm politikat kryesore kontabël të zgjedhura dhe të zbatuara;

- Nëse politikat kontabël të zgjedhura dhe të zbatuara janë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe janë të përshtatshme;

- Nëse vlerësimet e kontabilitetit të bëra nga menaxhimi janë të arsyeshme;

- Nëse informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare është relevant, i besueshëm, i krahasueshëm dhe i kuptueshëm;

- Nëse pasqyrat financiare japin informacione shpjeguese të mjaftueshme për t'i mundësuar përdoruesit të kuptojnë efektin e transaksioneve materiale dhe ngjarjeve në informacionin e shprehur në pasqyrat financiare;

- Nëse terminologjia e përdorur në pasqyrat financiare, duke përfshirë titullin e çdo deklaratë financiare, është e përshtatshme;

- Nëse pasqyrat financiare i referohen ose përshkruajnë mjaftueshëm kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT PROJEKT RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË.

- d) Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me dispozitat e paraqitjes drejtë, konkluzionet gjithashtu duhet të argumentojnë nëse pasqyrat financiare janë paraqitur drejtë:
- në aspektin e paraqitjes së përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen;
 - nëse pasqyrat financiare, duke përfshirë edhe shënimet përkatëse, paraqesin në mënyrë të drejtë transaksionet dhe ngjarjet.

Krijimi i opinionit

147. Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar, nëse konstatohet se pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën financiare në fuqi.

Nëse audituesi konkludon se, në bazë të evidencave të marra të auditimit, pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, ose nuk është në gjendje për të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në përfundim që pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, audituesi duhet të modifikojë opinionin në raportin e audituesit në përputhje me seksionin mbi "*Përcaktimin e llojit të modifikimit të opinionit të audituesit*".

148. Në qoftë se pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kërkesat e një kornize të drejtë prezantimi, nuk arrijnë të japin paraqitje të drejtë, audituesi duhet të diskutojë çështjen me menaxhimin dhe, në varësi me kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar dhe se si është zgjidhur çështja, të përcaktojë nëse është i nevojshëm modifikimi i opinionin e auditimit.

Elementët e kërkuar në raportin e audituesit

149. Raporti i audituesit duhet të shkruhet sipas formës dhe të përmbajë elemente të mëposhtme:

- Një titull që tregon qartë se ky është raporti i një audituesi të pavarur;
- Kujt i adresohet, siç kërkohet nga rrethanat e angazhimit;
- Një paragraf hyrës që:
 - (1) identifikon deklaratat financiare të cilit subjekt janë audituar;
 - (2) përcakton që pasqyrat financiare janë audituar;
 - (3) identifikon titullin e çdo deklarate që përfshihet në pasqyrat financiare;
 - (4) i referohet përmbledhjes së politikave të rëndësishme kontabël dhe informacioneve të tjera shpjeguese dhe
 - (5) specifikon datën apo periudhën e mbuluar nga çdo deklaratë financiare në përbërje të pasqyrave financiare;

Një seksion me titullin "Përgjegjësia e Menaxhmentit për pasqyrat financiare", duke deklaruar se menaxhimi është përgjegjës për pasqyrat financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit;

Një seksion me titullin "Përgjegjësia e Audituesit", duke deklaruar se përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion të bazuar në auditimin e pasqyrave financiare, duke përshkruar auditimin për sa i përket procedurave të përfshira për të marrë evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare, procedurat e përzgjedhura në varësi të gjykimit të audituesit të tilla si, ndër të tjera, riskun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e riskut, audituesi duhet të marrë parasysh kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe projektimin të procedurave të kontrollit që janë të përshtatshme për rrethanat e njesisë ekonomike. Ky seksion duhet të referohet gjithashtu vlerësimit të përputhshmërisë së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT PROJEKT RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË.

politikave kontabël të përdorura dhe arsyetimin e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhimi, si dhe paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare. Ai duhet të përcaktojë nëse audituesi beson se evidenca e marrë gjatë auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të qenë bazë për opinionin e audituesit;

-Një seksion me titullin "**Opinion**", në të cilin duhet përdorur një nga shprehjet ekuivalente të mëposhtme, kur shprehet për një opinion të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të drejtë prezantimit:

- *pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, ... në përputhje me... [kornizën e zbatueshme të raportimit];*
ose

- *pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të... në përputhje me [kornizën e zbatueshme të raportimit financiar].*

Kur shprehet opinion i pandryshuar mbi pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kuadrin e përputhshmërisë, opinionin e audituesit duhet të jetë që pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me [kornizën e zbatueshme të raportimit financiar].

Nëse referenca me kornizën e aplikueshme të raportimit financiar nuk është në IPSAS ose IFRS-t, (SNRF) opinionin e audituesit duhet të identifikojë juridiksionin origjinës së kuadrit.

- Nëse kërkohet, ose siç përcaktohet nga audituesi, një seksion me titullin "*Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore*" ose ndryshe, si të përshtatshme për përmbajtjen e seksionit, duhet të adresojë përgjegjësi të tjera në raportin e audituesit për pasqyrat financiare që janë të detyrueshme për të raportuar në pasqyrat financiare;

- *Nënshkrimi i audituesit;*

- *Data në të cilën audituesi ka marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në të cilat bazohet opinionin e audituesit për pasqyrat financiare, duke përfshirë evidenca që:*

-*Janë përgatitur të gjitha deklaratat që përbëjnë pasqyrat financiare, duke përfshirë edhe shënimet përkatëse; dhe*

-*Personat me autoritet të njohur kanë pohuar se ata të marrin përgjegjësinë për pasqyrat financiare;*

-*Enti në juridiksionin ku audituesi vepron.*

150. Përveç opinionit, audituesit mund t'i kërkohet me ligj ose rregullore të raportojë vërejtjet dhe gjetjet, të cilat nuk kanë ndikuar në opinion dhe çdo rekomandim të bërë si rezultat i tyre. Këto elemente duhet të jenë qartësisht të ndara nga opinionin.

Modifikimet e opinionit në raportin e audituesit

151. Audituesi duhet të modifikojë opinionin në raportin e audituesit nëse konstatohet se, në bazë të evidencës së marrë gjatë auditimit, pasqyrat financiare si tërësi nuk janë pa gabime materiale, ose në qoftë se audituesi nuk ishte në gjendje të merrte evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale.

Audituesit mund të hartojë tri lloje të mendimeve të modifikuara:

një *opinion të kualifikuar*,

një *opinion të negativ* dhe

të refuzojë opinionin.

Përcaktimi i llojit të modifikimit në opinionin e audituesit

152. Vendimi në lidhje me llojin e opinionit modifikuar që është i përshtatshëm varet nga:

- *Natyra e çështjes që shkakton modifikimin - që është, nëse pasqyrat financiare janë me gabime materiale, ose, në rast se ka qenë e pamundur për të marrë evidenca të*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
UJËSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË.

mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mund të jetë deklaruar gabim në mënyrë materiale; dhe

- Gjykimi i audituesit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme të çështjes në pasqyrat financiare.

153. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar në qoftë se:

(1) ka marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, audituesi konkludon se gabimet individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në pasqyrat financiare; ose

(2) audituesi nuk ishte në gjendje për të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, bazë për një opinion, por arrin në përfundimin se efektet mbi pasqyrat financiare të çdo gabimi të pazbuluar mund të jetë materiale por jo të përhapura.

154. Audituesi duhet të shprehë një opinion negativ, nëse, pasi ka marrë evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, audituesi konkludon se gabimet më vete ose së bashku, mund të jenë si materiale ashtu dhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Audituesi duhet të refuzojë një opinion nëse, duke mos qenë në gjendje të marrë evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme bazë për opinionin, audituesi konkludon se efektet mbi pasqyrat financiare të çdo gabimi të pazbuluar mund të jenë materiale dhe të përhapura. Në qoftë se, pas pranimit të angazhimit, audituesi bëhet i vetëdijshëm se menaxhimi kavendosur kufizime në fushëveprimin e auditimit që audituesi i konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar oserefuzim të një opinionin mbi pasqyrat financiare, audituesi duhet të kërkojë që menaxhimi të heqë kufizimin.

156. Në qoftë se shprehet një opinion i modifikuar i auditimit, audituesi duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit të shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që përdoret kur jepet një opinion i modifikuar dhe përshkrimin e përgjegjësisë së audituesit.

Paragrafët "Theksim i çështjes" dhe paragrafët "Çështje të tjera" në raportin e audituesit:

157. Nëse audituesi konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve për një çështje të paraqitur ose zbuluar në pasqyrat financiare, që është e një rëndësie themelore për të kuptuar pasqyrat financiare, por ka evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme që çështja nuk është gabim materiale në pasqyrat financiare, audituesi duhet të përfshijë ato në paragrafin "Theksimi i çështjes" në raportin e audituesit. Paragrafët "Theksim i çështjes" duhet t'ireferohet vetëm informacionit të paraqitur ose të zbuluar në pasqyrat financiare.

158. Paragrafi "Theksim i çështjes" duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;

- të përdorë titullin "Theksim i çështjes" ose ndonjë titull tjetër të duhur;

- të përfshijë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se ku mund të gjenden në pasqyrat financiare informacionet shpjeguese përkatëse që përshkruajnë plotësisht çështjen;

- të tregojë se opinionin e audituesit nuk është i modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse audituesi e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose zbuluar në pasqyrat financiare, e cila në gjykimin e audituesit, është e rëndësishme për tu kuptuar auditimin nga përdoruesit dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, kjo duhet të bëhet në një paragraf me titullin "Çështje të tjera" ose në një tjetër titull të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe çdo paragrafi të "Theksimit të çështjes".

160. Nëse audituesi dëshiron të përfshijë të dy këto paragrafë në raportin e auditimit, audituesi duhet t'ia komunikojë këtë pritshmëri dhe formulimin e paragrafëve të tilla të ngarkuarit me qeverisje. Audituesit gjithashtu mund ti kërkojë ose të vendosë të njoftojë palët e tjera, të tilla si ligjvënësi, përveç atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT PROJEKT RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË.

161. Mandatet e auditimit të sektorit publik apo pritshmërinë mund të zgjerojnë rrethanat në të cilat mund të jetë e rëndësishme përfshirja e paragrafit “*Theksimi i çështjes*” (lidhur me një çështje për të dhënë informacion shpjegues për pasqyrat financiare), ose një paragraf “*Çështje të tjera*” (në lidhje me informacionin që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare).

ANEKSI IV: DOKUMENTIMI I LËVIZJES SË AKTIVEVE.

(Bazuar në UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

-Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje,pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

-Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues- janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomike që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit,etj.

b. Dokumente vërtetues-vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet,faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandatarkëtimet, mandatpagesat,procesverbalet, dhe akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit janë dokumentet përmbledhës ose regjistrat kontabël(libri i madh,librat analitike,kartelat e aktiveve,etj)të çdo lloj forme,bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera,të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit,datën dhe vendin e kryerjes,objektin,treguesit sasiore dhe ato të vlerës,personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime,të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime,harresa,numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.

-Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse,të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri,pasi të jetë bërë qëparë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve,referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).

-Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit,fletëkërkesës,planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njëjsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

-Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje,pasqyrohen me dokumente të përkohshme,por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

-Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletëhyrjet,faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletëdaljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publik e në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.

-Në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesit e përdoruesit (p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (psh në magazinën qendrore të njësisë publike).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
UJËSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË.

Në këtë rast duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve.

GRUPI I AUDITIMIT

A.G

I.S

J.Zh

A.A

KONTROLI I LARTË I SHTETI